

**VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT
TË PREFEKTIT TË QARKUT
GJIROKASTËR**

Janar 2019



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT GJIROKASTËR**

**VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT TË
PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR**

2019

Janar 2019

PËRMBAJTJA

Faqja

I. Hyrje e Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë	3
II. Organika e Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë	4
III. Administrata e Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë	5
IV. Aktivitetet e Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë	11
V. Fjalimet Përshëndetëse të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë	105

Hyrje

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë është organi përfaqësues i Këshillit të Ministrave në njësinë administrativo-territoriale Qarku Gjirokastrë, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 115/2014 *“Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të Vetëqeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë”*.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, me seli në qytetin Gjirokastrë është krijuar në bazë të VKM nr.373, datë 26.03.1993 dhe funksionon në përputhje me ligjin nr. 107/2016 *“Për Prefektin e Qarkut”*.

Në Prefekturën e qarkut Gjirokastrë përfshihen shtatë bashki: Bashkia Gjirokastrë, Bashkia Dropull, Bashkia Libohovë, Bashkia Tepelenë, Bashkia Memaliaj, Bashkia Përmet dhe Bashkia Këlcyrë.

Brenda juridiksionit të institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë funksionojnë shtatë bashki, si niveli i parë i Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshilli i Qarkut si niveli i dytë i Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore.

Parimet e organizimit dhe funksionimit të Institucionit të Prefektit bazohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 107/2016 *“Për Prefektin e Qarkut”*, në legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në akte ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Ministrave, të cilat ndihmojnë në veprimtarinë e tij mbikqyrëse, kontrolluese dhe bashkërenduese në veprimtarinë e degëve territoriale e institucioneve të tjera shtetërore si dhe veprimtarinë e tyre me organet e njësisve të Vetëqeverisjes Vendore, duke pasqyruar parimet themelore të qeverisjes vendore.

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë në mbështetje të misionit dhe rolit që ka në rajon, ka si objekt pune verifikimin administrativo-ligjor të akteve të organeve të Vetëqeverisjes Vendore, kontrollin ligjor, monitorimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së degëve territoriale, institucioneve shtetërore në nivel vendor, midis tyre edhe me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të rajonit si dhe përgjigjet para Këshillit të Ministrave për detyrat që i janë ngarkuar dhe për zbatimin e politikës qeveritare në qarkun e Gjirokastrës.

Në institucionin e Prefektit të qarkut, për ushtrimin e funksioneve dhe plotësimin e përgjegjësisve e të detyrave, Prefekti ka aparatit e tij administrativ.

Struktura dhe numri organik i punonjësve të institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, miratohet me Urdhër të Kryeministrit *“Për miratimin e strukturës dhe organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Gjirokastrë”*.

ORGANIKA E ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

- I. PREFEKTI
- II. SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
- III. NËNPREFEKTI (2)
- IV. SEKTORI JURIDIK
- V. SEKTORI I MONITORIMIT TË KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA
- VI. SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN
- VII. SEKTORI I PLANIFIKIMIT, PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE
- VIII. SEKTORI I FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE





Fig. 1. Struktura e Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër

Bazuar në VKM-në nr. 1269, datë 17.09.2008 “Për përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe detyrat e përgjegjësitë e strukturave shtetërore, të ngarkuara për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar, në varësi të Prefektit të qarkut Gjirokastra deri më 31 dhjetor 2018 ka funksionuar Drejtoria e Verifikimit të Titujve të Pronësisë. Kjo drejtori rregullonte veprimtarinë e saj bazuar në VKM-në nr. 1269, datë 17.09.2008, të ndryshuar dhe i përgjigjej rregullores së brendshme të institucionit të Prefektit.

ADMINISTRATA E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR



SEKTORI JURIDIK



PËRGJEGJËS SEKTORI
ZNJ. SILVANA SHEHU




SPECIALIST JURIST
Z. EDMOND GJOKA

SEKTORI I
ZHVILLIMIT URBAN



PËRGJEGJËS SEKTORI
Z. VASIL SHUNDRI



SPECIALIST PËR
MBROJTJEN E
MJEDISIT
ZNJ. EDLIRA SHEHU

SEKTORI I
MONITORIMIT TË
KOMPETENCAVE
VENDORE DHE
FUNKSIONEVE TË
DELEGUARA



PËRGJEGJËS SEKTORI
Z. ERION XHAXHIU



SPECIALIST PËR
KOORDINIM
ZHVILLIMIN
ZNJ. ARJETA PAÇELI



SPECIALIST PËR
SHËRBIMET PUBLIKE
Z. GENTIAN KOTONI



SPECIALIST PËR
SIGURINË PUBLIKE DHE
SHËRBIMIN ZJARRFIKËS
ZNJ. NERTILA MENI



SPECIALIST PËR
ARSIMIN, TURIZMIN,
SHËNDETËSINË
ZNJ. BEJRE KURRA



SPECIALIST PËR
FUNKSIONET E
DELEGUARA
ZNJ. AFISA BRAHIMI

SEKTORI I
PLANIFIKIMIT,
PËRBALLIMIT TË
EMERGJENCAVE
CIVILE DHE KRIZAVE



PËRGJEGJËS SEKTORI
Z. THOMA KOTE



SPECIALIST I
EMERGJENCAVE CIVILE
DHE KRIZAVE
Z. MUHARREM GUÇE




SPECIALIST I
EMERGJENCAVE CIVILE
DHE KRIZAVE
Z. FADIL GUÇI

KOMISIONI VENDOR I
VLERËSIMIT TË
TITUJVE TË PRONËSISË



DREJTOR
ZNJ. ZILIHAN DANAJ



SPECIALIST JURIST
Z. MIKEL LATIFI



TEKNIK TOPOGRAF
Z. SHEFQET ALIKAJ

SEKTORI I FINANCËS
DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE



PËRGJEGJËS SEKTORI
Z. KLODIAN KORE



SPECIALIST FINANCE
Z. NIKOLLA KONOMI



SPECIALIST PËR BURIMET
NJERËZORE DHE
MARRËDHËNIET ME
PUBLIKUN
ZNJ. VASILIKA PAPA



SPECIALIST ARKIVË-
PROTOKOLL
ZNJ. EVIOLA LAPA



SHOFER
Z. LEFTER TARE



SANITARE
ZNJ. NEZAQET KOÇI

ZYRAT E GJENDJES
CIVILE



SPECIALIST I GJENDJES
CIVILE GJIROKASTËR
ZNJ. PAVLINA KORBECI



SPECIALIST I GJENDJES
CIVILE TEPELENË
Z. LAERT RAMA



SPECIALIST I GJENDJES
CIVILE PËRMET
ZNJ. PRANVERA LAPAJ

AKTIVITETET E INSTITUCIONIT TË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

04.01.2019

Sipas parashikimeve të IGJEUM për shkak të temperaturave të ulëta (dt. 04. -5 -1; dt. 05. -9 -3; dt. 06 -7 -1; dt 07. -7 -2), me pasojë ngrica dhe rreshje dëbore, qarku i Gjirokastrës është përballur me situata të pazakonta sidomos për qarkullimin e mjeteve, lëvizjen e qytetarëve, furnizimin me ujë, ngrohjen dhe problematika të tjera.

Duke marrë shkas nga parashikimet, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë, në rolin e drejtuesit të Shtabit të Emergjencave Civile dhe Krizave, i është drejtuar të gjithë banorëve të qarkut që të tregohen të kujdesshëm gjatë qarkullimit me mjete dhe të raportojnë çdo rast emergjent të mundshëm në numrin 129 të Drejtorisë Vendore të Policisë, në numrin 128 të sektorit të Zjarrfikëses dhe pranë sektorëve të emergjencave civile në bashkitë dhe njësitë administrative të qarkut. Institucioni i Prefektit të qarkut ka qënë disponibël për çdo problematikë apo shqetësim të mundshëm të krijuar përgjatë atyre ditëve të pazakonta.



07.01.2019

Qarku i Gjirokastrës ka qënë i përfshirë nga moti i paqëndrueshëm, me rreshje dëbore, ngrica dhe temperatura të ulëta.

Si rrjedhojë e kësaj situatë institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë në rolin e kryetarit të Shtabit të Emergjencave Civile dhe Krizave, ka marrë të gjitha masat dhe ka koordinuar veprimet me njësitë e vetëqeverisjes vendore të qarkut dhe institucionet shtetërore për kalimin pa problem të situatave me të cilat është përballur qarku jonë gjatë ditëve të fundit. Situata në qarkun e Gjirokastrës është paraqitur si më poshtë:

Në bashkinë Libohovë në Nj. Ad. Zagorie nuk ka patur vështirësi të qarkullimit të automjeteve por për disa pjesë qarkullimi është bërë me zinxhirë. Në bashkinë Dropull nuk janë paraqitur probleme.

Në bashkinë Gjirokastrë në Nj. Ad. Cepo rruga Taroninë – Fushëbardhë kalimi është bërë vetëm me zinxhirë. Në Nj. Ad. Picar rruga Kolonjë - Golem një pjesë ka qënë e kalueshme me zinxhirë. Në bashkinë Memaliaj nuk ka patur probleme në qarkullim.

Në bashkinë Tepelenë, në Nj. Ad. Kurvelesh kalimi i mjeteve është bërë me zinxhirë. Rrugët nacionale kanë patur një qarkullim normal me përjashtim të aksit Erind - Çajup, i cili në disa pjesë është bërë i kalueshëm me zinxhirë.

Në bashkinë Përmet në Nj. Ad. Frashër (Mican, Vercisht, Zavalan, Ogren) qarkullimi i mjeteve është bërë me vështirësi (me zinxhirë) për shkak të ngricave në rrugë. Në bashkinë Këlcyrë ka patur vështirësi në qarkullim në zonën e Malëshovës (Malëshovë, Limar, Leskaj).

Është bërë me dije se për 24 orët e ardhshme do të ketë një mot të qëndrueshëm por me temperatura të ulëta. Të gjithë banorët e qarkut duhet të tregohen të kujdesshëm gjatë qarkullimit me mjete dhe në levizjet e tyre të përditshme.



08.01.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrër z. Astrit Aliaj ka inspektuar nga afër disa nga shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qarkut për të parë gjendjen e kushteve për ngrohjen në klasa dhe ambientet përreth.

Në shkollën 9-vjeçare “Së bashku” në lagjen “Zinxhira” të qytetit të Gjirokastrës, klasat kanë qënë të pajisura me ngrohje (soba me dru) të cilat punonin me kapacitet të plotë.

Në Njësinë Administrative Lazarat, në shkollën fillore “Baba Rexhepi” dhe shkollën e mesme “Muhamet Gjollësia” klasat kanë qënë të pajisura gjithashtu me ngrohje pavarësisht mungesave në nxënës për shkak të temperaturave jo të favorshme për ndjekjen e lëndëve mësimore.

Gjithashtu, Prefekti i qarkut ndoqi edhe vazhdimin e punimeve në segmentin rrugor Postobllok - Kordhocë nga firma Salillari. Nga inspektimi i bërë është vënë re se po punohet për përfundimin e bankinave anësore në segmentin rrugor Kordhoc - Dervician si dhe për përfundimin e sinjalistikës horizontale dhe asaj vertikale.



10.01.2019

Zhvillimi i mbledhjes së jashtëzakonshme e Komisionit të Planifikimit të Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave për të diskutuar mbi situatën e vështirë në të cilën është gjendur qarku i Gjirokastrës si pasojë e rënies së reshjeve të dëborës.

Prefekti i qarkut Gjirokastrër z. Astrit Aliaj, në cilësinë e Kryetarit të KPPECK, ka kërkuar një raport të hollësishëm nga ana e kryetarëve të njësive vendore dhe degëve territoriale për masat e marra mbi minimizimin e të gjitha situatave problematike që janë krijuar në qarkun e Gjirokastrës.

Nisur edhe nga problematikat, shqetësimet dhe telefonatat e banorëve, sidomos të disa barinjve të cilët janë gjendur në një situatë të vështirë për sa i përket rezervave të bazës ushqimore, Prefekti i qarkut ka dhënë një sqarim për gjithë opinionin publik se këto problematika së pari duhet të adresohen pranë bashkive të qarkut me qëllim zgjidhjen e tyre. Kur njësitë vendore e kanë të pamundur dhënien e ndihmës për këta banorë, atëherë këto njësi duhet ti drejtohen institucionit të Prefektit të qarkut për të kërkuar ndihmë pranë institucioneve qendrore dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka dhënë rekomandimet përkatëse për të gjitha institucionet shtetërore, degët territoriale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore të qarkut.

1. Kryetarët e Komisioneve Vendore të bashkive duhet të aktivizojnë të gjitha forcat dhe mjetet që disponojnë për përballimin e situatës së krijuar. Të kontaktojnë me subjektet private dhe konform ligjit të Emergjencave Civile, ti angazhojnë ato për hapjen e rrugëve rurale;
2. OSSHE të marrin të gjitha masat për furnizimin e pandërprerë me energji elektrike;
3. Autoriteti Jugor Rrugor të intensifikojë punën për pastrimin e rrugëve duke mundësuar qarkullimin e lirshëm të mjeteve. Për situatën në vazhdim të hedhin skorje dhe kripë;
4. Drejtorja e Policisë Vendore të marrin masat për qarkullimin e mjeteve me zinxhirë;
5. DAR të marrin të gjitha masat për sigurimin e ngrohjes në shkolla, lëvizjen e nxënësve dhe mesuesve, në bashkëpunim edhe me kryetarët e bashkive;

6. Drejtorja e Shëndetit Publik të marrin masat për garantimin e kushteve normale në spitale dhe qendrat shëndetësore;

7. Specialistët e Emergjencave Civile në të gjitha bashkitë të monitorojnë gjendjen dhe të mbajnë kontakte të vazhdueshme me administratorët e njësisë administrative, duke raportuar informacione të sakta pranë institucionit të Prefektit të qarkut

8. Me qëllim përballimin me sukses të situatës së krijuar, ti jepet prioritet jetës së banorëve, gjësë së gjallë dhe normalizimit të situatës në qark.

Në përfundim të këtij takimi, Prefekti i qarkut ka kërkuar angazhimin maksimal të çdo anëtarit të Komisionit të KPPECK, intensifikimin e masave mbrojtëse dhe monitorimin e pandërprerë të situatave për përballimin me sukses të gjendjes së rënduar të krijuar në qark.



10.01.2019

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë, në cilësinë e drejtuesit të KPPECK, ka ndjekur dhe monitoruar nga afër situatën emergjente të krijuar gjatë atyre ditëve në të gjithë territorin e qarkut.

Si pasojë e angazhimit të institucioneve vendore dhe degëve territoriale, është bërë e mundur ndërhyrja në disa rrugë të brendshme të qytetit të Gjirokastrës dhe Libohovës.

Me angazhimin konkret të ARRSH-së është bërë e mundur hapja e segmenteve rrugore Ura e Kardhiqit - Kardhiq - Kakodhiq, segmentit rrugor Postbllok - sheshi “Çerciz Topulli”, segmentit rruga nacionale - Zinxhira, unaza e qytetit - lagjja “Granica” - kalceto - rruga nacionale.

Problematike kanë qënë rrugët e njësive administrative Picar, Cepo, Zagorie, Kurvelesh dhe Frashër për të cilat është parashikuar një ndërhyrje nga ana e atyre njësive për orët në vazhdim.

Për njësitë vendore është dhënë si detyrë një angazhim maksimal për ndërhyrjen e menjëhershme në këto zona dhe në pamundësi të ndërhyrjes ti drejtohen institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë dhe nëpërmjet tij, Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile me qëllim eliminimin e rasteve emergjente dhe ardhjen në ndihmë të personave të prekur nga këto situata.



11.01.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z.Astrit Aliaj nëpërmjet një shkrese zyrtare, nisur nga situata e rënduar si pasojë e rënies së reshjeve të dëborës në të gjithë territorin e qarkut si dhe vështirësive të krijuara në qarkullimin e mjeteve dhe lëvizjen e banorëve, ka kërkuar nga ana e drejtuesve të institucioneve vendore dhe degëve territoriale angazhimin e tyre maksimal dhe të personelit që ata drejtojnë për pastrimin e territorit të institucioneve nga dëborë deri në bashkimin me rrugën kryesore për ti dhënë mundësi komunikimi të gjithë qytetarëve që kanë problematika me këto institucione.

Gjithashtu është kërkuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale të marrë të gjitha masat për pastrimin e rrugëve hyrëse në institucionet arsimore (shkollat 9-vjeçare dhe të mesme) për të bërë të mundur lëvizjen e sigurtë të nxënësve dhe fillimin sa më parë të procesit mësimor.

Si rezultat i angazhimit të të gjitha institucioneve është bërë e mundur hapja e rrugëve nga dëborë në institucionet arsimore dhe institucionet vendore, duke bërë të mundur normalizimin e lëvizjes së banorëve dhe nxënësve për fillimin e procesit normal mësimor në të gjitha shkollat e qarkut.



14.01.2019

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka monitoruar dhe ka bashkërenduar veprimtarinë e njësive vendore dhe të degëve territoriale për normalizimin e situatës të krijuar si pasojë e reshjeve të dëborës në të gjithë territorin e qarkut Gjirokastrë.

Gjendja është paraqitur problematike si më poshtë:

Në lagjet e sipërme të qytetit të Gjirokastrës ku dhe lëvizja e mjeteve e këmbësorëve është bërë më me vështirësi për shkak të ngricave.

Në Nj. Administrative Picar problem ka patur aksi rrugor Kolonjë – Golem ku është punuar për hapjen e rrugës.

Është punuar gjithashtu në terren me fuqi punëtore të agjencisë së shërbimeve pranë bashkisë për normalizimin e situatës duke hedhur kripëra dhe skorje.

Në bashkinë Tepelenë, në Nj. Ad. Kurvelesh rruga ka qënë e hapur por e kalueshme vetëm me zinxhirë.

Në Nj. Ad. Qendër, fshati Salari rruga ka qënë e kalueshme me zinxhirë.

Në bashkinë Memaliaj, në Nj. Ad. Luftinjë fshatrat Maricaj e Arëz rruga ka qënë e kalueshme me zinxhirë.

Në bashkinë Libohovë, rrugët në Nj. Ad. Zagorie, fshatrat Zhej, Lliar, Konckë, Hoshtevë, Doshnicë kanë qënë të bllokuara.

Rruga Libohovë - Nj. Ad. Zagorie ka qënë e kalueshme vetëm me zinxhirë. Është punuar për zhbllokimin e rrugëve në Nj. Administrative Zagorie me një skrep.

Në bashkinë Përmet, rrugët rurale të Nj. Ad. Frashër në segmentin Bredhi Hotovës- Frashër, lëvizja bëhej me vështirësi vetëm me zinxhirë.

Të bllokuara kanë qënë rrugët e fshatrave Frashër, Miçan, Zavalan, Ogren për shkak të borës dhe ngricës.

Në fshatin Zavalan te Nj. Admin. Frashër tre abonente familjarë nuk kanë marrë energji elektike për shkak të dëmtimit të një gjatësie të konsiderueshme të rrjetit elektrik.

Në bashkinë Këlcyrë, rruga Këlcyrë - Malëshovë - Leskaj - Limar ka qënë e bllokuar. Rrugët rurale të fshatrave të tjerë kanë pasur vështirësi në lëvizjen e mjeteve.

Në bashkinë Dropull rruga që lidh Nj. Ad. Zagorie me Nj. Ad. Pogon ka qënë e kalueshme me zinxhirë.

Në të gjitha shkollat e qarkut Gjirokastrë është zhvilluar procesi mësimor me përjashtime të vogla. Në disa nga institucionet arsimore ka munguar ngrohja si pasojë e mungesës së furnizimit me naftë për vënien në punë të kaldajave.

Është bërë furnizimi normal me ujë të pijshëm në të gjitha njësitë e qarkut, po ashtu dhe furnizimi me energji elektrike ka qënë normal me përjashtim të ndonjë defekti. Institucioni i Prefektit të qarkut ka qënë në gadishmëri për ndjekjen e situatës duke mirëkuptuar çdo problematikë të adresuar pranë tij nga ana e qytetarëve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore.



14.01.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim pune me drejtues të degëve territoriale dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor lidhur me masat e marra nga ana e tyre për përballimin e situatave emergjente të krijuara si pasojë e rënies së reshjeve të borës me intensitet të lartë.

Nga ana e drejtuesve është raportuar mbi masat që ata kanë marrë për normalizimin e situatës në të cilën ndodhet i gjithë territori i qarkut dhe është diskutuar gjithashtu për zgjidhje konkrete të problematikave të hasura, përgjatë ditëve në vazhdim.

Konkretisht, Prefekti i qarkut ka lënë rekomandimet përkatëse për normalizimin e të gjitha situatave problematike në qark.



16.01.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z.Astrit Aliaj priti në zyrën e tij znj.Milena Saraçi e cila në detyrë, Kryetare e Dhomës së Avokatisë Gjirokastrë, z.Bekim Murati në detyrë Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe me përfaqësues nga Institucioni i Prefektit. Në këtë takim u diskutua mbi përfaqësimin që Avokatura e Shtetit do ti bëjë çështjeve ku KVVTP është palë. Pas mbylljes së



veprimtarisë së Komisionit të Vlerësimit të titujve të Pronësisë, Avokatura e Shtetit do të bëjë përfaqësimin e Prefektit në çështjet gjyqësore të cilat janë në proces. Në këtë takim Prefekti ofroi mbështetjen maksimale me zyrën e Avokatisë së Shtetit për përfaqësimin ligjor në këto çështje.

23.01.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë ka zhvilluar një takim me përfaqësues të disa subjekteve që operojnë në fushën e transportit në linjat ndërqytetase dhe qytetase në bashkitë Gjirokastrë dhe Dropull. Subjektet kanë paraqitur shqetësimin e tyre në lidhje me ushtrimin e këtij aktiviteti në mënyrë të parregullt nga një subjekt tjetër i cili nuk ka respektuar rregullat e parashikuara në licencën përkatëse, duke dëmtuar operatorët e tjerë. Gjithashtu është kërkuar ndihma e Prefektit për të zgjidhur situatën në të cilën ndodhen, për shkak se për të njëjtën linjë qytetase disponojnë licencë nga bashkia subjektet ankuuese dhe njëkohësisht edhe një operator tjetër i pajisur me licencë nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjitikës edhe pse nuk ka ushtruar asnjëherë aktivitet në këto bashki. Në përfundim të takimit Prefekti është angazhuar për t'iu drejtuar institucioneve përkatëse përgjegjëse në mënyrë që shqetësimet e këtyre subjekteve të gjejnë rrugën e zgjidhjes.



29.01.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është mbajtur takimi i parë i Komitetit Rajonal të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore me anëtarë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Autoriteti Rrugor Jugor, OSSHE, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Drejtoria Arsimore Rajonale, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Shoqëria mjedisore “Çajupi”, “Shoqëria mjedisore e ujërave, pyjeve dhe kullotave” Përmet,

përfaqësues nga pronarët e pyjeve dhe kullotave Gjirokastrë e Përmet si dhe përfaqësues nga Prefektura e Korçës duke qënë se zona e mbrojtur mjedisore e Parkut Kombëtar të Bredhit të Hotovë-Dangëlli shtrihet në të dy këto qarqe.

Ky Komitet Menaxhimi ka funksion mbikqyrës për zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura mjedisore dhe programeve që hartohen në mënyrë të hollësishme sipas kërkesave të tij dhe e shtrin veprimtarinë e tij në territorin e qarkut Gjirokastrë dhe në pjesën e Zonës së Mbrojtur që shtrihet edhe në qarkun e Korçës sipas rrejtimit të zonave të mbrojtura mjedisore të miratuara, përfshirë këtu edhe parqet natyrore bashkiake.

Në territorin e qarkut Gjirokastrë ka rreth 62.492 ha Zona të Mbrojtura (ose rreth 22% e territorit) ku përkatësisht janë të ndara në katër Zona të Mbrojtura të kategorive të ndryshme sipas Qendrës Botërore të Ruajtjes së Natyrës si:

- Rezervë Strikte Natyrore “Bredhi i Kardhiqit” (kategori I), Bashkia Gjirokastrë

- Parku Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli” (kategori II), Bashkia Përmet
- Monumenti i Natyrës “Bredhi i Sotirës”(kategori III), Bashkia Dropull
- Parku Natyror “Zagori” (kategori IV), Bashkia Libohovë

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj në cilësinë e Kryetarit të Komitetit ka theksuar në fjalën e tij se Parqet Natyrore, janë pika të forta të zhvillimit të qëndrueshëm turistik dhe ekonomik. “Bashkëpunimi dhe përfshirja e banorëve që jetojnë afër këtyre zonave të mbrojtura është shumë e rëndësishme sepse asnjë zonë nuk mund të mbrohet e zhvillohet pa kontributin e banorëve, që kanë jetuar e menaxhuar në kohë këto zona. Një pikë e fortë e përbushjes së këtyre detyrave është edhe edukimi e sensibilizimi i brezit të ri dhe të gjithë banorëve, për rëndësinë e veçantë që mbartin këto zona. Çdo institucion kompetent por edhe mediat lokale duhet të punojnë fort në drejtim të promovimit të vlerave të Zonave të Mbrojtura, si një pasuri e përbashkët që na ka falur natyra.”



29.01.2019

Në bashkinë e Dropullit është zhvilluar një takim llogaridhënës për parandalimin e krimit. Takimi ishte konceptuar si një mundësi komunikimi ku banorët e zonës patën rastin të shtrojnë probleme, të drejtojnë pyetje dhe të japin opinione për çështje që kanë të bëjnë me rendin dhe sigurinë publike. Në këtë takim, të organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, me mbështetjen e Ministrisë së Jashtme holandeze, morën pjesë Ministri i Brendshëm Sandër Lleshaj, Prefekti i Qarkut, përfaqësues të Policisë, Prokurorisë dhe zv.ambasadorja e Holandës në Tiranë. Banorët vlerësuan nismën si një platformë e mirë komunikimi dhe për rreth 2 orë i drejtuan pyetje panelit si dhe ngritën shqetësime, që hasin në jetën e përditshme. Bashkia e Dropullit, e banuar kryesisht nga minoriteti grek, ka në përbërje 41 fshatra. Zona e Dropullit ka një nivel kriminaliteti ndër më të ulët në qark.

"Ne duhet që Policinë ta konsiderojmë si Policinë tonë. Dhe ka shumë mënyra për t'u afruar me policinë. Së pari, duhet që vetë Policia ta fitojë besimin e qytetarëve, duhet që ajo ta bëjë hapin e parë. Por, duhet që edhe qytetarët të mundohen të gjejnë tek Policia një partner të tyre. Unë besoj se rruga më e mirë për ta bërë këtë dhe, këtu gjej rastin për ta përsëritur këtë thirrje, është që ne duhet t'i shohim djemtë dhe vajzat e minoritetit grek pjesë të Policisë tonë. Do të ishte një investim i madh për Policinë e Shtetit tonë, por dhe për miqësinë tonë, edhe për marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe grekëve, që pjesëtarë të minoritetit etnik grek të bëhen pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit tonë", nënvizoi ministri Lleshaj në fjalën e tij.



31.01.2019

Në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë është zhvilluar Analiza e Veprimtarisë së këtij institucioni për vitin 2018, me pjesëmarrjen e znj. Alma Mele, Drejtoreshë e Çështjeve Vendore dhe Prefekturave në Ministrinë e Brendshme, drejtuesve të njëjësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe të institucioneve shtetërore në nivel vendor.

Gjatë kësaj analize janë evidentuar mangësitë, arritjet dhe sukseset në përmbushjen e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave në nivel qarku.

Prioriteti i punës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2018 ka qënë ngritja në një shkallë më të lartë e frymës së bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit të organeve të qeverisjes vendore, degëve territoriale dhe institucioneve të tjera që veprojnë në qark. Drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

Pas diskutimeve të bëra në fund të këtij takimi, Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka bërë të ditur objektivat për vitin 2019, duke ju uruar të gjithë institucioneve në qark suksese në sfidat e reja që na presin!



05.02.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar një takim pune me drejtues të drejtorisë së Shëndetit Publik Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet dhe drejtoreshës së Spitalit Tepelenë në lidhje me situatën epidemiologjike të krijuar në qarkun e Gjirokastrës. Këtë sezon po qarkullon gripi stinor dhe gripi i derrit nga i cili është prekur edhe vendi ynë. Në qarkun e Gjirokastrës numri i rasteve njih një trend rritjeje dhe të gjithë janë para një situatë epidemiologjike të qetë, për këtë sëmundje.

Në të gjithë qarkun procesi vazhdon të menaxhohet prej mjekut të familjes në të gjitha qendrat shëndetësore. Personat të cilët duhet të kryejnë vaksinimin përcaktohen prej mjekut të

familjes sipas gjendjes shëndetësore, pranisë së sëmundjeve kronike dhe moshës. Kujdesi është i përqëndruar tek target grupet e riskut si fëmijët 0-5 vjeç, gratë shtatzëna, të sëmurët kronikë dhe moshat e treta mbi 70 vjeç. Është i rëndësishëm informimi publik shëndetësor i popullatës, sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi në lidhje me risqet dhe rreziqet e gripin stinor për shëndetin si dhe rekomandimet e dhëna për masat mbrojtëse dhe parandaluese si:

- Bashkëpunimi me mjekun e familjes.
- Rekomandimi për aplikimin e vaksinës antigrip për target grupet e risku
- Qëndrimi në shtat për 3-4 ditë në shtëpi e të sëmurit me grip.
- Marrja e antipiretikëve dhe lëngjeve kur ka temperaturë të lartë.
- Kujdesi specifik për pacientët kronikë dhe fëmijëve, evitimi i ambienteve të mbipulluara.
- Marrja e një mjekimi të specializuar apo shtrimi në spital në rastet e komplikuara.
- Në të gjitha qendrat shëndetësore në qark, personelit duhet të punojë me maskë dhe doreza si masë parandaluese për përhapjen e gripit tek personeli shëndetësor dhe pacientët e tjerë.



05.02.2019

Në Qarkun e Gjirokastrës ju nënshtuan rikonstruksionit tetë Qendra Shëndetësore dhe ambulanca, investim ky nga MSHMS. Krijimi i kushteve bashkëkohore në këto qendra do të përmirësojë ndjeshëm shërbimin shëndetësor ndaj pacientëve.

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj së bashku me drejtorin e DRSh z. Shpëtim Novi kanë vizituar QSh Lunxhëri rikonstruktuar nga MSHMS si edhe ambulancën Topullare rikonstruktuar nga DRSH me kontributin e donatorëve dhe të vetë personelit shëndetësor. Si në QSh Lunxhëri ashtu edhe në ambulancën e rikonstruktuar përveç pajisjeve të reja të vendosura në shërbim të qytetarit do të ketë edhe një personel mjekësor të përkushtuar dhe profesional.



12.02.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka pritur në ambientet e institucionit të Prefektit, nxënësit e klasës së V-të të shkollës 9-vjeçare “Koto Hoxhi” të qytetit të Gjirokastrës. Nxënësit e kësaj shkolle janë njohur me detyrat që mbulon Prefekti i qarkut si dhe janë prezantuar me historinë, kulturën dhe trashëgiminë e pasur të qarkut Gjirokastrë, duke zhvilluar kështu një orë mësimi ndryshe, jashtë ambienteve të klasës mësimore.



14.02.2019

Nismës së pyllëzimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, i janë bashkuar edhe nxënësit e stafi i shkollës së mesme gjuhësore “Pandeli Sotiri” në Gjirokastrë.

Me kontributin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë z. Armand Hila dhe në bashkëpunim me Prefektin e Qarkut Gjirokastrë, është bërë e mundur mbjellja e fidanëve të rinj në ambientet përreth kësaj shkolle, institucion që përcjell vlera prej 70 vitesh të ekzistencës së tij.

Fidanët e mbjellë me pasion dhe dashuri për natyrën, nga vetë nxënësit e shkollës, janë shembulli më i mirë i veprimeve konkrete për ta shëndërruar Shqipërinë në një vend më të gjelbëruar, më të pastër dhe më turistik.



19.02.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar një takim pune me Përgjegjësën e Sektorit të Bujqësisë z. Balil Bineri lidhur me problematikat që hasen në fushën e bujqësisë në qarkun e Gjirokastrës.

Në këtë takim nga ana e z. Bineri u trajtuan problematikat lidhur me rrjetin kullues i cili ka nevojë për ndërhyrje në mënyrë që të bëhet funksional, devijimi i shtretërve të lumenjve me pasojë dëmtimin e tokave bujqësore si dhe numri i ulët i fermerëve të regjistruar.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut ka theksuar ndërgjegjësimin nga ana e fermerëve në lidhje me regjistrimin pasi përveçse është detyrim ligjor, i ndihmon edhe për të përfituar subvencione bazuar në politikat e qeverisë shqiptare në mbështjen e Sektorit të Bujqësisë.



19.02.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë ka zhvilluar një takim me drejtuesit e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional Publik, Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë si dhe përfaqësuesin e shoqatës "Vizioni i së Ardhmes" e cila ka në objekt të aktivitetit të saj hartimin dhe zbatimin e projekteve zhvilluese në fushat sociale dhe kulturore kryesisht të komuniteteve Egjiptian dhe Rom.

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj e vuri theksin në detyrimet që institucionet kanë në zbatim të VKM nr. 1072, date 23.12.2015 "Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, 2016-2020", masat që duhet të merren bazuar në planet kombëtare dhe implementimi i tyre në bashkëpunim edhe me grupet e interesit.

Përfaqësuesi i shoqatës "Vizioni i së Ardhmes" diskutoi mbi problematikat që ka komuniteti që kjo shoqatë përfaqëson. Gjatë diskutimeve ai shtroi pyetje dhe kërkesa të ndryshme për të cilat kërkoi mbështetjen dhe angazhimin e këtyre institucioneve.

Nga ana e të gjithë drejtuesve të institucioneve është shprehur një angazhim maksimal për bashkëpunim mes tyre si dhe me shoqatën "Vizioni i së Ardhmes" në cilësinë e përfaqësuesit të këtyre pakicave, për realizimin e detyrave që dalin në zbatim të "Planit kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve, 2016-2020".



20.02.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar një takim për shqetësimet e ngritura nga banorët e fshatrave Kolonjë, Golem, Picar lidhur me projektvendimin e miratuar

në parim nga “Këshilli i Basenit Ujor Vjosë”. Të pranishëm në këtë takim ishin kryetari i fshatit Kolonjë dhe përfaqësues të tjerë të komunitetit të cilët shprehën shqetësimet e tyre lidhur me zbatimin e projektit të HEC-it të Kolonjës. Gjatë diskutimeve të bëra nga pjesëmarrësit u shprehën se ndërtimi i këtij HEC-i shkakton tre probleme kryesore:

1. Lënia pa ujë të pijshëm i banorëve të fshatrave Kolonjë dhe Picar.
2. Degradimi mjedisor i një pjese të luginës me gjatësi 2 km.
3. Humbje e burimit ujor për vaditje dhe përdorim blegtoral.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut ka shprehur mbështetjen e plotë të institucionit që ai drejton por edhe të institucioneve vendore, për ndërhyrje në instancat më të larta, në mënyrë që ky rast të trajtohet si një rast i veçantë për vetë natyrën e problematikave jetike dhe ekologjike që ai mbart.

Prefekti i qarkut do të jetë gjithmonë në monitorim të problemit dhe shqetësimit tuaj duke respektuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, qoftë ato në shërbim të komunitetit të zonës ashtu edhe në mbrojtjen e ruajtjen e hapsirave mjedisore.



24.02.2019

Në vizitën dy ditore të Kryeministrit të Shqipërisë z. Edi Rama në qarkun e Gjirokastrës është zhvilluar një tur aktivitetesh me karakter gjithëpërfshirës, ku të pranishëm ishin edhe disa ministra, deputetët e qarkut, Prefekti i qarkut, Kryetari i Këshillit të qarkut dhe drejtues të tjerë lokalë. Përgjatë ditëve të qëndrimit të Kryeministrit në qarkun tonë është zhvilluar takimi në kuadër të “Paktit për Universitetin”, si dhe një takim me studentët e universitetit “Eqrem Çabej”, një takim publik i ciklit kombëtar “Bashkia që duam” në Gjirokastrë e Përmet. Ndër aktivitetet e tjera që u zhvilluan në prani të Kryeministrit Rama ishin dhe vizita në kantierin e aksit strategjik Delvinë-Kardhiq, përrurimi i qendrës shëndetësore Lunxhëri, takimi me operatorët turistikë lokalë për rritjen e kërkesave turistike dhe vizita në qendrën historike të qytetit të Gjirokastrës e cila është duke u transformuar drejt një zhvillimi të ri.





27.02.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z.Astrit Aliaj ka marrë pjesë në takim të organizuar nga Ministria e Mbrojtjes, në Bashkinë Këlcyrë për të diskutuar për marrëveshjen e bashkëpunimit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Greqisë “Për kërkimin, zhvarrimin, identifikimin, dhe varrimin e ushtarakëve Grekë të rënë në luftën greko-italiane të vitit 1940-1941, ratifikuar me ligjin nr. 10256 datë 25.03.2010, akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të saj, si dhe vendimit të komisionit të përbashkët shqiptaro-grek të datës 27.03.2018.

Për shkak të pengesave që krijon ky vendim në procesin e varrimit të 21 kutive me mbetje mortore të paidentifikuara, Prefekti i Qarkut ka zhvilluar pranë bashkisë Këlcyrë një takim me përfaqësues të kësaj bashkie dhe këshillit të bashkisë. Gjithashtu të pranishëm në këtë takim ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes, dhe Ministrisë së Brendshme.

Në përfundim të takimit u dakortësua fakti i vazhdimit pa pengesë të procesit të varrimit të këtyre mbetjeve mortore të paidentifikuara.

28.02.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë dhe në N/Prefekturën Përmet janë mbajtur seminarët me pjesëmarrjen e anëtarëve të institucioneve vendore me përbërje multidisiplinare, të ngarkuara për avancimin e përpjekjeve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm (PVE) në komunitetet vendore.

Nën drejtimin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj dhe N/Prefektit të Përmetit z. Edvin Tuci, në bashkëpunim edhe me Qendrën CCCVE si pjesë e Projektit Rajonal për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm nëpërmjet Zërave dhe Iniciativave Lokale në BB, janë prezantuar aktivitetet në komunitet të IOM në Ballkanin Perëndimor (ËB) dhe qasja e IOM-it.

Në thelb të diskutimeve ishte qasja gjithëpërfshirëse në luftën kundër terrorizmit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë parandalimit dhe luftës kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm, që favorizojnë terrorizmin, duke mbrojtur të drejtat e njeriut dhe shtetin ligjor. Këto qasje kanë të bëjnë me iniciativat të përshtatura në shkallë vendore dhe të nxitura po në këtë formë, të cilat bazohen mbi partneritetet midis një game të gjerë aktorësh.

Nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, dhe analizimit të frytshëm të diskutimeve, kuptohet perspektiva lokale dhe veprimet që duhen ndërmarrë në bashkëpunim me Pushtetin Vendor, Koordinatorin Kombëtar / Drejtorinë e Qendrës CCCVE, përfaqësuesin e IOM-it dhe strukturat e tjera.



01.03.2019

Në kuadër të aksionit kombëtar të pyllëzimit “**krijoO2tënd**” në qarkun e Gjirokastrës në datat 1-2 Mars do të vazhdojë mbjellja e fidaneve dekorativ, pisha, bredha, blinj dhe selvi. Kësaj nisme pyllëzimi do t’i bashkohen punonjës të degëve territoriale në vend, të njësive administrative të qarkut dhe institucioneve të tjera shtetërore në nivel vendor për një Shqipëri më të gjelbër, më të pastër dhe më turistike.



07.03.2019

Nisur nga ankesat e komunitetit të Nj. Adm. Zagori të Bashkisë Libohovë dhe pronarit të ujit të pijshëm Living Ëater, Prefekti i qarkut Gjirokastrë ka vizituar këtë zonë për të biseduar nga afër për shqetësimet e ngritura si degradimi total i rrugës automobilistike kthesë Libohovë - Poliçan me gjatësi 22 km si dhe amortizimin e linjës elektrike Grapsh - Poliçan që furnizon Nj. Adm. Poliçan dhe Zagorie.

Në këtë vizitë Prefekti i qarkut ka shprehur mbeshtetjen e plotë të komunitetit dhe të biznesit si dhe shprehu gadishmërinë për ti përcjellë këto shqetësime institucioneve qendrore për një zgjidhje përfundimtare të tyre.

Gjithashtu Prefekti i qarkut ka vizituar nga afër ambientet e fabrikës së ujit GTG Living Ëater, ku që prej vitit 2017, zonës së Zagories i është shtuar ky investim i ri i cili financohet nga kompania “Skyton Development”, me qendër në Australi dhe shtrirje në shumë vende të botës, ndërsa zbatimi në Shqipëri i projektit kryhet prej kompanisë “STS Development” sh.p.k.

Nga malet e larta të Dhëmbelit dhe Nemërçkës rrjedh përmes shkëmbinjve të pasur me kalcium dhe minerale, uji i burimit të Bambullit, i cili është bakteriologjikisht i pastër dhe ka veti të jashtëzakonshme kurative dhe dietike. Kjo e konfirmuar dhe e certifikuar përmes analizave në laboratorë të specializuar jashtë vendit.

Kompania ka bërë një investim të madh në marrjen e teknologjive dhe pajisjeve më të mira prodhim i vitit 2017 nga kompania lider në botë KRONES AG, për të ofruar dhe siguruar cilësinë më të lartë të produkteve tek konsumatori.

Në statusin e kompanisë duket qartë se 90% e fitimeve do të investohen përsëri në zonën e Zagories dhe 10% e fitimeve do të shkojnë për bamirësi në familjet në nevojë prandaj është e domosdoshme që problematikat e mësipërme të gjejnë një zgjidhje përfundimtare në të mirë të interesit të komunitetit të zonës dhe zhvillimit ekonomik.



07.03.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka zgjedhur Shkollën e Mesme të Bashkuar të Dervicianit në Dropullin e Poshtëm për të uruar të gjithë mësuesit në këtë ditë të veçantë dhe për të shprehur mirënjohjen e tij të thellë për punën e palodhshme e fisnike që nxënësit e kësaj shkolle të edukohen në gjuhën e tyre me dije bashkëkohore për tu bërë të denjë, për veten dhe familjet e tyre dhe për t'i shërbyer të ardhmes evropiane të vendit tonë.



Gëzuar 7 Marsin të dashur Mësues!

07.03.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë ka organizuar një takim me përfaqësues të bizneseve të qendrës së pazarit, me pjesëmarrjen edhe të kryetares së Bashkisë Gjirokastrë znj. Zamira Rami, kryetarit të Dhomës së Tregëtisë z. Maksim Hoxha, përfaqësues të firmës kontraktore dhe mbikqyrës të punimeve që po bëhen në këtë zonë.

Në këtë takim janë trajtuar problemet për mënyrën e organizimit dhe zbatimit të punimeve në lidhje me afatin e bllokimit të rrugës nga ana e firmës kontraktore si dhe për masat që duhet të marrin vetë bizneset për përballimin e vështirësive deri në përfundim të punimeve.

Gjatë këtij takimi u gjet mirëkuptimi i plotë i të gjitha palëve pjesëmarrëse për rëndësinë e realizimit të këtij investimi, pavarësisht nga vështirësitë e krijuara momentalisht në qarkullimin e mjeteve dhe funksionimin normal të bizneseve në këtë zonë.

Në përfundim të takimit nga ana e Prefektit të qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj janë dhënë rekomandimet përkatëse si shtimi i ritmit të punës nga ana e firmës kontraktore duke rritur numrin e specialistëve dhe makinerive; bllokimi i segmentit sheshi “Çerciz Topulli” - Qafa e Pazarit dhe përqëndrimi i punës në pjesën e parë të segmentit, për përfundimin e tij brenda 10

ditëve duke bërë të mundur lidhjen me bypass-in e përfunduar, me qëllim lëvizjen normale të mjeteve dhe komunitetit sipas drejtimit të përcaktuar si dhe pajisja me sinjalistikën përkatëse nga ana e kontraktorit të objektit për të orientuar drejtimin e lëvizjes.



12.03.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar një takim i zgjeruar për të analizuar situatën emergjente dhe sidomos atë të zjarreve në qarkun Gjirokastrë për periudhën janar - 10 mars 2019.

Në këtë takim morën pjesë strukturat e emergjencave civile të njësive të vetëqeverisjes vendore, drejtues të Drejtorisë Vendore të Policisë dhe të komisariateve të policisë së qarkut, drejtuesit e stacioneve të MZSH-ve pranë bashkive të qarkut si dhe drejtues të Agjencisë së Zonave të Mbrojtura, ISHMPUT e Seksionit të Bujqësisë.

Gjatë këtij takimi u analizua situata dhe faktorët të cilët janë bërë shkak për krijimin e vatrave të zjarrit. Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj kërkoi nga të pranishmit angazhim maksimal, bashkëpunim ndërinstitucional dhe koordinim të veprimeve institucionale për parandalimin e situatave emergjente që mund të krijohen në vazhdim.

Gjithashtu, Prefekti i qarkut kërkoi nga autoritetet ligjzbatuese identifikimin dhe vënien përpara përgjegjësisë të autorëve të mundshëm të zjarrvënies së qëllimshme.



13.03.2019

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj, në kuadër të Platformës “Punë të Mbarë” ka prezantuar studentët ekselentë fitues të cilët kanë zgjedhur të punojnë në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Znj. Afisa Brahimi dhe znj. Bejre Kurra janë emëruar në pozicionet Specialist në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara pranë këtij institucioni.



Prefekti i qarkut duke i uruar mirëseardhjen i ka përgëzuar për rezultatet e larta të arritura gjatë shkollimit të tyre akademik dhe ju ka premtuar mbështetje maksimale nga i gjithë stafi në këtë detyrë të re.

16.03.2019

Kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë Z.Armand Hilaj ka vlerësuar me titullin “Nderi i Qarkut” Z.Kleanth Dedi, për kontributin e tij si veprimtar i shquar i kulturës në evidentimin dhe publikimin e folklorit, traditave dhe historisë së Lunxhurisë dhe më gjerë si protagonist e autor i shumë botimeve titull i cili u dorëzua nga Prefekti i Qarkut Z.Astrit Aliaj, si dhe Z.Mina Koci (pas vdekjes), për kontributin e tij dhe ndërgjegjësimin e rrallë në gjurmimin dhe evidentimin e vlerave të paçmuara të kulturës materiale e shpirtërore të krahinës së Lunxhërisë si pjesmarrës dhe protagonist.



18.03.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore të 111-vjetorit të Luftës së Çetës së Çerçiz Topullit në fshatin Mashkullorë.

Lufta e Mashkullorës është një ndër ngjarjet më të spikatura të rezistencës patriotike shqiptare të viteve 1908-1910, është një epope e ndritur e guximit dhe trimërisë shqiptare.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj vlerësoi jetën dhe veprën e heronjve dhe dëshmorëve që u sakrifkuan për lirinë e atdheut duke i dhënë një mesazh të gjithë shqiptarëve për t'i shërbyer kombit duke përcjellë ndjenjën e forcimit të unitetit dhe bashkimit.



20.03.2019

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë është zhvilluar mbledhja e Organit Këshillues të Prefektit të qarkut me tematikë “Mbi ecurinë e sezonit turistik 2018 dhe plani i masave, i hartuar nga degët territoriale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për mbarëvajtjen e sezonit të ri turistik 2019”.

Në fjalën e tij Prefekti theksoi se pavarësisht punës së mirë të zhvilluar në vitin 2018 nga të gjithë aktorët dhe faktorët e zhvillimit të turizmit në qarkun tonë, përsëri vihen re disa problematika të hasura nga turistët vendas dhe të huaj që kanë vizituar këtë qark.

Nga ana e njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe degëve territoriale kërkohet bashkëpunim i ndersjelltë me plane masash konkrete në mënyrë që viti 2019 të jetë një vit i sukseshëm për turizmin në qarkun tonë.



20.03.2019

Është zhvilluar në ambientet e Hotel Çajupi takimi i zgjeruar i Task-Forcës Vendore të Luftës kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit me qëllim sensibilizimin e komunitetit të qarkut Gjirokastrë.

Në këtë takim morën pjesë drejtuesi i Grupit të Monitorimit në Ministrinë e Brendshme z. Shaban Nexhi, kryetari i Këshillit të Qarkut, kryetarë të njësive të vetëqeverisjes vendore, drejtues të Policisë Vendore të Qarkut, Kufirit dhe Migracionit, drejtues të njësive administrative si dhe drejtues të degëve territoriale, pjesëtar të kësaj Task-Force.

Gjatë takimit u analizua puna e bërë nga gjithë institucionet ligjzbatuese dhe ato vendore për parandalimin e kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike për vitin 2018.

Gjithashtu u vlerësuan rezultatet e arritura gjatë vitit të kaluar por njëkohësisht u theksua angazhimi maksimal i të gjithë strukturave shtetërore për marrjen e masave për parandalimin e fenomenit të mbjelljes së bimëve narkotike.

Task-Forca Vendore duhet të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e saj ligjore për mbajtjen nën kontroll të territorit të qarkut Gjirokastrë, duke planifikuar kontrolle të përbashkëta me policinë e shtetit dhe të gjitha institucioneve pjesëmarrëse në këtë Task-Forcë.

Task-Forca Vendore pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë nga ana e saj ka hartuar një Plan-Veprim Vendor për luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.



26.03.2019

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë është zhvilluar mbledhja e radhës për problematikat e hasura nga Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë përgjatë vitit kalendarik 2018.

Mbledhja është drejtuar nga Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj, me praninë e z. Florjan Taci drejtor i ZVRPP Gjirokastrë dhe specialistëve të KVVTP pranë institucionit të Prefektit të qarkut.

Gjatë këtij takimi janë evidentuar problematikat e hasura nga ana e KVVTP-së, përgjatë realizimit të punës, është diskutuar ecuria e proceseve gjyqësore të nisura nga KVVTP-ja si dhe janë propozuar zgjidhjet e mundshme për të përmirësuar e lehtësuar procesin e verifikimit dhe regjistrimit të AMTP-ve.

Ky takim i paraprin rifillimit të punës nga ana e drejtorisë së KVVTP pranë institucionit të Prefektit të qarkut deri më 31 dhjetor 2019.



27.03.2019

Është mbajtur në Tiranë Konferenca Ndërkombëtare “Në rrugën drejt BE-së, Financimi modern i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta” në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe Shoqërisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ).

Projekti vepron në nivel kombëtar, bashkëpunim në veçanti me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ku sektori i menaxhimit të mbetjeve ngelet një prioritet i qeverisë shqiptare. Në nivel kombëtar, ky projekt kontribuon në një rishikim të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve si dhe në forcimin e rregulloreve sektoriale dhe kryerjen e aktiviteteve të përgjithshme të zhvillimit të kapaciteteve.

Parimi kryesor për menaxhimin e mbetjeve është hierarkia e mbetjeve. Strategjia Kombëtare e MIM merr parasysh dhe rëndësinë e menaxhimit të mbetjeve sipas parimit të ekonomisë qarkulluese për të mundësuar mbrojtjen sa më të plotë të burimeve natyrore dhe rritjen e efikasitetit të përdorimit të produkteve dhe parimit ndotësi paguan duke adresuar problemet kryesore të Menaxhimit të Mbetjeve. Strategjia është strukturuar që të përmbushë parimet bazë të BE të cilat janë harmonizuar në legjislacionin që mbulon fushën e menaxhimit të mbetjeve.



28.03.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka pritur në një takim zyrtar Konsullin e Përgjithshëm të Greqisë në Gjirokastrë z. Lambros Kakissis.

Gjatë këtij takimi Prefekti i qarkut ka uruar Konsullin e Përgjithshëm në detyrën e re që i është besuar, duke e vijuar takimin me diskutime për çështje të interesit të përbashkët, shqetësime dhe problematika për banorët e qarkut Gjirokastrë dhe sidomos atyre të minoritetit grek.



Prefekti i qarkut z. Aliaj ka shprehur angazhimin e tij maksimal për një bashkëpunim të vazhdueshëm në funksion të intesifikimit të dialogut të përbashkët institucional në interes të komuniteteve që jetojnë në të dy anët e kufirit.

02.04.2019

Pas zjarrit të rënë në nënstacionin elektrik Krahës të bashkisë Memaliaj, ku mori flakë transformatori i fuqisë 3.2 MVA, Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka vizituar nënstacionin elektrik për të parë nga afër gjendjen aktuale pas punimeve të kryera për rikthimin në normalitet të këtij nënstacioni.

Në ndihmë të 1500 abonentëve të prekur nga mungesa e energjisë elektrike si pasojë e një lidhjeje të shkurtër në rrjet, kanë ndërhyrë menjëherë njësitë ndihmëse avaro-shpëtuese për riparimin e dëmtimeve dhe vendosjen e transformatorit të ri e pajisjeve të tjera të traktit 100 Kv të këtij transformatori, investim i cili kap vlerën prej 500.000€.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë ka falenderuar të gjitha forcat zjarrfikëse, forcat e policisë së shtetit e vullnetarë të zonës për kontributin e tyre në shuarjen e flakëve si dhe të gjithë personelin e Drejtorisë Qëndrore të Tensionit të Lartë që bënë të mundur rivendosjen në punë në kohë rekord të nënstacionit Krahës. “Rehabilitimi i zonës së dëmtuar përreth nënstacionit është një vlerë e shtuar e cila duhet të gjej përparësi përgjatë ditëve të ardhshme”, ka shtuar në fjalën e tij Prefekti i qarkut.



03.04.2019

Pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi i radhës i Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave për qarkun Gjirokastrë. Takimi është zhvilluar me pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të këtij komiteti dhe pjesëmarrjen e znj. Alma Mele, Drejtor i Drejtorisë për Çështjet Vendore dhe Prefekturat në Ministrinë e Brendshme.

Rendi i ditës së takimit të zhvilluar ishte njohja me situatën dhe trajtimi i çështjeve të trafikimit në qark si dhe i disa ndryshimeve në Rregulloren e Funkcionimit të Komitetit Rajonal Antitrafik dhe miratimi i Planit të Veprimit për vitin 2019. Në përmbajtjen e tij, ky plan veprimi është në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, Planin e Veprimit 2018-2020, si dhe është produkt i një studimi paraprak të situatës, nevojave dhe specifikave të qarkut.

Nga informacionet zyrtare të marra nga institucionet shtetërore ligjzbatuese tregohet qartë niveli në minimum i trafikimit të qenieve njerëzore për qarkun tonë, megjithatë duhet të vazhdojë puna duke qenë në gadishmëri maksimale për parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore por edhe për dhënien e ndihmës nëse do të ketë raste trafikimi.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj në fjalën e tij trajtoi lëvizjet e personave me shtetësi të huaj në kufi të cilët vijnë nga zona të ndryshme konflikti, grupe njerëzish këto, të cilët janë vulnerabël dhe të ekspozuar ndaj fenomenit të trafikimit, duke përmendur edhe punën dinamike të strukturave të Drejtorisë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit. Prefekti i Qarkut theksoi në fjalën e tij se do të vazhdojë të jetë i gatshëm për të qenë promotor i një bashëpunimi ndër-institucional e ndër-qytetar, të promovojë e të mbështetë nisma si dhe të ndikojë fuqishëm tek strukturat e qarkut në fushata sensibilizuese për parandalimin e këtij fenomeni.



03.04.2019

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë kishte vizitorë të veçantë nxënësit e klasës së V të shkollës jopublike “Xhuzepe Gras” në Gjirokastrë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja nga ana e tyre e veprimtarisë së institucioneve shtetërore rajonale dhe në veçanti e institucionit të Prefektit të qarkut.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj zhvilloi një bashkëbisedim të ngrohtë dhe miqësor duke ju përgjigjur pyetjeve dhe interesit të tyre të çiltër për probleme të veprimtarisë së institucionit dhe çështjeve të ndryshme sociale të jetës së përditshme. Në përfundim të kësaj vizite nga ana e Prefektit të qarkut janë dhuruar disa libra për pasurimin e bibliotekës së kësaj shkolle.



04.04.2019

Nisur nga problematikat e krijuara së fundmi në sektorin e transportit të udhëtareve në qarkun Gjirokastrë si dhe nga takimet e zhvilluara nga Prefekti i qarkut për të marë shqetësimet e operatorëve që operojnë në këtë sektor dhe për ti adresuar ato, me propozimin e Prefektit të qarkut, është zhvilluar një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor.

Në këtë takim morën pjesë drejtori i Licensimit në DPSHTRR z. Olsi Cara, specialistë të kësaj drejtorie, përfaqësues të Agjencisë së Shërbimeve të bashkive Gjirokastrë, Dropull dhe Libohovë si dhe operatorë të shërbimit të transportit të udhëtarëve në qarkun Gjirokastrë.

Bashkëbisedim në lidhje me problematikat e licensimit, propozime për ndryshime të udhëzimeve dhe akteve ligjore në mënyrë që edhe operatorëve të cilët aktualisht kanë ngelur jashtë këtij shërbimi, t’ju ofrohet mundësia e aplikimit për tu pajisur me licensa në sektorin e transportit të udhëtarëve.

Shpresëplotë për fillimin e një bashkëpunimi të frytshëm për zgjidhjen e shqetësimeve të këtyre operatorëve.



08.04.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë ka zhvilluar një vizitë në objektin e rikonstruksionit të kalldrëmeve të Qafës së Pazarit në Gjirokastrë, punimet e të cilit po zbatohen nga firma Leon Construction.

Qëllimi i kësaj vizite ishte për të parë nga afër punën në terren si dhe problematikat e shqetësimet e disa bizneseve që operojnë në këtë zonë. Konkretisht puna po vazhdon në disa fronte, si në hapjen e kanaleve anësore në segmentin Qafa e Pazarit - Kala, betonimin e kanaleve në segmentin Sheshi “Çerçiz Topulli” - Qafa e Pazarit si dhe në ndërtimin e disa pusetave në keto segmente. Një vëmendje e veçantë ju kushtua edhe brigadës së ndërtimit të kalldrëmeve e cila ka filluar punë përpara disa ditëve në segmentin ish-Poliklinika - Qafa e Pazarit.

Nga vëzhgimet e bëra në vend si dhe nga opinioni i qytetarëve të ndryshëm rezulton se punimet janë duke u realizuar me një cilësi të mirë. Nga ana e Prefektit të qarkut është kërkuar që të përmirësohet edhe më shumë cilësia e kalldrëmeve.



09.04.2019

Në ambientet e institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrër është zhvilluar një takim me drejtuesit e degëve territoriale dhe institucioneve shtetërore vendore në qark. Nisur nga detyrimet e ligjit për Prefektin e qarkut dhe detyrave të caktuara nga zv/kryeministri në takimin e zhvilluar me Prefektet e qarqeve, Prefekti i qarkut kërkoi nga ana e drejtuesve të institucioneve zbatimin me rigorizitet të detyrave që ju ngarkon ligji.

Gjithashtu Prefekti i qarkut i bëri thirrje të gjithë drejtuesve për të qenë sa më pranë qytetarit jo duke ju shpjeguar atyre por duke i treguar rrugën drejt zgjidhjes së problemeve. Kjo mënyrë pune do ta bënte administratën e Prefektit të qarkut më të dobishme ndaj qytetarëve.

Bashkëpunimi me degët territoriale dhe institucioneve të tjera shtetërore në nivel vendor ka qenë dhe do të jetë një nga drejtimit kryesore të punës së institucionit të Prefektit të qarkut, - ka theksuar në fjalën e tij Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj.



10.04.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrër z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore të masakrës së Peshkëpisë, ku 25 vite më parë janë vrarë në krye të detyrës kapiteni i parë z. Fatmir Shehu 34-vjeç dhe ushtari z. Arsen Gjini 20-vjeç, në postën kufitare të Peshkëpisë të bashkisë Dropull.

Në këtë ceremoni morën pjesë Kryetari i Këshillit të qarkut z. Armand Hila, Drejtori i Policisë Vendore Gjirokastrër z. Perlat Vatoci, familjarë të të rënëve dhe përfaqësues të veteranëve të luftës. Masakra e Peshkëpisë është nga ato ngjarjet e rënda që nuk është hetuar anjëherë plotësisht. Autorët, pjesëmarrësit dhe mbështetësit e saj ende dhe sot jetojnë të lirë dhe të pashqetësuar. Zbardhja e kësaj ngjarjeje është detyrim në emër të drejtësisë për kapitenin e ndjerë Fatmir Shehu dhe ushtarin Arsen Gjini, është detyrim që historia mos të përsëritet, por të sjellë në fund të vërtetat.

Prefekti i qarkut në fjalën e tij shprehu nderim dhe respekt për dëshmorët e rënë, të cilët kanë qenë dhe do të jenë obligimi i krenarisë sonë kombëtare sepse dhanë jetën në krye të detyrës.



11.04.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë ka zhvilluar një takim me përfaqësues të komunitetit rom në qytetin e Gjirokastrës me kërkesë të tyre. Përfaqësuesit e këtij komuniteti kanë ngritur disa shqetësime që lidhen kryesisht me kushtet në zonën ku ata banojnë, me mungesën e ujit të pijshëm, ndriçimit publik dhe hapësirave të organizuara publike brenda zonës së banimit.



Përfaqësuesit kërkojnë rikonstrukcion të rrugës që lidh këto lagje e cila aktualisht është shumë e ngushtë si dhe angazhimin e strukturave përkatëse për zgjidhjen e çështjes së strehimit për ta.

Përfaqësuesit e komunitetit rom kanë kërkuar ndërhyrjen e Prefektit pranë institucioneve përkatëse dhe Bashkisë Gjirokastrë për t'i dhënë zgjidhje këtyre problematikave në një kohë sa më të shpejtë me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për këtë komunitet.

12.04.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në takimin “Dëgjese publike” të zhvilluar nga Komisioni për Integrimin Europian në qytetin e Përmetit me autoritetet lokale për të diskutuar mbi çështjet e sipërmarrjes, turizmit e kulturës si pjesë e procesit të Integritimit Europian.

Në këtë takim ishin të pranishëm znj. Senida Mesi, nënkryetare e Komisionit për Integrimin Europian, znj. Mirela Kumbaro, deputete e qarkut Gjirokastrë, z. Musa Ulqini deputet, anëtarë të këtij Komisioni, Kryetari i Këshillit të Qarkut z. Armand Hila, Kryetari i bashkisë Përmet z. Niko Shupuli si dhe përfaqësues të organizatave dhe shoqërisë civile të qytetit të Përmetit dhe Rajonit.

Gjatë këtij takimi u diskutua në mënyrë interaktive mbi mundësitë për përthithjen e fondeve për projekte në fushën e sipërmarrjes, turizmit e kulturës të cilat do të ndihmojnë në zhvillimin e Rajonit duke ndikuar kjo edhe në procesin e Integritimit Europian dhe plotësimin e Rekomandimeve të Bashkimit Europian.

Prefekti i qarkut në fjalën e tij theksoi domosdoshmërinë e rehabilitimit të aksit rrugor Tre Urat – Çarshovë – Përmet si një mundësi reale për zhvillimin e turizmit dhe shkëmbimeve dypalëshe mes dy vendeve fqinjë.

Gjithashtu institucioni i Prefektit të qarkut është duke realizuar disa projekte të përbashkëta ndërkufitare që kanë të bëjnë me zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit ndërkufitar, krijimin e shtigjeve dhe vendosjen e teknologjisë në mënyrë që turistët e huaj të cilët vizitojnë qarkun tonë të shpenzojnë më shumë ditë qëndrimi në territorin e qarkut tonë.



15.04.2019

Është zhvilluar në ambientet e N/Prefekturës Tepelenë takimi me drejtuesit e degëve territoriale të bashkive Tepelenë dhe Memaliaj me qëllim përmirësimin e performancës të degëve territoriale të qarkut Gjirokastrë.

Në këtë takim morën pjesë kryetari i bashkisë Tepelenë z. Tërmet Peçi, nënprefekti Tepelenë z. Avni Lala si dhe drejtues të degëve territoriale të bashkive Tepelenë dhe Memaliaj. Në fjalën e tij Prefekti theksoi marrëdhëniet që ka institucioni i Prefektit të Qarkut me njësitë e qeverisjes vendore me qëllim rritjen e një bashkëpunimi të ndërsjellë për përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi ndaj qytetarëve.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj kërkoi nga të pranishmit angazhim maksimal, bashkëpunim ndërinstitucional dhe koordinim të veprimeve institucionale për një efikasitet më të lartë të institucioneve shtetërore.

Gjithashtu Prefekti i qarkut ofroi mbështetje ndaj drejtuesve të degëve territoriale mbi problemet që mund të hasin, si dhe kërkoi marrjen e masave për hapjen e sezonit të ri turistik në qarkun Gjirokastrë.



16.04.2019

Është zhvilluar në zyrën e Prefektit të qarkut një takim pune me KVVTP-në, ku në fokus ishin detyrat dhe objektivat që i dalin këtij Komisioni me rifillimin e punës në bazë të ligjit Nr.10/2019, ligj i cili shtyn afatin e veprimtarisë të Komisionit deri më 31.12.2019.

Duke parë ndjeshmërinë e lartë që ka çështja e tokave bujqësore dhe angazhimin e qeverisë shqiptare mbi këtë çështje, Prefekti i qarkut z.Astrit Aliaj kërkoi nga Komisioni hartimin e planeve me afate konkrete për trajtimin e dosjeve që janë në shqyrtim dhe të kërkesave të reja që do të vijnë pranë Komisionit.

Një problem i mprehtë që u theksua me forcë nga Prefekti ishte edhe problemi i pritjes së qytetarëve, pasi shumë herë qytetarët dalin të pasqaruar nga zyrat e shtetit duke bërë që të krijohen pakënaqësi dhe sorollatje të qytetarëve.



17.04.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka qenë i pranishëm në stërvitjen komplekse me temë “Veprimtaria e dy stacioneve zjarrfikëse kufitare për shuarjen e një zjarri masiv në afërsi të qendrave të banuara, në pyje-kullota në kufirin midis dy bashkive në rajonin Dervician – Lazarat” e organizuar nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, në bashkëpunim me të gjitha strukturat vendore.

Në rolin e vëzhguesit kanë qenë të pranishëm dhe kryetari i Bashkisë Gjirokastrë, znj. Zamira Rami, kryetari i Bashkisë Dropull, z. Ahilea Deçka, kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, z. Armand Hila, Drejtori i MZSH-së dhe z. Kujtim Bizhga.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut vlerësoi rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional për përballimin me sukses të rasteve emergjente në vazhdimësi. Stina e verës konsiderohet si periudha më kritike e vitit për rënien e zjarreve në pyje e kullota dhe në këtë kuadër, Prefekti i Qarkut ka kërkuar marrjen e masave të nevojshme nga të gjitha institucionet përgjegjëse për perandalimin dhe përballimin e situatave të mundshme që mund të krijohen si pasojë e rënies së zjarreve.

Në përfundim të stërvitjes, Prefekti i qarkut falenderoi forcat e MZSh-së, shërbimin e urgjencës mjekësore, grupet vullnetare dhe organizatorët për punën e realizuar.



23.04.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka qenë i pranishëm në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Koto Hoxhi” në kuadër të Ditës Botërore të Librit.

Dita Botërore e Librit organizohet çdo vit më 23 prill me qëllim promovimin e leximit, botimit dhe të drejtave të autorit. UNESCO ka zgjedhur këtë datë pasi përkon edhe me përvjetorin e lindjes e vdekjes të disa autorëve të spikatur botërorë si Miguel de Cervantes, Ëilliam Shakespeare etj.



Prefekti i qarkut ka vizituar klasën IX-D ku dhuroi disa libra për nxënësit e kësaj klase dhe për bibliotekën e shkollës. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe drejtori i shkollës z. Vezir Mamo, profesor z. Kristaq Shabani si dhe mësues të shkollës 9-vjeçare.

Prefekti i qarkut, në fjalën e tij theksoi domosdoshmërinë e librit si instrumenti më i fuqishëm i shpërndarjes së njohurive dhe mjeti më efikas për sigurimin e ruajtjes së këtyre njohurive, se çdo nismë për promovimin e librave të rinj është një faktor i pasurimit kulturor.

23.04.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar një takim mbi investimin për rikonstruksionin e kalldrëmeve të zonës së Pazarit në qytetin e Gjirokastrës. Në këtë takim ishin të pranishëm përfaqësues të firmës zbatuese nënkontraktore, përfaqësuesi i supervizimit të punimeve si dhe Drejtori Rajonal i Kulturës Kombëtare.

Qëllimi i këtij takimi ishte informimi i institucionit të Prefektit të qarkut për punën e kryer në objekt, për cilësinë e punimeve si dhe për zbatimin e grafikut të punimeve. Gjatë këtij takimi janë diskutuar gjithashtu edhe vështirësitë e hasura gjatë zbatimit të projektit si mungesa e zgjidhjeve teknike për disa probleme të objektit, mangësitë e furnizimit me bazë materiale për mbylljen e punimeve në infrastrukturën tokësore si dhe mungesa e drejtuesit teknik të licencuar të firmës kontraktore “Leon Construction”. Nga informacionet e marra punimet e infrastrukturës nëntokësore kanë qënë në përfundim. Gjithashtu ndërtimi i trotuarëve priten të përfundojnë brenda dy javëve të ardhshme, si dhe është duke u punuar për ndërtimin e kalldrëmeve në segmentet e përcaktuara.

Në përfundim të këtij takimi Prefekti i qarkut ka falenderuar pjesëmarrësit për punën e kryer si dhe kërkoi nga të pranishmit që këto takime të kryhen në mënyrë periodike çdo muaj në mënyrë që përfundimi i objektit të realizohet brenda afateve të parashikuara në grafikun e punimeve.



25.04.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore të 75-Vjetorit të formimit të Brigadës së VIII Sulmuese organizuar nga Komiteti i Dëshmorëve dhe Veteranëve të Bashkisë Libohovë, në fshatin Sheper të Njësisë Administrative Zagori.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe kryetari i Këshillit të Qarkut, z. Armand Hila, kryetari i bashkisë Libohovë, znj. Luiza Mandi, veteranë dhe familjarë të dëshmorëve të rënë.



Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut theksoi se është detyra jonë që të mbajmë lart vlerat, emrin dhe veprën e dëshmorëve të atdheut që dhanë jetën për liri. Brigada e VIII-të Sulmuese ka luftuar për çlirimin e qytetit të Gjirokastrës, Beratit, Lushnjës dhe Tiranës, si dhe jashtë kufijve shqiptarë duke u udhëhequr nga ndjenja e atdhetarizmit, kontribuan në përpjekjet për çlirimin e viseve kosovare.

Në përfundim të fjalës së tij, Prefekti i qarkut shprehu mirënjohjen dhe respektin ndaj dëshmorëve që dhanë jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, si dhe falenderoi organizatorët e kësaj ceremonie përkujtimore në nder të 75-vjetorit të formimit të Brigadës së VIII Sulmuese.

25.04.2019

Në ambientet e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi mbi “Finalizimin e procesit të emërimit të bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve në qarkun e Gjirokastrës dhe pajisjen me adresë të shtetasve shqiptarë”. Të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësues të Ministrisë së Brendshme, specialistë të Zyrave të Urbanistikës pranë njësive të vetëqeverisjes vendore dhe specialistë të Zyrave të Gjendjes Civile.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi i masave konkrete të marra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për finalizimin me sukses të objektivave të parashtruara në Planin e Masave sipas afateve kohore të parashikuara.

Deri më tani, bazuar në Planin e Masave të hartuar nga Ministria e Brendshme, janë ngritur grupet e punës në nivel prefekturë/bashkie dhe komisionet në nivel bashkie të cilët kanë evidentuar dublimet në emërtime dhe janë duke punuar aktualisht për përcaktimin e emërtimeve fillestare të bulevardeve, rrugëve, rrugicave, shesheve dhe parqeve të paemëruata ende në bashki/njësi administrative, duke i paraprirë kështu hapit të katërt të miratimit të propozimeve në emërtime të kryetarëve të njësive të vetëqeverisjes vendore nga këshillat bashkiakë.

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë kërkon angazhim maksimal të të gjitha institucioneve që marrin pjesë në realizimin e këtij procesi.



30.04.2019

Në kuadër të luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm, në ambientet e Pallatit të Kongreseve është zhvilluar Konferenca e Parë Kombëtare me temë "Aktorë të vijës së parë kundër ekstremizmit të dhunshëm", në të cilën i pranishëm ishte dhe Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm të gjithë aktorët e vijës së parë në nivel kombëtar, nga të gjitha ministrinë dhe agjencitë shtetërore të linjës.

Gjithashtu ishin të ftuar edhe përfaqësues të trupës diplomatike të akredituar në vendin tonë, organizatave ndërkombëtare, bashkësive fetare dhe medias, si dhe organizatave joqeveritare dhe sektorit privat.



Qëllimi i konferencës ishte forcimi i bashkërendimit, bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal dhe kombëtar mes agjencive qeveritare të ngarkuara nga Strategjia Kombëtare, për përcaktimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive të P/ CVE.

Gjatë zhvillimit të konferencës, çdo ministri e përfshirë në zgjidhjen e disa rasteve konkrete prezantoi ndërhyrjet dhe sfidat sipas specifikave të kompetencave dhe përgjegjësie përkatëse. Kjo konferencë parashtron angazhimin e qeverisë shqiptare për ruajtjen e vlerave të tolerancës dhe harmonisë fetare, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, shtetin e së drejtës dhe demokracisë, si dhe mbrojtjen e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

02.05.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z.Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim pune me personelin për përmbushjen e detyrave, për zgjidhjen e ankes-kërkesave të qytetarëve nga çdo sektor përkatës. Ky takim kishte në fokus disiplinën në punë, trajnimet e ndryshme me programet përkatëse për çdo punonjës të Administratës të Prefektit të qarkut Gjirokastrë që do të sillte një rritje të produktivitetit dhe performancës në punë. Në fund të takimit Prefekti i qarkut theksoi në fjalën e tij për një angazhim, ndërgjegjësim dhe komunikim të mirëfilltë në punë.



03.05.2019

Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, Z.Astrit Aliaj është zhvilluar analiza mujore mbi aktivitetin dhe veprimtarinë e Institucionit të Prefektit për muajin prill 2019. Analiza pasqyroi në detaje të gjithë treguesit e punës bazuar në planin e punës së Institucionit dhe objektivat e qeverisë.

Në këtë takim morrën pjesë përgjegjësit dhe specialistët e sektorëve përbërës të Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Çështjet kryesore që u trajtuan gjatë kësaj analize përfshinë kryesisht punën e realizuar dhe problematikat e evidentuara në këtë periudhë kohore. Më pas, shefat dhe specialistët e sektorëve diskutuan mbi ecurinë e deritanishme në zbatim të detyrave të planifikuara dhe nivelet e arritura. Në përfundim Prefekti, pasi vlerësoi arritjet dhe punën e bërë nga personeli, vuri theksin në rëndësinë që i duhet kushtuar përcaktimit të objektivave për të ardhmen. U dhanë rekomandimet e duhura me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të punës dhe performancës në çështjet, të cilat kërkojnë përkushtim dhe angazhim nga të gjitha strukturat.



05.05.2019

5 Maj, Dita e kujtimit të Dëshmorëve të Atdheut, është dëshmi e sakrificës sublime të djemve dhe vajzave të kësaj toke që jetën e tyre ia kushtuan idealeve kombëtare.

Nderimi për heroizmin e tyre sot shoqërohet nga krenaria jonë legjitime për hapat e hedhur drejt ëndrrës europiane.

Kujtimi dhe sakrifica e çdo dëshmori do të rrojë përjetësisht për t'i treguar kujtdo se asgjë nuk është e pamundur, nëse na udhëheq dashuria për Shqipërinë dhe dëshira e mirë për ta lartësuar emrin e saj ndër ne dhe jashtë saj.

Lavdi të përjetshme dëshmorëve të atdheut!



07.05.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z.Astrit Aliaj zhvilloi një takim me një përfaqësi ushtarake të Batalionit të Dytë të Këmborisë të Forcave Tokësore të Zallherit, ku u diskutua rreth stërvitjes që do të zhvillohet në territorin e qarkut Gjirokastrë gjatë periudhës shtator-tetor. Sipas komandantit të batalionit, qëllimi i kësaj stërvitjeje do të jetë rritja e ndikimit të Forcave të Armatosura te popullata e gjerë, sensibilizimi i komunitetit mbi rëndësinë e Forcave të Armatosura dhe njohja nga afër e qarkut të Gjirokastrës. Prefekti i qarkut nga ana e tij ofroi mbështetjen e pakursyer për realizimin sa më të suksesshëm të kësaj stërvitjeje duke koordinuar kështu veprimet me gjithë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjatë këtij takimi Prefekti nuk ka lënë pa përmendur me nderim edhe nëntetaren Zarife Hasanaj, ushtaraken që humbi jetën në krye të detyrës në bazën ushtarake Camp Adazi në Letoni, duke e vënë theksin edhe një herë në rëndësinë e Forcave të Armatosura jo vetëm në sigurinë e vendit.



07.05.2019

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, Z. Astrit Aliaj ishte i pranishëm në aktivitetin e zhvilluar në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Infermierëve, organizuar nga Urdhëri i Infermierëve të qarkut Gjirokastrë.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Presidentja e Urdhërit të Infermierit për Qarkun Gjirokastrë, Mimoza Llavdaniti, Përfaqësues nga Këshilli i Qarkut, Ylli Alike si dhe punonjës të sistemit të shërbimit shëndetësor të qarkut Gjirokastrë.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut vlerësoi punën e infermierëve në drejtim të shërbimit 24 orë ndaj pacientëve ku spikat humanizmi, profesionalizmi, gadishmëria dhe theksoi se ndër faktorët e shumtë që kontribuojnë në cilësinë e shërbimeve shëndetësore kanë të bëjnë me kompetencat e personelit ku rol të rëndësishëm luajnë edhe infermierët. Infermiera është një mision, profesion dhe shkencë me ndikim të fuqishëm në shërbimin publik. Gjatë zhvillimit të aktivitetit u shpërndanë disa çertifikata mirënjohjeje për infermierët e qarkut Gjirokastrë, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre për kujdesin shëndetësor dhe human ndaj komunitetit.

Në përfundim të fjalës, Prefekti shprehu vlerësimet e tij për rolin e infermierit duke iu uruar suksese të mëtejshme për të cilën kanë fituar respekt në profesionin e tyre fisnik i cili nuk njih as kohë dhe as moshë.



08.05.2019

Prefekti Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim me administratën e institucionit të Prefektit të Qarkut në lidhje me mbikëqyrjen e sjelljes së nënpunësit civil gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet e njëzive të vetëqeverisjes vendore, qershor 2019.

Qëllimi këtij takimi ishte njohja e punonjësve të administratës së Prefektit me Rregulloren e Brendshme, për të siguruar kështu parimin e meritës dhe paanësisë politike, mbi të cilin bazohet administrimi i shërbimit civil.

Në Institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është ngritur grupi i monitorimit, veprimtaria e të cilit do të jetë kontrolli i vazhdueshëm i nënpunësve civil në lidhje me realizimin e detyrave funksionale në shërbim të shtetit dhe qytetarëve si dhe me zbatimin e disiplinës formale në punë.

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, në fund të këtij takimi, e vuri theksin tek vijueshmëria normale e punës së administratës, pa u ndikuar nga fushata zgjedhore.



14.05.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi i Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit për qarkun e Gjirokastrës. Të pranishëm në këtë takim ishin anëtarë-përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore, degëve territoriale, si dhe përfaqësues të shoqatës lokale për turizmin që kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në zhvillimin e sektorit të turizmit në qarkun Gjirokastrë.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj në fjalën e tij vuri theksin tek problematikat të cilat kërkojnë vëmendjen e strukturave përkatëse dhe kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme për t'u ndjekur dhe monitoruar hap pas hapi nga këto struktura apo task-forca që do të funksionojë gjatë gjithë sezonit turistik 2019.

Prefekti i Qarkut, në cilësinë e drejtuesit të Komitetit Rajonal të Turizmit në përfundim të këtij takimi, shprehu angazhimin e tij se do të punojë në mënyrë të vazhdueshme, për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore dhe me degët territoriale për objektivin kryesor, zhvillimin e turizmit gjithëpërfshirës dhe gjithëvjetor në qarkun Gjirokastrë.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë dha rekomandimet përkatëse dhe kërkoi angazhimin maksimal në zbatimin e planit të veprimit dhe bashkëpunim ndër-institucional për çdo problematikë apo situatë, për një menaxhim sa më të mirë të sezonit turistik 2019.



15.05.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj priti në zyrën e tij një grup turistësh amerikanë. Prefekti pasi i uroi mirëseardhjen, bëri një prezantim të shkurtër të Institucionit të Prefektit në kuadër të zhvillimit të sektorit të turizmit në qarkun Gjirokastrë si një nga destinacionet turistike që ofron një larmishmëri vendesh tërheqëse për të vizituar.

Në fjalën e tij Prefekti theksoi se destinacion kryesor për çdo turist që vjen për herë të parë në Gjirokastrë është Kalaja, shtëpitë-muze e shumë atraksione tërheqëse të tjera, të cilat ruajnë brenda tyre jo vetëm bukuritë arkitekturore, por edhe vlera kulturore, historike, tradicionale.

Për këtë arsye z. Aliaj i ftoi të promovojnë Gjirokastrën duke qenë se është një qytet i mbrojtur nga UNESCO, si dhe njësitë administrative të qarkut me karakteristikat e tyre të veçanta.



17.05.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj priti në një takim Presidentin e Organizatës Ndërkombëtare të Asistencës Publike Humanitas, Itali, z. Roberto Schiavone, Drejtorin e Përgjithshëm të Universitetit të Lirë Popullor Humanitas z. Luigi Garbo Sorrento dhe Konsullin e Nderit të Italisë në Gjirokastrë z. Teodor Bilushi.

Me kërkesë të Prefektit të qarkut z. Astrit Aliaj, Presidenti i Organizatës Ndërkombëtare të Asistencës Publike Humanitas, Itali, z. Roberto Schiavone ka dhuruar një autoambulancë për qendrën shëndetësore të Bashkisë Këlcyrë.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut shprehu falenderimet dhe mirënjohjen për kontributin e çmuar të z. Roberto Schiavone, i cili me këtë akt tregoi se duhet të forcohet solidariteti, bashkëpunimi midis njerëzve dhe popujve duke vënë në themel humanizmin njerëzor. Nga ana e Presidentit të Organizatës Ndërkombëtare Humanitas u vlerësua mikëpritja dhe u shpreh se ky mision humanitar nuk do të jetë i fundit që po kryejmë në Shqipëri, por do të vijojmë me projekte të reja humanitare në shërbim të komunitetit shqiptar.

Në përfundim të këtij takimi u nënshkrua akti i dhurimit nga Dr. Prof. Roberto Schiavone dhe Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj për autoambulancën e dhuruar për Qendrën Shëndetësore të qytetit të Këlcyrës.



21.05.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj mori pjesë në aktivitetin “Stolitë tona” organizuar nga Këshilli i Qarkut Gjirokastrë në bashkëpunim me Parkun Arkeologjik Antigone/Adrianopol, në kuadër të hapjes së sezonit turistik për vitin 2019.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm deputetja e qarkut Gjirokastrë znj. Mirela Kumbaro, kandidati për kryetar bashkie për Gjirokastrën z. Flamur Golemi, kryetari i Këshillit të qarkut z. Armand Hila si dhe drejtues të institucioneve në nivel vendor.

Ky aktivitet i cili po kthehet në një traditë të përvitshme me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në qarkun tonë, u shoqërua nga një sërë veprimtarish artistike si parada e kostumeve tradicionale të krahinave të qarkut Gjirokastrë, ekspozita e punimeve artizanale, koncert me valle dhe këngë polifonike të performuara nga asamble të ndryshme të zonës së Gjirokastrës, Përmetit, Tepelenës, Libohovës, Dropullit dhe Delvinës.



21.05.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim me drejtues të degëve territoriale dhe inspektoriateve shtetërore vendore.

Ky takim u zhvillua në kuadër të forcimit të kapaciteteve në drejtim të intensifikimit të përpjekjeve të përbashkëta të strukturave shtetërore në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Në fjalën e tij, Prefekti vlerësoi arritjet dhe punët që është bërë nga institucionet përkatëse në kuadër të luftës kundër mbjelljes, kultivimit dhe trafikimit të kanabisit. Pavarësisht masave të ndërmarra dhe rezultateve të arritura, Prefekti theksoi se është e domosdoshme nevoja për vigjilencë të shtuar duke vijuar me një intensitet të lartë takimesh dhe kontrollesh në terren.

Në përfundim të takimit u kërkua nga të gjithë strukturat përgjegjëse, një bashkëpunim i ndërsjelltë dhe angazhim maksimal në drejtim të parandalimit, ndërgjegjësimit, sensibilizimit ndaj aksionin dhe luftës kundër kanabisit si një ndër prioritetet kryesore të kësaj qeverisje në prag të hapjes së negociatave me Bashkimin Europian.



24.05.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore të 75-vjetorit të Kongresit të Përmetit.

Të pranishëm gjithashtu në këtë ceremoni ishin N/Prefekti Përmetit, N/Kryetari i Bashkisë Përmet, Kryetari i Komitetit të Veteranëve të Shqipërisë si dhe Sekretari i Organizatës së Dëshmorëve.

Prefekti i qarkut në fjalën e tij u shpreh se është e rëndësishme të përkujtojmë këtë Kongres i cili i dha fund juridikisht monarkisë dhe hodhithemelet për një Shqipëri të Lirë dhe Demokratike. Data 24 Maj e vitit 1944, pa dyshim që zotëron peshën e saj eventuale në zhvillimet historike të shtetit shqiptar, pavarësisht nga të gjitha ngjyrimet që i janë veshur me kalimin e dekadave. Vendimi më i rëndësishëm i këtij kongresi ishte kalimi i luftës së popullit shqiptar nga faza e luftës partizane, në një luftë të rregullt e me veprime të mëdha të bashkërenduara dhe krijimi i një Shqipërie të re dhe demokratike.

Prefekti i qarkut nuk la pa përmendur as rolin e qytetarëve të Përmetit, të cilët edhe në këtë rast treguan bujarinë dhe mikpritjen që i karakterizon ndërsa e mbylli fjalën e tij duke shprehur nderimet më të larta për veprën e Kongresit të Përmetit.



27.05.2019

Është zhvilluar në ambientet e Pallatit të Kulturës Tepelenë takimi i zgjeruar i Task-Forcës Vendore të Luftës kundër Trafikimit dhe Kultivimit të Kanabisit. Në këtë takim morën pjesë Zv. Ministria e Brendshme dhe njëkohësisht drejtuese e Task-Forcës Qendrore e Luftës kundër Trafikimit dhe Kultivimit të Kanabisit znj. Rovena Voda, Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë znj. Aida Hajnaj, kryetari i Bashkisë Tepelenë z. Tërmet Peçi, Drejtori Vendor i Policisë z. Perlat Vatoci si dhe pjesëtarë të tjerë të Task-Forcës Vendore. Ky takim u zhvillua në kuadër të forcimit të kapaciteteve në drejtim të intensifikimit të përpjekjeve të përbashkëta të strukturave shtetërore në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut vlerësoi arritjet dhe punën e bërë nga institucionet përgjegjëse në kuadër të luftës kundër mbjelljes, kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

Pavarësisht masave të ndërmara dhe rezultateve të arritura, Prefekti theksoi se është e domosdoshme nevoja për vigjilencë të shtuar duke vijuar me një intensitet të lartë takimesh dhe kontrollesh në terren.

Nga ana e saj Zv. Ministria e Brendshme znj. Voda kërkoi nga strukturat përgjegjëse plane kontrolli veprimi në terren me data të paracaktuara nën monitorimin e Prefektit të qarkut dhe tolerancë zero në luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.



28.05.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z.Astrit Aliaj zhvilloi një takim me drejtorin e Policisë Vendore, Gjirokastrë z.Perlat Vatoci, Nënkryetarin e bashkisë Gjirokastrë z.Aurel Lapa, Kryeinspektorin e pyjeve dhe mjedisit z. Dino Selimi, drejtorin e Zonave të Mbrojtura z.Gligor Dushi. Ky takim kishte në fokus krijimin e grupeve të punës në terren me pjesëmarrjen e punonjësve të bashkisë, inspektoriatit shtetëror të mjedisit, zonave të mbrojtura për kontrollin e territorit për kultivimin dhe trafikimin e kanabisit. Në fund të takimit Prefekti i qarkut ofroi mbështetjen e tij për eliminimin e fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike.



28.05.2019

Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, z.Astrit Aliaj u zhvillua një takim me antarët e Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë, pranë Prefektit për organizimin e një takimi të zgjeruar që do të zhvillohet më datë 29.05.2019 me drejtoritë dhe zyrtarë që merren me problemet e tokës bujqësore.

Ky takim zhvillohet për të parë kuadrin e ri ligjor dhe për të analizuar ecurinë e procesit të kalimit në pronësi të tokës bujqësore.



29.05.2019

Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, z. Astrit Aliaj është zhvilluar një takim i zgjeruar për të analizuar procesin e kalimit të tokës në pronësi si dhe për të trajtuar problematikat e pazgjidhura. Në këtë takim morën pjesë drejtues të Drejtorive Vendore të ASHK, Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut, përfaqësuesve të ISSH Gjirokastrë dhe përfaqësuesve të zyrave të pronave pranë bashkive të qarkut.

Në fjalën e tij Prefekti i Qarkut theksoi vëmendjen dhe përkushtimin e Qeverisë Shqiptare për zgjidhjen e problemit të pronave në përgjithësi dhe të tokës bujqësore në veçanti. Kjo vëmendje e shtuar vjen pasi edhe pse kanë kaluar 27 vjet nga ndarja e tokës, ende nuk ka përfunduar procesi i pajisjes së qytetarëve me tituj definitiv pronësie. Për këtë arsye janë marrë nga Qeveria Shqiptare një sërë masash që konsistojnë në përmirësimin e kuadrit ligjor dhe ngritjen e strukturave sa më efikase për përmbylljen brenda afateve kohore të këtij procesi.

Nga ana e Prefektit të qarkut u tërhoq vëmendja për punën e pamjaftueshme që kanë bërë njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesave dhe sensibilizimin e qytetarëve që përfitojnë nga ky proces.

Në përfundim të takimit, Prefekti i Qarkut ka përcaktuar detyra konkrete, bazuar në ligjet dhe VKM-të që rregullojnë marrëdhëniet midis institucioneve si raportimi periodik për numrin e kërkesave dhe AMTP-ve të plotësuara, rritjen e bashkëpunimit midis institucioneve që janë të angazhuara në këtë proces.



30.05.2019

Në kuadër të detyrave të caktuara nga Zv. Ministria e Brendshme znj. Rovena Voda, në takimin e fundit të Task-Forcës Vendore Antikanabis, Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj, ka zhvilluar takime në Gjirokastrë, Dropull, Libohovë, Përmet dhe Këlcyrë për ngritjen e grupeve të përbashkëta për kontrollin e territorit në çdo njësi administrative të qarkut.

Në këto takime kanë marrë pjesë kryetarët e bashkive, drejtues të Policisë Vendore dhe të Komisariateve, përfaqësues të AZDM-së, ISHMPUT-së, njësive administrative, shërbimeve pyjore, sektorit të bujqësisë dhe DRKK-së ku përfaqësues të këtyre institucioneve përgjegjëse do të jenë anëtarë të grupeve të përbashkëta për kontrollin e territorit.

Prefekti i Qarkut në fjalën e tij është ndalur në:

- Sensibilizimin e komunitetit dhe ndërgjegjësimin e të gjitha shtresave të popullsisë për rrezikshmërinë, pasojat që ka fenomeni i kultivimit të bimëve narkotike në jetën shoqërore e familjare të qytetarëve;

- Në angazhimin e bashkive në luftën kundër kultivimit të kanabisit duke vendosur në funksion të kësaj pune administratorët e njësisive, kryetarët e fshatrave, komunitetin e këtyre njësisive, shërbimet pyjore ato të bujqësisë;
- Strukturat e specializuara të policisë të planizojnë dhe të zbatojnë të gjitha detyrimet ligjore në luftën kundër këtij fenomeni si dhe të zhvillojnë takime me përfaqësues të pushtetit vendor, të komunitetit, njësisive administrative, kryetarët e fshatrave në shkolla për pasojat e kultivimit e trafikimit të lëndëve narkotike;
- Përsosjen e mëtejshme të punës së të gjitha strukturave si në shkëmbimin e informacionit e të eksperiencës deri në mbështetjen e aksioneve të ndërsjellta nga institucione të ndryshme;
- Grupet e kontrollit të territorit të instruktohen e të kryejnë me përgjegjësi detyrimet që kanë duke zbatuar të gjitha procedurat ligjore;

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut theksoi se një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet territoreve të ashtuquajtura të "nxehta" sidomos në njësitë administrative më problematike për tokat pa pronarë, territoret e largëta e të thella, të serave, tuneleve dhe objekteve publike të pa privatizuara.

Gjatë këtyre takimeve janë zhvilluar diskutime nga përfaqësues të këtyre institucioneve për punën e bërë dhe problemeve me të cilat janë ndeshur gjatë kryerjes së detyrave.



05.06.2019

Në ambientet e bashkisë Memaliaj nën drejtimin e Prefektit të qarkut u zhvillua një takim për krijimin e grupeve të përbashkëta të kontrollit të territorit për evidentimin e rasteve të mundshme të kultivimit të kanabisit. Në këtë takim morën pjesë kryetari i bashkisë Memaliaj, drejtori i drejtorisë vendore të policisë, inspektorë të IShMP- së në qark, administratorë të njësisive administrative dhe të kryetarëve të fshatrave të bashkisë Memaliaj.

Në fjalën e tij, Prefekti vlerësoi angazhimin e treguar nga strukturat e bashkisë Memaliaj dhe Policisë së Shtetit për punën e bërë deri më tani në luftimin e fenomenit të kultivimit të bimëve narkotike, por kërkoi nga strukturat e bashkisë Memaliaj një punë me efektive pasi janë evidentuar raste të këtij fenomeni në disa zona.

Prefekti i qarkut falënderoi bashkëpunimin midis institucioneve dhe kërkoi që ky bashkëpunim të vazhdojë dhe më tej. Nga ana e tij Prefekti i qarkut kërkoi që të diskutohej nga kryetarët e njësisive administrative dhe kryetarëve të fshatit për masat që duhen marrë në luftën kundër fenomenit të kultivimit të kanabisit.

Në përfundim të takimit, Prefekti i qarkut bëri me dije angazhimin dhe masat e marra nga qeveria për luftimin e fenomenit dhe kërkoi nga të gjitha strukturat rezultate konkrete brenda datës 15 qershor, me qëllim që në territorin e bashkisë Memaliaj dhe më gjerë të mos ketë asnjë rast të kultivimit të bimëve narkotike.



05.06.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë, z. Astrit Aliaj priti në një takim vëzhguesit afatgjatë të OSBE-ODIR në kuadër të zgjedhjeve vendore 2019. Përfaqësuesit e OSBE-së znj. Stephanie Marsal dhe z. Ilgiz Kambaroy, në cilësinë e vëzhguesve të procesit zgjedhor po zhvillojnë takime të njëpasnjëshme me të gjithë aktorët përgjegjës në qark për të vlerësuar më tej ecurinë e këtij procesi nëse ai është në përputhje me angazhimet e OSBE-ODIR, standardeve të tjera ndërkombëtare si dhe me legjislacionin vendas.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut bëri një pasqyrim të detyrimeve të institucionit të Prefektit dhe masave që janë ndërmarrë për procesin e zgjedhjeve si :

Përcaktimin e vendnumërimit të votave për KZAZ-në,

Numrin e anëtarëve të këshillit bashkiak në çdo bashki të qarkut.

Hartimin e rregullores së brendshme për mbikqyrjen e punonjësve të administratës së Prefektit gjatë periudhës së zgjedhjeve.

Në përfundim të takimit, vëzhguesit e OSBE-së falenderuan dhe vlerësuan institucionin e Prefektit për masat e marra në kuadër të zhvillimit të procesit zgjedhor në qark si dhe vlerësuan pozitivisht qarkun Gjirokastrë si një nga destinacionet turistike më tërheqëse të Shqipërisë. Prefekti i qarkut ofroi gjithë mbështetjen institucionale për realizimin e misionit që do të kryejnë në vazhdimësi dy vëzhguesit afatgjatë të OSBE-ODIR.



06.06.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi i radhës i Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave për qarkun Gjirokastrë “Për marrjen e masave në përballimin e zjarreve në pyje e kullota” për stinën e verës.

Në këtë takim morën pjesë drejtues të njësive të vetëqeverisjes vendore, drejtues të Drejtorisë Vendore të Policisë, drejtues të stacioneve të MZSH-ve pranë bashkive të qarkut si dhe drejtues të ISHMPUT e Seksionit të Bujqësisë dhe drejtues të strukturave të emergjencave civile të njësive të vetëqeverisjes vendore të qarkut.

Gjatë këtij takimi u analizua situata e zjarreve përgjatë vitit të kaluar dhe faktorët të cilët janë bërë shkak për krijimin këtyre situatave.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj kërkoi nga institucionet përgjegjëse një planifikim të detajuar masash organizative, rritje të aftësive drejtuese, bashkëpunim ndërinstitucional dhe koordinim të veprimeve për parandalimin dhe përballimin e situatave emergjente që mund të krijohen nga zjarret në pyje e kullota.

Gjithashtu Prefekti i qarkut kërkoi nga autoritetet ligjzbatuese identifikimin dhe vënien përpara përgjegjesisë të autorëve të mundshëm të zjarrvënies së qëllimshme.

Në përfundim të këtij takimi nga ana e Prefektit të qarkut u lanë disa rekomandime për zbatim për të gjitha institucionet pjesëmarrëse në këtë Komision.



06.06.2019

Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi tokën bujqësore, pranë Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, zhvilloi nën drejtimin e Prefektit të Qarkut, z. Astrit Aliaj, takimin e radhës për marrjen e vendimeve për vlefshmërinë ligjore të disa AMTP-ve.

Në këtë takim u arrit marrja e një vendimi për rikonfirmim AMTP-je dhe një vendim për përfundim të procedurës së verifikimit të vlefshmërisë ligjore.

Duke parë numrin e lartë të kërkesave të depozituara dhe interesimin e madh të Qeverisë për përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë mbi tokën, nga ana e Prefektit u kërkua rritja e ritmit të punës për të bërë të mundur përfundimin e shqyrtimit të kërkesave të subjekteve të ndryshme, pasi sipas ligjit 10/2019, afati për përfundimin e këtij procesi është data 31.12.2019.



07.06.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ishte i pranishëm në Panairin Rajonal të punës, aktivitet i organizuar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit në bashkëpunim me Zyrën Rajonale të punës së Gjirokastrës.

Panairi Rajonal i Punës Gjirokastër synon të vendosë marrëdhënie konkrete bashkëpunimi dhe komunikimi, midis kërkesës dhe ofertës në Tregun e Punës, si dhe të prezantojë mundësitë që ofron ky treg në rajonin e Gjirokastrës, për të gjetur mënyra të vlefshme në plotësimin e vendeve të lira të punës. Gjithashtu një objektiv tjetër është dhe prezantimi i nevojave për aftësi, zhvillimin e karrierës dhe mundësi dhe ide për kualifikim e formim profesional.

Prefekti i qarkut vizitoi nga afër standat e subjekteve që ofrojnë vende punësimi, ku mori dhe shkëmbeu informacion mbi nevojat dhe shqetësimet e punëdhënësve. Në çdo standë u bë prezantimi i secilit subjekt pjesëmarrës në këtë panair, produkteve të tyre dhe mundësitë që ofronin për punësim.

Panairi Rajonal i punës kishte një pjesëmarrje të aktorëve kryesorë të interesuar për punësimin në Qarkun Gjirokastër, si: hoteleri, industri përpunuese, në fushën e ndërtimit, ku së bashku prezantuan rreth 390 vende të lira pune, por edhe shumë mundësi të tjera formimi profesional për ata që duan të fillojnë një profesion të ri apo ata që duan të zhvillohen më shumë në karrierë.



09.06.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, mori pjesë në aktivitetin e çeljes së sezonit turistik në bashkinë e Këlcyrës.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm kryetari i bashkisë Këlcyrë, z. Klement Ndoni, kryetari i shoqatës "Përmeti", z. Altin Meshini, kryetari i Këshillit Bashkiak Këlcyrë etj.

Ky aktivitet, i cili u organizua për herë të parë këtë vit dhe çeli siparin për sezonin turistik 2019, kishte për qëllim promovimin e produkteve të zonës dhe inkurajimin e të gjithë bizneseve në Këlcyrë.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut vlerësoi zonën e bashkisë Këlcyrë si një nga atraksionet më tërheqëse të qarkut Gjirokastër me një numër të konsiderueshëm në rritje vizitorësh vit pas viti, gjë e cila kërkon padyshim rritjen e kapaciteteve pritëse, akomoduese dhe përmirësimin e shërbimeve të ofruara. Zhvillimi i sektorit të bujqësisë ndikon padyshim edhe në ekonominë e familjeve vendase. Prefekti i qarkut ofroi gjithë mbështetjen institucionale për çdo nismë që bashkitë e qarkut ndërmarrin për të promovuar vlerat e tyre turistike.



10.06.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka pritur në ambientet e institucionit të Prefektit, mësues dhe nxënës me origjinë shqiptare nga Ukraina. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja nga afër me historinë, kulturën, gjuhën, traditat e zakonet shqiptare, me vendin e origjinës së paraardhësve të tyre.



Në fjalën e tij përshëndetëse Prefekti i qarkut i uroi mirëseardhjen dhe i falënderoi për vizitën e veçantë në qytetin e Gjirokastrës, njëkohësisht edhe origjina e shumë personaliteteve të njohura si Eqrem Çabej, Ismail Kadaresë, Musine Kokalarit etj.

Prefekti i qarkut theksoi datën e sotme si një ditë historike e simbolike në historinë e Kombit Shqiptar, Dita e Lidhjes së Pizrenit. Me anë të copëzave të historisë shqiptare, Prefekti inkurajoi nxënësit të përdorin burimet e shumta të informacionit për t'u njohur edhe më shumë me historinë dhe vlerat e vendit tonë, në mënyrë që të mbajnë gjallë kulturën e prejardhjes së tyre.

Mësuesit dhe nxënësit nga Ukraina falënderuan Prefektin e qarkut për mikëpritjen e ngrohtë dhe shprehën vlerësimet e tyre pozitive për qytetin e gurtë dhe Shqipërinë. Në përfundim të kësaj vizite, Prefekti i qarkut i ka dhuruar nxënësve libra artistik të përkthyer në gjuhën shqipe të autorëve të huaj dhe atyre shqiptarë, si një kujtim simbolik nga vendi i tyre i origjinës.

11.06.2019

Në kuadër të Zhvillimit Rajonal të Qarkut dhe në zbatim të politikave të Qeverisë shqiptare për rëndësinë e veçantë që i jepet programeve të investimeve për uljen e papunësisë dhe rritjes së kapaciteteve të tregut të punës, Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka vizituar nga afër punishten e përpunimit të ullirit “Elia-Ulliri” Sh.p.k.

Gjatë takimit të punës me administratorin e firmës, Prefekti i qarkut falënderoi për investimin në aktivitetin e ngritur në bashkinë Dropull dhe për kontributin e rëndësishëm që ky aktivitet jep në zhvillimin ekonomik të qarkut.

Fabrika e përpunimit të ullirit ka rreth 3 vite që ushtron aktivitetin e saj në fshatin Jorgucat, njësi administrative Dropull i sipërm, bashkia Dropull, me 75 punonjës të cilët përpunojnë ullirin si lëndë e parë që importohet nga Greqia dhe pasi bëhet mbushja e tyre rikthehet në vendin e origjinës. Gjithashtu firma “Elia-Ulliri” Sh.p.k ka filialin e saj edhe në bashkinë e Delvinës me rreth 70 punonjës.



Prefekti i qarkut theksoi se do t'i qëndroj korrekt problematikave që ka ngritur administratori i firmës, për të mundësuar vijueshmërinë sa më të mirë të zhvillimit të kësaj punishteje si dhe krijimin e një klime më të mirë bashkëpunimi, mbështetjeje dhe besimi në kuadër të rritjes së sipërmarrësve të huaj që kanë dëshirë të investojnë në qarkun tonë.

18.06.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim në Komisaratin e Policisë Përmet në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional për mbarëvajtjen e procesit të zgjedhjeve vendore 2019 si dhe luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike.

Në takimin e zhvilluar Shefi i Komisarimit të Përmetit z. Petrit Gjokaza ka shprehur gadishmërinë dhe angazhimin e tij maksimal në monitorimin e mbarëvajtjes së procesit zgjedhor dhe pajisjes së qendrave KZAZ me pajisjet e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij procesi.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj është shprehur se brenda datës 29 duhet të sigurojmë mbarëvajtjen e këtij procesi duke patur kujdes maksimal në ushtrimin e detyrës nga ana e forcave të policisë, qoftë edhe për cilësinë e personave që hyjnë e dalin nën statusin e turistit, duke garantuar kështu një proces zgjedhor të qetë e bashkëkohor ashtu si çdo vend tjetër i lirë e demokratik.



18.06.2019

Është zhvilluar në Qendrën Multifunktionale Përmet takimi mbi “Aplikimin e Direktivës në Kuadër të Ujit dhe Politikave të Iniciativave të Bashkimit Europian” me pjesëmarrjen e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit si partner lider i projektit dhe katër partnerëve të tjerë greke e shqiptare.

Projekti Aquanex “Ruajtja dhe sigurimi i cilësisë së trupave ujore sipërfaqësore në Greqi dhe Shqipëri duke përdorur teknikat e vëzhgimit të tokës” është një projekt ndërkufitar i financuar nga BE në kuadër të programit IPA Interreg Greqi-Shqipëri 2014-2020”.

Qëllimi i organizimit të këtij seminari, me pjesëmarrjen e autoriteteve kombëtare e lokale, ishte përfrimi i Direktivës dhe Metodologjisë për monitorimin e ujërave sipërfaqësore në basenin e lumit Vjosa dhe Drino. Risia e këtij eventi qëndron tek prezantimi i aktorëve lokale me metodologjinë e monitorimit ndërkufitar të ujërave sipërfaqësore me teknikat e vëzhgimit të tokës, nëpërmjet imazheve satelitore në zbatim të direktivës së ujit, në basenin e lumit Vjosa si zonë e zbatimit të projektit ndërkufitar IPA Greqi-Shqipëri.

“Investimet e vërteta që vijnë nga BE janë të fokusuara në zhvillimin e turizmit veçanërisht në zonën e Përmetit, duke e transformuar atë në një pol të rëndësishëm jugor për zhvillimin e agroturizmit, kulinarisë e vlerave arkeologjike” është shprehur në fjalën e tij Ministri i Mjedisit z. Blendi Klosi. Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkufitar në kuadër të mbrojtjes së vlerave natyrore e kulturore, duke ofruar të gjithë mbështetjen e institucionit që ai drejton në implementimin e projekteve të tilla të një rëndësie të lartë.



19.06.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë priti në zyrën e tij qytetarë të fshatit Taroninë, njësi administrative Cepo, bashkia Gjirokastrë.

Banorët e zonës ngritën një shqetësim lidhur me kanalin vaditës të fshatit të tyre që është dëmtuar për shkak të punimeve që po zhvillohen në autostradën Ura e Kardhiqit – Delvinë. Prefekti i qarkut ofroi mbështetjen institucionale si dhe garantoj për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit të banorëve të fshatit Taroninë.



26.06.2019

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, z. Astrit Aliaj ka qenë i pranishëm në ambientet e Teatrit “Zihni Sako” në kuadër të dhënies së titullit “Nderi i Qarkut Gjirokastrë” trashëgimtarëve të denjë të atdhetarisë, të ish-partizanëve për kontributin e shquar në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare, si dhe në punë pas përfundimit të luftës.

Në këtë ceremoni të ndarjes së titujve të nderit të ish-partizanëve Sadik Bocaj, Rukie Gjoça Aliaj, Dalip Guçe dhe Asllan Veizi, morën pjesë Kryetari i Këshillit të Qarkut z. Armand Hila, Kryetari i Shoqatës së Veteranëve z. Hodo Liço, veteranë dhe familjarë të afërt të ish-partizanëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Prefekti i qarkut vlerësoi dhe përkujtoi sakrificën dhe veprat e ish-partizanëve, të cilët kontribuan në luftë dhe në punë si në fushën e ekonomisë dhe më gjerë për të ardhmen e qarkut tonë. Gjithashtu theksoi se nderimi për kontributin është detyrim yni që veprën dhe historinë t’ua trashëgojmë brezave që vijnë dhe të shërbejnë si model për të rinjtë në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin e vendit tonë, për një Shqipëri me vlera demokratike.



28.06.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim pune me drejtuesit e institucioneve shtetërore në nivel vendor në kuadër të marrjes së masave paraprake për mbarëvajtjen e Zgjedhjeve Vendore të datës 30 qershor.

Në këtë takim morën pjesë drejtori i Drejtorisë së policisë Gjirokastrë z. Perlat Vatoci, drejtori i Drejtorisë Vendore të OSHEE-së z. Robert Lili, drejtoreshë ISKSh -së Gjirokastrë znj. Anxhela Hoxha, drejtori i Njesive Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë z. Shpëtim Novi, si dhe përfaqësues të degëve territoriale nga bashkia e Përmetit dhe Tepelenë. Në fjalën e tij, Prefekti i Qarkut pasqyroi masat që ka marrë institucioni në zbatim të detyrimeve që janë të përcaktuara në Kodin Zgjedhor, të tilla si : përcaktimin e ambienteve dhe pajisjen me bazë materiale të zyrave Rajonale Zgjedhore për Qarkun Gjirokastrë. Prefekti i Qarkut kërkoi nga të gjitha strukturat përkatëse marrjen e masave të nevojshme duke vijuar si më poshtë:

1. Nga ana e Drejtorisë Vendore e Policisë Gjirokastrë së bashku me Komisaritet në të gjithë qarkun të ushtrohet me përpikmëri të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me procesin zgjedhor dhe të shmangë çdo formë presioni apo provokimi nga persona apo grupe të caktuara që mund të tentojnë të prishin rendin apo të çënojnë procesin zgjedhor.
2. Nga ana e Zyrave Vendore Arsimore Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet të orientojnë drejtoritë e shkollave të caktuara si Qendra Votimi për të bashkëpunuar në dorëzimin e ambienteve sipas kërkesave të ligjit Komisioneve të QV-së.
3. Nga ana e Drejtorisë Rajonale dhe atyre vendore të OSHEE të merren masa për mirëmbajtjen e sistemit dhe furnizimin e energjisë të pandërprerë në të gjithë qarkun për zhvillimin normal të procesit zgjedhor dhe jetës normale të qytetarëve.
4. Nga ana e Njesive Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet të merren masa për shërbimin shëndetësor nisur dhe nga temperaturat e larta të këtyre ditëve si dhe të mbajnë në gatishmëri ambientet në administrim të tyre nëse do të kërkohen të vihen në dispozicion të procesit zgjedhor.

Në përfundim të fjalës, Prefekti theksoi se do të ndjekë dhe do të monitorojë në vazhdimësi veprimtarinë e institucioneve për të garantuar zhvillimin e një procesi normal zgjedhor.



28.06.2019

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë është zhvilluar analiza 6-mujore e veprimtarisë së institucionit për periudhën janar - qershor 2019.

Gjatë kësaj analize janë prezantuar objektivat e arritura bazuar në detyrat sektoriale si dhe janë evidentuar problematikat e hasura në fushat e përgjegjësive përgjatë kësaj periudhe.

Nisur nga problemet e parashtruara, Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e respektimit të afateve ligjore në kthimin e përgjigjeve të shkresave zyrtare për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të ardhura nga qytetarët në kohë, në bashkëpunim kjo edhe me institucionet shtetërore përgjegjëse në nivel qendror e vendor.



09.07.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi i punës me aktorët përgjegjës të përfshirë në projektin “Rehabilitimi i infrastrukturës dhe restaurimit të kalldrëmeve” në Qafën e Pazarit, lidhur me ankesën e komunitetit të bizneseve në këtë zonë, për organizimin e shkarkimit të ujërave të shiut nga çatitë e Qafës së Pazarit në qytetin e Gjirokastrës.



Të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësuesi i supervizimit të punimeve, përfaqësues të firmës zbatuese nënkontraktore si dhe Drejtori Rajonal i Kulturës Kombëtare. Lidhur me kërkesën e bërë nga bizneset, nga ana e të pranishmeve është pranuar, pas shumë diskutimesh të bëra, edhe në një tryeze teknike me përfaqësues të Ministrisë së Kulturës, pamundësia teknike për futjen e shkarkimit të ujërave të çatave në rrjetin e sapo ndërtuar të largimit të ujërave të shiut.

Punimet për këtë ndryshim do të kërkonin prishje të shumta të shtresave të realizuara në trotuare dhe çdo defekt i tyre me kalimin e kohës do të jetë i vështirë për t'u riparuar, duke shkaktuar probleme në rrjetin elektrik dhe rrjetin e fibrës optike për shkak të lagështirës.

Nga informacionet e marra lidhur me punën e deritanishme të kryer në objekt, punimet e infrastrukturës nëntokësore kanë përfunduar, ndërtimi i trotuareve është realizuar në masën 90% si dhe është duke u punuar për ndërtimin e kalldrëmit në segmentet e përcaktuara.

16.07.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka qënë i pranishëm në analizën 6-mujore të Drejtorisë Rajonale Gjirokastrë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, për periudhën janar - qershor 2019, të zhvilluar në ambientet e kësaj drejtorie.

Të pranishëm gjatë kësaj analize ishin drejtuesit e Zyrës Vendore të Punësimit Tepelenë dhe Përmet, drejtori i DR të Formimit Profesional Publik, Gjirokastrë z. Sulo Mucobega dhe drejtoresha e DR të Shërbimit Social Shtetëror, Gjirokastrë znj. Magdalena Margariti. Në fjalën hapëse të drejtorit të DR Gjirokastrë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, z. Eduart Pasha bëri një prezantim të detyrave të kryera për veprimtarinë 6-mujore duke i pasqyruar në statistika sipas kategorive të caktuara. Gjatë kësaj analize u diskutuan objektivat e realizuara për periudhën janar - qershor, problematikat e hasura, aktivitetet e takimet e ndryshme që ka organizuar DR Gjirokastrë të Shërbimit Kombëtar të Punësimit në bashkëpunim me institucionet e tjera shtetërore dhe subjektet private.

Në përfundim të takimit, Prefekti i qarkut vlerësoi punën e kryer deri më tani dhe frymën e bashkëpunimit, e cila duhet të shtrihet edhe më gjerë mes institucioneve shtetërore dhe subjekteve private në kuadër të punësimit të personave me aftësi të kufizuara dhe atyre mbi moshën 50-vjeçare, duke lënë rekomandimet përkatëse dhe duke ofruar mbështetjen e vazhdueshme institucionale të Prefektit të qarkut.



17.07.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj mori pjesë në ceremoninë përkujtimore të zhvilluar në sheshin “Çerçiz Topulli” me rastin e 75-Vjetorit të rënies së dy Heroinave të Popullit, Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima.

Në këtë ceremoni morën pjesë kryetari i Këshillit të Qarkut z. Armand Hila, kryetari i Bashkisë Gjirokastrë znj. Zamira Rami, z. Flamur Golemi, përfaqësues veteranë të LANÇ si dhe përfaqësues të institucioneve të tjera shtetërore në nivel vendor.

Prefekti i qarkut në nderim të jetës dhe veprës së tyre vendosi një kurorë me lule në emër të të gjithë institucionit që ai drejton.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut vlerësoi kontributin e madh të dëshmorëve të luftës dhe shprehu mirënjohjen, respektin, përvuljen ndaj heronjve, të cilët dhanë jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare. Vepra e tyre duhet të shërbejë si shembull frymëzimi duke u respektuar përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.



18.07.2019

Prefekti i Qarkut, z. Astrit Aliaj, zhvilloi një takim pune me Përgjegjës të Sekretariatit Teknik të Tokës z. Ramadan Kananaj, ku u diskutua lidhur me problematikat e hasura nga KVVTP, pranë Prefektit të Qarkut.



Nga ana e Prefektit u theksua gama e gjerë e problemeve të pronës tokë bujqësore, si pamundësia e shumë subjekteve për të regjistruar AMTP, si pasojë e korrigjimeve të tyre apo mangësitë e ndryshme në dokumentacionin e kërkuar dhe ju kërkua z. Kananaj që të shkurtohen procedurat e miratimit të vendimeve që merren nga KVVTP.

Nga ana e tij z. Kananaj theksoi se për zgjidhjen e gjithë problematikës së tokës bujqësore dhe pronave në përgjithësi është gati për miratim një paketë dispozitash kalimtare, e cila do bëjë të mundur shkurtimin e afateve kohore dhe të procedurave për regjistrim të AMTP.

23.07.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka pritur në ambientet e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë shkrimtarët e Shoqatës Kulturore-Artistike "Migjeni", e cila prej shumë vitesh kryen veprimtarinë e saj në qytetin Boras të Suedisë.

Kjo shoqatë në bashkëpunim me Lidhjen Ndërkombëtare të Poetëve dhe Shkrimtarëve "Pegasi Albania" në kuadër të ditës ndërkombëtare Pegasiane të Letërsisë Bashkëkohore zhvilloi në shtëpinë e shkrimtarit Ismail Kadare veprimtarinë letrare ndërkombëtare "Muza Poetike Pegasi 2019", me pjesëmarrjen e poetëve dhe shkrimtarëve Sokol Demaku, Rizah Sheqiri, Hamit Gurguri, Kristaq Shabani etj.

Gjatë takimit me Prefektin e qarkut Gjirokastrë, shkrimtarët kërkuan mbështetje institucionale për të çuar më tej misionin e tyre për promovimin e vlerave artistike e kulturore të Shqipërisë. Gjithashtu gjatë këtij takimi u fol mbi mundësinë e një shkëmbimi kulturor mes dy vendeve dhe mundësinë e hapjes së një shtëpie kulture skandinave në qytetin e Gjirokastrës.

Nga ana e tij Prefekti i qarkut vlerësoi përpjekjet e shumta të shkrimtarëve shqiptarë për ruajtjen e gjuhës shqipe në Suedi dhe u shpreh i gatshëm për të mbështetur projektet e tyre në kuadër të promovimit, të ruajtjes së identitetit, vlerave dhe traditave të shqiptarëve.



24.07.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi i punës me drejtues të degëve territoriale dhe inspektoriateve shtetërore në kuadër të luftës kundër informalitetit dhe mbarëvajtjes së sezonit turistik.

Të pranishëm në këtë takim ishin Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore, Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë, Drejtori i Autoritetit Rrugor Jugor, Kryeinspektori i Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Drejtori i AKU Gjirokastrë si dhe Drejtori i Administratës Shtetërore të Zonave të Mbrojtura.

Në kuadër të luftës kundër informalitetit Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e planeve të përbashkëta të inspektimit duke evituar inspektimet individuale, në mënyrë që të mos rëndohet veprimtaria e subjekteve tregtare apo turistike. Gjithashtu Prefekti i qarkut kërkoi angazhim maksimal nga të gjitha strukturat vendore në qark për një koordinim të përbashkët në luftën kundër informalitetit.

Në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik nga ana e Prefektit të qarkut është kërkuar që të merren masa nga Drejtoria e Policisë Vendore me qëllim mbështetjen e turistëve, operatorëve dhe bizneseve duke mos lejuar manipulimin e tyre nga individë apo subjekte të papërgjegjshëm që mundohen të shtrytëzojnë mundësitë e krijuara nga flukset turistike.

Në përfundim të takimit Prefekti i qarkut theksoi se lufta kundër informalitetit është një vullnet i fortë i qeverisë shqiptare për të garantuar rregulla të barabarta në treg, për të mbështetur biznesin që respekton rregullat dhe që punon në mënyrë të ndershme.



25.07.2019

Nën drejtimin e Prefektit të Qarkut, është zhvilluar mbledhja e radhës e KVVTP, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, ku u morën në shqyrtim 3(tre) projekt vendime për tre kërkesa të qytetarëve, lidhur me verifikimin e titujve të pronësisë. Pasi u bënë vrejtyet dhe korrigjimet e nevojshme nga ana e Prefektit, të tre vendimet u miratuan dhe kaluan për konfirmim në Sekretariatit Teknik të Tokës.



26.07.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim pune me sekretarët e këshillave bashkiakë dhe të qarkut me qëllim njohjen e procedurave ligjore që ata duhet të ndjekin për konstituimin e këshillave bashkiakë si dhe këshillin e qarkut.

Në këtë takim u diskutua mbi hapat që do të ndiqen për organizimin e mbledhjes së parë të këshillit bashkiak dhe rendin e ditës.



Në fjalën e tij Prefekti i qarkut kërkoi nga sekretarët e këshillave të bashkive të qarkut Gjirokastër zbatimin me rigorozitet të procedurave ligjore sipas udhëzimit të Ministrisë së Brendshme, me qëllim mbarëvajtjen e këtij procesi.

Gjithashtu gjatë këtij takimi u përcaktuan edhe datat kur bashkitë përkatëse do të zhvillojnë mbledhjen e parë për konstituimin e këshillave bashkiakë.

Ceremonia e betimit të kryetarit të bashkisë do të zhvillohet sipas një protokollit të veçantë, në ambiente jashtë institucionit në prani të deputetëve të qarkut, këshilltarëve bashkiak, të ftuarve dhe qytetarëve.

29.07.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastër Z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim pune në ambientet e institucionit të Prefektit në kuadër të luftës kundër informalitetit dhe mbarëvajtjes së sezonit turistik. Në këtë takim ishin të pranishëm drejtori i Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin z. Hidajet Hoxha, kryeinspektori i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Gjirokastër z. Dino Selimi dhe përfaqësues nga Inspektoriatit Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e planeve të përbashkëta të inspektimit duke evituar inspektimet individuale, në mënyrë që të mos rëndohet veprimtaria e subjekteve tregtare apo turistike.

Gjithashtu theksoi që një menaxhim i suksesshëm i sezonit turistik duke pasur një bashkëpunim të ndërsjelltë me të gjitha strukturat përgjegjëse do të shërbejë si një imazh pozitiv në vendimarrjen e shteteve anëtare për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, njëkohësisht dhe në zhvillim ekonomik rajonal dhe kombëtar.

Nga ana e pjesëmarrësve në këtë takim u shprehën për masat që kanë marrë si në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik por edhe ndaj luftës kundër informalitetit.

Në përfundim të takimit, Prefekti i qarkut u shpreh se lufta kundër informalitetit është një vullnet i fortë i qeverisë shqiptare për të garantuar rregulla të barabarta në treg, për të mbështetur biznesin që respekton rregullat dhe që punon në mënyrë të ndershme.



30.07.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në mbledhjen e parë të konstituimit të Këshillit Bashkiak përkatësisht të bashkive Tepelenë, Memaliaj dhe Libohovë.

Të pranishëm në këto mbledhje ishin Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Bledi Çuçi, deputetët e qarkut Gjirokastër znj. Mirela Kumbaro, znj. Artemis Malo si dhe Drejtoresha e

Çështjeve Vendore dhe Prefekturave në Ministrinë e Brendshme znj. Alma Mele.

Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak Tepelenë janë legjitimuar 12 nga 15 mandate. Gjithashtu gjatë mbledhjes së parë të këshillit u zhvillua edhe ceremonia e betimit e kryetarit të bashkisë z. Tërmet Peçi, i cili rizgjidhet për herë të tretë në krye të kësaj bashkie.

Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak Memaliaj janë legjitimuar 19 nga 21 mandate. Gjatë mbledhjes së parë të këshillit u zhvillua edhe ceremonia e betimit e kryetarit të bashkisë z. Gjolek Guçi, i zgjedhur për herë të parë në krye të kësaj bashkie.

Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak Libohovë janë legjitimuar 14 mandate. Gjatë mbledhjes së parë të këshillit u zhvillua edhe ceremonia e betimit e kryetares së bashkisë znj. Luiza Mandi, e rizgjedhur për herë të dytë në krye të kësaj bashkie.

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj gjatë fjalës së tij u shpreh se finalizimi me sukses i zgjedhjeve vendore të 30 qershorit 2019 përbën një arritje për demokracinë e vendit tonë dhe një hap më shumë drejt të ardhmes europiane, ndërsa vlerësoi Kryebashkiakët e zgjedhur si të duhurit për të udhëhequr Bashkitë përkatëse për katër vitet e ardhshme.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 48, gjatë mbledhjes së parë të konstituimit të këshillit bashkiak u zgjodh edhe kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit të bashkisë Tepelenë, Memaliaj dhe Libohovë.



31.07.2019

Janë zhvilluar mbledhjet e para të konstituimit të Këshillit Bashkiak përkatësisht të bashkive Këlcyrë dhe Përmet.

Të pranishëm në këto mbledhje ishin Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Bledi Çuçi, si dhe deputetet e qarkut Gjirokastrë znj. Artemis Malo dhe znj. Mirela Kumbaro.

Gjatë mbledhjes së parë të këshillit bashkiak Këlcyrë janë legjitimuar 12 nga 15 mandate. Gjithashtu gjatë mbledhjes së parë të këshillit u zhvillua edhe ceremonia e betimit e kryetarit të bashkisë z. Klement Ndoni, i cili rizgjidhet për herë të tretë në krye të kësaj bashkie.

Në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak Përmet janë legjitimuar 14 nga 15 mandate. Gjatë mbledhjes së parë të këshillit u zhvillua edhe ceremonia e betimit e kryetares së bashkisë znj. Alma Hoxha, e zgjedhur për herë të parë në krye të kësaj bashkie.

Nënprekfteti i qarkut Gjirokastrë z. Edvin Tuçi, në emër të institucionit të Prefektit si përfaqësues i tij u shpreh se finalizimi me sukses i zgjedhjeve vendore të 30 qershorit 2019 përbën një arritje për demokracinë e vendit tonë dhe një hap më shumë drejt të ardhmes europiane, ndërsa vlerësoi Kryebashkiakët e zgjedhur si të duhurit për të udhëhequr Bashkitë përkatëse për katër vitet e ardhshme.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 48, gjatë mbledhjes së parë të konstituimit të këshillit bashkiak u zgjodh edhe kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit të bashkisë Këlcyrë dhe Përmet.



01.08.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në mbledhjen e parë të konstituimit të Këshillit Bashkiak përkatësisht të bashkive Gjirokastrë dhe Dropull.

Të pranishëm në këto mbledhje ishin Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Bledi Çuçi, Zëvendësministrja e Punëve të Brendshme znj. Rovena Voda, deputetët e qarkut Gjirokastrë znj. Mirela Kumbaro dhe znj. Artemis Malo.

Gjatë mbledhjes së parë të këshillit bashkiak Gjirokastrë janë legjitimuar 30 nga 31 mandate. Gjithashtu gjatë mbledhjes së parë të këshillit u zhvillua edhe ceremonia e betimit e kryetarit të bashkisë z. Flamur Golemi, i cili zgjidhet për herë të parë në krye të bashkisë Gjirokastrë. Ndërsa në mbledhjen e parë të këshillit bashkiak Dropull janë legjitimuar 19 nga 21 mandate. Gjatë mbledhjes së parë të këshillit u zhvillua edhe ceremonia e betimit e kryetarit të bashkisë z. Dhimitraq Toli i zgjedhur për herë të parë në krye të kësaj bashkie.

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 48, gjatë mbledhjes së parë të konstituimit të këshillit bashkiak u zgjodh edhe kryetari dhe zëvendëskryetari i këshillit të bashkisë Gjirokastrë dhe Dropull.



02.08.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë ka ndjekur konstituimin e organeve të vetëqeverisjes vendore në shtatë bashkitë e qarkut të dala nga zgjedhjet vendore të datës 30 qershor 2019. Në datën 1 gusht janë zhvilluar mbledhjet e konstituimit në dy bashkitë e fundit, përkatësisht Gjirokastrë dhe Dropull. Në këto mbledhje ka marrë pjesë edhe Zëvendësministrja e Brendshme znj. Rovena Voda. Pas këtyre mbledhjeve znj. Voda ka zhvilluar një takim në zyrën e Prefektit të qarkut ku është diskutuar mbi ecurinë e procesit të konstituimit të organeve të reja të vetëqeverisjes vendore dhe bashkëpunimit të mëtejshëm me këto organe. Znj. Voda, në cilësinë e drejtueses së Task Forcës Qendrore të Luftës Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit ka diskutuar me Prefektin e qarkut në lidhje me veprimtarinë e Task Forcës Vendore si dhe raportimin javor dhe periodik të punës së kësaj Task Force. Në këtë takim u

diskutua edhe mbi masat që duhet të merren nga institucioni i Prefektit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore mbi përballimin e situatave të mundshme emergjente të shkaktuara nga zjarret.



02.08.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë, z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore të zhvilluar në kuadër të 76-Vjetorit të Masakrës së fshatit Glinë në Njësinë Administrative Dropull i Poshtëm, bashkia Dropull.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe nënkryetari i bashkisë Dropull, Komandant i Detashmentit të Mbështetjes Rajonale Gjirokastrë, kryeplaku i fshatit Glinë si dhe veteranë dhe pasardhës të familjeve të dëshmorëve.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut vlerësoi rolin që ka luajtur minoriteti grek pas çlirimit të vendit dhe kontributin e vyer të tyre në ndërtimin e Shqipërisë së re demokratike. Gjithashtu Prefekti theksoi se është detyrë e jona që të mbajmë lart vlerat, emrin dhe veprën e dëshmorëve të atdheut që dhanë jetën për liri.

Në përfundim të fjalës, Prefekti i qarkut shprehu mirënjohjen dhe respektin për 28 dëshmorët e fshatit Glinë, të cilët dhanë jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare si epopeja më e lavdishme në historinë e popullit tonë dhe që bëri realitet çlirimin e Shqipërisë.



07.08.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore të 76-vjetorit të themelimit të batalionit “Asim Zeneli”, zhvilluar në fshatin Kardhiq, njësi administrative Cepo, bashkia Gjirokastrë.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin kryetari i bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, kryetari i Komitetit të Veteranëve Gjirokastrë z. Shkëlqim Guce si dhe veteranë e pasardhës të familjeve të dëshmorëve të rënë.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut vlerësoi rolin e batalionit të Asim Zenelit, një arritje historike për popullin shqiptar, rezultat i luftës patriotike duke përmendur disa prej luftërave më të ashpra të batalionit së bashku me brigadat e tjera kundër pushtuesve nazifashistë. Prefekti i

qarkut shprehu mirënjohjen dhe respektin për partizanët e batalionit “Asim Zeneli”, që dhanë jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare si epopeja më e lavdishme në historinë e popullit tone.



08.09.2019

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë është zhvilluar mbledhja e radhës e Këshillit të Basenit Ujor të Vjosës, drejtuar nga Kryetari i Këshillit, njëkohësisht Prefekt i Qarkut Vlorë z. Flamur Mamaj.

Në mbledhje ishin të pranishëm gjithashtu Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj, Drejtoresha e Përgjithshme e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore znj. Gerta Lubonja, përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Shëndetit Vlorë, Bashkitë Gjirokastrë, Fier, Dropull, Libohovë, Mallakastër, Memaliaj, Delvinë, Himarë, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore si dhe përfaqësues të grupeve të interesit. Gjatë mbledhjes janë diskutuar problemet e hasura gjatë praktikës së punës si dhe marrja e vendimeve përkatëse në zbatim të ligjit nr. 111/2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, sipas rendit të ditës të miratuar.



13.08.2019

Në kuadër të 76-vjetorit të themelimit të batalionit “Misto Mame”, Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore të organizuar në Shën Todhër, njësia administrative Lunxhëri të bashkisë Gjirokastrë.

Në këtë ceremoni ishin të pranishëm gjithashtu kryetari i Këshillit të Qarkut Gjirokastrë z. Armand Hila, përfaqësues të bashkisë Gjirokastrë, kryetari i Komitetit të Veteranëve Gjirokastrë si dhe veteranë e pasardhës të familjeve të dëshmorëve.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut vlerësoi rëndësinë e rolit të batalionit "Misto Mame", jo vetëm në historinë e krahinës së Lunxhërisë por për të gjithë kontributin e dhënë në luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare. Prefekti i qarkut theksoi se përkujtimi i dëshmorëve,

idealeve dhe vlerave të LANÇ-it është një detyrë patriotike ndaj të rënëve, e cila përcjell frymëzim dhe kurajo në mbrojtje të integritetit e sovranitetit të vendit tonë.



15.08.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi me kryetarët e rinj të zgjedhur të bashkive të qarkut Gjirokastrë, nën drejtimin e Prefektit të qarkut z. Astrit Aliaj dhe me pjesëmarrjen e Zv/Ministres së Brendshme znj. Romina Kuko.

Prefekti i qarkut ka përcjellë urimet më të përzemërta për kryetarët e rinj të sapozgjedhur dhe i ka uruar suksese në përmbushjen e sfidave të reja në drejtimin e bashkive përkatëse, duke i ofruar të gjithë mbështetjen e institucionit që ai drejton, nëpërmjet një bashkëpunimi të frytshëm ndërinstitucional, për realizimin e këtij misioni të rëndësishëm në të mirë të gjithë komunitetit të qarkut.

Nga ana e saj, Zv/Ministria e Brendshme znj. Romina Kuko ka kërkuar nga kryetarët e zgjedhur përmbushjen me përgjegjësi maksimale të detyrimeve funksionale që ju janë besuar në zgjedhjet e fundit vendore, duke adresuar edhe problematikat aktuale në qark të cilat kërkojnë angazhim maksimal si ndjekja me përparësi e procesit të rinovimit të pasaportave e kartave të identitetit për shkak të fluksit të lartë, finalizimi me sukses i procesit të adresarit sipas planit të masave të Ministrisë së Brendshme dhe trajtimi me përparësi i ofrimit të materialeve dhe informacioneve bazë turistike, çdo vizitori të huaj që do t'i shërbej gjatë qëndrimit në vendin tonë, duke zhvilluar më tej një model të ri komunikimi me turistët.



16.08.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj mori pjesë në festën e organizuar në fshatin Skore të njësisë administrative Pogon, me rastin e 250-vjetorit të themelimit të Bashkësisë së Skoresë “Lindja e Hyjlindëses”.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin gjithashtu konsulli i Përgjithshëm i Greqisë në Gjirokastrë z. Llambros Kakisis, kryetari i bashkisë Dropull z. Dhimitraq Toli si dhe personalitete të tjera të njohura dhe drejtues të dikastereve shtetërore e fetare.

Në fjalën e tij përshëndetëse, Prefekti i qarkut shprehu urimet më të mira në këtë përvjetor të rëndësishëm për kulturën kombëtare e fetare duke vlerësuar punën, angazhimin, përkushtimin dhe kontributin e bijëve dhe bijave të Skoresë që kanë punuar për zhvillimin e kësaj bashkësie, e cila përcjell vlera hyjnore, humane e kulturore.



17.08.2019

Në nderim të legjendës së futbollit shqiptar, sportistit Lefter Millo, është organizuar ceremonia përkujtimore e figurës së jashtëzakonshme të futbollistit, me pjesëmarrjen e Prefektit të qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj, kryetarit të bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, kryetarit të bashkisë Dropull z. Dhimitër Toli si dhe personaliteteve të tjera nga radhët e sportit dhe kulturës.

Në nderim dhe respekt të veprës së tij, Prefekti i qarkut i ka dorëzuar të motrës, fanellën kombëtare kuqezi me shqiponjën dykrenare, nga e cila u mirëprit edhe promovimi i librit të ri me poezi.

Fusha e futbollit në fshatin Dervician të bashkisë Dropull, që përdoret për stërvitje nga ekipi i Luftëtarit, nga sot e tutje do të mbajë emrin e Lefter Millos si dhe bustin e personalitetit të futbollit shqiptar nga radhët e minoritetit grek.



27.08.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim në ambientet e bashkisë Memaliaj, ku morrën pjesë kryetari i kësaj bashkie Z. Gjolek Guci, nënprefekti Z. Avni Lala, administratorët e njësive administrative të bashkisë Memaliaj si dhe drejtues të degëve territorial të kësaj bashkie.

Prefekti i Qarkut e nisi fjalën e tij duke shprehur urimet më të mira për kryetarin e ri të zgjedhur të bashkisë Memaliaj z. Gjolek Guci. Gjatë këtij takimi Z. Prefekt trajtoi disa nga problematikat kyçe më emergjente si domosdoshmëria e bashkëpunimit ndërinstytucional, përmirësimi i shërbimit të ofruar ndaj qytetarëve, marrja e masave për garantimin e institucioneve arsimore



për mbarëvajtjen e procesit mësimor 2019-2020. Gjithashtu Z. Prefekt e vuri theksin te rëndësia e planeve të punës të hartuara prej kryetarëve të njësive administrative me qëllim përmbushjen sa më efektive të detyrave të tyre funksionale. Duke marrë shkas nga rastet e shumta të zjarrvënies Prefekti i qarkut kërkoi sensibilizimin e masës jo vetëm për shmangien e situatave të tilla, por edhe për gatishmërinë që duhet marrë në raste emergjente.

Një vëmendje e veçantë në këtë takim iu kushtua problemit të mbetjeve duke zbatuar detyrimet që dalin nga ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane. Ndër të tjera u trajtua dhe nxitja e turizmit nëpërmjet shfrytëzimit të resurseve që disponon bashkia, objekteve të ndryshme të trashëgimisë kulturore etj.

Nga ana e kryetarëve të njësive administrative u shtruan disa nga problematikat ekzistuese si mosfurnizimi i rregullt me energji elektrike për shkak të amortizimit të rrjetit elektrik, mungesa e infrastrukturës rrugore në zonat rurale si dhe menaxhimi i mbetjeve urbane. Në përfundim të këtij takimi Z. Prefekt dha rekomandimet përkatëse për zgjidhjen e problematikave të ngritura dhe ofroi mbështetjen e tij institucionale për një efikasitet më të lartë të njësive të vetëqeverisjes vendore.

27.08.2019

Në zbatim të programit të Qeverisë Shqiptare për “Zhvillimin e Arsimit” dhe ligjit 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, institucioni i Prefektit ka ndjekur me vëmendje dhe në vazhdimësi mbarëvajtjen e procesit mësimor 2018-2019. Nisur nga problematikat e evidentuara për këtë vit mësimor, informacionet e marra nga institucionet arsimore vendore në qarkun Gjirokastrë mbi gjendjen e infrastrukturës së ambienteve shkollore si dhe detyrimet ligjore që kanë njësitë e vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave dhe vënien në gatishmëri të institucioneve arsimore të qarkut për fillimin me sukses të vitit të ri arsimor 2019-2020, Prefekti i qarkut ka ngritur një grup pune për Monitorimin e Institucioneve Arsimore të Qarkut Gjirokastrë për marrjen e masave për fillimin e procesit mësimor 2019-2020.

Gjatë këtyre ditëve grupi i punës ka kryer inspektime në institucionet arsimore të qarkut Gjirokastrë, përkatësisht në institucionet nën juridiksionin e ZVA Gjirokastrë-Dropull-Libohovë ku përfshihen në total 27 shkolla, në ZVA Tepelenë-Memaliaj janë 56 shkolla, ndërsa në ZVA Përmet-Këlcyrë janë së bashku 38 drejtori dhe shkolla vartëse.

Nga inspektimet e kryera deri më tani grupi i punës ka konstatuar disa problematika të tilla si: hidroizolimi i pjesshëm i tarracave, eliminimi i lagështirës në ambientet shkollore, rregullimi i tualeteve, lyerja e ambienteve të jashtme dhe të brendshme në disa shkolla etj.

Lidhur me këto problematika nga ana e kryetarëve të bashkive përkatëse rezulton se po merren masat e nevojshme për të bërë të mundur eliminimin e mangësive dhe problematikave me qëllim që viti i ri shkollor 2019-2020 në qarkun e Gjirokastrës të zhvillohet në kushte sa më normale.



Në kuadër të mbarëvajtjes së procesit mësimor do të kërkohet nga ana e drejtuesve të institucioneve arsimore të pajisen me tekstet shkollore dhe të planifikojnë në kohë shpërndarjen e tyre në bashkëpunim me distributorin për të gjithë nxënësit si dhe të marrin masa për regjistrimin e nxënësve për vitin arsimor 2019-2020.

Në ditët në vijim do të vazhdojnë inspektimet nga Institucioni i Prefektit, i cili do të ndjek me prioritet çdo problematikë apo çështje në drejtim të përmirësimit të cilësisë së arsimit në qarkun tonë me qëllim fillimin e mbarë të vitit arsimor 2019-2020.

29.08.2019

Në sajë të bashkëpunimit të Ministrisë së Brendshme me Organizatën Ndërkombëtare të Migracionit (IOM) është zhvilluar, në ambientet e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë një takim i tryezës teknike rajonale dhe strukturave lokale në lidhje me kontrabandimin e migrantëve dhe trafikimin e qenieve njerëzore në qarkun Gjirokastrë. Të pranishëm në këtë takim ishin Drejtori i Azilit dhe i Shtetësisë z. Sokol Sheti, Drejtoresha e Antitrafikut dhe Migracionit znj. Julia Done, Drejtori i Kufirit dhe Migracionit z. Shaban Nexhi, Koordinatore e Drejtorisë Antitrafik znj. Ina Zhupa, përfaqësuesja e organizatës IOM znj. Alketa Gaxha.

Në fjalën e tij Prefekti i qarkut theksoi domsdoshmërinë e bashkërendimit të veprimeve shtetërore dhe joshtetërore, për parandalimin e fenomenit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe parandalimin e viktimave të mundshme të trafikimit dhe kërkoi marrjen e masave për mbrojtjen e individëve dhe grupeve të rrezikuara nga trafikimi, në mënyrë të veçantë të grave dhe fëmijëve.

Në fund të këtij takimi Prefekti qarkut u shpreh se roli i Tryezës Teknike është tejet i rëndësishëm në përcaktimin e veprimeve të nevojshme për parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e familjeve, grupeve, personave dhe fëmijëve në situatë rruge, të cilët janë edhe më të predispozuar ndaj këtij fenomeni.

Në cilësinë e Kryetarit të Komitetit Rajonal, Prefekti kërkoi ndaj anëtarëve të Tryezës Teknike përgjegjësi të lartë në zbatimin e detyrave të lëna.



29.08.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim me sipërmarrësin shqiptar Z. Sotir Çoni dhe me investitorin australian Z. George Andreës, të cilët kanë ndërtuar një fabrikë uji në fshatin Sheper, njësi administrative Zagori, bashkia Libohovë. Prefekti i qarkut falënderoi dhe vlerësoi sipërmarrësit për investimin e biznesit që po krijon një perspektive të re jo vetëm për fshatin Sheper por edhe më gjerë duke u shtrirë në të gjithë qarkun Gjirokastrë. Gjithashtu



u shpreh se ky biznes po rikthen shpresën në bashkinë Libohovë dhe po ndihmon ekonominë lokale në zhvillimin ekonomik-social dhe human të krahinës së Zagorisë.

Fabrika e ujit “GTG Living Eater” financohet prej kompanisë ndërkombëtare “Skyton Development”, me qendër në Australi dhe shtrirje në shumë vende të botës, ndërsa zbatimi në

Shqipëri i projektit kryhet prej kompanisë “STS Development” Sh.p.k. Prodhimi i ujit natural dhe ujit të gazuar “Living Eater” që merret nga burimi i “Bambullit”, i cili ka ujë me veti të jashtëzakonshme kurative dhe dietike, shpërndahet për eksport jashtë vendit, kryesisht në Australi, Azi, Afrikë, Qipro e Amerikë.

Vlen të përmendim që 10 % e fitimit të kompanisë së tyre shkon në interes të komunitetit përkatësisht në familjet e varfra dhe fëmijëve jetimë të bashkisë Libohovë, si edhe në drejtim të zhvillimit të infrastrukturës etj.

Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e veçantë që sjellin këto programe investimesh për uljen e papunësisë dhe rritjes së kapaciteteve të tregut të punës, si dhe ofroi mbështetjen institucionale për krijimin e një klime më të mirë bashkëpunimi, mbështetje dhe besimi në kuadër të rritjes dhe nxitjes së sipërmarrësve të huaj që duan të investojnë në qarkun tonë.

30.08.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim pune me stafin e Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë me qëllim analizimin e veprimtarisë të kësaj drejtorie për periudhën kohore Prill- Gusht 2019.

Gjatë këtij takimi u pasqyrua një analizë e veprimtarisë duke specifikuar objektivat e realizuara, ku mund të përmendim ndjekien me përparësi të proceseve gjyqësore, trajtimit të kërkesave të reja për verifikim e vlefshmërisë ligjore të AMTP-ve, si dhe trajtimit të kërkesave nga qytetarët apo nga institucione.

Për sa më sipër janë ndjekur nga ana e KVVTP-së procese gjyqësore, të cilat ishin në proces nga viti i kaluar. Ndërkohë për vitin 2019 janë zhvilluar gjithsej pesë seanca në dy procese të ndryshme gjyqësore. Ka përfunduar inventarizimi i 311 dosjeve në total si dhe krijimi i regjistrit elektronik të dosjeve të vendimeve dhe të kërkesave.

Në vazhdimësi të nismës "Bëhu pronar i tokës tënde", KVVTP-ja ka realizuar takime të ndryshme në bashkitë e qarkut Gjirokastrë. Nga konstatimet e bëra në bashkëpunim me administratën e bashkive rezulton se procesi është në përfundim e sipër.

Në kuadër të nismës “Bëhu pronar i tokës tënde”, në përfundim të takimit u caktua që do të zhvillohet një fushatë sensibilizuese në bashkëpunim me Drejtorinë e DAMT-të Gjirokastrë dhe Drejtorinë e ASHK-së Gjirokastrë.



02.09.2017

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim pune në ambientet e institucionit të Prefektit në kuadër të 75-Vjetorit të Çlirit të Shqipërisë. Në këtë takim ishte i pranishëm Kryetari i Organizatës së Familjeve të Dëshmorëve z. Hodo Liço.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e këtij aktiviteti për 75-Vjetorin e Çlirit të Shqipërisë ku të hartohet programet, organizimi dhe bashkërendimi i punës për realizimin e veprimtarisë nga njësië e vetëqeverisjes dhe degët territoriale për 75-Vjetorin e Çlirit të Shqipërisë.



03.09.2019

Është zhvilluar ceremonia e 99-vjetorit të Luftës së Vlorës me pjesëmarrjen e Kryetarit të Kuvendit z. Gramoz Ruçi, Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit z. Blendi Klosi, Prefektit të qarkut Vlorë z. Flamur Mamaj, Prefektit të Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj, Prefektit të qarkut Fier z. Baki Bala, deputetëve, kryetarëve të njësisve të vetëqeverisjes vendore, përfaqësuesve të institucioneve vendore si dhe familjarëve të dëshmorëve të rënë.

Kremtimi i 99-vjetorit, zhvilluar nën kujdesin e Prefektit të qarkut Vlorë, është shoqëruar me vendosjen e kurorave me lule pranë varrezave të dëshmorëve, aty ku prehen edhe 150 dëshmorët e luftës së Vlorës, si dhe me përshëndetjet përkatëse të drejtuesve pjesëmarrës në teatrin “Petro Marko” në Vlorë. Ky përvjetor shënon pragmylljen e një shekulli ku përgjatë gjithë këtyre viteve janë nderuar heronjtë e luftës të rënë për lirinë e Atdheut, luftës së parë zyrtare të shtetit shqiptar të formuar pas Kongresit të Lushnjës.



06.09.2019

Thirrje për pjesëmarrje në konferencën shkencore kombëtare “Prefektura e Gjirokastrës gjatë luftës së dytë botërore”, me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të vendit.



09.09.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi i punës lidhur me njohjen dhe marrjen e masave për një fillim sa më të mbarë të procesit mësimor 2019-2020. Të pranishëm në këtë takim ishin drejtues të Agjensive të Mirëqenies dhe Kujdesit Social pranë bashkive të qarkut, drejtues të ZVA Gjirokastrë, Tepelenë e Përmet, drejtorë të institucioneve arsimore në qark, përfaqësues të drejtorisë së Policisë Vendore të qarkut si dhe përfaqësues të Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor.

Prefekti i qarkut vlerësoi punën e bërë nga ana e drejtuesve të institucioneve arsimore në ofrimin dhe sigurimin e një shërbimi arsimor cilësor në të gjitha institucionet arsimore të sistemit parauniversitar në qarkun tonë, në përputhje me politikën, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar, me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësve.

Në kuadër të mbarëvajtjes së procesit mësimor, nga ana e Prefektit të qarkut u theksua se përgjegjësia kryesore i takon njësisve të vetëqeverisjes vendore, të cilat në bashkëpunim me drejtuesit e shkollave, të hartojnë planet e mirëmbajtjes apo rikostruksionit të shkollave, me qëllim përmirësimin e zhvillimit të procesit mësimor në kushte sa më të përshtatshme.

Në përfundim të takimit Prefekti i qarkut dha rekomandimet përkatëse si:

- Nga ana e bashkive të qarkut të merren masa të menjëhershme për vënien në gatishmëri të të gjitha ambienteve arsimore për një fillim të mbarë të procesit mësimor.
- Drejtoria e Shëndetit Publik të kontrollojë higjienën në ambientet shkollore me qëllim parandalimin e sëmundjeve infektive dhe kujdesit ndaj nxënësve të sëmurë kronik duke plotësuar me kuti të ndihmës së shpejtë çdo shkollë.
- Bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 134 datë 10.03.2017 “Për përcaktimin e nivelit të masave shtesë të sigurisë dhe llojin e masave që duhet të marrin subjektet në varësi të aktivitetit apo vlerësimit të rrezikut, si dhe procedurat e njoftimit të tyre”, nga ana e njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe Policisë së Shtetit të merren masa për vendosjen e kamerave në çdo ambient shkollore.



10.09.2019

Në kuadër të garantimit të institucioneve arsimore për mbarëvajtjen e procesit mësimor 2019-2020, duke u nisur edhe nga takimet e zhvilluara në institucionin e Prefektit me përfaqësues të institucioneve arsimore, Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj, së bashku me grupin e punës inspektoi gjimnazin “Asim Zeneli”, ku në të cilin është kryer një investim së fundmi që ka bërë të mundur përmirësimin e kushteve infrastrukturore të kësaj shkolle.

Gjatë takimit me drejtoreshën Znj. Alma Malaj dhe me mësuesit e gjimnazit “Asim Zeneli”, Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e bashkëpunimit me njësinë e vetëqeverisjes vendore për vënien në gatishmëri të të gjitha ambienteve të gjimnazit “Asim Zeneli” brenda datës 16 shtator, e cila përkon me datën e fillimit të vitit të ri arsimor.

Prefekti vlerësoi punën e bërë ndër vite nga ana e stafit pedagogjik në këtë institucion arsimor kaq të rëndësishëm e plot vlera historike ku kanë dalë personalitete të shquara si shkrimtari i njohur Ismail Kadare etj. Si dhe u drejtua mësuesve për të qenë vazhdues të kolegëve të tyre para-ardhës që mësuan dhe edukuan dhjetëra e dhjetëra gjimnazistë që i dhanë një emër të nderuar gjimnazit “Asim Zeneli”.



Prefekti i qarkut kërkoi zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme në bashkëpunim me shkollat e tjera në bashkitë e qarkut Gjirokastrë dhe më gjerë në kuadër të 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë. Gjithashtu theksoi dhe një element të rëndësishëm të rolit të oficerit të sigurisë në

shkollë, i cili synon rritjen e sigurisë për parandalimin e dukurive negative përmes mbështetjes dhe ndërveprimit me aktorët e shkollës.

Në përfundim të këtij takimi, Prefekti i qarkut i uroi stafit pedagogjik të gjimnazit “Asim Zeneli” një vit sa më të mbarë shkollor si dhe ofroi mbështetjen institucionale në drejtim të përmirësimit të cilësisë së arsimit në qarkun tonë.

11.09.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj ishte i pranishëm në ambientet e shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi” në bashkinë Libohovë në kuadër të garantimit të institucioneve arsimore për mbarëvajtjen e procesit mësimor 2019-2020.

Të pranishëm në këtë takim ishin kryetarja e bashkisë Libohovë znj. Luiza Mandi, drejtoresha znj. Vjollca Idrizi dhe stafi pedagogjik i shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi”. Prefekti i qarkut vlerësoi punën e mirë të bërë gjatë rikonstruksionit të kësaj shkolle, e cila tashmë siguron kushtet e favorshme për zhvillimin sa më normal të procesit mësimor, pasi së fundmi është kryer investim nga Qeveria Shqiptare në këtë shkollë. Gjithashtu theksoi punën e mirë të bërë nga bashkëpunimi ndër-institucional midis njësisë së vetëqeverisjes vendore me drejtorinë e shkollës.

Vlen të përmendim se në shkollën “Avni Rustemi” do të hapet për herë të parë një klasë parashkollore me qëllim stimulimin e zhvillimit të mësimin të çdo nxënësi, si dhe përgatitjen e tyre për arsimin e ardhshëm.

Prefekti i qarkut kërkoi një angazhim maksimal nga ana e mësuesve në ofrimin dhe sigurimin e një shërbimi arsimor cilësor me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësve.

Në përfundim të këtij takimi, Prefekti i qarkut i uroi stafit pedagogjik të shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi” një vit sa më të mbarë shkollor si dhe ofroi mbështetjen institucionale në drejtim të përmirësimit të cilësisë së arsimit në qarkun tonë.



12.09.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj mori pjesë në një takim pune në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë në kuadër të trajtimit të problematikave të ndryshme dhe marrjen e masave policore në përputhje me objektivat, programin dhe planin e veprimit të përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Në fjalën e tij në këtë takim, Prefekti i qarkut vlerësoi për punën me shumë përkushtim të Drejtorit të D.V.P Gjirokastrë z. Perlat Vatoci dhe të gjithë strukturës policore të kësaj drejtorie në rritjen e performancës në luftën kundër krimit të organizuar, parandalimit të kultivimit të bimëve narkotike si dhe në garantimin e një mjedisi të sigurt dhe cilësor për komunitetin. Gjithashtu Prefekti theksoi rëndësinë e imazhit të mirë që duhet të kenë forcat policore të udhëhequr nga etika dhe kultura e integritetit me qëllim rritjen e besimit të

qytetarëve.

Drejtori i Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë z. Perlat Vatoci prezantoi punën e bërë dhe masat e marra nga strukturat e D.V.P për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike dhe jo vetëm, duke përmendur si masat sensibilizuese, ashtu edhe masat operacionale.

Prefekti i qarkut kërkoi një bashkëpunim ndërinstitucional, koordinim nga të gjithë strukturat ligjzbatuese për intensifikimin e masave të nevojshme për përballimin me sukses të problematikave të ndryshme që hasen sidomos në këtë fillim viti të ri arsimor.

Me këtë rast, Prefekti i qarkut takoi nga afër efektivët e forcave policore dhe inspektoi mjetet e tyre policore në funksion të përmbushjes së detyrave të policisë në patrullim sipas juridiksionit të strukturave në kontrollin e territorit.

Në përfundim të këtij takimi, Prefekti i qarkut theksoi angazhimin maksimal të çdo efektivit të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastrë në rritjen e parametrave të sigurisë publike në qarkun tonë.



13.09.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë, z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në ceremoninë përkujtimore në kuadër të 76-Vjetorit të çlirimit të qytetit të Përmetit, organizuar nga Bashkia e Përmetit në bashkëpunim me shkollën 9-vjeçare “Nonda Bulku”.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin deputetët e qarkut Gjirokastrë znj. Mirela Kumbaro, kryetare e Këshillit të Qarkut znj. Lindita Rova, kryetare e bashkisë së Përmetit, znj. Alma Hoxha, nënprefekti i qarkut z. Edvin Tuçi, si dhe veteranë e qytetarë të Përmetit. Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut theksoi se 13 shtatori do të kujtohet brez pas brezi si dita e revoltës së bashkuar të përmetarëve ndaj pushtuesve nazi-fashistë, një ngjarje e shënuar jo vetëm për popullin e Përmetit, por edhe për Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare të popullit tonë. Gjithashtu Prefekti përmendi rolin e veçantë të brigadës së VI sulmuese e formuar në qytetin e Përmetit, për kontributin e çlirimit të këtij qyteti dhe më gjerë. Në përfundim të fjalës, Prefekti shprehu mirënjohjen, respektin, përuhljen ndaj gjithë dëshmorëve të Përmetit dhe të Shqipërisë që dhanë jetën për lirinë e atdheut, si dhe theksoi se

me rastin e vitit jubilar të 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë do të zhvillohen aktivitete kulturore-artistike në rang qarku.



13.09.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj ishte i pranishëm në shkollën e mesme profesionale “Thoma Papapano”, bashkia Gjirokastrë dhe në shkollën e mesme “Sejfulla Malëshova”, bashkia Këlcyrë, në kuadër të garantimit të institucioneve arsimore për mbarëvajtjen e procesit mësimor 2019-2020.

Në fjalën e tij në këto takime, Prefekti i qarkut vlerësoi rëndësinë e shkollës industriale, ku në të cilën kualifikohesh në nivele të larta në drejtime të ndryshme dhe theksoi se zgjedhja e arsimit profesional është si një hap i sigurt drejt tregut të punës. Gjithashtu Prefekti inspektoi nga afër ambientet e brendshme dhe të jashtme të dy shkollave dhe përgatitjen e tyre në prag fillimi të procesit mësimor 2019-2020.

Vlen të përmendim se së shpejti shkolla e mesme profesionale “Thoma Papapano” në Gjirokastrë do t’i nënshtrohet një rikonstruksioni të plotë godinës për të bërë të mundur që shkolla të ketë kushte sa më normale për zhvillimin e procesit mësimor. Ndërkohë që shkolla e mesme “Sejfulla Malëshova” në Këlcyrë i është nënshtuar një rikonstruksioni të godinës që ka bërë të mundur që ky viti i ri arsimor të zhvillohet në kushte optimale dhe sipas të gjitha standardeve.

Prefekti i qarkut kërkoi një angazhim maksimal nga ana e mësuesve në ofrimin dhe sigurimin e një shërbimi arsimor cilësor me qëllim zhvillimin dhe edukimin e plotë e të gjithanshëm të nxënësve. Në përfundim të këtyre takimeve, Prefekti i qarkut i uroi stafit pedagogjik të dy shkollave të mesme një vit sa më të mbarë shkollor si dhe ofroi mbështetjen institucionale në drejtim të përmirësimit të cilësisë së arsimit në qarkun tonë.



15.09.2019

Është zhvilluar ceremonia përkujtimore në kuadër të 76-vjetorit të çlirimit të Tepelenës me pjesëmarrjen e zëvendës kryeministrit z. Erion Braçe, prefektit të qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj, kryetares së Këshillit të Qarkut znj. Lindita Rova, kryetarit të bashkisë Tepelenë z. Tërmet Peçi, kryetarit të bashkisë Memaliaj z. Gjoleka Guci, përfaqësues të institucioneve vendore si dhe familjarë të dëshmorëve të rënë.

Ceremonia përkujtimore e 76-vjetorit të çlirimit të Tepelenës, zhvilluar nën kujdesin e kryetarit të bashkisë Tepelenë z. Peçi, është shoqëruar me vendosjen e kurorave me lule pranë varrezave të dëshmorëve duke vijuar më pas me aktivitete të ndryshme si ekspozitë fotografike “Tepelena në vite”, vizitë në “Muzeun e Qytetit”, si dhe ndarjen e vlerësimeve për disa qytetarë me “Tituj nderi” për kontributin e tyre ndaj qytetit të Tepelenës. Në fjalët përshëndetëse nga drejtuesit pjesëmarrës shprehën mirënjohjen, respektin, përuljen ndaj gjithë dëshmorëve dhe heronjve të Tepelenës dhe gjithë Shqipërisë që dhanë jetën për lirinë e atdheut gjatë luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.



16.09.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ishte i pranishëm në aktivitetin festiv të zhvilluar në shkollën 9-vjeçare "Nimete Progonati" dhe gjimnazin “Sali Nivica”, bashkia Memaliaj me rastin e fillimit të vitit të ri arsimor 2019-2020.

Të pranishëm ishin kryetari i bashkisë Memaliaj z. Gjoleka Guci, nënprefekti z. Avni Lala, drejtoresha e shkollës 9-vjeçare "Nimete Progonati" znj. Etleva Malaj, drejtori i gjimnazit "Sali Nivica" z. Hetem Kanani, si dhe stafi pedagogjik i të dy shkollave.

Ndërkohë sekretari i Përgjithshëm z. Arian Korkuti mori pjesë në ceremoninë hapëse të gjimnazit “Asim Zeneli” bashkia Gjirokastrë me pjesëmarrjen e kryetarit të bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, kryetares së këshillit të Qarkut znj. Lindita Rova. Të pranishmit përshëndetën nxënësit dhe mësuesit duke i uruar për një fillim të mbarë të këtij viti të ri arsimor.

Gjithashtu përfaqësues nga institucioni i Prefektit ishin të pranishëm në shkollën jopublike “Frymë Dashurie” dhe në shkollën 9-vjeçare “Koto Hoxhi”, bashkia Gjirokastrë. Në fjalën e tij përshëndetëse, Prefekti i qarkut përcolli urimet më të ngrohta për ditën e parë të shkollës, duke i uruar të gjithë nxënësve, mësuesve dhe prindërve një fillim të mbarë, të suksesshëm dhe sa më të frytshëm.

Prefekti i qarkut vlerësoi rolin e mësuesit, i cili mbart një emër fisnik që përmes punës së tyre plot përkushtim dhe përgjegjshmëri, luajnë rolin jetik për zhvillimin e një shoqërie, duke mundësuar realizimin e objektivave reformuese, frytet e të cilave po ndihen dhe do të ndihen së shpejti në të gjitha nivelet e arsimit.

Në përfundim të fjalës, Prefekti u shpreh se ky vit përkon me vitin jubilar të 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, ku në rang prefekturë janë përgatitur dhe planifikuar aktivitete me karakter historik e kulturor në nderim dhe respekt për gjakun dhe sakrificën e dhënë në luftë, me pjesëmarrjen edhe të institucioneve arsimore.

Gjithashtu Prefekti i qarkut theksoi se investimi në dije dhe arsim, është investimi më potencial për të ardhmen e qarkun tonë, të Shqipërisë.



17.09.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj mori pjesë në aktivitetin “Stafetë lapidaresh” organizuar nga bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve 'Fato Berberi', në kuadër të 75-vjetorit të çlirimit të qytetit të Gjirokastrës.

Të pranishëm ishin kryetari i bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, kryetari i Organizatës së familjeve të Dëshmorëve z. Hodo Liço, si dhe përfaqësues të institucioneve vendore, veteranë e qytetarë.

Aktiviteti festiv u shtri në të gjithë qytetin, duke nisur nga busti i heroit të popullit Muzafer Asqeriu dhe vijoi më pas në dy lapidaret që ndodhen në lagjen Palorto, Gjirokastrë. Ceremonia përkujtimore në lapidarin e dëshmorit Pertef Kokona, u shoqërua me vendosjen e luleve si dhe me këndim të këngëve patriotike në nder të dëshmorëve të rënë. Në fjalën përshëndetëse, Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e nderimit dhe respektimin të veprës e kontributit të dëshmorëve në çlirimin e qytetit të Gjirokastrës, veçanërisht që ky vit përkon edhe me vitin jubilar të 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë.

Në përfundim të fjalës, Prefekti i qarkut shprehu mirënjohjen dhe respektin për të gjithë dëshmorët dhe heronjtë e Gjirokastrës, të cilët dhanë jetën jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare si epopeja më e lavdishme në historinë e popullit tonë. Gjithashtu Prefekti theksoi se është detyrë e jona që të përcjellim brez pas brezi vlerat e bijve

dhe bijave që dhanë jetën e tyre për çlirimin e atdheut tonë. Të nderohen dhe të respektohen ndër vite!



18.09.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj ishte i pranishëm në aktivitetet festive që kulmuan në kuadër të ditës së 75-vjetorit të çlirimit të qytetit të Gjirokastrës.

Të pranishëm në këto aktivitete ishin deputete të qarkut Gjirokastrë znj. Mirela Kumbaro dhe znj. Artemisa Malo, kryetare e Këshillit të qarkut znj. Lindita Rova, kryetari i bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, kryetari i organizatës së familjeve të dëshmorëve z. Hodo Liço, komandat i Forcës Tokësore z. Albert Mullai, si dhe përfaqësues të institucioneve vendore, veteranë e qytetarë.

Aktivitetet e shumta festive me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të Gjirokastrës nisën me një ekspozitë fotografike “Me fitimtarët”, në të cilat paraqiteshin copëza historie të Gjirokastrës gjatë Luftës së dytë Botërore. Duke vijuar më pas me marshimin në bulevardin “18 Shtatorin” drejt varrezave të dëshmorëve, ku homazhet u shoqëruan me vendosjen e kurorave me lule. Më tej u zhvilluan aktivitete në teatrin “Zihni Sako” të tilla si ekspozitë e arteve figurative “75-vjet çlirim përmes penelit dhe daltës”, dokumentarë ‘Me fitimtarët’, i ndjekur nga këngët patriotike kënduar nga zërat femënorë dhe grupi polifonik. Ceremonia përkujtimore për 75-vjetorin e çlirimit të Gjirokastrës u përmbyll me ndarjen e vlerësimeve për disa veteranë me “Tituj nderi” për kontributin e tyre ndaj qytetit të Gjirokastrës.

Në fjalën përshëndetëse, Prefekti i qarkut shprehu mirënjohjen dhe përluljen përpara heroizmit, luftës, përpjekjeve, sakrificave të dëshmorëve e heronjve që derdhën gjakun jo vetëm për çlirimin e qytetit të Gjirokastrës, por për të gjithë luftëtarët që kontribuan në LANÇ për çlirimin e Shqipërisë.

Në përfundim të fjalës, Prefekti theksoi rëndësinë e veçantë të nderimit dhe përkujtimit me solemnitet dhe dinjitet të veprës së dëshmorëve, të cilët do të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do vijnë.



19.09.2019

Është zhvilluar një vizitë pune në kantierën e Sajmolës në fshatin Dragot të njësisë administrative Qendër- Tepelenë, bashkia Tepelenë për varrezat e ushtarëve greke, nga një ekip ekspertësh të komisionit të palës shqiptare, të kryesuar nga gjenerale brigade Znj. Manushaqe Shehu. Të pranishëm në këtë vizitë pune ishin drejtoreshë e Çështjeve Vendore dhe e Funksioneve të Deleguara pranë ministrisë së Brendshme znj. Alma Mele, drejtori për Rajonin dhe e Vendeve fqinje pranë ministrisë për Evropën dhe Punët e Jatshme z. Ilir Melo, si dhe Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj.



Ekipi i ekspertëve të komisionit të palës shqiptare kërkoi nga ekipet e përbashkëta të terrenit të njihen me punën e bërë deri më tani, realizimet dhe problematikat që janë hasur gjatë procesit të punës.

Pas inspektimit që u krye në kantier, u zhvillua një takim me kryetarin e bashkisë Këlcyrë z. Klement Ndoni në kuadër të marrëveshjes Shqipëri-Greqi për varrezat e ushtarëve grekë. Gjatë këtij takimi, në fjalën e tij, Prefekti i qarkut shprehu gatishmërinë për të bërë të mundur koordinimin midis ekipit të terrenit dhe njësisë të vetëqeverisjes vendore të përfshira në këtë proces. Ndërsa nga ana e gjenerales znj. Shehu u kërkua bashkëpunim ndërinstitucional nga strukturat e bashkisë së Këlcyrës për realizimin e procesit të ndërtimit të varrezave të ushtarëve grekë. Më tej u krye dhe një vizitë në varrezën historike të manastirit të Këlcyrës, ku gjenden të varrosura eshtrat e ushtarëve grekë të rënë në luftën italo-greke në vitet 1940-1941.

25.09.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj ishte i pranishëm në aktivitetin “Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përparësitë e zhvillimit lokal” i zhvilluar në ambientet e hotel Çajupit. Të pranishëm ishin koordinatori i Përhershëm i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri Z. Brian J. Eilliams, ambasador i Italisë Z. Alberto Cutillo, përfaqësues të UNIFEC, UNHCR, FAO, UNDP, UNFPA, UN Eoman, deputete e qarkut Znj. Artemis Malo, kryetari i bashkisë Gjirokastrë Z. Flamur Golemi, kryetarë të bashkive të qarkut Gjirokastrë si dhe përfaqësues të institucioneve vendore.

Gjatë këtij kuvendimi u mbajtën fjalët përshëndetëse nga të pranishëm, të cilët përmendën 17 objektivat dhe treguesit e synuar për zhvillimin e qëndrueshëm që do të rrisin kapacitetet, mundësitë dhe zhvillimin njerëzor në Shqipëri. Një rëndësi të veçantë iu dha arritjes së objektivave si sigurimi i arsimit cilësor, arritja e barazisë gjinore, nxitja e rritjes ekonomike të qëndrueshme nëpërmjet punësimit, promovimit të produkteve lokale, etj.

Në fjalën përshëndetëse, Prefekti i qarkut u shpreh mirënjohës për përzgjedhjen që iu bë Gjirokastrës për zhvillimin e këtij aktiviteti në rang kombëtar mbi objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe përparësitë e zhvillimit në nivel vendor.

Ndër të tjera, Prefekti nënvizoi se përcaktimi i hapave konkretë të bashkëpunimit, kontributi i përbashkët dhe ndihma e ndërsjellë dhe e koordinuar janë një përpjekje e vazhdueshme për të arritur çdo lloj qëllimi të përbashkët. Gjithashtu Prefekti theksoi rolin koordinues të

institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë, i cili shërben si një urë lidhëse mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore për të garantuar bashkëpunim strategjik për arritjen e objektivave të Axshtëndës 2030.



25.09.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë, u zhvillua një takim pune me drejtuesit e degëve territoriale dhe të institucioneve shtetërore në nivel vendor. E pranishme në këtë takim ishte deputetja e qarkut Gjirokastrë Znj. Artemisa Malo. Qëllimi i këtij takimi ishte analiza 9-mujore e punës për përmbushjen e objektivave institucionale në realizimin e programit të qeverisë shqiptare në qarkun Gjirokastrë.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë që ka bashkëpunimi i institucionit të Prefektit me degët territoriale në qark pasi vetëm përmes kësaj fryme do të arrihet zgjidhja e problematikave duke synuar gjithmonë e më shumë një afrim me komunitetin, në mënyrë që të zbatohen me përpikmëri dhe përgjegjësi detyrimet ligjore të ngarkuara secilit prej tyre. Nga ana e drejtuesve u paraqit analiza 9-mujore e punës së institucioneve përkatëse, duke përfshirë arritjet, problematikave e hasura, si dhe objektivat e përcaktuara për 3-mujorin e fundit të vitit 2019.

Në fund të takimit, Prefekti i qarkut dha rekomandimet e duhura me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të punës dhe performancës në çështje të cilat kërkojnë përkushtim dhe angazhim nga të gjitha strukturat shtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qark.

- Profesionalizmi dhe integriteti moral duhet të jetë kusht thelbësor i punonjësve të të gjithë degëve territoriale dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor.
- Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve duke i adresuar drejt zgjidhjes ligjore brenda afateve kohore.
- Nisur nga situata e krijuar pas rënies së tërmetit në qarqet Tiranë dhe Durrës, qeveria shqiptare ka ndërmarrë nismën për sensibilizimin e komunitetit dhe institucioneve për të ardhur në ndihmë zonave të prekura nga tërmeti. Në këtë kuadër, si Prefekt i qarkut ju bëj thirrje të gjitha institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore të kontribuojnë vullnetarisht sipas mundësive të gjithsecilit në numrin e llogarisë së dedikuar për këtë qëllim.



26.09.2019

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka vizituar nga afër ambientet e biznesit të dëmtuar së fundmi si pasojë e rreshjeve të shumta të shiut, “Stabiliment Peshku Kolonjë”, që ndodhet në njësinë administrative Picar, bashkia Gjirokastrë. Nga ana e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, në bashkëpunim me njësinë administrative Picar, u ngrit një grup pune dhe u verifikua gjendja reale në terren.

Nga inspektimi i kryer në këtë biznes u konstatua se vërshimi i ujërave ka sjellë depozitim të inerteve dhe dherave në vaskat e rritjes së peshkut, duke shkaktuar një dëm të konsiderueshëm për biznesin. Sipas pronarit të biznesit “Stabiliment Peshku Kolonjë”, z. Rexho Bahoja, dëmi i shkaktuar është i një vlere të lartë, gjë e cila mund ta çojë biznesin drejt falimentimit.

Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë i është drejtuar bashkisë Gjirokastrë për marrjen e masave për rehabilitimin e infrastrukturës dhe për zhvendosjen e dherave. Njëkohësisht për zgjidhjen e këtij problemi i është kërkuar Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural furnizimin i biznesit me rasat peshku për të bërë të mundur rifillimin e aktivitetit të tij.



26.09.2019

Në kuadër të marrjes së masave për mbarëvajtjen e procesit mësimor, Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka vizituar shkollën 9-vjeçare në fshatin Picar, njësinë administrative Picar, bashkia Gjirokastrë.

Në një bashkëbisedim me stafin pedagogjik të kësaj shkolle, u evidentuan disa problematika kryesore si infrastruktura e dëmtuar dhe frekuentimi i ulët nga nxënësit e zonës. Problem për këtë shkollë mbetet mungesa e investimeve për rikonstruksionin e kësaj godine. Kati i dytë i shkollës është i braktisur për shkak të lagështisë, ndërsa procesi mësimor aktualisht zhvillohet në vetëm dy klasa të bashkuara, pasi numri i nxënësve zvogëlohet vit pas viti, duke qenë se shumë prindër zgjedhin t’i dërgojnë fëmijët në shkollat e qytetit.

Gjithashtu, Prefekti i Qarkut paraqiti propozimin e tij për zhvendosjen e këtyre dy klasave në një ambient më të përshtatshëm për t’ju siguruar kështu nxënësve kushtet e duhura për zhvillimin e një procesi mësimor të rregullt.

Me qëllim sigurimin e disa prej mjeteve mësimore të nevojshme për këtë shkollë, Prefekti i Qarkut ju drejtohet gjithë bizneseve të qarkut Gjirokastrë të kontribuojnë brenda mundësive të tyre ekonomike.



28.09.2019

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë partner i rëndësishëm në realizimin e konferencës kombëtare për zhvillimin e turizmit tematik në qarkun Gjirokastrë në kuadër të aktiviteteve të projektit THEMA.
Conference on thematic tourism by THEMA project in Gjirokastrë!!



29.09.2019

Nismës Shqipëria Solidare i janë bashkuar të gjitha strukturat e shtetit, të cilat janë në gatishmëri të plotë për të ndihmuar banorët e prekur nga tërmeti i rënë në qarqet Durrës dhe Tiranë. Në këtë kuadër, vijojnë verifikimet dhe takimet në terren që askush të mos ndihet vetëm! Prefekti i Qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj, gjatë datave 28-29 Shtator 2019, ka kontaktuar drejtpërdrejtë me të gjitha familjet e dëmtuara nga tërmeti, në Njësinë Administrative Sukth në bashkinë Durrës si dhe në Njësinë Administrative Thuman, bashkia Krujë.

Institucioni i Prefektit të qarkut ju bën thirrje të gjithë qytetarëve të kontribuojnë vullnetarisht sipas mundësive të gjithsecilit në numrin e llogarisë së dedikuar për këtë qëllim.



30.09.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj mori pjesë në takimin e Komitetit Ndërmintor për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, nën drejtimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit Z. Blendi Klosi, i cili prezantoi paketën antikorrupsion në mjedis.

Në fjalën e tij, ministri Z. Blendi Klosi theksoi se mjedisi është një nga fushat me më shumë impakt për komunitetin dhe për këtë arsye Qeveria Shqiptare e ka gjithmonë si prioritet të saj në reforma dhe projekte.

Në këtë kuadër, gjatë takimit u pasqyruan 5 projektet e reja në fushën e mjedisit, të tilla si eliminimi i hallkës burokratike që e çon administratorin e një biznesi në një raport të vështirë me shtetin, në mënyrë që të krijohen mundësi për mbrojtjen e mjedisit. Njëkohësisht një tjetër masë që synon të presë kontaktet e biznesit me administratën është kalimi i lejeve mjedisore online prej datës 1 mars 2020.

Një nga reformat më me rëndësi është ajo e zhdukjes së qeseve plastike nga përdorimi, afati i fundit për ekzekutimin e kësaj reforme është data 1 Qershor 2020. Gjithashtu reforma në mjedis është shtrirë edhe në ristrukturimin institucional të Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, i cili i kalon kontrollin e paligjshmërisë forcave të rendit ku çdo shkelës duhet të gjykohet edhe për krimin mjedisor.

Ndër të tjera, u nënvizua se vendimi i ushtrimit ose jo i një biznesi të vogël si dhe në rastin e zhurmave do të vendoset nga bashkitë përkatëse. Me këtë rast do të ftoja të gjitha bashkitë e qarkut tonë për të qenë edhe njëherë tjetër pjesë e çdo nisme të Qeverisë Shqiptare, për të arritur në rezultate konkrete.



02.10.2019

Në institucionin e Prefektit u zhvillua një takim pune me drejtoreshën e Zyrës Vendore të Arsimit Gjirokastër-Libohovë-Dropull Znj. Albana Hasani me qëllim trajtimin e problematikave të ndryshme dhe marrjen e masave në përputhje me politikat, strategjitë kombëtare dhe kurrikulën e arsimit parauniversitar të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Prefekti i qarkut Gjirokastër Z. Astrit Aliaj i uroi suksese në detyrën e re Znj. Hasani dhe vlerësoi punën e bërë gjatë këtij viti në kuadër të mbarëvajtjes së procesit mësimor, si dhe në cilësinë e arsimit parauniversitar në qarkun tonë. Ndër të tjera, Prefekti i qarkut kërkoi nga ana e ZVA Gjirokastër-Libohovë-Dropull raportime jo vetëm mujore duke qenë se arsimit është prioritet i institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastër.

Gjatë këtij takimi u diskutua në lidhje me problematikat më të ndjeshme që kanë të bëjnë me çështjen e arsimit të tilla vlerësimet e dosjeve të mësuesve, lëvizjen e nxënësve në shkollat e qytetit, lëvizjet paralele të mësuesve, etj. Nga ana e drejtoreshës Znj. Hasani u paraqitën situatat aktuale të çështjeve të diskutuara dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre nga ana e ZVA Gjirokastër.

Në përfundim të takimit, Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm me të gjitha ZVA e qarkut Gjirokastër si dhe me institucionet arsimore në drejtim të përmirësimit të cilësisë së arsimit në qarkun tonë.



02.10.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z Astrit Aliaj ishte i pranishëm në punimet që po kryhen për rehabilitimin e Qafës së Pazarit Gjirokastrë, të cilat janë në fazën përfundimtare të investimit që po realizohet në kuadër të projektit “Zhvillimi i Integruar Urban e Turistik në Shqipëri”. Rehabilitimi i zonës “Qafa e Pazarit”, synon të luajë një rol kyç në orientimin dhe demonstrimin e dobisë që kjo qasje inovative e integruar, ka për zhvillimin rajonal dhe mundësitë që krijon, për adresimin e një sërë objektivash që janë edhe pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Territorit.

Prefekti i qarkut vendosi gurin e fundit të kalldrëmit të mozaikut në zonën e Qafës së Pazarit, një zonë e njohur për vlerat e larta të trashëgimisë kulturore. Kjo zonë është një nga destinacionet më të vizitueshme dhe të preferuara në Gjirokastrë, e konsideruar si porta hyrëse drejt qendrës historike dhe Bashkimit Europian.



02.10.2019

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ka pritur në një takim bashkëpunimi znj. Ajola Daja, producente dhe drejtore e projektit “Balkan’s Gate” si dhe n/kryetaren e bashkisë Gjirokastrë znj. Jorida Muho.

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë mbështet projektin “Balkan’s Gate”, një rezidence kulturore e cila mban edicionin e saj të pestë këtë vit në Gjirokastrë, nga datat 1-10 Tetor. Projekti “Balkan's Gate” do të zhvillojë dy seksione paralele, xhirimin e filmave të shkurtër me temë sociale si dhe trajnimin e të rinjve nga fusha e gazetarisë dhe shkencave sociale me temë “Dhuna ndaj gruas”. Gjatë këtyre 10 ditëve të rezidencës janë mbledhur bashkë regjisorë të huaj dhe shqiptarë si dhe të rinj të gazetarisë dhe shkencave sociale nga vende të ndryshme të Shqipërisë.



Projekti mbështetet nga Ministria e Kulturës, Ambasada Amerikane, Prezenca e OSCE në Shqipëri, Ambasada Franceze dhe Bashkia Gjirokastrë. Qyteti i Gjirokastrës është zgjedhur për të festuar vitin e pestë të kësaj rezidence si një pasuri jo vetëm e vendit tonë por e gjithë

njerëzimit. Ky qytet do të japë kontributin e tij, më shumë frymëzim, më shumë kulturë, e memorizuar në filmat që do të krijohen.

03.10.2019

Në kuadër të projektit “Balkan’s Gate” u zhvillua trajnimi me temë “Barazia Gjinore”, në ambientet e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë me pjesëmarrjen e Prefektit të qarkut Z.Astrit Aliaj, drejtoresha e projektit znj. Ajola Daja, përfaqësues nga prezenca e OSBE-së në Shqipëri, si dhe të rinj profesionistë të fushës së kinematografisë nga vende të ndryshme të Ballkanit dhe më gjerë.

Në fjalën përshëndetëse, Prefekti i qarkut falënderoi mbështetësit e projektit Balkan's Gate, si për tematikën e zgjedhur ashtu edhe për faktin që këtë edicion të 5-të po e realizojnë në qytetin e Gjirokastrës. Pasi Gjirokastra është një pasuri jo vetëm e vendit tonë, por e gjithë njerëzimit duke qenë pjesë e trashëgimisë botërore kulturore, e UNESCO-s. Ndër të tjera, Prefekti theksoi rëndësinë e bashkëpunimit në mënyrë të tillë që të rritet sensibilizimi i shoqërisë, pjesë e së cilës jemi si individ, por dhe në institucione shtetërore. Njëkohësisht vlerësoi mundësinë që krijon ky projekt me shkëmbimet ndërkulturore mes vendeve të ndryshme, por gjithashtu u jep atyre mundësinë që të kuptojnë më nga afër perspektivat në vendin tonë.

Në këtë trajnim u diskutuan çështjet sociale, si ajo e barazisë gjinore, dhuna ndaj gruas, që do të reflektohen përmes 5 filmave artistik me metrazh të shkurtër, të cilët do të shfaqen në festivale të ndryshme shqiptare dhe ndërkombëtare.



03.10.2019

Në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 89, datë 08.05.2019 “Për ngritjen e komisionit shtetëror për përkujtimin e 75-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë”, institucioni i Prefektit të qarkut ka ngritur një komision organizator në nivel vendor për organizimin e aktiviteteve që do të kulmojnë në datën 26 nëntor me Konferencën Shkencore me temë “Prefektura e Gjirokastrës gjatë Luftës së Dytë Botërore, 7 prill 1939-29 nëntor 1944”.

Në këtë kuadër, është mbajtur takimi i grupit të punës, i përbërë nga historianë, studiues, veteranë, intelektualë nga fusha të artit, kulturës, letërsisë si dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore në nivel vendor. Pjesëmarrësit diskutuan mbi temat që do të referohen në konferencën shkencore dhe organizimin e punës për mbledhjen e studimeve në bazë të së cilave synohet të përgatitet një botim përfundimtar.

Në përfundim të takimit, Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj ritheksoi rëndësinë e sensibilizimit të gjithësecilit duke kontribuar me dokumenta historike me qëllim rivlerësimin dhe rikujtimin e të gjithë atyre që kanë dhënë jetën në çlirimin e vendit tonë.



14.10.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ishte i pranishëm në ceremoninë e fillimit të vitit të ri akademik 2019-2020 në Universitetin e Gjirokastrës “Eqrem Çabej”.

Fjala përshëndetëse u mbajt nga Rektori i këtij universiteti z. Bektash Mema. Morën pjesë kryetarja e Këshillit të qarkut znj. Lindita Rova, kryetari i bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, kryetari i bashkisë Dropull z. Dhimitraq Toli.

Në fjalën përshëndetëse, Prefekti i qarkut uroi të gjithë studentët, stafin akademik për një vit të mbarë dhe të suksesshëm akademik. Gjithashtu Prefekti u shpreh se zgjedhja e studentëve të rinj për të ndjekur rrugën e arsimit në degët që ofron Universiteti i Gjirokastrës, jo vetëm që ofron besimin se e ardhmja do të jetë më e mirë, por si drejtues institucionesh na vendos para përgjegjësisë që të vijojmë përpjekjet, angazhimin intensiv në rritjen e standardeve të cilësisë së sistemit arsimor si një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare. Në përfundim të fjalës, Prefekti i qarkut theksoi se duhet një angazhim maksimal për një rritje të cilësisë së mësimdhënies, por edhe të përvetësimit të njohurive shkencore me qëllim përgatitjen e studentëve për të qenë të aftë dhe për t’iu përshtatur sa më mirë kërkesave të tregut të punës.



16.10.2019

Në institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi i radhës i Organit Këshillues të Prefektit me tematikë ”Puna e zhvilluar për parandalimin dhe përballimin e zjarreve gjatë stinës së verës si dhe masat që do të merren për përballimin e periudhës vjeshtë – dimër 2019-2020”.

Gjatë këtij takimi janë analizuar masat e marra për përballimin e zjarreve për periudhën qershor - shtator 2019, dëmet e shkaktuara si pasojë e zjarreve në rang qarku si dhe masat që do të merren për përballimin e situatave emergjente të mundshme për periudhën vjeshtë – dimër 2019-2020 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka kërkuar vlerësim dhe bashkëpunim ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore, degëve territoriale dhe strukturave shtetërore për

parandalimin, shmangien dhe minimizimin e dëmeve në situata emergjente të natyrave të ndryshme si dhe planifikim të detajuar të masave organizative – teknike.

Në përfundim të këtij takimi nga ana e Prefektit të qarkut janë lënë rekomandimet përkatëse për zbatim për të gjitha institucionet përgjegjëse si:

1. Të riorganizohet në cdo bashki Komisioni i Mbrojtjes Civile mbështetur në ligjin e ri nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.
2. Të merren masat për pastrimin e kanaleve, tombinove e pusetave për përforcimin e argjinaturave, për pastrimin e kanaleve, tombinave, pusetave, pastrimin e rrugëve nga inertet dhe sigurimin e sasisë së domosdoshme të kripës dhe skorieve. Ky proces duhet të ketë përfunduar deri më datë 30.10.2019.
3. Të ngrihen grupet e konstatimit dhe të vlerësimit të dëmeve në terren dhe të përgatitet me korrektësi dokumentacioni për kompesimin e qytetarëve në lidhje me dëmet e shkaktuara.



17.10.2019

Në kuadër të programit të aktiviteteve që Qeveria Shqiptare ka ndërmarrë me rastin e 75-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 89/2019 “Për ngritjen e komisionit shtetëror për përkujtimin e 75-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë”, Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka zhvilluar një takim me veteranët e bashkisë Tepelenë. Në fjalën përshëndetëse, Prefekti i qarkut vlerësoi kontributin e veteranëve në LANÇ dhe i ka falënderuar për angazhimin e tyre në organizimin e aktiviteteve gjatë këtij viti jubilar.



Gjatë bashkëbisedimit, veteranët përgëzuan nismën e ndërmarrë nga pushteti qendror si dhe shprehën disa problematika lidhur me rehabilitimin e lapidarëve të dëmtuara, mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve, identifikimin e të rënëve që nuk kanë përfituar ende statusin e dëshmorit, etj.

Në përfundim të takimit, Prefekti ka kërkuar bashkëpunim maksimal nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore me organizatat e veteranëve me qëllim realizimin sa më dinjitoz të aktiviteteve që do të përcjellin vlera patriotike edhe për brezat e ardhshëm.

23.10.2019

Në kuadër të Ditës Evropiane kundër Trafikimit të Personave, sikurse është kthyer në traditë, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë në bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe organizatat të ndryshme përgjatë muajit tetor, i nominuar tashmë "Muaji i Luftës kundër

Trafikimit të Personave" ka organizuar aktivitete sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere për parandalimin e trafikimit të personave në të gjithë qarkun Gjirokastrë.

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj priti në një takim mësues dhe nxënës të shkollës së mesme artistike "Feim Ibrahim". Prefekti i qarkut ka falenderuar nxënësit për punën e palodhur dhe plot pasion të pasqyruar nga ana e tyre në punimet dhe pikturat e shumta, të cilat përcillnin mesazhe shumë të rëndësishme në luftën kundër trafikimit të personave dhe dhunës ndaj fëmijëve. Këto punime do të dërgohen në ekspozitën kombëtare që do të zhvillohet në Tiranë në datën 24 tetor 2019.

Prefekti i qarkut shprehu gjithë mbështetjen institucionale për intesifikimin e përpjekjeve të institucioneve shtetërore në luftën kundër këtij fenomeni.



23.10.2019

Në kuadër të aktiviteteve që po zhvillohen për festimin e 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj zhvilloi takimin e rradhës me grupin e punës të komisionit organizator në nivel vendor. Në këtë takim ishte i pranishëm Prof. z. Shyqyri Hysi,

shkrimtari z. Kristaq Shabani dhe përfaqësuesi i komunitetit fetar z. Sheh Hysen Ali Hormova.



Nga të pranishmit u diskutua mbi organizimin e konferencës shkencore dhe problematika të ndryshme si evidentimin e lapidarëve dhe gjendjen e tyre, mbledhja e materialeve të rëndësishme historike dhe përpunimi i tyre duke i pasqyruar në një ekspozitë të veçantë.

Prefekti i qarkut theksoi rëndësinë e organizimit të konferencës shkencore si një nga aktivitetet më të rëndësishme që është zhvilluar vitet e fundit në qarkun Gjirokastrë, me kryefjalë Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Në përfundim, Prefekti kërkoi angazhim maksimal në evidentimin e vlerave dhe përkujtimin me solemnitet dhe dinjitet të veprës së dëshmorëve, të cilët do të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.

24.10.2019

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka pritur në një takim Konsullin e Përgjithshëm të Greqisë në Gjirokastrë z. Lambros Kakissis.



Prefekti i qarkut ka falenderuar Konsullin e Përgjithshëm të Greqisë për përkrahjen dhe qëndrimin e mbajtur të Qeverisë Greke gjatë procesit të çeljes së negociatave për Shqipërinë, rritjen e bashkëpunimit dhe forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Konsulli i Përgjithshëm z. Lambros Kakissis ka shprehur gatishmërinë për një bashkëpunim të ngushtë dhe mbështetje të plotë nga pala greke në zgjidhjen e problematikave të komunitetit të Qarkut Gjirokastrë dhe në veçanti të minoritetit grek në rajon.

28.10.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj së bashku me zv/shëfën e Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneral brigade znj. Manushaqe Shehu, morën pjesë në ceremoninë përkujtimore zhvilluar në fshatin Bularat të bashkisë Dropull me rastin e 28 tetorit, festës kombëtare të Greqisë.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin deputetja e qarkut Gjirokastrë znj. Artemis Malo, zv/ministri i Punëve të Jashtme të Greqisë z. Antonios Diamataris, ambasadorja greke në Shqipëri znj. Sofia Pilpopullo, si dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore në nivel vendor të qarkut Gjirokastrë.

Ceremonia u zhvillua në varrezat historike të fshatit Bularat, ku u mbajtën fjalët përshëndetëse të përcaktuara sipas protokollit të ceremonisë. Ceremonia u shoqërua me vendosjen e kurorave si dhe u ndoqën aktivitete të organizuara nga ana e nxënësve të shkollës së fshatit Bularat, bashkia Dropull.

Prefekti i qarkut dhe zv/ shëfë e Shtabit të Përgjithshëm të FA vendosën një kurorë në nder të të rënëve.



29.10.2019

Në kuadër të javës së gjuhës dhe kulturës italiane, Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ishte i pranishëm në koncertin e Ansambllit Frymor, mbajtur në ambientet e Muzeut Historik në kalanë e qytetit, ku performuan studentët të Liceut Artistik “Feim Ibrahim” Gjirokastrë, studentët të shkollës artistike “Naim Frashëri” Vlorë dhe studentët të Konservatorit N. Piccini të Barit.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin Kryetari i bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, Kryetarja e këshillit të qarkut Gjirokastrë znj. Lindita Rova, Konsullja e Përgjithshme e Italisë në Vlorë znj. Luana Mikeli, Konsulli i Nderit i Italisë në Gjirokastrë z. Theodor Bilushi etj. Ky koncert u zhvillua në vazhden e aktiviteteve kulturore në kuadër të javës së gjuhës dhe kulturës italiane në Gjirokastrë, ndërkaq Konsullja e Përgjithshme e Italisë në Vlorë znj. Luana Mikeli shprehu gatishmërinë dhe vullnetin e saj për të thelluar më tej bashkëpunimin mes dy vendeve.



30.10.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë u zhvillua takimi i Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit në kuadër të analizimit të ecurisë së sezonit turistik janar-shtator 2019 dhe të problematikave të hasura gjatë kësaj periudhe.

Nën drejtimin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj, u bë një prezantim lidhur me ecurinë e sezonit turistik, masat e marra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe të degëve territoriale për mbarëvajtjen e këtij sezoni, duke përfshirë numrin e turistëve vendas dhe të huaj, kapacitetet akomoduese dhe investimet e kryera nga qeveria shqiptare.

Gjatë takimit, nga të pranishmit u diskutua mbi disa problematika të cilat kërkojnë vëmendjen e strukturave përkatëse dhe kanë nevojë për përmirësime të mëtejshme për t'u ndjekur dhe monitoruar hap pas hapi nga këto struktura.

Në përfundim, Prefekti i qarkut dha rekomandimet përkatëse dhe ofroi mbështjetjen institucionale për koordinimin dhe bashkërendimin e veprimtarisë së njësive të vetëqeverisjes vendore dhe me degët territoriale për objektivin kryesor, zhvillimin e turizmit gjithëpërfshirës dhe gjithëvjeter në qarkun Gjirokastrë.



31.10.2019

Në zbatim të politikave të Qeverisë shqiptare për rëndësinë e veçantë që u jep programeve me qëllim uljen e papunësisë dhe rritjes së kapaciteteve të tregut të punës, Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj vizitoi nga afër ambientet e biznesit të mobilerisë “Lani” që ndodhet në zonën industriale të qytetit të Gjirokastrës.

Gjatë takimit me z. Simon Lani, sipërmarrësi i kësaj mobilerie, Prefekti i qarkut e falënderoi për kontributin e rëndësishëm që jep ky biznes në zhvillimin ekonomik të qarkut tonë. Nga ana e z. Lani u ngritën disa problematika si konkurrenca e pandershme, mungesa e punëtorëve që duan të ushtrojnë profesionin e marangozit si dhe paraqiti kërkesën e tij që të zhvillojë kurse profesionale për punëtorë pa eksperiencë.

Mobileria “Lani” ka rreth 26 vite që ushtron aktivitetin e saj në qytetin e Gjirokastrës, tashmë me 15 punonjës të cilët përpunojnë lëndën e parë për të prodhuar mobileri të ndryshme me cilësi të lartë.

Prefekti i qarkut theksoi mbështetjen institucionale në zgjidhjen e problematikave që ngriti z. Lani, për të mundësuar vijueshmërinë sa më të mirë të zhvillimit të këtij biznesi.



02.11.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj mori pjesë në aktivitetin me tematikë "Promovimi i konsumit të produkteve organike, tradicionale dhe treguesve gjeografikë të Shqipërisë", në ambientet e shtëpisë së Zekatëve, Gjirokastrë. Ky aktivitet u organizua nga Food and Agriculture Organization of the United Nations, lëvizjen Sloë Food në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe organizatën CESVI.

Të pranishëm ishin ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural z. Bledi Çuçi, deputetët e qarkut Gjirokastrë znj. Mirela Kumbaro dhe znj. Artemis Malo, kryetari i bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, si dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore në nivel vendor. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte promovimi i bizneseve dhe të produkteve karakteristike lokale, prodhimeve agro-bujqësore, të etnografisë kulturore, si dhe kulinarinë e qarkut Gjirokastrë.

Në përfundim të aktivitetit u zhvillua një panair me qëllim të degustimit të produkteve tipike tradicionale të Gjirokastrës.



06.11.2019

Në kuadër të aktiviteteve që do të zhvillohen për festimin e 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z.Astrit Aliaj zhvilloi takimin e radhës me grupin organizator, me përfaqësues nga institucione shtetërore në nivel vendor.

Nga të pranishmit u diskutua mbi organizimin e ceremonive festive që do të zhvillohen përgjatë këtij viti jubilar, në mënyrë të veçantë përgatitjen e programit të konferencës shkencore, që do të zhvillohet në 26 nëntor 2019.



07.11.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim me grupin e punës të komisionit organizator si dhe me përfaqësues të institucioneve shtetërore në nivel vendor në kuadër të aktiviteteve që do të zhvillohen për festimin e 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë. Në fjalën e tij, Prefekti falënderoi kryetarët e bashkive për masat që kanë marrë për të përkrahur organizimin të aktiviteteve për festimin e datave historike të qyteteve dhe planifikimit për festimin e 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë duke bashkëpunuar me organizatat e veteranëve, familjet e dëshmorëve dhe zyrat arsimore në qark.

Ndër të tjera, Prefekti paraqiti punën e bërë deri më tani nga komisioni organizator lidhur me përgatitjen e konferencës shkencore, që do të mbahet më 26 nëntor në teatrin “Zihni Sako”. Në përfundim të takimit, Prefekti kërkoi angazhim maksimal në evidentimin e vlerave dhe përkujtimin me solemnitet dhe dinjitet të veprës së dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare si dhe realizimin sa më dinjitoz të aktiviteteve që do të përcjellin vlera patriotike edhe për brezat e ardhshëm.



07.11.2019

Në kuadër të projektit “Care and Dare” Qendra Tirana Art në bashkëpunim me Ambasadën e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Tiranë, çelën mbasditen e së enjtes Ekspozitën e Përbashkët të Piktorëve të Rinj me temë “Ti themi stop trafikut të qënieve njerëzore me pjesëmarrje të studentëve, nxënësve të shkollës artistike dhe të shkollave 9- vjeçare të qytetit të Gjirokastrës”.

Në ceremoninë e çeljes në hollin e Teatrit "Zihni Sako" ishte i pranishëm edhe Prefekti i Qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj.

Ky projekt synon të edukojë dhe ndërgjegjësojë të rinjtë kundër trafikimit të qënieve njerëzore. Për tre ditë, studentë, nxënës të shkollës artistike dhe shkollave 9-vjeçare të Gjirokastrës u angazhuan në një punë krijuese me këtë temë.

Në këtë ekspozitë u përfshinë 26 krijimet më të mira të përzgjedhura nga një numër shumë i madh aplikuesin. Artistët e vegjël u përshëndetën nga z. Astrit Aliaj i cili nga ana e tij i falenderoi për përfshirjen në këtë veprimtari, për fantazinë dhe talentin e manifestuar.



14.11.2019

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj priti në një takim Zv. Guvernatoren e Parë të Bankës së Shqipërisë Prof. Dr. Luljeta Minxhozi. Gjatë këtij takimi është diskutuar lidhur me rolin e Bankës së Shqipërisë në realizimin e objektivave për stabilitetin e çmimeve dhe kontributin me politikat e saj në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien e rajonit e më gjerë.

Gjithashtu Prefekti i qarkut, i ftuar nga Zv. Guvernatorja, mori pjesë në ekspozitën e organizuar nga Banka e Shqipërisë për njohjen e komunitetit të qarkut Gjirokastrë me serinë e re të dy kartmonedhave që Banka Qendrore ka hedhur së fundmi në qarkullim.

Prefekti i qarkut shprehu falenderime të përzemërta për Bankën e Shqipërisë për organizimin e kësaj ekspozite në qytetin e Gjirokastrës. Gjirokastra si qendër e dijes dhe si qyteti i lindjes së shumë personaliteteve të shquar, për qytetarët e Gjirokastrës organizimi i aktiviteteve të tilla, është një vlerë e shtuar për të rritur kulturën financiare të qytetarëve tanë.



14.11.2019

Në kuadër të ditës botërore të diabetit, Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj mori pjesë në aktivitetin ndërgjegjësues organizuar nga Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë, zhvilluar në fshatin Dervician, njësia administrative Dropull i Poshtëm, bashkia Dropull.



Në këtë aktivitet ishin të pranishëm kryetarja e Këshillit të qarkut Gjirokastrë znj. Lindita Rova, kryetari i bashkisë Dropull z. Dhimitraq Toli, si dhe banorë të këtij komunitetit.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte informimi dhe sensibilizimi i shoqërisë në lidhje me rëndësinë e ndërgjegjësimit të komunitetit për kryerjen e kontroleve periodike dhe marrjen e masave për parandalimin e sëmundjes së diabetit, që vjen si pasojë e kequshqyerjes dhe moskryerjes së aktiviteteve fizike.

Krahas pjesës informuese, ky aktivitet kishte si qëllim edhe ofrimin e matjes së glicemisë falas për banorët e fshatit Dervician. Banorët që rezultojnë me një glicemi jo normale u këshilluan se si të vepronin, duke i orientuar për të kryer një kontroll dhe takim me mjekun. Depistime të tilla janë të rëndësishme dhe shërbejnë si rikujtesë që shëndeti është mbi gjithçka.

19.11.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj vizitoi nga afër kompaninë “Vagexco” sh.p.k, me vendndodhje në fshatin Vrisera, njësia administrative Dropull i Sipërm, bashkia Dropull, në kuadër të zhvillimit rajonal të qarkut Gjirokastrë.

Aktiviteti kryesor i kompanisë “Vagexco”sh.p.k është prodhimi, importimi, eksporti, magazinimi, transporti dhe përdorimi i lëndëve plasëse për përdorimcivil dhe materiale të tjera plasëse.

Prefekti i qarkut falënderoi dhe ofroi mbështetjen institucionale për investimin e këtij aktiviteti dhe për kontributin e rëndësishëm që jep në zhvillimin ekonomik të qarkut Gjirokastrë.

20.11.2019

Pas thirrjes së parë të shpallur më datë 6 shtator 2019 nga ana e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë drejtuar historianëve, intelektualëve dhe gjithë opinionit shkencor për pjesëmarrje në konferencën shkencore kombëtare me temë: “Prefektura e Gjirokastrës gjatë Luftës së Dytë Botërore” (7 prill 1939 – 29 nëntor 1944), u zhvillua takimi i rradhës me grupin e punës në kuadër të përfundimit të organizimit të kësaj konference.

Në këtë takim ishin të pranishëm drejtoresha e Zyrës Vendore të Arsimit Gjirokastrë znj. Albana Hasani, drejtori i Agjencisë së Kulturës, Turizmit dhe Sporteve në bashkinë Gjirokastrë z. Kudret Alikaj, drejtori i Radio Televizionit të Gjirokastrës z. Arjan Xhani, shkrimtari z. Kristaq Shabani dhe regjisori z. Ilir Luri.

Nga të pranishmit u diskutuan mbi ecurinë e punës së bërë deri më tani si dhe programin që do të ketë konferenca kombëtare duke përfshirë promovimin e librit që do të zhvillohet në

datën 25 nëntor; ekspozita me objekte historike që do të paraqiten për herë të parë, dy filma dokumentarë, kumtesat si dhe në përfundim të konferencës do të ndiqet një koncert festiv të paraqitur nga nxënësit e shkollave të Gjirokastrës.

Gjatë përgatitjes së konferencës, takimet me komisionin vendor ka qenë të shumta duke ndjekur planin vendor, si dhe janë ndjekur një sërë aktivitete organizuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore të qarkut Gjirokastrë. Në konferencën kombëtare që do të zhvillohen më datë 26 nëntor në bashkëpunim me Universitetin e Gjirokastrës “Eqrem Çabej” do të referojnë materialet e tyre si akademiku z. Beqir Meta, Prof. Asoc. Dr. z. Benard Zotaj, Prof. Asoc. Dr. znj. Sonila Boçi, Prof. Dr. Hamit Kaba dhe personalitete të tjerë në fushën e historisë dhe letërsisë.

Gjatë fjalës së tij, Prefekti i qarkut falënderoi për angazhimin maksimal të treguar prej të gjithë aktorëve të përfshirë që po kontribuojnë në realizimin e kësaj konference shkencore kombëtare për të transmetuar tek brezat e ardhshëm vlerat historike të epopes më të rëndësishme të vendit tonë, atë të LANÇ-it si dhe të evidentojë kontributin e popullit të Prefekturës së Gjirokastrës në çlirimin e Atdheut.



21.11.2019

Në ambientet e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë u zhvillua një takim ndërgjegjësues mbi çështjet e sigurisë, radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm midis aktorëve lokal dhe përfaqësuesve në nivel qendror CVE.



Qëllimi i këtij takimi ishte mbi fuqizimin dhe ngritjen e kapaciteteve për aktorët e vijës së parë që operojnë në komunitet. Në këtë takim u theksuan strategjitë dhe qasjet bashkëpunuese mes të gjithë aktorëve për identifikimin e hershëm dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj, u shpreh se bashkëpunimi i frytshëm midis gjithë aktorëve lokalë e rajonalë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit të çdo lloji është një detyrë e të gjithë institucioneve dhe një përgjegjësi e përbashkët sociale për të mirën e shoqërisë sonë.

21.11.2019

Në kuadër të aktiviteteve që po zhvillohen për kremtimin e festave kombëtare të 28-29 nëntorit, Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj mori pjesë në aktivitetin e zhvilluar nga shkolla 9-vjeçare “Avni Rustemi”, bashkia Libohovë.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm kryetarja e bashkisë Libohovë znj. Luiza Mandi, drejtoresha e shkollës 9-vjeçare “Avni Rustemi” znj. Vjollca Idrizi si dhe mësues dhe nxënës të kësaj shkolle.

Prefekti i qarkut iu ka dhuruar në mënyrë simbolike nxënësve të klasës së pestë një pako të veçantë me flamurin kombëtar dhe një disk me himnin kombëtar. Më tej, vijoi atmosfera festive me recitalin e përgatitur nga nxënësit e kësaj klase, ku kënduan dhe recituan këngë dhe poezi patriotike.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut u shpreh se kjo dhuratë është në kujtim të datave të rëndësishme, që këtë vit përkojnë me vitin jubilar të 75-vjetorit të çlirimit të Atdheut, si dhe të 107-përvjetorit të shpalljes së pavarësisë më 28 nëntor. Gjithashtu theksoi që flamuri kombëtar të mos mbetet vetëm si një send simbolik por të shpaloset në çdo festë kombëtare nga të gjithë shqiptarët.



25.11.2019

Në datën 25 nëntor, është zhvilluar ceremonia e promovimit të librit “Prefektura e Gjirokastrës gjatë Luftës së Dytë Botërore (7 prill 1939-29 nëntor 1944)” në ambientet e hotel “Çajupi”. Në ceremoninë e promovimit të këtij libri morën pjesë studiues, historianë dhe intelektualë që kontribuan me punimet e tyre shkencore si dhe të ftuar të tjerë. Ky libër vjen në kuadër të 75-vjetorit të çlirimit të Atdheut, si botim i institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë në bashkëpunim me Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë. Në përmbajtjen e librit përfshihen një sërë kumtesash me larmi tematike, materiale të ilustruara me dokumente arkivore të përgatitura nga personalitete të fushës së historisë.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast, Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj shprehu vlerësimet e tij duke falënderuar bordin e botimit, anëtarët e komisionit vendor dhe të gjitha institucionet, organizmat arsimore, kulturore dhe artistike të hapësirës sonë administrative. Ndër të tjera, Prefekti i qarkut theksoi se libri është një risi në evidentimin dhe në krijimin e fondit historik të Prefekturës së Gjirokastrës duke respektuar të gjithë dëshmorët dhe heronjtë që dhanë jetën për lirinë e Atdheut.

Botimi i këtij libri është një kontribut në fondin e artë të historisë sonë kombëtare për një nga periudhat më sinjifikative, sikundërse është ajo e LANÇ- it dhe një vlerë e shtuar në ndërgjegjen e çdo shqiptari, i cili krenohet me historinë e Kombit.



28.11.2019

Është zhvilluar ceremonia e ngritjes së flamurit kombëtar në sheshin “Çerçiz Topullit” Gjirokastër në kuadër të 28 nëntorit, ditës së shpalljes së pavarësisë. Shqipëria mbush 107 vjet ku Ismail Qemali ngriti flamurin në Vlorë duke shpallur vendin tonë shtet sovran dhe të pavarur. Aktiviteti u zhvillua sipas Ceremonialit Shtetëror, duke anuluar të gjitha aktivitetet festive në respekt të viktimave të tërmetit të datës 26 nëntor. Më tej, përfaqësuesit e institucioneve vendore vendosën kurora lulesh në bustin e heroit të popullit Çerçiz Topulli.

Shqipëria gjendet në një situatë të vështirë prandaj dita e sotme si ditë e flamurit, duhet të jetë një ditë solidariteti dhe bashkimi kombëtar, një ditë shprese dhe inkurajimi për të gjithë shqiptarët për tu gjendur sa më pranë familjeve që humbën të afërmit e tyre nga kjo tragjedi. Institucioni i Prefektit të qarkut iu bën thirrje të gjithë institucioneve shtetërore, njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe biznesit, për mbështetje dhe gadishmëri në këto ditë të vështira për vendin.



28.11.2019

Dita e Flamurit është kthyer në ditën e bashkimit kombëtar si një nga ditët më të dhimbshme në historinë e shtetit të pavarur shqiptar.

Drejt Durrësit dhe të gjithë zonave të dëmtuara janë ofruar ndihmat e domosdoshme në ushqime, strehim dhe përkujdesje shëndetësore nga të gjitha trevat shqiptare, të mobilizuar në këto ditë të vështira, duke ju ardhur në ndihmë të prekurve nga tërmeti i datës 26 nëntor. Prefekti i qarkut Gjirokastër z. Astrit Aliaj, së bashku me Prefektët e qarqeve të tjera të Shqipërisë, kanë qenë në mbështetje të Prefektit të qarkut Durrës gjatë këtyre ditëve të vështira. Janë organizuar disa takime me Komisionin e Mbrojtjes Civile dhe me delegacione të vendeve të ndryshme, ku Ministri i Kulturës dhe deputetë të Maqedonisë së Veriut kanë shprehur solidarizimin e tyre me popullin shqiptar gjatë këtij takimi me Prefektin e qarkut të Durrësit. Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj i ka bërë thirrje bashkive dhe drejtorive rajonale që të ofrojnë ndihmën e tyre me profesionistë të fushave të ndryshme si inxhinierë ndërtimi, gjeodet, arkitektë, infermierë, psikologë e mësues, drejt zonave të dëmtuara nga tërmeti për të dhënë kontributin e tyre vullnetar për një **shqipërisolidare**.



29.11.2019

Është zhvilluar ceremonia e homazheve në Varrezat e Dëshmorëve në Gjirokastrë me rastin e 29 Nëntorit që përkon me 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë.

Të pranishëm ishin Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj, kryetari i bashkisë Gjirokastrë z. Flamur Golemi, kryetarja e Këshillit të qarkut z. Lindita Rova, kryetari i Organizatës së Familjeve të Dëshmorëve Gjirokastrë z. Hodo Liço si dhe përfaqësues të institucioneve shtetërore në nivel vendor.

Gjatë ceremonisë u vendosën kurora me lule për të përkujtuar të gjithë ata që dhanë jetën për çlirimin e vendit dhe më pas vijoi me ekzekutimin e himnit kombëtar.

29 Nëntori shënon një nga ditët më të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, atë të çlirimit të Shqipërisë, ku respektohen dhe nderohen të gjithë dëshmorët për sakrificat sublime dhe për heroizmin shembullor e dhënë gjatë Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare, në luftën që solli çlirimin e atdheut dhe që na ka bërë sot të ndihemi krenarë për sakrificën e madhe që kanë bërë të gjithë ata që dhanë jetën për çlirim.



29.11.2019

Në kuadër të situatës emergjente të krijuar si pasojë e tërmetit të datës 26 nëntor, Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj ka qënë i pranishëm në bashkitë Përmet dhe Këlcyrë për ndjekjen nga afër të zhvillimeve në ndihmë të banorëve të prekur nga dëmtimet që kanë sjellë lëkundjet e forta sizmike.

Në bashkinë e Përmetit, Prefekti i qarkut mori pjesë në mbledhjen e komisionit vendor të mbrojtjes civile, ku Kryetarja e bashkisë znj. Alma Hoxha e njohu me punën e bërë nga komisioni i mbledhur një ditë më parë dhe me masat e mara lidhur me pritjen dhe akomodimin e qytetarëve që kanë ngelur të pastrehë nga dëmtimet. Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj e ka falenderuar Kryetaren e bashkisë për gadishmërinë e treguar dhe masat e mara duke kërkuar bashkëpunim dhe koordinim të mëtejshëm të të gjithë administratës, për ndjekjen e situatës në vazhdimësi, evidentimin e nevojave që mund të kenë të sapoardhurit, evidentimin e kapaciteteve të hoteleve për akomodim e ushqim si dhe ju bëri thirrje të gjithë qytetarëve e bizneseve për solidarizim dhe ndihmesë në këtë situatë të vështirë.

Në përfundim të takimit, Prefekti i qarkut takoi nga afër 10 banorët e akomoduar në hotel "Amerika" dhe 27 banorët e akomoduar në hotel "Aroma" të qytetit të Përmetit. Në Bashkinë Këlcyrë, në takimin e zhvilluar me N/Kryetarin e bashkisë, N/Kryetarin e Këshillit të qarkut dhe shefin e stacionit të policisë, është bërë e ditur se janë akomoduar gjithsej 516 banorë nga Durrësi, Tirana dhe Shijaku, të shpërndarë sipas njësave administrative të bashkisë Këlcyrë, njësia administrative Ballaban 30 familje me 143 persona,

njësia administrative Suhë 50 familje me 110 persona, njësia administrative Dëshnicë 15 familje me 45 persona, qyteti i Këlcyrës 30 familje me 150 persona, hotel “Mandi” 12 persona, hotel “Grykë e Këlcyrës 38 persona dhe hotel “Riviera” 18 persona.



02.12.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut Gjirokastrë është zhvilluar takimi i jashtëzakonshëm i Komisionit të Mbrojtjes Civile lidhur me situatën emergjente aktuale që po përjeton vendi ynë pas lëkundjeve të fuqishme të tërmetit të datës 26 nëntor.

Në nderim të viktimave të tërmetit Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj i ka ftuar pjesëmarrësit të mbajnë një minutë heshtje. Prefekti i qarkut ka vijuar takimin duke falenderuar të gjitha ekipet e MZSH-ve të bashkive të qarkut tonë, të cilët morën pjesë në operacionet e kërkim shpëtimit duke treguar përkushtim dhe profesionalizmin të lartë në shpëtimin e jetëve njerëzore, individët dhe bizneset që u solidarizuan duke kontribuar me ndihma materiale dhe monetare si dhe njësitë akomoduese e familjarët e qarkut Gjirokastrë të cilët kanë pritur e strehuar banorët e ardhur nga zonat e dëmtuara gjatë këtyre ditëve.

Në vijim të detyrave të dhëna nga Kryeministri në mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave, si Kryetar i Komisionit të Mbrojtjes Civile për qarkun, Prefekti i qarkut në fjalën e tij theksoi se menaxhimi i situatave emergjente kërkon organizim dhe menaxhim të burimeve dhe përgjegjësi për trajtimin e të gjitha aspekteve të emergjencave, në veçanti gatishmërisë, përgjigjes dhe hapave fillestarë të rimëkëmbjes si dhe ka dhënë një sërë rekomandimesh mbi masat konkrete që duhen marrë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore lidhur me përballimin e situatave emergjente në qarkun tonë.



05.12.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj ka marrë pjesë në mbledhjen e parë për formalizimin e Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje në bashkinë Dropull. Në këtë mbledhje, drejtuar nga Kryetari i bashkisë Dropull Z. Dhimitraq Toli, ishin të pranishëm përfaqësues nga: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Komisariati i Policisë Dropull, Zyra Rajonale e Shërbimeve Sociale Gjirokastrë, Spitali Rajonal “Omer Nishani” dhe Koordinatorja Kombëtare e

Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara Znj. Edlira Papavangjeli, së bashku me ekspertë të UNDP-së.

Gjatë mbledhjes është nënshkruar edhe marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve të këtij mekanizmi, të cilët do të koordinojnë punën brenda juridiksionit territorial të bashkisë së Dropullit lidhur me identifikimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Në fjalën e tij Z. Aliaj u shpreh se Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje në bashkinë Dropull duhet të jetë si pikë kryesore mbështetje dhe mirëbesimi për qytetarët që hasen me fenomenin e dhunës në përditshmërinë e tyre, ndërsa kërkoi bashkërendim të veprimeve prej të gjithë institucioneve përgjegjëse.

Ndër të tjera, Prefekti i qarkut theksoi se dhuna në familje nuk duhet të shihet më si një çështje private, familjare, por duhet të pranohet e trajtohet hapur në mënyrë që viktimat e saj të marrin mbështetjen dhe shërbimin e nevojshëm.



06.12.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut është mbajtur takimi me specialistë të inxhinierisë, arkitekturës, gjeologjisë, ndërtimit dhe përfaqësues të institucioneve vendore në qark lidhur me situatën dhe gjendjen e ndërtimeve aktuale në qarkun e Gjirokastrës.

Në bashkëpunim me bashkinë Gjirokastrë dhe në vijimësi të takimit të Komisionit të Emergjencave Civile të zhvilluar më datë 2 dhjetor, lidhur me situatën e krijuar pas tërmetit dhe masave të marrave nga ana e njësisve të vetëqeverisjes vendore, është kërkuar nga Prefekti i qarkut të ngrihen grupet e punës me inxhinierë të fushave të ndryshme të cilët do të kontrollojnë e verifikojnë zonat më të rrezikshme dhe me risk, gjendjen fizike aktuale të banesave egzistuese, parametrat dhe cilësia e ndërtimeve të reja si dhe evidentimi i ndërtimeve pa leje (shtesave anësore dhe shtesave të kateve në godinat e ndërtuara). Gjatë takimit, nga ana e pjesëmarrësve janë diskutuar problematikat lidhur me zbatimin e parametrave dhe kushteve në ndërtim në qytetin e Gjirokastrës si dhe për hartimin e procedurave dokumentare për hipotekimin e ndërtesave.



Në përfundim të takimit, është rënë dakort që firmat ndërtuese në bashkëpunim me bashkinë Gjirokastrë, duhet të pajisen me një akt konstatimi të lëshuar nga Drejtorja e Urbanistikës së

bashkisë, për vlerësimin e godinave ndërtimore, si ato egzistuese dhe ato që janë në proces ndërtimi.

12.12.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj mori pjesë në mbrëmjen poetike organizuar nga Universiteti i Gjirokastrës “Eqrem Çabej” në bashkëpunim me trupën e teatrit “Zihni Sako”, në kuadër të festimeve të 75-vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Ky aktivitet i mbajtur në ambientet e auditorit të universitetit “Eqrem Çabej” u çel nga fjala përshëndetëse e rektorit të këtij universiteti z. Bektash Mema. Z.Mema vlerësoi iniciatorët e kësaj mbrëmjeje poetike kaq të veçantë dhe shprehu gatishmërinë e tij për mbështetje të vazhdueshme institucionale ndaj organizimeve të tilla. Më tej aktiviteti vijoi me interpretime poetike dhe këngë patriotike prej studentëve dhe trupës së teatrit të Gjirokastrës.



17.12.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë Z. Astrit Aliaj, në bashkëpunim me Konsullin e Përgjithshëm të Greqisë në Gjirokastrë, Z. Lambros Kakissis ishin të pranishëm në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në qytetin e Tepelenës dhe të Këlcyrës.

Gjatë këtyre vizitave z. Aliaj dhe z. Kakissis u pritën nga përfaqësues të bashkive, Zyrave Vendore Arsimore si dhe drejtues të shkollave përkatëse. Gjatë takimeve u shpreh miqësia e mirë midis dy vendeve, mirënjohja ndaj solidarizimit të qeverisë dhe popullit grek ndaj fatkeqësisë që përfshiu vendin tonë nga tërmeti i 26 nëntorit si dhe mbështetja e vazhdueshme e qeverisë fqinje për çeljen e negociatave të vendit tonë me Bashkimin Evropian.

Më tej u vijua me shpërndarjen e pakove me dhuratave të mundësuar nga Ministria e Mbrojtjes Greke, në të cilat përfshiheshin mjete kancelarike për shkollat si dhe sete sportive për Qendrat Multifunktionale të Aktiviteteve Sportive në këto bashki.





18.12.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastrë z. Astrit Aliaj vizitoi nga afër familjet e prekura nga zjarri i rënë i datës 16 dhjetor 2019 në banesën që ndodhet në lagjen “Dunavat”, qyteti Gjirokastrë. Të pranishëm ishin dhe drejtori i Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare z. Njazi Çobani, së bashku me inxhinierin z. Vasil Polo. Shtëpia e familjes së z. Sokol dhe Dritan Topulli është dëmtuar si pasojë e zjarrit që përfshiu këtë banesë si dhe është dëmtuar pjesërisht banesa ngjitur e z. Rakip Topulli. Forcat policore dhe shërbimi zjarrfikës u angazhuan maksimalisht në operacionin e shuarjes së zjarrit pavarësisht se dëmet në banesa janë të shumta. Prefekti i qarkut theksoi ndër të tjerash koordinimin e punës, duke filluar me masat e menjëhershme që duhen merren për stabilizimin e familjeve të prekura në banesa të sigurta, vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në banesës e djegur si dhe përfitimin financiar sipas ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”. Në përfundim, Prefekti i qarkut shprehu gatishmërinë dhe ofroi mbështetjen e tij institucionale për të gjetur një zgjidhje të shpejtë duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat shtetërore përgjegjëse deri në stabilizimin e situatës.



18.12.2019

Në institucionin e Prefektit të qarkut u organizua një takim me sekretarët e këshillave bashkiakë dhe specialistë të njësisve të vetëqeverisjes vendore me qëllim përmirësimin e punës në lidhje me procedurën e verifikimit të akteve të organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore. Nisur edhe nga problematikat e konstatuara deri tani, ky takim ishte konceptuar si një mini-trajnim për të shpjeguar dhe standartizuar mënyrën e paraqitjes së akteve për verifikim të ligjshmërisë pranë Prefektit të qarkut, elementët formale dhe të përmbajtjes që këto akte duhet të përmbushin në zbatim të lëgjislacionit në fuqi si dhe u bë një prezantim dhe interpretim i bazës ligjore që duhet të zbatohet nga sekretarët e këshillave por edhe nga specialistët e tjerë pranë bashkive të qarkut.

Prefekti i qarkut z. Astrit Aliaj gjatë diskutimeve e vuri theksin në rolin e rëndësishëm që kanë sekretarët e këshillave në hartimin e vendimeve të këshillave bashkiakë, por edhe të gjithë specialistët e bashkive që përgatisin këto akte. Prefekti kërkoi angazhimin e tyre për të punuar me përgjegjshmëri, njohjen dhe azhurnimin me legjislacionin në mënyrë që aktet e organeve të njësisve të vetëqeverisjes vendore të jenë në zbatim korrekt të ligjit.



26.12.2019

Në kuadër të rritjes së masave në pikat e kalimit kufitar, Prefekti i qarkut z.Astrit Aliaj ishte në një inspektim në pikën e kalimit kufitar të Kakavijës. Prefekti i qarkut zhvilloi një takim me kryetarin e degës së doganës Kakavijë dhe drejtorin e policisë kufitare dhe migracionit. Në këtë takim janë diskutuar disa problematika dhe masat që janë marrë për lehtësimin e lëvizjes së qytetarëve që udhëtojnë nga shtetet fqinje drejt Shqipërisë me rastin e festave të fundvitit.

Nga ana e drejtuesve të këtyre institucioneve është dhënë garancia për masa shtesë dhe për sigurimin e lëvizjes së shtetasve duke mos krijuar rradhë dhe duke u gjendur pranë qytetarëve të cilët udhëtojnë drejt vendeve respektive për festimin e këtyre festave.

Prefekti i qarkut ka falenderuar të gjithë punonjësit e policisë kufitare dhe të doganave për gadishmërinë e treguar gjatë këtyre ditëve me fluks të shtuar.

27.12.2019

Prefekti i qarkut Gjirokastër Z. Astrit Aliaj zhvilloi një takim me punonjësit e Sektorit të Policisë Rrugore në ambientet e Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër.

Në fjalën e tij, Prefekti i qarkut shprehu falenderimet për punën e bërë dhe bashkëpunimin e ofruar Sektorit të Policisë Rrugore në mënyrë të veçantë si dhe gjithë sektorëve të tjerë të Drejtorisë Vendore të Policisë Gjirokastër në përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve dhe për të qenë pranë tyre për garantimin e një mjedisi të sigurt në qarkun tonë. Prefekti i qarkut ndër të tjera theksoi masat që duhen marrë për parandalimin e aksidenteve rrugore duke bërë përcaktimin e vendeve të njohura si “njolla të zeza” dhe vendosjen e patrullave apo të sinjalistikës së nevojshme rrugore. Gjithashtu, z. Aliaj nënvizoi përdorimin e formave të sensibilizimit dhe të ndërgjegjësimit nga ana e punonjësve të policisë rrugore për rastet e shkeljeve të rënda të rregullave të qarkullimit rrugor.

Në përfundim të takimit, Prefekti uroi të gjithë punonjësit me rastin e festave të fundvitit dhe kërkoi fokusimin e punës së sektorit të policisë rrugore në mbarëvajtjen e qarkullimit rrugor, sidomos gjatë ditëve festive, kur pritet rikthimi i emigrantëve në vendlindje.



26.12.2019

Për mbylljen sa më dinjitoze të një viti të gjatë, me larmishmëri aktiviteteve Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka organizuar aktivitetin festiv me pjesëmarrjen e stafit të cilët bënë të mundur mbylljen me sukses të vitit 2019.

Me respekt për njëri-tjetrin dhe devotshmëri në punë u realizuan me sukses objektivat e punës për vitin 2019.



FJALIMET PËRSHËNDETËSE TË PREFEKTIT TË QARKUT GJIROKASTËR

13.01.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për ceremoninë festive të 106-vjetorit të krijimit të Policisë Shqiptare

Të nderuar miq,

Në këtë ceremoni festive të 106 vjetorit të krijimit të Policisë Shqiptare, për të gjithë efektivët e policisë, 13 janari është një ditë që përkujton kontributin, vlerat dhe sakrificat e punonjësve të policisë me një mision fisnik në shërbim të shoqërisë.

106 vjet më parë, më 13 janar të vitit 1913, me një akt të posaçëm të Kryeministrit të Qeverisë së parë shqiptare Ismail Qemali, u krijua Policia Shqiptare.

Po në vitin 1913, në muajin Qershor u vendos për herë të parë uniforma e rregullt kombëtare e xhandarmërisë. Gjatë kohës së Regjimit Mbretëror, u formuan disa polici si, ajo e Sigurisë Publike, Policia Bashkiake, Policia Rurale dhe Policia Kufitare.

Në dhjetor 1946, Policia Popullore u përcaktua si organ ekzekutiv i administratës shtetërore.

Pas vitit 1991, edhe policia u bë pjesë e ndryshimeve të rëndësishme, sikurse u krijua Ministria e Rendit Publik dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Pas ndryshimeve demokratike, Policia e Shtetit ka pësuar ndryshime të rëndësishme përsa i përket strukturës dhe mënyrës së organizimit, duke pasur një mision të ri sikurse është sigurimi i jetës, pronës, siguria publike dhe siguria rrugore.

Jam i bindur që edhe në të ardhmen, strukturat e Policisë së Shtetit do të jenë përherë në avantgardën e ndryshimit dhe të suksesit, vartës të kulturës dhe moralit të shëndoshë qytetar, traditave më të vyera të popullit tonë. Shumë beteja me krimin i keni fituar dhe beteja të tjera do të fitoni, sepse lufta kundër krimit dhe kriminelëve, korrupsionit dhe trafikëve të paligjshme të drogës dhe prostitucionit, vazhdon.

Prandaj dhe puna juaj ka qenë, është dhe do të mbetet në të ardhmen, asnjë tolerancë ndaj krimit dhe korrupsionit. Më lejoni, që duke përfunduar t'ju uroj edhe njëherë Gëzuar festën e Policisë.

20.01.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për 75-vjetorin e formimit të Brigadës së V Sulmuese

Të nderuar veteranë,

Të nderuar familjarë të dëshmorëve,

Të nderuar miq,

Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare e vështrojmë jo si dikur nën presionin e saj, por si ngjarje që tashmë ka hyrë në histori.

Sot kremtojmë 75 vjetorin e formimit të Brigadës V Sulmuese e cila u krijua më 28 nëntor 1943 në Gumenicë të Vlorës me në krye komandantin Abaz Shehu dhe komisararin Hysni Kapo, fill pas kapitullimit të Italisë Fashiste në shtator të 1943. Mbas kapitullimit të forcave italiane, forcat gjermane mësynë në territorin e Shqipërisë dhe Kosovës ku jetonin shqiptarët. Në këtë brigadë morën pjesë bijë dhe bija më të mira të Labërisë që në lule të rinisë sakrifkuan jetën e tyre për çlirimin e vendit. Partizanët e Brigadës së 5 Sulmuese luftuan si luanë kundër nazistëve e ballistëve në Luginën e Mesaplikut dhe në Dukat, ku në 12 dhjetor 1943 ra heroikisht Abaz Shehu, komandanti i brigadës.

Brigada e V Sulmuese mori formën e plotë me të gjitha elementët e saj për të mbrojtur territoret përreth. Në të gjitha këto beteja dhe aksione u tregua heroizmi i lartë ndaj detyrës përfundimtare për çlirimin e vendit nga okupatorët nazis-fashistë.

Pa luftën dhe gjakun e tyre s'do të ekzistonte as fjala jonë, pasi rënia e tyre ka qenë sa heroike aq edhe krenare në mbrojtje të nderit, identitetit dhe krenarisë kombëtare. Në këto beteja kanë dhënë jetën dhjetra heronj dhe dëshmorë të cilët mbuluan me lavdi gjithë rrugën e kësaj brigade dhe u jemi mirënjohës që me gjakun e tyre shkruan histori lavdie gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Kjo brigadë ka nxjerrë figura të shquara që me shembullin e sakrificës e të vetëmohimit, kanë zënë vendin e merituar në altarin e lirisë së kombit shqiptar. Ndër dëshmorët e kësaj brigade përmendim: Komandantin e brigadës Abaz Shehu, Shefqet Peçi, Hysni Kapo, Kastriot Muço, Zonja Çurre, Nimete Progonati, Laze Nuro, Llambro Andoni, Dervish Hekali e shumë e shumë dëshmorë të tjerë.

Në këtë ditë të shënuar më lejoni edhe njëherë të shpreh mirënjohjen, respektin, përluljen ndaj dëshmorëve, që dhanë jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Gjaku dhe vepra e dëshmorëve do të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.

Nder dhe lavdi heronjve të Brigadës së V Sulmuese!

26.01.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për 75-vjetorin e formimit të Brigadës së VI Sulmuese

Të nderuar veteranë!

Të nderuar familjarë dhe të afërm!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kryetar i qarkut, Kryetar i bashkisë,

Të nderuar miq dhe të ftuar,

Si sot para 75 vitesh më 26 janar të 1944 me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, në qytetin e lavdishëm të Përmetit u krijua Brigada e 6- të Sulmuese "Heroinë e Popullit", si një formacion i rëndësishëm ushtarak i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, e cila përkon me vitin jubilar të 75 vjetorit të Çlirimit të Atdheut.

Që në fillim më duhet të them se ky është një moment ringjallje e kujtesës për këto data të rëndësishme të historisë të popullit tonë.

75 vjetori i formimit të Brigadës së 6-të Sulmuese është një nga faqet më të ndritura në historinë e luftës Nacionalçlirimtare që e renditi Shqipërinë në krah të shteteve aleate si : Anglia, Rusia, ShBA, Franca dhe na çliroi nga pushtuesit fashistë.

Me krijimin e Shtabit të Përgjithshëm, forcat partizane ishin kthyer në një ushtri të vërtetë, me rregull dhe disiplinë. Edhe pse ndodheshin përballë një armiku të fortë, të egër dhe ç'njerëzor, dashuria për lirinë ishte më e madhe se çdo agresivitet asgjësues.

Pjesë e kësaj brigade u bënë partizanët e batalioneve “Asim Zeneli”, “Abaz Shehu”, “Naim Frashëri”, si dhe batalioni “Zaho Koka”. Të gjithë së bashku si një fuqi e pandashme, luftuan me heroizëm të pasqyruar. Kjo brigadë i përballoi me sukses të gjitha operacionet, ndaj ne përkulemi me respekt përpara 28.000 dëshmorëve, djem dhe vajza, bijë dhe bija të këtij populli dhe të këtij gjaku që u sakrifikuan për këto ditë të bukura lirie. Ata nuk u flijuan nga dashuria për vdekjen, por se lirisë i duhej gjaku i tyre, se shkolla e tyre ishte atdhedashuria, misioni i ushtarit të lirisë ishte detyrimi ndaj atdheut.

Rruga luftarake e Brigadës 6-të Sulmuese ishte e gjatë, ajo luftoi në gjithë territorin e Shqipërisë, që nga jugu në veri. Rol të rëndësishëm për kryerjen e misionit të Brigadës 6-të Sulmuese kanë luajtur komandantët e saj si: Tahir Kadare dhe Jaho Gjoliku “Hero i Popullit”, komisarët Mustafa Matohiti “Hero i Popullit” dhe Haki Toska si dhe kuadro komanduese e drejtuese të Shtabit e batalioneve si Riza Veipi, Sejfidin Meçe, Adil Çarçani, Xhule Çiraku, Petrit Radovicka, Avdul Hakiu “Hero i Popullit”, Mitro Xhani “Hero i Popullit”, Zini Sako, etj.

Nderimi dhe respekti për dëshmorët është dhe do të jetë obligimi i krenarisë sonë kombëtare sepse dhanë jetën për lirinë e këtij vendi.

Ndaj detyrimi dhe obligimi jonë është që veprën dhe historinë t’ua trashëgojmë brezave që vijnë.

Kujtimi i të rënëve dhe emrat e tyre do të nderohen në breza dhe shekuj.

Ti gëzojmë këto ditë lirie dhe feste!

Lavdi dëshmorëve të Atdheut!

Lavdi Brigadës 6-të Sulmuese “Hero i Popullit”!

29.01.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin e Komitetit Rajonal të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore

Të nderuar anëtarë të Komitetit Rajonal të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore,

Bazuar në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e qarkut”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 593, datë 08.10.2018 “Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore” dhe në pikën 1, të nenit 41, të ligjit nr. 81/2017, “Për zonat e mbrojtura” Prefekti i qarkut ka nxjerr Urdhërin për ngritjen e Komitetit

Rajonal të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore me përbërje anëtarë nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Autoriteti Rrugor Jugor, OSSHE, Inspektoriat Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Drejtoria Arsimore Rajonale, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, Shoqëria mjedisore “Çajupi” dhe “Shoqëria mjedisore e ujërave, pyjeve dhe kullotave” Përmet, përfaqësues nga pronarët e pyjeve dhe kullotave Gjirokastër e Përmet si dhe përfaqësues nga Prefektura e Korçës duke qënë se zona e mbrojtur mjedisore e Parkut Kombëtar të Bredhit të Hotovë-Dangëlli shtrihet në të dy këto qarqe.

Qëllimi i këtij Komiteti është që krahas Administratës së Zonave të Mbrojtura në menaxhimin e qëndrueshëm të tyre, të marrin pjesë edhe përfaqësues të shoqërisë civile, komunitetit që jeton brenda këtyre zonave të mbrojtura dhe aktorë të tjerë të interesuar të institucioneve shtetërore qendrore e vendore.

Referuar VKM-së nr. 593, datë 08.10.2018 “Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore” pika 6, Komiteti i Menaxhimit ka funksion mbikqyrës për zbatimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura mjedisore dhe programeve që hartohen në mënyrë të hollësishme sipas kërkesave të tij. Mënyra e funksionimit të këtij komiteti do të përcaktohet në rregulloren që do të miratohet nga vetë ky komitet. Kjo Rregullore është ende në fazë përgatitore nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura por në momentin më të parë që do të përcillet Komitetit të Menaxhimit, do të bëhet e ditur bashkë me ndryshimet e vlefshme.

Ky komitet e shtrin veprimtarinë e tij në territorin e qarkut Gjirokastër dhe në pjesën e Zonës së Mbrojtur që shtrihet edhe në qarkun e Korçës sipas rrejtës të zonave të mbrojtura mjedisore të miratuara, përfshirë ketu edhe parqet natyrore bashkiake.

Aktualisht në territorin e qarkut Gjirokaster ka rreth 62.492 ha Zona të Mbrojtura (ose rreth 22% e territorit) ku përkatësisht janë të ndara në katër Zona të Mbrojtura të kategorive të ndryshme sipas Qendrës Botërore të Ruajtjes së Natyrës si:

- Rezervë Strikte Natyrore “Bredhi i Kardhiqit” (kategori I), Bashkia Gjirokastër
- Parku Kombëtar “Bredhi i Hotovës-Dangëlli” (kategori II), Bashkia Përmet
- Monumenti i Natyrës “Bredhi i Sotirës” (kategori III), Bashkia Dropull
- dhe Parku Natyror “Zagori” (kategori IV), Bashkia Libohovë

Një informacion më i zgjeruar i Zonave të Mbrojtura në qarkun tonë do të prezantohet nga ana e z. Gligor Dushi, Drejtor i Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura.

Parqet natyrore, janë pika të forta të zhvillimit të qëndrueshëm turistik dhe ekonomik. Bashkëpunimi dhe përfshirja e banorëve që jetojnë afër këtyre zonave të mbrojtura është shumë i rëndësishëm sepse asnjë zonë nuk mund të mbrohet e zhvillohet pa kontributin e banorëve, që kanë jetuar e menaxhuar në kohë këto zona.

Zhvillimi i sektorit të natyrës ecën paralelisht me ekonominë e vendit dhe modelet më të mira vijnë nga rajoni, ku parqet kombëtare janë pararojë e zhvillimit natyror dhe ekonomik, që me kujdes janë kthyer në atraksione turistike, me një fluks të madh turistësh, ku përfitimet ekonomike kanë zhvilluar edhe zonat e banuara. Por ndryshe nga rajoni, ne ende nuk kemi krijuar një stabilitet zhvillimi e përfitimi të bazuar mbi studime për peshën që ka turizmi malor nga zonat e mbrojtura në ekonominë lokale dhe të vendit.

Ndërkohë që shembujt janë të prekshëm e të arritshëm, duhet ende shumë punë për të krijuar e zbatuar një raport të drejtë ndërmjet zhvillimit ekonomik, traditave kulturore dhe mbrojtjes së mjedisit.

Komiteti i Menaxhimit nëpërmjet mbikqyrjes së zbatimit të planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura dhe të programeve që do të hartohen në mënyrë të hollësishme, duke respektuar kërkesat për mbrojtjen e zonave, do të nxisë zhvillimin ekologjik të mjediseve përreth zonës me qëllim ruajtjen e cilësisë së saj, vlerave të trashëgimisë e peisazhit kulturor.

Një pikë e fortë e përbushjes së këtyre detyrave është edhe edukimi e sensibilizimi i brezit të ri dhe të gjithë banorëve, për rëndësinë e veçantë që mbartin këto zona. Çdo institucion kompetent por edhe mediat lokale duhet të punojnë fort në drejtim të promovimit të vlerave të Zonave të Mbrojtura, si një pasuri e përbashkët që na ka falur natyra.

Qëllimi i këtij takimi ishte konstituimi i Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura për Qarkun e Gjirokastrës dhe hartimi i rregullores së funksionimit të këtij Komiteti.

31.01.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Analizën e Veprimtarisë së Institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë për vitin 2018.

Tematika: Analiza e veprimtarisë së Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2018.

Çështjet:

- I Raportim dhe informim në ushtrim të funksionit.**
- II Marrëdhëniet e prefektit te qarkut me administratën shtetërore.**
- III Marrëdhëniet e prefektit te qarkut me organet e vetëqeverisjes vendore.**
- IV Emergjencat civile.**
- V Task Forcat e ngritura pranë institucionit të Prefektit.**
- VI Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore.**
- VII Shërbimet ndaj komunitetit.**

Hyrje

I nderuar Z/Znj.

Të nderuar drejtues të organeve të qeverisjes vendore,

Të nderuar drejtues të degëve territoriale që veprojnë në qark dhe institucione të tjera,

Të nderuar pjesëmarrës.

Jemi mbledhur sot për të analizuar punën tonë një vjeçare duke evidentuar mangësitë, arritjet dhe sukseset tona në të gjitha fushat në përmbushje të detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave në nivel qarku.

Bazuar në objektivat për vitin 2018, institucioni i Prefektit të Qarkut ka bashkërenduar veprimtarinë me degët territoriale, institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe të organeve të Vetëqeverisjes Vendore.

Prioriteti kryesor i punës së Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë për vitin 2018 ka qenë ngritja në një shkallë më të lartë e frymës së bashkëpunimit, bashkërendimit dhe koordinimit të organeve të qeverisjes vendore, degëve territoriale që veprojnë në qark dhe institucione të tjera, drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile, drejtimin e task forcave, kontrollin dhe monitorimin e zbatimit në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

Objektivat e institucionit të Prefektit për vitin 2018;

Ndërtimi i një marrëdhënie të qëndrueshme ndërveprimi dhe besimi ndërmjet institucionit të Prefektit të Qarkut, njësisive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel qarku dhe komunitetit.

Rritja e cilësisë së shërbimeve publike gjatë vitit 2018 si dhe zgjidhja e shqetësimeve dhe ankesave të qytetarëve do të jetë në fokus të veprimtarisë së institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Monitorimi i zbatimit të politikave sektoriale të Qeverisë Shqiptare në bujqësi, arsim, shëndetësi, turizëm, mjedis, rend publik, ndihmë e përkrahje sociale etj.

Ndjekja me përparësi e punës së Task-Forcave që janë ngritur dhe funksionojnë nën drejtimin e Prefektit të qarkut, bazuar në aktet ligjore dhe nën ligjore përkatëse.

Rritja e përgjegjësisë dhe angazhimi i strukturave përkatëse, bazuar në ligjin nr. 26.3.2001 “Për Emergjencat civile” për marrjen e masave për përballimin e situatave të mundshme emergjente.

Ndjekja me përparësi e kërkesave dhe ankesave të shtetasve deri në zgjidhjen e tyre ligjore. Kjo analizë vjen pasi ju keni përfunduar diskutimet dhe keni analizuar problematikat që keni hasur gjatë vitit që sapo kaluam dhe në bazë të rekomandimeve të dala nga këto analiza keni përgatitur planet tuaja të punës për realizimin e detyrave dhe objektivave për vitin 2018.

Nisur nga këto informacione të marra nga ana juaj, ku në disa prej tyre kam qenë vetë prezent, dua të sjell në vëmendjen tuaj se në se ne i konstatojmë dhe njëkohësisht marrim masa konkrete për eliminimin e tyre, rezultati nuk do të mungojë. Kam theksuar edhe në analizat tuaja, se një rëndësi të madhe për të patur sukses ka drejtuesi i institucionit, por edhe menaxhimi i personelit jo vetem nga ana formale, por nga sjellja profesionale në punë. Duke sjellë në vëmendjen tuaj problemet të cilat kanë qenë objekt dhe subjekt i punës tonë, do të donim që së bashku me mendimet dhe diskutimet tuaja të dilnim në konkluzione dhe me rekomandime konkrete të bëjmë zgjidhjet e tyre.

I. Raportim dhe informim në ushtrim të funksionit

Në veprimtarinë e tij të punës një-vjeçare, institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë ka funksionuar dhe ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me ligjin nr. 107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", me aktet ligjore dhe nënligjore të Këshillit të Ministrave, të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrive të linjës në drejtim të garantimit të zbatimit të programit të Këshillit të Ministrave në nivel qarku.

Gjatë vitit 2018 puna e institucionit të Prefektit është fokusuar në kontrollin dhe zbatimin në nivel qarku të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrëfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë.

Administrata e Prefektit ka luajtur një rol të rëndësishëm në realizimin e detyrave dhe objektivave kryesore duke patur në fokus zbatimin e ligjshmërisë, ndjekjen dhe monitorimin e veprimtarisë së degëve territoriale dhe institucioneve të tjera shtetërore në nivel vendor në drejtim të:

Sigurimit të rendit dhe qetësisë, intensifikimit të mëtejshëm të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, krimit të organizuar, kultivimit të bimëve narkotike, të dhunës në familje, në parandalimin dhe përballimin e emergjencave civile, në zbatimin e ligjshmërisë për prodhimin dhe tregëtimin e produkteve ushqimore, në zhvillimin e qëndrueshëm të arsimit parauniversitar, turizmit në punësim, në infrastrukturën rrugore, në realizimin në kohë të investimeve të akorduara nga buxheti i shtetit në njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe administratën shtetërore në nivel vendor etj.

Bazuar në ligjin 107/2016 "*Për Prefektin e Qarkut*", neni 8 "*Përgjegjësitë në marrëdhënie me institucionet qendrore në nivel vendor*", Institucioni i Prefektit ka ushtruar të gjitha përgjegjësitë që jep ligji në lidhje me zbatimin e programit të qeverisë nga këto institucione dhe ka bashkërenduar veprimtarinë e tyre me organet e Vetëqeverisjes Vendore.

Marrëdhëniet midis Prefektit të Qarkut dhe organeve të vetëqeverisjes vendore janë bazuar në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta. Këto

marrëdhënie janë përcaktuar në ligjin nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe në *ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*.

II. Marrëdhëniet e Prefektit të Qarkut me degët territoriale, agjencitë dhe inspektoriatet.

Në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 10, Prefekti ushtron përgjegjësitë, kontrollon dhe kërkon marrjen e masave për zbatimin e programit të qeverisë. Më poshtë do të trajtohen marrëdhëniet e institucionit të Prefektit me këto institucione dhe veprimtarinë e tyre.

Rendi dhe Siguria

Prefekti i Qarkut ka bashkërenduar veprimtarinë dhe ka siguruar mbështetjen e ndërsjelltë të organeve të Policisë së Shtetit, të institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe të organeve të vetëqeverisjes vendore, për marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike në nivel qarku.

Marrëdhënia e bashkëpunimit të Prefektit të Qarkut me Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut Gjirokastrë dhe Drejtorinë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin në drejtim të rendit dhe sigurisë kanë qenë korrekte. Për vitin 2018 një punë e mirë u bë në drejtim të masave të marra për sensibilizimin e gjithë komunitetit të rajonit tonë për të parandaluar mbjelljen dhe kultivimin e bimëve narkotike. Veprimtaria e organeve të Policisë ka konsistuar në eliminimin e sipërfaqeve të mbjella në territorin e qarkut. Kjo veprimtari ka qenë rezultative sidomos në rritjen e fuqisë goditëse për kapjen dhe vënien para ligjit të personave që trafikojnë lëndë narkotike, ndaj krimit të organizuar, në drejtim të kalimit të paligjshëm të kufirit, në trafikimin e qenieve njerëzore, në rritjen e sigurisë rrugore nëpërmjet forcimit të kërkesës për zbatimin e rregullave të kodit rrugor. Gjithashtu me Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut është mbajtur kontakt i vazhdueshëm, lidhur me informimin e Institucionit të Prefektit për bashkërendimin e masave në përballimin e situatave të ndryshme emergjente apo fatkeqësitë e natyrës. Angazhimi i strukturave të policisë për këtë problem ka qenë kryesisht për disiplinimin e qarkullimit rrugor, parandalimin e fatkeqësive, evakuimin e të rrezikuarve etj.

Gjatë vitit 2018 në qarkun e Gjirokastrës janë evidentuar **847** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **744** prej tyre, ose **87.8%**. Rritja e forcës zbuluese të kriminalitetit në masën 78%. Realizuar, 9.8% më shumë se objektivi.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2017, kur janë evidentuar **972** vepra penale, nga të cilat janë zbuluar **863** prej tyre ose **88.7%**, konstatohet një reduktim i kriminalitetit me **125** vepra penale më pak, kurse forca zbuluese është ulur me 1%.

Në fushën e narkotikëve janë evidentuar **67** vepra penale, zbuluar **58** ose **86.5%**, ku janë sekuestruar rreth **3.65 ton** marijuanë (3.637 kg), **1.5 kg** heroinë, **3.545** gram kokainë **119 kg** “çokollatë” dhe **940** fara “Cannabis Sattiva”. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur u evidentuan **99** vepra penale dhe u sekuestruan **15.256** kg marijuanë, konstatohet një reduktim i kriminalitetit me

32 vepra penale më pak si dhe reduktim të sasive të lëndëve narkotike të sekuestruara me rreth **4** herë më pak.

Në fushën e trafiqeve të paligjshme janë evidentuar **21** vepra penale, zbuluar **21 ose 100%**. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur u evidentuan **13** vepra penale, konstatohet një rritje e forcës evidentuese egoditëse me **8** raste më shumë.

Në fushën e korrupsionit, pastrimit të parave dhe krimeve eko-financiare janë evidentuar **101** vepra penale, zbuluar **96 ose 95%**. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur u evidentuan **109** vepra penale, konstatohet një reduktim i kriminalitetit me **8** raste më pak.

Në fushën e krimeve kundër personit dhe pronës janë evidentuar **19** vepra penale, zbuluar **17 ose 89.4%**. Pa autor mbeten dy raste për “shkatërrim prone me eksploziv”. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur u evidentuan **14** vepra penale dhe u zbuluan **9** prej tyre ose **64%**, konstatohet një evidentim më i mirë i kriminalitetit me **5** vepra penale më shumë, por ka edhe rritje të forcës zbuluese me **25.4%** më shumë.

Gjatë vitit të kaluar nga ana e Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Emigracionin është punuar në drejtim të kontrollit të përgjithshëm të sektorit kufitar (brezit kufitar) me qëllim parandalimin dhe goditjen e kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike. Sipas statistikave në tre pikat kufitare të kalimit Kakavie, Tre Urat dhe Sopik janë përpunuar në total në hyrje-dalje rreth 2 087 265 shqiptarë / të huaj si dhe rreth 553 992 automjete të transportit të udhëtarëve dhe të mallrave.

Janë intervistuar **9081** shtetas shqiptar të kthyer DEPORTIVË e INAD nga pala greke. Janë kapur shtetas shqiptar në tentativë për kalim të paligjshëm të kufirit dhe **816** shtetas të vendeve të treta, i është refuzuar dalja nga Shqipëria **2186** shtetasve shqiptare, që nuk plotësonin kushte për të udhëtuar në zonën shengen dhe janë prapësuar **178** shtetas të huaj, janë kapur **57** persona në kërkim, janë ndëshkuar administrativisht **254** shtetas nga të cilët **253** shqiptarë dhe 1 shtetas i huaj.

Nga punonjësit e policisë të Sektorit të Kufirit kanë ardhur **19** informacione policore SK-2, të cilat janë vlerësuar nga Sektori Zbatimit të Masave Plotësuese dhe Kontrollit të Territorit.

Në kuadër të luftës kundër trafikimit të lëndëve narkotike, kontrabandës së mallrave dhe mjeteve, është forcuar puna në Pikat e Kalimit Kufitar në sektorët e vijës së dytë ku për periudhën analizuese janë kontrolluar në total **26683** mjete, nga këto **18732** mjete janë kontrolluar në bashkëpunim me Doganën dhe Pikën e Skanimit të Kompanisë Rapiscan S2 Albania.

Me gjithë punën e mirë dhe rezultatet e arritura për vitin 2017 janë evidentuar edhe disa probleme shqetësuese si:

Kompletimi i plotë i organikës së DVKM Gjirokastër me **11** efektivë punonjës policie, **7** (shtatë) të nivelit zbatues me gradën “Inspektor” dhe **4**(katër) i nivelit të parë komandues me gradë “Kryekomisar”, “Komisar” dhe “Nënkomisar”

Mungon sistemi i vëzhgimit me kamera, në godinën e DVKM-ës, në PKK Kakavijë, PKK Sopik, PKK Tre Urat për monitorimin e zonës së kontrollit kufitar gjatë 24 orëve nga shërbimet e Policisë Kufitare.

Në PKK Kakavijë, nuk është bërë e mundur krijimi i kushteve të përshtatshme për ushtrimin e kontrollit të detajuar të mjeteve, në vijën e dytë. Nuk ekziston një ambient i mbyllur, i cili të

mundësojë ushtrimin e kontrollit të mjeteve në përputhje me procedurat standarte të punës. Ky kontroll jo vetëm që është i ekspozuar, por kryhet në disa raste edhe në kushtet e vështira të motit . Mungesa e fondeve për trajtimin me ushqim, medikamente mjeksore dhe transport e të kthyerve deportiv nga PKK deri në Gjirokastrë e Përmet.

Spektori i Migracionit dhe Spektori i Masave Plotesuese per Kontrollin e Territorit (MPKT), vazhdon ta ketë të domosdoshëm zgjidhjen e problemit të përkthyesit te gjuhës angleze e arabe, sidomos gjatë kësaj periudhe ku kemi patur në rritje të numrit të shtetasve të huaj të vendeve të treta që hyjnë në territorin e RSH dhe rasteve të hetimit për veprat penale të kryera nga shtetas shqiptar ku janë implikuar dhe shtetas të huaj.

Mungesa e baterive për mbajtjen në funksion të kamerave termike, përdorimi e mirëmbajtja e pajisjve të kontrollit të vijës së parë e të dytë në PKK -të.

Kontrolli i mjeteve në Pikat e Kalimit Kufitar nuk është në nivelin e duhur pavarësisht rezultateve të arritura gjatë kësaj periudhe analizuese.

Përzgjedhja për kontroll të detajuar në vijën e dytë në disa raste nuk bëhet siç e parashikojnë Procedurat Standarte.

ARSIMI

Në drejtim të Arsimit Parauniversitar, nga ana jonë është monitoruar situata arsimore rajonale, janë kërkuar informacione nga Drejtoria Arsimore Rajonale mbi numrin e maturanëve pjesëmarrës në provimet e Maturës Shtetërore në rang qarku si dhe për rezultatet përfundimtare të tyre dhe të Arsimit Bazë.

Gjatë muajit qershor janë zhvilluar provimet e Maturës Shtetërore për vitin arsimor 2017-2018 përkatësisht në datat:

- 4 qershor 2018 lënda (Gjuhë e huaj) (D3)
- 8 qershor 2018 lënda (Gjuhë shqipe dhe letërsi) (D1)
- 13 qershor 2018 lënda (Matematikë) (D2)
- 20 qershor 2018 lënda (me zgjedhje) (Z1/Z2)

Ecuria e këtyre provimeve u monitorua me kujdesin më të madh gjatë gjithë kohëzgjatjes, edhe prej përfaqësuesve të Prefektit te Qarkut të cilët në përfundim të këtij procesi lanë disa rekomandime të cilat Institucioni i Prefektit i raportoj në Ministrinë e Brendshme dhe në Zyrën Operacionale të Situatës në Kryeministri.

Në muajin Shtator 2018 nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut pati bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore Rajonale si dhe Njësite e Qeverisjes Vendore për garantimin e ambienteve shkollore për fillimin sa më të mirë të vitit të ri arsimor parauniversitar 2018-2019.

Numri i nxënësve në sistemin arsimor parauniversitar 2018-2019 në qarkun Gjirokastrë është **9059 nxënës:**

- Drejtoria Arsimore Gjirokastrë 4730 nxënës (Gjirokastrë,Libohovë,Dropull)

- Zyra Arsimore Përmet 1888 nxënës (Përmet, Këlcyrë)
- Zyra arsimore Tepelenë 2441 nxënës (Tepelenë, Memaliaj)

SHËRBIMI SHËNDETËSOR

Për sa i përket Shërbimit Spitalor dhe Shëndetësor në rang qarku gjatë periudhës Janar–Dhjetor 2018 nga informacionet e kërkuara dhe të marra nga institucionet përkatëse, rezulton se këto shërbime në përgjithësi kanë qenë normale, pa probleme dhe situata ka qenë e mirë.

Në mënyrë periodike është kërkuar informacion edhe pranë Drejtorisë së Spitalit Rajonal “Omer Nishani” mbi gjendjen aktuale të spitalit, mbi gadishmërinë materiale dhe të specialistëve. Shërbimet kanë punuar me kapacitet të plotë 24 orë, furnizimi me ujë dhe energji elektrike ka qenë i vazhdueshëm 24 orë etj.

Gjatë kësaj periudhe nga informacionet e marra konstatohet se në ambjentet e shërbimit shëndetësor situata paraqitet normale dhe pa probleme .

Drejtoria Rajonale Shëndetësisë duke qenë se ka një rol lider në fushën shëndetësore dhe mjekësore, ajo është udhëhequr në punën e saj nga sensi i përgjegjësisë, duke u përqëndruar në disa objektiva dhe prioritete të cilat janë:

Promovimi i shëndetit dhe marrja e masave mbrojtëse, prevenuese dhe parandaluese për sëmundjet e ndryshme.

Ndjekja e surveillancës epidemiologjike të sëmundjeve akute dhe kronike, si dhe frekuenca e hasjes së tyre, Incidenca dhe Prevalenca në komunitet.

Kontrulli dhe parandalimi i sëmundjeve ngjitëse.

Kujdesi specifik për shëndetin e nënës dhe fëmijës.

Menaxhimi i sistemit të informacionit shëndetësor, grumbullimi, përpunimi dhe analiza e të dhënave bio-statistikore në kohë dhe afatet optimale.

Monitorimi i vazhdueshëm i indikatorëve të higjienës mjedisore si: Ajri, Uji, Toka, Higjiena komunitare dhe Siguria Ushqimore.

Ndjekja e problematikave shëndetësore dhe psiko-sociale për personat me aftësi të kufizuara, personat e moshës së tretë, si dhe shtresat vulnerabël.

Rritja e kapaciteteve menaxhuese të qendrave shëndetësore, ofrimi dhe shpërndarja e barabartë e shërbimeve të mjekësisë familjare për të gjitha nivelet e popullatës.

Gjithashtu nga kjo drejtori veçanërisht në prag të sezonit turistik veror, janë kryer kontrole të vazhdueshme në lokalet e ndryshme për një higjenë sa më të mirë, për cilësinë e ushqimeve, për cilësinë e ujit të pijshëm në rajon etj. Janë bërë investime në ambientet e qendrave shëndetësore në të gjithë qarkun, në fokus të përmirësimit të kushteve për një shërbim sa më cilësor si për pacientët po kështu edhe për personelin. Këto ndërhyrje në investime, konsistojnë në ambiente të reja profesionale për shumë qendra shëndetësore në qarkun Gjirokastrë. Gjatë këtij sezoni turistik kjo drejtori bashkëpunoi edhe me strukturat e tjera në lidhje me përballimin e fluksit të turistëve vendas dhe të huaj përsa i përket kushteve higjieno – sanitare dhe problematikave të tjera si viruset e stinës, gadishmëria spitalore, gjëndja e ujit të pijshëm etj.

Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor gjatë vitit 2018 ka patur si mision garantimin dhe respektimin e kërkesave ligjore në fushën e shëndetit publik. Ky inspektoriat ka zhvilluar veprimtari intensive në përpjekje për të arritur objektivin dhe efektivitetin e veprimtarisë inspektuese në qarkun e Gjirokastrës.

Kjo degë rajonale në total ka realizuar 3100 inspektime dhe riinspektime, nga të cilat 2957 inspektime dhe 143 riinspektime. Inspektimet janë kryer për ligjet ligjit 9636 datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, Ligjit 9518 datë 18.04.2006 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit, pijeve energjike dhe pijeve të gazuara që përmbajnë sheqer të shtuar”, i ndryshuar, Ligjit 9928 datë 09.06.2008 “ Për shërbimin stomatologjik në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (ALUIZNI)

Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave / Ndërtimeve Informale ka bashkërenduar punën me organet qendrore shtetërore dhe njësitë e qeverisjes vendore për legalizimin e ndërtimeve të ngritura pa leje në "vendbanime formale", "zona informale", "territore të tjera", si dhe të "shtesave pa leje në ndërtime me leje", kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore, ku është ngritur ndërtimi pa leje, urbanizimin e zonave, blloqeve informale e të ndërtimeve informale, si dhe integrimin e tyre në zhvillimin territorial dhe infrastrukturor të vendit, duke përmirësuar kushtet e jetesës, procedurat për realizimin e legalizimit të zonave/ndërtimeve informale dhe ngritjen e funksionimit të strukturave përgjegjëse për realizimin e tyre. Nga specialistët e kësaj agjencie është punuar për pranimin, trajtimin dhe kontrollin e vetëdeklarimeve të objekteve pa leje, si dhe për zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj, për kryerjen e procesit të legalizimit.

Për vitin 2018 janë arritur këto rezultate:

Numri i objekteve të përditësuar në terren: 1015

Numri i lejeve të legalizimit të emëtuara: 591

Numri i lejeve të legalizimit të dërguara në ZVRPP për regjistrim: 558

Numri i objekteve me funksion banim me vetëdeklarues para/tetraplegjik: 2

Numri i objekteve me funksion banim, të ndërtuar në tokë të vetëdeklaruesit: 82

Numri i objekteve të përjashtuara nga legalizimi: 49

Të ardhura të arkëtuara nga parcela ndërtimore janë: 19.989.701 lekë

Të ardhura të arkëtuara nga tarifa e shërbimit janë: 1.312.000 lekë

Të ardhura nga gjoba dhe penalitete janë: 1.907.496 lekë

Disa nga problematikat e hasura nga kjo agjenci për vitin 2018 janë:

Mungesa e planeve urbanistike pothuajse për të gjitha bashkitë që bëhet pengesë në kualifikimin e objekteve për legalizim.

Mungesa e hartave dixhitale dhe sistemit dixhital në ZVRPP-t e të tre Rrethëve, si dhe përditësimi i hartave të hipotekës sipas gjendjes faktike në terren gjë e cila na vështirëson në procesin e punës për azhurnimin e hartës në të cilën konfigurohet objekti i legalizuar së bashku me parcelën ndërtimore

Shpërdarja e objekteve informale sporadike, gjë që sjell vështirësi në matjen e tyre, në azhonimin e hartës si dhe në realizimin e normative.

Planet e Përgjithshme Vendore të pazbardhura të bashkive Memaliaj e Tepelenë janë bërë pengesë për procesin e legalizimit në këto bashki në të cilat kemi zhvillime informale të konsiderueshme.

Problem janë edhe dy zonat më të mëdha të qytetit të Gjirokastrës, lagjia Zinxhira dhe Kodra e Shtufit me ndërtime informale në të cilat ka mbetur pezull procesi i legalizimit për shkak se për këto zona janë në proces regjistrimi në ZVRPP Gjirokastrë pronat e Teqesë .

Zyrat Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

Gjatë vitit 2018, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme kanë punuar për realizimin e detyrave dhe zbatimin e urdhrave dhe udhëzimeve të ardhura nga Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Objekti i punës së tyre ka qenë shërbimi në kohë dhe cilësi ndaj qytetarëve dhe institucioneve publike e shtetërore. Gjatë vitit 2018 vërehet rritje e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, produktivitet në punën e ZVRPP-ve duke trajtuar në afat kërkesat (aplikimit) e qytetarëve si dhe duke trajtuar praktika të prapambetura nga vite të ndryshme rast pas rasti.

Veprimet e kryera me qytetaret (numri total i aplikimeve,perqindja e realizuar).

Për periudhën janar – dhjetor 2018, janë aplikuar dhe përcjellë për trajtim 5229 aplikime ne total (AV dhe aplikime për regjistrim), nga të cilat:4839 janë aplikuar pranë sportelit të ADISA Gjirokastrë, dhe 390 aplikime, janë aplikime online nga Drejtoria e Aluiznit për regjistrimin e lejeve të legalizimit.

Janë realizuar dhe kanë marrë përgjigje 4595 aplikime, shprehur në % janë trajtuar në masën 95% të numrit total të aplikimeve.

Gjithashtu ZVRPP Gjirokastrë gjatë vitit 2018, ka trajtuar dhe kanë marrë përgjigje 385 aplikime të prapambetura ndër vite, të trajtuara rast pas rasti me interesimin e qytetarëve.

Regjistrimi i Lejeve te Legalizimit

Gjatë vitit 2018 për periudhën janar-dhjetor janë aplikuar on-line nga Drejtoria e Aluiznit Gjirokastrë 390 aplikime AV-0 për regjistrim të lejeve të legalizimit. Janë përcjellë për regjistrim zyrtarisht, të protokolluara pranë ZVRPP Gjirokastrë 376 Leje Legalizimi, nga të cilat janë regjistruar 345 Leje Legalizimi, 23 janë kthyer për riplotësim, pra janë realizuar në masën 97.9%.

Gjatë vitit 2018 janë aplikuar nga qytetarët dhe është paguar shërbimi 304 njësi Leje Legalizimi, nga te cilat 251 te certifikuara dhe 14 AV për plotësim dokumentacioni. Realizuar 87.2%. Nga nr. total i aplikimeve me kod shërbimi R8 (regjistrim i lejeve te legalizimit) prej 304 aplikime, nga keto 223 jane aplikime per regjistrim leje legalizimi te vitit 2018 dhe 81 leje legalizimi te vitit 2016 dhe 2017.

Regjistrimi i tokave bujqesore te perfituara ne zbatim te ligjit 7501

Gjate periudhes Janar- Dhjetor 2018 jane aplikuar nga qytetaret per certifikimin e tokave bujqesore te perfituara ne zbatim te ligjit 7501, te cilat jane te regjistruara ne regjistrat kadastrale.

Numri i AMTP-ve te trajtuara 149 AMTP

Numri i Certifikatave te pronesise per AMTP-te e sipercituara 433 (sipas aplikimeve te qytetareve)

VJETORE JANAR – DHJETOR 2018

NR	INSTITUCIONI	Numri i AMTP-ve të trajtuara	Numri certifikatave të lëshuara	Numri i AMTP të kthyer Bashkisë për plotësim
1	ZVRPP GJIROKASTER	149	433	0

Infrastruktura rrugore

Gjithë aktiviteti i mirëmbajtjes së rrugëve realizohet nëpërmjet kontratave të mirëmbajtjes me kompanitë fituese pas procedurave të prokurimit. Kontratat e mirëmbajtjes së Bankës Botërore përfshijnë akset nacionale kryesore. Për qarkun e Gjirokastrës në Kontratën e Mirëmbajtjes së Bankës Botërore janë përfshirë, konkretisht aksi rrugor Liqeni Krahës (Kufi Q/Fier) – Tepelenë – Gjirokastrë – Kakavi dhe aksi rrugor Jorgucat – Qafë Muzinë (Kufi Q/Vlorë) me gjatësi 96 km e kontratuar nga firma “Salilari” sh.p.k. Gjithashtu brënda kontratës së mirëmbajtjes Banka Botërore ka bërë shtesë investimi për rikonstruksionin e segmentit rrugor Gjirokastrë (Postobllok) – Lazarat – Mongjillë si dhe ndërtimin e urës mbi përroit e Gjokanës, duke zgjidhur përfundimisht problemin e bllokimit të rrugës në periudhën e përmbajtjeve të dimrit. Përveç kontratave me Bankën Botërore Autoriteti Rrugor Shqiptar gjatë vitit 2018 me financimet e buxhetit të shtetit ka lidhur kontrata edhe me subjekte private për mirëmbajtjen e rrugëve me performancë si më poshtë:

1. Aksi rrugor Përmet – Çarshovë – Tre Urat (Doganë), Aksi rrugor Çarshovë – Leskovik – Ersekë dhe Aksi rrugor Leskovik – Doganë (Tre Urat), gjithsej 107 km mirëmbahet nga kontraktori “Riviera” shpk me kontratën e lidhur me datën 19.11.2018.

2. Aksi rrugor Ura e Leklit – Këlcyrë + aksi Këlcyrë –Përmet, 35.3 km në rrethin e Përmetit mirëmbahen nga firma kontraktore “Eral” shpk. Aksi rrugor Valare – Erind – Çajup dhe aksi rrugor K/Dhuvjan – Libohovë 28 km, në rrethin e Gjirokastrës mirëmbahen po nga firma “Eral” shpk nëpërmjet kontratës “Mirëmbajtje rutinë e dimërore me performancë rruga Ura e Leklit – Këlcyrë + rruga Këlcyrë – Përmet + rruga Valare – Erind – Çajup + rruga K/Dhuvjan – Libohovë 63.3 km” të lidhur me Drejtorinë e Rajonit të Jugut Gjirokastrë në datën 21.12.2018.

3. Në bashkinë Tepelenë Aksi rrugor Tepelenë – Dorrëz - Qafë Dushk, dhe aksi rrugor Sevaster–Kalivaç 66.4 km mirëmbahen nga firma “Eral” shpk nëpërmjet kontratës “Mirëmbajtje rutinë me performancë rruga Tepelenë –Dorrëz- Qafë Dushk + rruga Sevaster – Kalivaç 66.4 km të lidhur me Drejtorinë e Rajonit të Jugut Gjirokastër në datën 27.12.2018.

4. Aksi rrugor Ura e Kardhiqit – Prongji aktualisht është pa kontratë mirëmbajtjeje.

Në periudhën Mars – Shtator (pas përfundimit të sezonit dimëror) u morrën masa për përgatitjen e sezonit veror 2018. Gjatë kësaj periudhe janë marrë masa në drejtim të përmirësimit të sinjalistikës rrugore dhe menaxhimit të trafikut në bashkëpunim me Seksionin e Policisë Rrugore.

Në periudhën Shtator – Dhjetor 2018 D.R.J.Gjirokastër morri masat për përgatitjen e emergjencave dimërore. Gjatë muajit Dhjetor 2018 për shkak të fenomeneve të motit si rreshjet e pa zakonta, Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër u përball me disa problematika në akset rrugore kryesisht në reagimin me vonesë në disa raste emergjente, ardhja me vonesë e mjeteve të duhura etj.

Për akset që mirëmbahen nëpërmjet Kontratës “C” me afat 5-vjeçar të Bankës Botërore me kontraktor “Salillari”sh.p.k, pavarësisht se nga ana e kësaj kompanie gjatë vitit të kaluar është punuar përgjithësisht mirë në komponentin e mirëmbajtjes rutinë, në punimet e rehabilitimit vërehet një ngadalësi dhe vonesë në procedurat e miratimit të punimeve nga Njësia e Menaxhimit dhe Kompania Mbikqyrëse.

TURIZMI

Në zbatim të urdhërit të Kryeministrit nr. 39, datë 28.02.2018 "Për miratimin e planit të masave përgatitore për mbarëvajtjen e sezonit turistik veror për vitin 2018 dhe ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës, Task-Forcë për menaxhimin e sezonit turistik veror”, mbështetur në nenin 20 të Ligjit Nr.93/2015, datë 27.07.2015 “Për Turizmin”, gjatë vitit 2018, instiucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër ka organizuar takimet periodike të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit. Është përgatitur plan i masave nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore dhe institucionet rajonale për mbarëvajtjen e sezonit të ri turistik 2018.

Instiucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër në mënyrë të vazhdueshme ka grumbulluar të dhëna statistikore për lëvizjen e vizitorëve vendas dhe të huaj, nga të gjitha njësia e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet shtetërore. Numri i vizitorëve vendas dhe të huaj që kanë vizituar qarkun tonë për vitin 2018 është 162 995 vizitorë rreth 52.57% më shumë se viti 2017.

Nga të dhënat e administruara nga ana jonë gjatë vitit 2018 për njësia e vetë qeverisjes vendore paraqiten këto të dhëna:

Bashkia Gjirokastër: 114 278 vizitorë

Bashkia Përmet: 26000 vizitorë

Bashkia Tepelenë: 8000 vizitorë

Bashkia Libohovë: 9200 vizitorë

Bashkia Dropull: 3000 vizitorë

Bashkia Këlcyre: 1517 vizitorë

Bashkia Memaliaj: 1000 vizitorë

Bazuar në të dhënat e mësipërme, në krahasim me vitet e kaluara, sezoni turistik 2018 pati një fluks të madh vizitorësh vendas dhe të huaj të cilët e kanë vlerësuar qarkun Gjirokastrë si një nga destinacionet më të kërkuara për vitin 2018. Kjo falë dhe burimeve turistike që qarku ynë ka dhe jo pak por 697 burime turistike që nënkuptojnë pika kulturore, monumente të natyrës si shpella, kanione, objekte kulti, ndërtime popullore etj, 30 prej të cilave janë etiketuar zonë e mbrojtur.

Gjatë vitit 2018, instiucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka ndjekur hap pas hapi ecurinë e sezonit turistik në të gjithë rajonin tonë dhe ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me institucionet përgjegjëse për zhvillimin e turizmit për të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe për të bërë të mundur që sitet turistike të kthehen në qendra të vizitueshme dhe në muze të hapur për vizitorët.

Mjedisi.

Dega Rajonale e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit në zbatim të Urdhrit nr. 10 datë 11.01.2018 të lëshuar nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, për *“Kontrollin e zbatimit të kërkesave për respektimin e standarteve mjedisore dhe të lejes minerare nga subjektet e shfrytëzimit minerar”* ka realizuar inspektime në 12 subjekte të qarkut Gjirokastrë ku në 5 prej këtyre subjekteve është lënë si detyrë kryerja e kërkesës për heqje nga fondi i parashikimeve sipas ligjit. ISHMPUT Gjirokastrë përgjatë vitit 2018 ka kryer gjithësej 210 inspektime dhe ka ndërmarrë 6 masa administrative.

Spektori i Inspektimit Mjedisor të Degës Rajonale të ISHMPUT, e ushtron veprimtarinë në territorin e qarkut Gjirokastrë, është përgjegjës për inspektimin në këtë qark dhe ka për mision garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Përgjatë vitit 2018 është përgatitur baza e të dhënave, përkatësisht *“Regjistrit të Lejeve”* të ndara sipas viteve dhe tipit të lejeve (A, B, C) për harkun kohor 2008-2018. Në total janë kryer 106 inspektime/verifikime ku nga këto, 45 inspektime janë kryer online me listë verifikimi, dokumenta standarte.

Spektori i Inspektimit të Ujrave të Degës Rajonale të ISHMPUT, në zbatim të Urdhrit Nr. 228, datë 1.12.2017 *“Për ndërhyrjen ndaj shfrytëzimit dhe gërryerjes së brigjeve dhe shtretërve të lumenjve”* ka ngritur gjatë muajit janar 2018, grupin vendor të punës, në bashkëpunim edhe me struktura të tjera shtetërore, të cilët kanë hartuar relacionin për gjendjen e deritanishme dhe kanë monitoruar situatën në vazhdimësi duke kryer kontrole në subjekte që janë përdorues të materialeve inerte lumore. Në kontrollin e ushtruar nga grupi i punës është vënë re se në të gjithë basenin ujor Vjosa, asnjë prej subjekteve nuk ka rezultuar i pajisur me leje për shfrytëzimin e materialeve inerte lumore. Problematikë ngelet mos pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe ndalimit të shfrytëzimit, në segmente të ndryshme të lumenjve Vjosë, Drino e degëve të tyre, ka akumulime të mëdha sasish të materialeve inerte. Si pasojë, në disa segmente, prurjet e mëdha të lumenjve, kanë krijuar devijim të rrjedhës natyrore të shtretërve të lumenjve, duke marrë drejtim në brigjet anësore të tyre e duke krijuar erozion në tokat përreth. Në zbatim të ligjit Nr. 9115 date 24.07.2003 *“Për trajtimin mjedisor*

të ujëra të ndotura” janë evidentuar dhe regjistruar të gjitha subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura pranë zonave turistike. Problem kryesor janë shkarkimet organike nga rrjeti i kanalizimeve direkt në lumë ku asnjë prej bashkive të qarkut, nuk është i pajisur me impjant për trajtimin e ujërave të zeza.

Spektori i Policisë Pyjore të Degës Rajonale të ISHMPUT sipas autorizimeve të dhëna ka kryer inspektime në pyje, kullota, gjueti si dhe bimë medicinale eterovajore e tanifere. Për periudhën kohore tetor – dhjetor janë kryer fushata sensibilizuese për mbrojtjen e pyjeve dhe faunës së egër në të shtatë bashkitë e qarkut.

Agjencia Rajonale e Mjedisit Gjirokastrë përgjatë vitit 2018 e ka përqëndruar punën e saj në sigurimin e informacioneve mbi gjendjen e mjedisit nga pushteti vendor dhe subjektet që monitorojnë sasinë e mbetjeve dhe gjenerimin e tyre. Materialet e grumbulluara janë përdorur për hartimin e Raportit të Gjendjes së Mjedisit.

ARM Gjirokastrë ka monitoruar mirëmenaxhimin e ndotjeve urbane në vendgrumbullimin e tyre dhe problemet mjedisore të hasura. Gjatë vitit 2018 janë kryer monitorime nga 56 subjekte me laboratorë të akredituar.

Problematike ngelet mosraportimi nga ana e disa subjekteve, problem ky që kërkon zgjidhje dhe konceptim më të mirë pune nga ISHMPUT

Ndihma Ekonomike

Me aplikimin e sistemit të ri të ndihmës ekonomike, shumë prej familjeve pretenduese nuk u vlerësuan me pikët e mjaftueshme nga ky sistem dhe duke u krahasuar me vitin 2017 pati një rënie të konsiderueshme të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

Përsa i përket aplikimeve me sistemin e ri nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Gjirokastrë, paraqiten këto të dhëna:

Dhjetor 2018

Nr.	Qarku	Aplikues	Përfitues	Të refuzuar
1	Qarku Gjirokastrë	1104	840	264

Në aplikimet e deritanishme, vihet re një rritje e vogël e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike afërsisht 332 familje e shprehur në % situata në bashkitë e qarkut paraqitet si më poshtë:


Bashkitë Gjirokastrë, Libohovë dhe Dropull zënë afërsisht 19% të numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.

Bashkitë Tepelenë dhe Memaliaj zënë afërsisht 56 % të numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.

Bashkitë Përmet dhe Këlcyrë zënë afërsisht 30 % të numrit të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike.

Punësimi

Bazuar në të dhënat e marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Gjirokastër, për vitin 2018 janë paraqitur pranë zyrave të punës **3667** punëkërkuës të papunë nga **3523** pu.pa që janë rregjistruar në vitin 2017. Aplikimi i skemës së re të ndihmës ekonomike solli një rritje të konsiderueshme të punëkërkuësve që janë drejtuar pranë zyrave të punës.



Nëpërmjet programeve të qeverisë për hapjen e vendeve të reja të punës, mundësia e ndërmjetësimit dhe nxitja e formimit profesional, kanë bërë të mundur që gjatë kësaj periudhe të punësohen rreth 1122 pu.pa nga të cilët:

602 punësime me ndërmjetësim



193 punësime nga programet e nxitjes

327 gjetën punë vetë.

REFORMA E UJIT TË PIJSHËM

Në vijim të ecurisë së aksionit në kuadër të Reformës së Ujit të Pijshëm, gjatë kësaj periudhe nga inspektorët përgjegjës të SH.A Ujësjellës Kanalizime të qarkut Gjirokastër janë kryer verifikime për evidentimin e lidhjeve të paligjshme në institucione shtetërore, biznese private dhe konsumatorë familjarë të cilët janë pa kontratë dhe matësa shërbimi.

Sipas informacioneve të marra nga grupet e Task -Forcës për verifikimet e kryera për vitin paraqiten këto të dhëna:



(grafik nr. 1; verifikimet e kryera sipas bashkive)




(grafik nr. 2; ecuria e procesit të verifikimeve)

1. **ADISA** (Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara në Shqipëri)

2.

ADISA - Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara realizon standardizimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve, klasifikimin dhe kodimin e shërbimeve të institucioneve publike qendrore, krijimin e kartelave informative që do shërbejnë për shpërndarjen, thjeshtëzimin si dhe unifikimin e informacionit, për të gjitha shërbimet publike. Gjatë këtij viti pranë kësaj agjencie janë kryer shërbime të ndryshme konkretisht;

Në vitin 2018 janë kryer gjithësej 35,779 aplikime. Numri i qytetarëve të interesuar për aplikime, ankesa apo pyetje për shërbimet që ofrohen në Z.R.Gjirokastrë ka arritur në 43,157



Ajo çka është parë si domosdoshmëri nga kjo agjenci është informimi i gjerë i popullsisë duke filluar nga shkollat për të drejtën e marrjes së shërbimit dhe transformimi i mënyrës së ofrimit të shërbimit në Shqipëri përmes qasjes me në qëndër qytetarin.

BUJQËSIA

Gjatë vitit 2018, institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Bujqësisë për problematika të ndryshme, bazuar në ligjin nr. 10 465 datë 29.09.2011 “Për Shërbimin Veterinar”. Nga ana e kësaj drejtorie aktualisht aktiviteti është përqëndruar në shërbimin veterinar dhe shërbimin këshillimor dhe konkretisht:

Është kryer vaksinimi kundër plasjes në 36000 krerë të imta dhe kafshë të tjera sipas strategjisë së plasjes. Kjo masë është realizuar brenda muajit Maj.

Është kryer procesi i vaksinimit për bagëtitë e imta kundër brucelozës në të gjithë qarkun, ku i janë nënshtruar këtij vaksinimi 88 000 krerë të planifikuar.

Problem nga ana e drejtorisë së Bujqësisë është matrikullimin pasi një pjesë e fermerëve refuzojnë ta kryejnë.

Aktualisht janë të mbjella me bimë arash gjithsej 18 840 ha.

Me kulturat drufrutore (vreshta, pemë dhe ullinj) 2200 ha.

AUTORITETI KOMBËTAR I USHQIMIT


Në zbatim të Aktit Normativ të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 16.8.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therrjen e kafshëve dhe tregtimin e mishit të tyre”, është vlerësuar vazhdimisht situata e krijuar për parandalimin e fenomenit të therrjes dhe tregëtimit të mishit jashtë kushteve normale që garantojnë higjenën, jetën e njeriut, mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Në mbështetje të shqetësimit të ngritur nga Autoritetit Kombëtar i Ushqimit (Drejtoria Rajonale), nga ana jonë është kërkuar që strukturat përkatëse (inspektoriatet) në bashkëpunim me AKU-ne dhe me bashkitë e Qarkut të inspektojnë dhe të marrin masat përkatëse për ndalimin e tregëtimit të produkteve ushqimore në mënyrë ambulante në afërsi të shkollave 9 – vjeçare dhe të mesme të qarkut për të parandaluar situata të padëshiruara dhe të rrezikshme në lidhje me shëndetin e nxënësve. Nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit është punuar edhe për forcimin e kontrollit të sigurisë ushqimore për produkte ushqimore, për afatet e skadencave dhe për etiketimin e mallrave në gjuhën shqipe etj.

Gjatë vitit 2018 nga sektorët e inspektimit në terren janë kryer në total 1429 inspektime, nga të cilat janë konstatuar shkelje të kërkesave ligjore dhe për rrjedhojë janë marrë gjithësej 216 masa administrative dhe janë bllokuar 4557 kg produkte ushqimore me origjinë shtazore.

III. Marrëdhëniet e Prefektit të Qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Marrëdhënia e institucionit të Prefektit me njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohet në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”. Në zbatim të tyre gjatë vitit 2018 është bërë verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore të paraqitura pranë institucionit të Prefektit. Për çdo akt të depozituar, Prefekti i Qarkut është shprehur për ligjshmërinë e tij brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit në zyrën e protokollit sipas procedurës së parashikuar në ligj.


Për vitin 2018 nga këshilli i qarkut dhe shtatë bashkitë që përfshin qarku i Gjirokastrës janë paraqitur për verifikim të ligjshmërisë pranë Prefektit të qarkut Gjirokastrë gjithsej 637 akte nga të cilat janë konfirmuar si të bazuara në ligj 555 (rreth 87%) dhe janë kthyer të pakonfirmuar 82 (rreth 13%) .



Nga evidence e akteve rezulton se njësitë me numrin më të vogël të vendimeve të pakonfirmuara janë këshilli i qarkut me asnjë vendim të pakonfirmuar, bashkia Gjirokastrë dhe bashkia Memaliaj me 4% të akteve të pakonfirmuara. Njësitë me numrin më të madh të vendimeve të pakonfirmuara është bashkia Përmet me 22 % dhe bashkia Këlcyrë me 26% të akteve të pakonfirmuara.

Numri i akteve të njëjive të vetëqeverisjes vendore

Viti 2018




Krahasimisht me vitin 2017 vihet re një numër më i madh aktesh të paraqitura nga ana e njëjive të vetëqeverisjes vendore, ndërsa për sa i përket nivelit të vendimeve të pabazuara në ligj ai është pothuaj i njëjtë (me një ndryshim të vogël 1%). Koncretisht në vitin 2017 nga totali i akteve të paraqitur për konfirmim nuk janë konfirmuar 12% e akteve, ndërsa në vitin 2018 nuk kanë marrë konfirmimin e Prefektit afërsisht 13% e akteve të paraqitura.

Numri i akteve të pakonfirmuara

Viti

2017 / 2018



Disa nga arsyet e moskonfirmimit të akteve, për shkak të papajtueshmërive ligjore kanë qenë:

Mosnjohja e akteve ligjore e nënligjore në lidhje me çështjet e trajtuara.

Zbatimi jo i saktë i ligjit.

Pasaktësi në anën formale të aktit.

Në çdo rast të kthimit të pakonfirmuar të akteve të njërive të vetëqeverisjes vendore, nga ana jonë është bërë argumentimi ligjor i papajtueshmërive të konstatuara.

Në këtë kuadër janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me sekretarët e këshillave të bashkive por edhe me specialistët sipas kërkesave në funksion të përmirësimit të punës në lidhje me vendimet e këshillave bashkiakë dhe bazueshmërisë së tyre ligjore.

Në kaudër të bashkëpunimit dhe konsultimit mes institucionit të Prefektit dhe njërive të vetëqeverisjes vendore, në muajin prill në ambientet e institucionit të Prefektit të qarkut u zhvillua një takim me përfaqësues të organeve të njërive të vetëqeverisjes vendore në kuadër të zbatimit të detyrimeve që lindin nga ligji 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar.

Nga ana e sektorit juridik në këtë takim, me sekretarët e këshillave bashkiakë dhe specialistët juristë të bashkive u trajtuan parashikimet ligjore që duhet të mbahen parasysht nga organet e vetëqeverisjes vendore në lidhje me procedurën për paraqitjen e akteve të Prefektit si dhe për bazueshmërinë në ligj të akteve që ata nxjerrin si nga forma ashtu edhe nga përmbajtja. Në këtë takim u shpërnda edhe një material referues për të gjithë sekretarët e këshillave bashkiakë.

Po në këtë kuadër Prefekti i Qarkut i ka drejtuar të gjitha njërive të vetëqeverisjes vendore, shkresën nr. 997 prot, datë 30.03.2018 “Mbi verifikimin e ligjshmërisë së akteve të organeve të njërive të vetëqeverisjes vendore” me anë të së cilës i silltet në vëmendje të gjitha organeve të njërive të vetëqeverisjes vendore mënyra si duhet të paraqiten aktet mbi të cilat bëhet verifikimi i ligjshmërisë nga ana e institucionit të Prefektit.

Bazuar edhe në rekomandimet e lëna në Raportin e Auditimit të Ministrisë së Brendshme pranë institucionit të Prefektit, në muajin dhjetor Prefekti i qarkut i ka drejtuar të gjitha njërive të vetëqeverisjes vendore të qarkut Gjirokastër shkresën “Udhëzim mbi paraqitjen e akteve normative të organeve të njërive të vetëqeverisjes vendore për verifikim të ligjshmërisë pranë Prefektit të qarkut Gjirokastër”.

Gjatë vitit 2018 është realizuar procesi i verifikimit të ligjshmërisë së akteve të vetëqeverisjes vendore në vend në zbatim të nenit 17 të ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut”. Është ngritur grupi i punës me urdhërin nr. 22, datë 28.02.2018 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e ligjshmërisë së akteve pranë njërive të vetëqeverisjes vendore për vitin 2018”. Është realizuar verifikimi i ligjshmërisë në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, konkretisht:

Në Këshillin e Qarkut 1 verifikim, në bashkia Gjirokastër 2 verifikime, në bashkia Dropull 1 verifikim, në bashkinë Libohovë 1 verifikim, në bashkinë Tepelenë 3 verifikime, në bashkinë Memaliaj 2 verifikime, në bashkinë Përmet 3 verifikime, në bashkinë Këlcyrë 3 verifikime.

Janë verifikuar gjithsej 431 akte. Nga verifikimi është konstatuar se nuk ka patur akte normative (vendime) të këshillave bashkiakë të padepozituara pranë institucionit të Prefektit. Në përgjithësi vendimet për të cilat është bërë konfirmimi ligjor kanë qënë të bazuara në ligj

dhe procedura për marrjen e këtyre vendimeve ka qënë e rregullt e në përputhje me ligjin. Nuk ka patur problematika për t'u evidentuar apo për të ndjekur procedurën e parashikuar nga Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” , neni 17, pika 2.)

Është konstatuar në disa raste se dokumentacioni i mbajtur nga ana e sekretarëve të këshillave për pasqyrimin e vendimmarrejs së këshillit ka qënë jo i plotë, duke mos u pasqyruar saktë procedura e ndjekur nga këshilli në marrjen e vendimit. Në këto raste janë lënë rekomandimet përkatëse të cilat në pjesëm më të madhe janë reflektuar në vazhdimësi sipas verifikimeve të mëvonshme.

IV. Emergjencat civile.

Bazuar në ligjin nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, ligjin nr. 8576, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar, dhe VKM-se Nr. 655, datë 18.12.2003 “Për ngritjen dhe funksionimin e strukturës së sistemit kombëtar të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile”, në institucionin e Prefektit është ngritur dhe ka funksionuar Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në nivel qarku. Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë gjatë vitit 2018 ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha situatat emergjente të krijuara në qarkun tonë si rezultat i kushteve të vështira atmosferike në stinën e dimrit apo të verës. Janë marrë masat për të bashkërenduar punën mes institucioneve qendrore në nivel vendor dhe organeve të vetëqeverisjes vendore për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.

Në të gjitha takimet e zhvilluara me komisionin e Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave është kërkuar përgjegjësi dhe angazhim maksimal për përgatitjen e planeve të emergjencave civile në çdo bashki dhe marrje masash për përballimin e situatave emergjente.

Gjatë stinës së dimrit të vitit 2018, i gjithë territori i qarkut Gjirokastrë u përfshi nga rreshje të dendura shiu duke krijuar një situatë emergjente të pazakontë. Si rezultat i kësaj situatë në të gjitha njësitë vendore ka patur bllokime rrugësh, dëmtime ujësjellësash, ura dhe pasarela, banesa të rrezikuara nga rrëshqitja si dhe mjaft banesa e biznese të përmbytura.

Për përballimin e kësaj situatë emergjente, Komisioni i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave në qark angazhoi të gjitha strukturat shtetërore në bashkëpunim dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Megjithëse kryetarët e bashkive, në të gjitha takimet e zhvilluara kanë informuar se kanë marrë të gjitha masat e domosdoshme për përballimin e situatave emergjente të pritshme, rezulton se krahas punës së bërë, janë evidentuar mangësi të cilat lidhen drejtpërdrejtë me fushën e përgjegjësisë. Kjo situatë nxorri edhe të meta veçanërisht në organizimin dhe veprimtarinë e strukturave përgjegjëse.

Nuk janë kryer të gjitha detyrat konform ligjit Nr. 8756, dt.26.03.2001, “ Për emergjencat civile” dhe udhëzimit Nr.15 datë 10.07.2003 për “Ngritjen e Komisionit Vendor të Emergjencave Civile, në Bashki dhe Njësi Administrative”

Nuk janë zbatuar të gjitha rekomandimet e dhëna nga Kryetari i Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave të Qarkut .

Nuk ishin përgatitur plane reale me skenarë veprimi për përballimin e situatave emergjente civile, në të gjitha fazat: parandalim, pakësim dhe riaftësimin nga situata emergjente që u krijua, pothuajse në të gjithë, qarkun, dhe nuk janë planifikuar fondet e domosdoshme për përballimin e Emergjencave Civile.

Në adresë të Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, gjatë vitit 2018 janë adresuar shumë ankesa të qytetarëve që kërkonin zgjidhje urgjente nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Jo nga të gjitha bashkitë, në buxhetin e vitit 2018 kanë planifikuar fonde për emergjencat civile në vlerën 3% gjë e cila do ti paraprinte përballimit më me efikasitet të situatave të krijuara.

Informacionet dhe raportimi pranë Komisionit nuk ka qënë në kohë dhe i saktë.

Mbështetur në Urdhërin e Prefektit të qarkut nr. 36, datë 18.05. 2018 “Për Ngritjen e Task Forcës Rajonale për marrjen e masave parandaluese në përballimin e emergjencave civile për Zjarret në Pyje dhe Kullota” gjatë stinës së verës 2018 u përgatit Plani i Masave dhe u realizua takimi i Task Forcës Rajonale .

Situata e zjarreve krahasuar me vitin 2017: Gjatë vitit 2017 u dogjën (3228.65 ha kullota, shkurre e pyje), ndërsa sipërfaqet e djegura deri në fund të shtatorit të vitit 2018 janë 40.2 ha kullota, shkurre tokë arë dhe pyje me numër të papërfillshëm janë:

Rreth 6 ha në bashkinë Gjirokastrë
Rreth 3.5 ha në bashkinë Libohovë
Rreth 15.5 ha në bashkinë Dropull
Rreth 2.5 ha në bashkinë Tepelenë
Rreth 14 ha në bashkinë Memaliaj
Rreth 2 dynym në bashkinë Këlcyrë
Rreth 1.6 dynym në bashkinë Përmet

Nisur nga problematikat e ndodhura vitin e kaluar, task forca rajonale e ngritur për vitin 2018 rishikoi me përgjegjësi dhe kompetencë planin e masave, për organizimin dhe përgjigjen në kohë nga ana e strukturave shtetërore dhe ato lokale, duke parashikuar masa parandaluese dhe rregulluese ndaj rënies së zjarreve mbi sipërfaqet pyjore dhe ato të kullotave gjatë verës së këtij viti. Nga analiza e rënies së zjarreve për këtë vit theksojmë se mbi 90% e tyre ka qënë si rezultat i vënies së zjarreve nga ana e njerëzve për rigjenerimin e kullotave, por në ndryshim nga vitet e kaluara janë vlerësuar dhe janë ndaluar menjëherë, duke përfshirë të gjitha strukturat lokale dhe ato shtetërore. Pothuajse nga të gjitha bashkitë, institucionet shtetërore, degët territoriale pati vlerësim dhe përgjegjësi për marrjen e masave dhe përballimin e situatave që u krijuan në të gjithë territorin e qarkut.

Disa nga masat që u planifikuan, zbatuan dhe rezultuan të suksesshme ishin:

Planifikimi dhe zhvillimi i takimeve me drejtuesit e institucioneve , njësi administrative, kryepleqtë e fshatrave, shërbimet pyjore, punonjësit e policisë, stacioneve zjarrfikëse, bizneset, për organizimin dhe marrjen e masave për mbrojtjen nga zjarri.

Bashkitë, degët territoriale, institucionet shtetërore, vunë në efikasitet të plotë strukturat operacionale, ndërhyjnë në kohë, dhe angazhuan të gjitha kapacitetet materiale dhe njerëzore që disponojnë për neutralizimin e vatrave të zjarrit. Nëpërmjet strukturave përkatëse të tyre të shërbimit të MZSH-së, si dhe në veçanti strukturat e shërbimit pyjor për të ruajtur sipërfaqet pyjore dhe ato të kullotave u organizua puna, për ngritjen e grupeve vullnetare dhe atyre vrojtuese për marrjen e masave parandaluese dhe përgatitore, për mbrojtjen pyjore dhe kullotave nga rreziku i zjarrit dhe për inspektimin në vend të gjëndjes.

Institucioni i Prefektit të Qarkut vlerëson se pavaresisht se EC janë sfida të vështira, mund të evitohen dhe përballohen me sukses, nëse vlerësohen seriozisht dhe merren të gjitha masat mbrojtëse.

V. Task Forcat e ngritura pranë institucionit të Prefektit.

Në zbatim të ligjit për Prefektin, të akteve të tjera ligjore dhe të akteve normative të Këshillit të Ministrave, pranë institucionit të Prefektit të Qarkut janë ngritur dhe kanë funksionuar disa Task-Forca në nivel vendor për problematika të ndryshme, veçanërisht këto në shërbim të komunitetit.

Konkretisht:

1. Task-forca në nivel vendor mbështetur në Aktin Normativ të KM nr. 4, datë 16.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave për therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre”.

Kjo task-forcë ka monitoruar dhe ushtruar kontrole të vazhdueshme dhe të menjëhershme në të gjitha tregjet brenda qarkut për të shmangur therjen e kafshëve dhe tregëtimin e mishit të tyre jashtë kushteve higjieno sanitare si dhe ka bërë monitorimin e punonjësve të ngarkuar me përgjegjësinë për zbatimin e këtij akti normativ.

2. Në zbatim të shkresës së Ministrit të Punëve të Brendshme datë 15.06.2016 “Për marrjen e masave në përballimin e zjarreve në pyje dhe kullota si dhe informim”, me urdhër të Prefektit të Qarkut është ngritur Task- Forca rajonale për marrjen e masave parandaluese në përballimin e emergjencave për zjarret në pyje dhe kullota gjatë stinës së verës 2018 me përbërje drejtuesit e vetëqeverisjes vendore dhe strukturave të veçanta të institucioneve shtetërore në nivel vendor.
3. Gjithashtu bazuar në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, bazuar në Plan Veprimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme “Për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike gjatë vitit 2018”, pranë këtij institucioni me urdhër të Prefektit të Qarkut është ngritur Taks forca vendore e Luftës Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit me përbërje të drejtuesve kryesor të disa institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe ata të bashkive të qarkut. Për realizimin e objektivave për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe goditjen e kësaj veprimtarie të

paligjshme, Shtabi Rajonal ka bashkëpunuar me të gjitha strukturat shtetërore në nivel vendor duke përmendur këtu edhe grupet e punës. Si rezultat në qarkun tonë kemi patur

4. Bazuar në Urdhërin e Kryeministrit nr. 130, datë 27.03.2014 “Për krijimin e Task – Forcës në nivel kombëtar, për marrjen e masave të ndërhyrjes emergjente ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara”, me urdhër të veçantë të Prefektit të Qarkut është ngritur Task-Forca në nivel qarku për marrjen e masave të ndërhyrjes emergjente ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara.
5. Bazuar në Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Personave dhe Planit të Veprimit 2014 – 2017 (miratuar me VKM 814, datë 26.11.2014) dhe në Urdhërin. nr. 139, datë 19.06.2006 i Kryeministrit për “*Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore*”, pranë këtij institucioni gjat vitit 2018 është ngritur Komiteti Rajonal i Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore për Qarkun e Gjirokastrës. Ky komitet ka zhvilluar rregullisht dhe në mënyrë periodike mbledhjet e tij si dhe ato të Tryezës Teknike Rajonale. Gjatë këtij viti nuk kemi patur asnjë rast të trafikimit të qenieve njerëzore.

VI. Komisioni Vendor i Verifikimit të Titujve të Pronësisë mbi Tokën Bujqësore.

KVVTP për vitin 2018 ka realizuar detyrat bazuar në ligjin nr. 9948 datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore” i ndryshuar , dhe VKM nr. 2, datë 13.01.2010 “Për mënyrën e verifikimit të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë”.

Gjatë vitit 2018 në pranë KVVTP-së janë paraqitur 87 kërkesa nga subjekte të ndryshme me objekt:

- Plotësim me tokë bujqësore
- Cënim pronësie
- Vlefshmëri AMTP-je
- Konfirmim legjitimiteti
- Kërkesë informacioni lidhur me tokat e refuzuara, etj.

Gjatë këtij viti, KVVTP ka bërë shfuqizimin e plotë për 31 AMTP, shfuqizim të pjesshëm për 3 AMTP dhe janë marrë gjithësej 15 vendime nga të cilat një vendim është i përbashkët për njëzet kërkesues.

Po ashtu, nga ana e KVVTP-së janë kthyer 25 përgjigje administrative.

Puna e KVVTP-së ka hasur vazhdimisht pengesë në korespondencën me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, gjë e cila ka sjellë pengesë dhe vonesa të konsiderueshme në zhvillimin e hetimit administrativ.

Janë plotësuar rreth 350 dosje të cilat janë në fazën e shqyrtimit për të dalë në konkluzionet përfundimtare. Mosmarrja e Vendimeve në kohë ka ardhur si pasojë e mungesës së gadishmërisë nga ana e institucioneve për të na kthyer përgjigje në afatet ligjore si njësitë e vetëqeverisjes vendore, Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut.

Është dhënë asistencë e nevojshme për subjekte të ndryshme për çështje që kanë qenë jashtë kompetencave së këtij Komisioni dhe qytetarët janë informuar brenda afateve ligjore në lidhje me


këto kërkesa duke i sugjeruar se cilit organ përkatës duhet t'i drejtohen për zgjidhjen e problemeve të tyre konform ligjeve dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim të tyre.

KVVTP ka ndjekur 13 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë në Gjykatën e Shkallës së Parë Gjirokastrë dhe në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Në këto procese gjyqësore Komisioni vendor është paraqitur si palë paditëse, palë e paditur dhe si person i tretë i thirrur nga gjykata. Në përfundim të proceseve Gjyqësore nga shfuqizimi i pjesshëm i AMTP-ve , KVVTP-ja ka kthyer në favor të shtetit 27 ha tokë.

VII. Shërbimet ndaj komunitetit.

Përmirësimi i shërbimeve publike gjatë vitit 2018 ka qenë në fokus të veprimtarisë së institucionit të Prefektit. Gjatë këtij viti pranë institucionit të Prefektit kanë ardhur një numër i konsiderueshëm kërkesash dhe ankesash nga qytetarët të cilat kanë qenë të adresuara direkt në institucionin e Prefektit ose janë dërguar për ndjekje nga Kryeministria apo Ministrinë.

Konkretisht në institucionin e Prefektit gjatë vitit 2018 janë adresuar dhe trajtuar gjithsej 139 kërkesa dhe ankesa të ardhura nga shtetas të ndryshëm nga të cilat 111 prej tyre kanë marrë përgjigje ndërsa 28 janë pa përgjigje.



Shqetësimet e përcjella nga komuniteti pranë institucionit kanë qenë të natyrave të ndryshme, si infrastruktura, kullotat, pyjet, pronat, uji i pijshëm, zhurma në mjedis, ndihma sociale, përfitimi i dëmshpërblimeve si pasojë e emergjencave civile etj.

Duhet të vëmë në dukje se në mjaft raste njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe degët territoriale që veprojnë në qark, për ankesat dhe kërkesat e qytetarëve të përcjella për ndjekje dhe zgjidhje nga ana e institucionit të Prefektit të Qarkut, nuk kanë kthyer përgjigje brenda afateve ligjore dhe nuk u kanë dhënë zgjidhje një pjesë të këtyre problematikave. Kjo situatë lë për të dëshiruar në mosimpinjimin e titullarëve drejtues kundrejt angazhimit të institucionit të Prefektit të Qarkut për të dhënë zgjidhje deri në fund halleve, shqetësimeve, shërbimeve dhe problemeve të ndryshme të komunitetit.



Zhvillimi Rajonal:

Në kuadër të zhvillimit ekonomik të rajonit, Qeveria Shqiptare ka akorduar fonde për realizimin e një sërë investimesh të cilat patën një impakt të rëndësishëm në jetën sociale dhe ekonomike të banorëve të qarkut Gjirokastrë.

Konkretisht, në qarkut tonë, me fonde nga buxheti i shtetit apo donatorë të tjerë, janë prokuruar dhe janë në proces një sërë projektesh të cilat konsistojnë në: përmirësim të infrastrukturës rrugore, rehabilitim urban, shëndetësi, arsim, turizëm, etj.

Realizimi i investimeve në bashkitë e qarkut Gjirokastrë
viti 2018

Vlera e prokurimit: 1.5 miliard lekë
 Realizimi : rreth 1.1 miliard lekë
 Realizimi në %: rreth 79 %



(bazuar në evidencat e dërguara nga NJVQV për vitin 2018)

Disa nga investimet më kryesore vlen të përmendim;

RIKUALIFIKIM URBAN

Restaurimi i Pazarit të Gjirokastrës, mbi 5000 m2.



Investim i Qeverisë Shqiptare dhe Fondacionit Shqiptaro-Amerikan në kujdesin e FSHZH. (faza I)
 Vlera e projektit: rreth 3.5 milion dollarë.
 Përfitojnë rreth 52 mijë banorë

(pamje,para investimit)

(pamje,pas investimit)

RIKUALIFIKIM URBAN I QENDRËS SË QYTETIT PËRMET.



Investim i Qeverisë Shqiptare.
Vlera e projektit: 102 milion lekë.
Përfitues rreth 18 mijë banorë



(pamje,para investimit)
(pamje,pas investimit)

RIKUALIFIKIM URBAN I QENDRËS SË QYTETIT LIBOHOVË.

Investim i Qeverisë Shqiptar nëpërmjet FZHR (Fondi për Zhvillimin e Rajoneve)
Vlera e projektit: 139 milion lekë.
Përfitojnë rreth 7 mijë banorë.





(pamje,para investimit)



(pamje,pas investimi)

RIKUALIFIKIM URBAN I QENDRËS SË QYTETIT TEPELENË.

Investim i Qeverisë Shqiptare nëpërmjet FZHR.
Vlera e projektit: rreth 150 milion lekë.
Përfitojnë 15 mijë banorë.

(pamje,para investimit)



(pamje,pas investimit)

RIJETËSIMI I PEDONALEVE DHE HAPËSIRAVE REKREATIVE NË SHESHIN QENDËR, BASHKIA KËLCYRË.

Investim i Qeverisë Shqiptare nëpërmjet FZHR.

Vlera e projektit: 148 milion lekë.

Përfitojnë rreth 12 mijë banorë



(pamje,para investimit)



(pamje,pas investimit)



**ANSAMBLI
ARKITEKTO
NIK**

"SHESHI MINATORI", BASHKIA MEMALIAJ



Rikonstruktion i Ansambli Arkitektonik "Sheshi Minatori", bashkia Memaliaj.

Investim i Qeverisë Shqiptare nëpërmjet FZHR.

Vlera e projektit: 98 milion lekë.

Përfitojnë rreth 20 mijë banorë

(pamje,para investimit)

(pamje,pas investimit)

RIKONSTRUKSION I RRUGËS "AGO ÇELI", RRUGËS SË RE DHE PALESTRA E LGJ."15 SHTATORI:", BASHKIA TEPELENË.

Investim i Qeverisë Shqiptare nëpërmjet FZHR.
Vlera e projektit: 146 milion lekë.



Rikonstruksioni i palestrës së lgj."15 Shtatori"



(pamje,para investimit)

(pamje,pas investimit)

➤ **INFRASTRUKTURË RRUGORE**

-Ndërtim i rrjetit rrugor "Unaza Pogon", bashkia Dropull



- Investim i FZHR
- Vlera e prokurimit: 138 milion lekë

-Aksi Gjirokastrë-Lazarat

Rehabilitimi i plotë i aksit Gjirokastrër-Lazarat me gjatësi 3.5 km, në kuadër të projektit të përbashkët me Bankën Botërore për mirëmbajtjen e akseve rrugore kombëtare

Vlera e investimit rreth 1 milion euro.

➤ RESTAURIM I MONUMENTEVE TË KULTURËS

Gjatë vitit 2018 në qarkun e Gjirokastrës, vëmendje është treguar për mirëmbajtjen dhe restaurimin e monumenteve të kulturës, në shërbim të zhvillimit të turizmit.

Disa nga restaurimet kryesore janë:

(Kisha e "Shën Marisë" në Labovën e Kryqit)



e Katiut)

(Ura e Kordhocës, Gjirokastrër).



(Ura

(Ura Nivanit)



Programet kombëtare "Rrugët e Besimit" dhe "Rrugët e Kujtesës" do të ofrojnë përgjatë vitit të ardhshëm shumë itinerare të reja turistike, ku në fokus do të jetë gjithmonë e më shumë turizmi kulturor.

❖ PROJEKTE NË VAZHDIM

Rehabilitim i Infrastrukturës dhe Restaurim i Kalldrëmeve në Pazarin e Gjirokastrës.

Pas përfundimit të fazës së parë ku është ndërhyrë në 10 blloqe banimi në Qafën e Pazarit, ka nisur faza e dytë e punimeve në kuadër të programit "Për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turizmin"

- Vlera e punimeve: 137 milion lekë
- Afati i realizimit të projektit: 12 muaj
- Sipërfaqja që do të trajtohet është 5,290 m² dhe ndërhyrja do të prekë të gjitha rrjetet infrastrukturore nëntokësore.



BY PASS-I TEPELENË

Fondi limit nga Buxheti i Shtetit : 2.4 miliard lekë

Gjatësia e segmentit: 2.3 km 2 korsi me 3.7 m

Afati i realizimit të projektit: 22 muaj

Projekti përfshin lidhjen e dy segmenteve rrugore:

- Levan Tepelenë në hyrje
- Tepelenë – Gjirokastrë – Kakavie në dalje, si pjesë e korridorit Veri-Jug.

(Pamje nga projekti)



AKSI RRUGOR KARDHIQ-DELVINË

Gjatësia totale: 34 km
Rrugë të ndërtuara: 16 km
Rrugë për ndërtim: 16 km
Numri i loteve: 8
Lote të ndërtuara: 3
Lotë për ndërtim 2018: 3
Lotë për ndërtim 2019: 2



Vlera për ndërtimin e dy segmenteve:

41 milion dollarë

Realizimi i këtij projekti:

- Zhvillon turizmin, ekonominë dhe punësimin
- Shkurton distancën Tiranë-Sarandë
- Kthen Sarandën dhe Gjirokastrën në një ofertë të përbashkët turistike
- Afron Delvinën me Tiranën dhe Gjirokastrën
- Zgjeron potencialin turistik dhe ekonomik të gjithë zonës.



(Pamje nga projekti)

RIKONSTRUKSION QENDRA SHËNDETËSORE

Gjatë vitit 2018 me investime nga buxheti i shtetit, u rehabilituan disa qendra shëndetësore, konkretisht;

-Gjirokastrë: qendra shëndetësore në lagjen “Dunavat”, “Palorto”, “11 Janari”, “18 Shtatori”, “Varosh”, etj.

-Nj.Ad Cepo: qendra shëndetësore Kardhiq

-Nj.Ad Lunxhëri: qendra shëndetësore Shën Todhër:

-Tepelenë: qendra shëndetësore Krahëz

-Përmet: qendra shëndetësore Petran.

Në qarkun Gjirokastrër do të rehabilitohen gjithësej 22 qendra shëndetësore dhe pika autoambulancash, për t'u ofruar qytetarëve një shërbim sa më cilësor.

Qendra shëndetësore, Igj. Varosh Gjirokastrër



Qendra shëndetësore, Valare



RIKONSTRUKSION UJËSJELLËSA -KANALIZIME

Ka përfunduar faza e parë e sistemit të depove dhe pompave, një investim i qeverisë shqiptare me KFË Gjermane dhe shumë shpejt pritet të fillojë edhe faza e dytë për të gjithë bashkinë e Gjirokastrës. Me përfundimin e fazës së dytë të investimit i gjithë qyteti i Gjirokastrës do të ketë furnizim me ujë për 24 orë.

Do të fillojë investimi për rrjetin e shpërndarjes së ujësjellësit në qytetin e Tepelenës dhe në Memaliaj. Po vazhdon investimi shumë i rëndësishëm në Bashkinë e Përmetit, Këlcyrë dhe në Dropull”

RIKONSTRUKSION SHKOLLASH

Rikonstruksion i shkollës së mesme “Asim Zeneli” + sistem i jashtëm (loti I + loti II)

- Investim i Qeverisë Shqiptare (FZHR) dhe Bashkisë Gjirokastrë
- Vlera e plotë e projektit : 83 milion lekë

Rikonstruksion i shkollës së mesme "Sami Frashëri", Përmet

- Investim i Qeverisë Shqiptare (FZHR) dhe Bashkisë Përmet
- Vlera e plotë e projektit : 85 milion lekë

Rikonstruksioni shkollës së mesme të përgjithshme , bashkia Këlcyrë

- Investim i Qeverisë Shqiptare (FZHR) dhe Bashkisë Këlcyrë
- Vlera e plotë e projektit : 56 milion lekë



Rikonstruksion i shkollës "Avni Rustemi", bashkia Libohovë

- Investim i Qeverisë Shqiptare (FZHR) dhe Bashkisë Libohovë
- Vlera e plotë e projektit : 65 milion lekë



VIII. Rekomandimet dhe objektivat.

a- Rekomandimet

b- Objektivat e institucionit të Prefektit për vitin 2019

08.02.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Greke

I nderuar Z.Rektor, Prof.Bektash Mema,

I nderuar Konsull i Përgjithshëm i Greqisë në Gjirokastrë,

Zoti Lambros Kakissis,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar miq dhe të ftuar,

Duke ju falenderuar për ftesën më lejoni të them se ndjehem shumë i nderuar që marrë pjesë në një veprimtari të një natyre krejt të veçantë, atë të konstituimit të Ditës Ndërkombëtare të Gjuhës Greke.

Dhe të theksoj, me këtë rast, se ky nderim nuk lidhet thjeshtë më faktin e festimit. Lidhet me rëndësinë e madhe të gjuhës greke, si gjuhë e folur dhe e shkruar, me jetgjatësinë më të madhe se çdo gjuhë tjetër. Me faktin se gjuha greke ka kontribuar në ecurinë e të gjitha gjuhëve me peshë në të gjithë botën. Me faktin se gjuha qëndron në themel të mendimit shkencor,filozofik, letrar e akademik që kemi sot, qëndron në themel të atij civilizimi që trashëgoi dhe zhvilloi njerëzimi deri në ditët tona, por edhe në të ardhmen.

Dita e sotme na jep mundësinë për të vlerësuar se secili nga ne, në veprimtarinë tonë të përditshme, profesionale dhe njerëzore, shoqërore dhe civile, përdorim në mënyrë të natyrshme, fjalë, koncepte, mënyra të menduari që i kemi marrë ose e kanë rrënjën tek gjuha greke.

Të nderuar miq!

Të gjitha sa thashë sa më sipër, dhe shumë të tjera që do të thuhën në këtë veprimtari, kanë vlerë për çdo vend të botës. Për mua personalisht dhe vendin që përfaqësoj ky fakt përbën një vlerë më shumë se, gjuha greke është gjuha e vendit dhe e popullit mik grek, me të cilin kemi një histori të gjatë, kemi shumë gjëra që na lidhin dhe na afrojnë. Gjuha dhe kultura greke përbëjnë premisë për të forcuar këtë lidhje dhe marrëdhënie të fqinjësisë së mirë, dhe të gjithë ne duhet të punojmë në këtë drejtim. Gjuha greke është njëkohësisht gjuha që hasim më shumë se çdo gjuhë tjetër të huaj dhe në prefekturën e qarkut Gjirokastrë.

Është gjuha e minoritetit etnik grek me të cilin bashkëjetojmë në paqe dhe miqësi, është gjuha që përdorin me mijra emigrantë shqiptarë në Greqi, faktor këta me shumë rëndësi, për të na afruar më shumë me njëri-tjetrin duke na dhuruar më shumë mirëkuptim, miqësi e bashkëpunim!

Edhe njëherë ju falenderoj për ftesën dhe i urojmë Gjuhës greke dhe popullit grek jetëgjatësi pa fund dhe kontributë të vazhdueshëm për të mirën e kulturës botërore!

12.03.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin mbi analizimin e zjarreve në qarkun Gjirokastër

Të nderuar pjesëmarrës në takim,

Në zbatim të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, ligjit nr.8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar, ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin si dhe akteve të tjera nënligjore”, nisur dhe nga ngjarjet e pazakonta të ndodhura gjatë këtyre dy muajve të fundit, zhvillojmë këtë takim me pjesëmarrjen e përgjegjësive të emergjencave civile pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, përfaqësues nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut dhe komisariatet e policisë në qark, përfaqësues nga Inspektoriati i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave, Drejtoria Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Sektori i Bujqësisë në qark për të analizuar mosmarrjen e masave parandaluese, mosraportimin, reagimin me vonesë dhe mosinformimin në kohë sipas modelit të përcaktuar.

Qarku Gjirokastër përbëhet prej 45.104 ha të sipërfaqes me tokë të punueshme, 95.533 ha kullota, 84.662 ha pyje, shkurre dhe drurë të ndryshëm.

Gjatë periudhës janar –mars 2019 situata e zjarreve ka qënë si më poshtë:

1. Në datën 20.02.2019 në Ujin e Ftohtë Tepelenë - Bashkia Tepelenë (zjarr i qëllimshëm), në datën 24.02.2019 në Njësine Administrative Memaliaj Fshat - bashkia Memaliaj (u dogj një sipërfaqe rreth 1 dynim shkurre dhe 7 rrënjë ullinj).
2. Në datën 27.02.2019 në Qafën e Muzinës – Njësia Administrative - bashkia Dropull, zjarr i qëllimshëm (u dogj rreth 5 ha shkurre e ferra – shpëtuan 1 pikë karburanti, 1 stallë lopësh, 30 koshere bletësh).
3. Në datën 08.03.2019 në fshatin Martalloz-Tosk, Njësia Administrative Luftinjë - bashkia Memaliaj, zjarr shkëndijë elektrike (u dogj një sipërfaqe rreth 10 ha nga këto 2 ha pyll me pisha, pyll me shkurre sipërfaqe me ullinj që ende nuk ka informacion, si dhe u përshkuan varrezat e këtij fshati).
4. Në datën 08.03.2019 në Njësine Administrative Krahës – bashkia Memaliaj, shkaqe zjarri të pa njohura (u dogj një sipërfaqe rreth 3 dynim pyll me pisha).
5. Po në datën 08.03.2019 në hyrje të qytetit Tepelenë – bashkia Tepelenë, shkaqe zjarri të pa njohura (u dogj një sipërfaqe me livadhe e kullota me dëm të pallogaritshëm).

Në disa Bashki, zjarret kanë marrë përmasa duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në pyje, pemë frutore, dhe në disa raste janë bërë rrezik potent për territore të banuara. Tërheqim vëmendjen se edhe pse djegia e sipërfaqes kullosore bëhet për rigjenerimin e barit, në të vërtetë ky proces kontaminon sipërfaqene e tokës dhe njëkohësisht edhe barin e ri duke trasmetuar sëmundje të rezikshme edhe në qumshin e bagëtive e më pas tek konsumatori.

Thuajse në të gjitha rastet e konstatuara, zjarret janë të vendosur me dashje dhe qëllim të caktuar nga banorët e zonave, duke synuar djegien e shkurreve të thata, eliminimin e mbeturinave, pastrimin e hapësirave për kultivimin e bimëve të stinës, njëkohësisht duke mos përjashtuar edhe ndezjen e zjarreve të qëllimshme për të shkaktuar dëme në zona të caktuara, veçanërisht ato të mbrojtura.

Nisur nga këto problematika kërkoj nga ana juaj, të analizojmë me përgjegjësi dhe kopetencë në bazë të legjislacionit përkatës rastet e ndodhura në çdo njësi administrative duke nxjerrë përgjegjësitë dhe rritjen e gatishmërisë nëpërmjet bashkëpunimit dhe koordinimit të të gjitha strukturave shtetërore e vendore për parandalimin e çdo situatë në vazhdim.

Njësitë e vetqeverisjes vendore, kryetarët e bashkive, nëpërmjet strukturave përkatëse të tyre të shërbimit të MZSH-së si dhe në veçanti strukturat e shërbimit pyjor, për të ruajtur sipërfaqet pyjore dhe ato të kullotave duhet të organizojnë punën për ngritjen e grupeve vullnetare dhe ato vrojtuese për inspektimin e përhershëm në vend të gjëndjes për marrjen e masave parandaluese dhe përgatitore për mbrojtjen pyjore dhe kullotave nga rreziku i zjarrit. Gjithashtu njësitë e vetqeverisjes vendore si dhe Drejtoria Rajonale e Zonave të Mbrojtura të ushtrojnë kontrolle ndaj subjekteve të cilët kanë marrë me kontrata qiraje kullota dhe të kërkojnë në vazhdimësi zbatimin e detyrimeve kontraktuale duke parashikuar sanksionet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

Në zbatim të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”-Drejtoria Vendore e Policisë së qarkut të përpilojë për çdo komisarjat plan masash konkret për rritjen e sigurisë, në parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota, në garantimin e rendit dhe sigurisë publike nga rreziqet që mund t’i kanosen jetës së njeriut dhe pronës në situatat e fatkeqësive natyrore e atyre aksidentale.

Drejtoria e Policisë Vendore të Qarkut në bashkëpunim me njësitë e vetqeverisjes vendore të organizojë takime me komunitetin, me administratorët e njësive vendore, kryetarët e fshatrave, me personat që kanë marrë me qera kullotat, për sensibilizimin e tyre, për njohjen e legjislacionit, penalteteve në zjarrvëniet e qëllimshme dhe pakujdesitë, të cilat sjellin shfaqjen e zjarreve në pyje dhe kullota.

Kërkohet ndërgjësimi i komunitetit se shkatërimi i pronës nga zjarri apo nga pakujdesia janë vepra penale të parashikuar sit ë tilla nga nenet 151 dhe 161 të Kodit Penal për të cilat janë parashikuar masa me gjobë dhe burgim.

Nga ana e Prefektit të Qarkut do të ushtrohen të gjitha funksionet e tij, në shkëmbimin e informacionit, në menaxhimin e çdo emergjence me strukturat qendrore në qark, në veçanti gjatë këtij sezoni për zjarret në sipërfaqet pyjore. Për rastet kur situatat emergjente zjarresh të pa përballueshme duke bashkëpunuar me ju, të kërkojmë ndihmë për pjesëmarrjen e forcave të tjera nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile do të realizojmë koordinimin e të gjitha forcave për parandalimin, ndërhyrjen dhe eliminimin e këtyre lloj emergjencash.

Nga bashkitë kërkohet realizimi, koordinimi dhe ndjekja në vazhdimësi i detyrimeve ligjore dhe porosive të dhëna.

Për sa më sipër, kërkojmë të vazhdohet informimi me shkrim çdo ditë të premtë ora 12⁰⁰ (Qershor-Shtator) për sezonin e stinës së nxehtë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër në lidhje me ndjekjen nga ana e njësive të vetqeverisjes vendore dhe institucionet shtetërore që bëjnë pjesë në TFR gjithë problematikat e ndodhura për zjarret në pyje dhe kullota.

17.03.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Festën e Ditës së verës në Përmet.

I nderuar Kryetar i Bashkisë së Përmetit,

Të nderuar organizatorë të këtij aktiviteti,

Të nderuar motra e vëllezër përmetarë !

Dita e verës është dita e ripërtëritjes, e gjelbërimit, e vazhdimësisë së jetës. Zanafillën e ka në foltoren që quhet “Zana e Çermenikës”, perëndesha e gjuetisë, pyjeve dhe natyrës së bukur të Shqipërisë. Zana dilte nga foltorja e saj vetëm në 14 Mars.

Naim Frashëri e quan ditën e verës "Një ditë të bekuar" nga vjen bukuria. Më poshtë po citoj disa reshta që poeti i madh përmetar Naim Frashëri ka shkruajtur për ditën e verës: *“ Sot është një ditë që përsëritet moti, lind vera, lind ngrohtësia, lind vetë zoti. Është një ditë e bekuar që rrjedh vetë bukuria. Qielli qesh e gëzohet dhe lulët lulëzojnë. Është ditë e dashurisë dhe vëllazërisë, ditë e mbarë gëzimi, ditë e bardhë e miqësisë ”.*

Karakteristikë e qytetit të Përmetit është rritja e trëndafilave në oborret e shtëpive të vjetra, i cili njihet ndryshe si Qyteti i Trëndafilave. Zona që përfshihet në bashkinë e Përmetit është e pasur me monumente arkeologjike, historike, monumente kulti dhe natyrore, me vlera unike në llojin e vet, të vizitueshme në çdo kohë dhe të njohura ndërkombëtarisht. Falë investimeve të qeverisë për shtimin e sheshit kryesor të qytetit, përmirësimin e ndriçimit dhe rikonstruksionin e akseve rrugore, të shtëpive të kulturës dhe rikonstruksionin e fasadave, Përmeti sot tërheq gjithnjë e më shumë me bukuritë që ofron, me historinë dhe traditën përmetare. Burimet e zhvillimit të turizmit kulturor janë edhe burimet termale të Bënjës, fshat i ndodhur rreth 8 km nga Përmeti. Tradita e gatimeve tradicionale përmetare si dhe prodhimi i glikove e rakisë kanë përmirësuar zhvillimin e agroturizmit duke i dhënë përparësi ekonomisë dhe punësimit familjar.

Ju pra i plotësoni të gjitha kushtet për të patur gjithmonë progres dhe zhvillim të pashtershme. Jeni pra, një fuqi që i shtoni vlera qarkut tonë.

Pozicioni gjeografik e bën Përmetin një qendër potenciale, duke u bashkuar me zonat e tjera përreth. Ju mund të bëni gjëra edhe më të mëdha pasi i zotëroni të gjitha potencialet e nevojshme si: potencialet hidrike, bujqësore, blegtorale dhe turistike të të gjithë zonës.

Uroj gjithë përmetarët dhe kushdo që ka ardhur sot në Përmet, Gëzuar ditën e Bukur të Verës!

Sa më shumë gjëra të ëmbla në zemrat tuaja, sikundër glikoja shumë e preferuar!

18.03.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Luftën e Mashkullorës

I nderuar Kryetar i Këshillit të Qarkut,

E nderuara Kryetare e Bashkisë Gjirokastrë,

Të dashur vëllezër e motra,

Si sot 111 vjet më parë, çeta e kapedan Çerçiz Topullit do të zhvillonte në fshatin Mashkullorë të qarkut të Gjirokastrës një ndër betejat më të ashpra të shekullit të kaluar të rezistencës patriotike shqiptare. Lufta e Mashkullorës do të ishte ndër ngjarjet më të spikatura të rezistencës patriotike të viteve 1908-1910 të cilat do ti paraprinin Shpalljes së Pavarësisë më 1912.

Lufta e Mashkullorës nuk ishte e vetmja betejë e luftës së kësaj çete. Çeta e Çerçizit, besnike ndaj programit kombëtar, e kreu misionin e saj me forcën e fjalës, të librit dhe të armës.

Kjo ngjarje historike do të pasonte aktin heroik të dy pjestarëve të çetës, patriotëve Hito Lekdushi dhe Bajram Ligu, të cilët në 13 mars 1908 në një atentat të mirëorganizuar, do të vrisnin bimbashin turk të Gjirokastrës. Pesë ditë më vonë, çeta e Çerçiz Topullit e përbërë nga 9 vetë do të arrinte të përballonte hordhitë turke duke bërë një luftë të pabarabartë, por ai luftoi si luan dhe historia e vendosi në altarin e lirisë.

Një grup luftëtarësh të çetës u bënë ballë gjatë një dite të tërë sulmeve të pareshtura të forcave turke dhe mundën ta çanin rrethimin. Nga luftëtarët e çetës mbeti i vrarë Hajredin Tremishti, kurse ushtria turke humbi 20 veta.

Çeta e Çerçiz Topullit me 11 vetë pas asgjësimit të Majorit të xhandarmërisë u strehua në “zonën luftarake” të Labërisë, që në fakt ishte në çdo vatër e zjarr të ndezur të lebërve. Çerçizi kishte me vete: Mihalin, Hajredinin, Asllaninin, Zemanin, Hiton, Myftarin dhe ditën e martë më 17 mars luftëtarët shkuan në shtëpinë e Myrto Haskës, i cili ishte babai i Zeman Haskës, siç njihet ndryshe Zeman Mashkullora.

Është nder për të gjithë ne të vendosim kurorë me lule në monumentin e patriotit dhe heroit Çerçiz Topullit, i cili dha gjithçka për vendin e vet. Këto momente kthehen në çaste lumturie, bashkimi, solidariteti dhe miqësie midis të gjithëve nesh dhe përcjellin në breza ndjenjën e mirënjohjes dhe të falenderimit.

Një personalitet si Çerçiz Topulli duhet marrë si shembull i rezistencës, guximit, dhe trimërisë. Ai sot na bën të ndjehemi të gjithë krenarë dhe ta falenderojmë se falë tij dhe të gjithë atyre që luftuan me vetëmohim, ne sot jetojmë të lirë dhe ëndërrojmë për një të ardhme akoma edhe më të mirë.

Lufta e Mashkullorës mbetet ende sot, një epike e ndritur e guximit dhe trimërisë shqiptare, ku kapedani i jugut, trimi i paepur Çerçiz Topulli dhe burra me fishekë të numëruar luftuan kundër një ushtrie të tërë.

Jeta dhe vepra e heronjve dhe dëshmorëve që dhanë jetën për Atdheun është një mesazh i përhershëm që u bëhet shqiptarëve kudo që ndodhen, për t'i shërbyer kombit të tyre, duke na përcjellë ndjenjën e forcimit të unitetit dhe bashkimit.

Nderim në jetë të jetëve heronjve e dëshmorëve të kombit!

Nderim Heroit të Popullit Çerçiz Topulli dhe shokëve të tij për veprën e tyre të shenjtë që kryen ndaj Atdheut!

20.03.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin e Task Forcës Vendore të Luftës kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit për sensibilizimin e komunitetit të qarkut Gjirokastrë

I nderuar z. Shaban Nexhi, Drejtues i grupit të Monitorimit, pranë Ministrisë së Brendshme;

Të nderuar drejtues të organeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe të degëve territoriale në qarkun e Gjirokastrës;

Të nderuar antarë të Task Forcës Vendore të Luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të Kanabisit,

Të nderuar pjesëmarrës!

Në zbatim të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e qarkut”, ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM nr. 248, datë 29.03.2017 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit 2017-2020”, Urdhërit nr. 51, datë 13.04.2017 të Kryeministrit “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave drejtuese dhe koordinuese ndërinstucionale në nivel qendror” si dhe plan - kalendarit vjetor të Institucionit të Prefektit të Qarkut dhe të Drejtorisë së Përgjithëshme të Policisë së Shtetit, po zhvillohet ky takim në nivel qarku, duke marrë në analizë punën e bërë nga të gjithë institucionet ligjzbatuese dhe ato vendore si dhe për sensibilizimin e komunitetit për parandalimin e kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike për vitin 2019.

Për vitin 2018, sipas të dhënave zyrtare të Policisë së Shtetit, të trajtuar edhe në takimin e zhvilluar nga Ministri i Brendshëm z.Sandër Lleshaj niveli i kultivimit të kanabisit në Shqipëri është në minimumin historik. Ky sukses konfirmohet plotësisht edhe nga bregu përballë, Italia fqinje ku sipas Gurdia di Finanza në vitin 2018, sasia e kanabisit të kapur në Itali me origjinë nga Shqipëria është 81% më e ulët se në vitin 2017”.

Prapa këtij rezultati shumë inkurajues është puna dhe përkushtimi i gjithë strukturave të Policisë së Shtetit, organeve të pushtetit qendror dhe vendor.

Me këtë rast do të doja të falenderoja të gjitha strukturat shtetërore dhe ato vendore, të cila kanë ndërvepruar në kuadër të Task Forcës vendore, duke kontribuar që në procesin e hartimit të Planit të Veprimit kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit ashtu dhe në fazën e zbatimit të tij.

Suksesi i arritur në fund të vitit 2018, na krijon besim dhe shpresë se, përmes bashkimit të gjerë të energjive tona ne mund të arrijmë të fitojmë luftën edhe këtë vit, si një vit shumë i rëndësishëm, ku pritët hapja e negociatave me bashkimin European dhe ky është një nga kushtet kryesore që duhet përmbushur.

Pavarësisht rezultateve pozitive të arritura gjatë vitit 2018, grupet kriminale këtë vit do të mundohen të përdorin forma të tjera më të sofistikuara dhe veçanërisht ata mund të

shfrytëzojnë ambjentet e mbyllura. Prandaj del detyrë kryesore e të gjithë aktorëve që janë pjesë e Task Forcës Vendore të ushtrojnë kompetencat e tyre ligjore për mbajtjen nën kontroll të territorit që kanë në administrim, duke planifikuar kontrole të përbashkëta me policinë e shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, Seksionit të Policisë Ushtarake pranë Detashmentit të Mbështetjes Rajonale sidomos ndaj objekteve të mbyllura me rrisht të lartë në këtë fazë për kultivimin e kanabisit, siç janë: depo, tunele kapanone të mëdha, shtëpi të braktisura apo të mbyllura, stane që dyshohen se mund të kthehen në sera të mbyllura, etj.

Në cilësinë e kryetarit të Task Forcës Vendore kërkoj nga ana e drejtuesve të njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe degëve territoriale që zotërojnë kullota livadhe dhe pyje, dhe që lidhin kontrata për dhënie qera apo përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik, të specifikojnë detyrimisht përgjegjësitë ligjore që kanë qiramarrësit për mos kultivimin në ato territore të bimëve narkotike si dhe parandalimin e zjarreve dhe marrjen e masave për shuarjen e tyre. Po kështu të shihet mundësia për lidhjen e këtyre kontratave me afat më të gjatë pasi kjo do të rrisë sigurinë e qiramarrësit për zhvillimin e biznesit të tij por njëkohësisht do të bëjë të mundur edhe rritjen e shkallës së identifikimit të personave që merren me këtë aktivitet.

Dua të rikojtoj se pjesëmarrja e drejtuesve të bashkive në Task Forcën Vendore, rregullohet me Marrëveshje të përbashkët ndërmjet Prefektit të qarkut dhe kryetarëve të bashkive përkatëse. Për këtë janë bërë marrëveshjet e bashkëpunimit midis prefektit të qarkut dhe kryetarëve të bashkive, ku kryetari i bashkisë, në nenin 2 është përfaqësues në Task Forcën Vendore (firmosur nga prefekti i qarkut dhe kryetari i bashkisë, datë 31.05.2017).

Nisur nga detyrimet ligjore, Task Forca Vendore pranë Prefektit të qarkut ka hartuar **Plan - Veprimin Vendor** për parandalimin dhe luftën kundër kultivimit të bimëve narkotike .

Të gjitha institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore që marrin pjesë në TFV duhet të raportojnë pranë institucionit të prefektit të qarkut çdo ditë të premtë mbi veprimtarin e punës së tyre lidhur me zbatimin e detyrave të caktuara në këtë plan- veprimi. Ky informacion do t'i përcillet Sekretariatit teknik pranë Task Forcë Qëndrore TFQ në Ministrinë e Brendshme.

Lufta kundër kultivimit të bimëve narkotike nuk është një punë që i takon vetëm policisë. Në një shoqëri demokratike, policia nuk mund t'ja dalë e vetme pa mbështetjen dhe bashkëpunimin e komunitetit, institucioneve shtetërore ligjzbatuese, organeve të Vetëqeverisjes Vendore, institucioneve arsimore, mediat lokale dhe qëndrore, por në këtë luftë duhet të përfshihen edhe persona me reputacion publik nga fusha e shkencës, artit, kulturës dhe sportit.

Bazuar në Planin Kombëtar të Luftës Kundër Kultivimit të Kanabisit 2018-2020, objektivat për vitin 2019 janë:

- Rritja e bashkëpunimit me organet e pushtetit vendor, Drejtoritë Rajonale të Arsimit, Bujqësisë, Shëndetit Publik, OJF-të, për organizimin e një fushate efektive sensibilizuese, për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike.
- Forcimi i kontrollit të territorit, jo vetëm nëpërmjet shkeljes fizike, por kryesisht nëpërmjet marrjes së informacione policore me vlerë, vlerësimit e ndjekjes së tyre me përgjegjësi e profesionalizëm.
- Rritja e numrit të procedimeve penale proaktive ndaj autorëve të kultivimit të bimëve narkotike e kryesisht ndaj grupeve kriminale e financuesve të këtij fenomeni.

Prioriteti i Qeverisë Shqiptare dhe premtimi i Kryeministrit z.Rama për vitin 2019 është **kultivimi zero** i bimëve narkotike në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Në cilësinë e Prefektit të qarkut, si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel qarku dhe kryetar i kësaj Task Force Vendore, më lejoni të ofroj gjithë mbështetjen time personale, por edhe të institucionit që unë drejtoj për realizimin në afate dhe me sukses të Plan – Veprimit në rang qarku në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike.

03.04.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Takimin e Komitetit Rajonal të Luftës kundër Trafikimit të Personave.

Të nderuar anëtarë të Komitetit Rajonal Antitrafik,

Të nderuar të ftuar,

Organizojme këtë takim të radhës të Komitetit Rajonal Antitrafik të Qarkut Gjirokastrë për të analizuar punën e bërë nga ana e institucioneve ligjëzbatuese kundër fenomenit të trafikimit të qënieve njerëzore, miratimin dhe disa ndryshime Rregulloren për “Funksionimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave “ si dhe me njohjen e “Planit të Veprimit Vjetor “ të këtij Komiteti.

Bazuar në Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore, dhe Planit të Veprimit miratuar me VKM-në Nr. 814, datë 26.11.2014, në mbështetje të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 6, datë 26.01.2017 “Për Krijimin e Komiteteve Rajonale të Luftës Kundër Trafikimit të Personave në çdo qark”, pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë në mbështetje të ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut, me urdhërin e Prefektit nr. 10, datë 20.02.2019 pranë këtij institucioni është ngritur Komiteti Rajonal i Luftës Kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore për Qarkun e Gjirokastrës pjesë e të cilit jeni edhe ju.

Më vjen mirë të konfirmoj se nëpërmjet informacioneve zyrtare të ardhura nga institucionet ligjëzbatuese tregojnë nivelin në minimum të trafikimit të qënieve njerëzore për qarkun tonë, megjithatë duhet të vazhdojmë punën duke qënë në gadishmëri maksimale për sa i përket parandalimit të trafikimit të qënieve njerëzore por edhe dhënies ndihmë nëse do të kemi raste.

Më lejoni të shpreh vlerësimin mbi angazhimin tuaj personal dhe të institucioneve që drejtoni në luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore i pasqyruar në punën serioze dhe me kompetencë nga ana e Komitetit Rajonal Antitrafik të Qarkut tonë, të treguar përgjatë gjithë periudhës duke filluar nga momenti i ringritjes së këtij komiteti e deri më tani.

Trafikimi i personave sot është një sfidë reale ndaj sistemit tonë të vlerave shoqërore e njerëzore si dhe ndaj sistemit të së drejtës dhe respektimit të ligjit, si shkelje e hapur ndaj të drejtave themelore të njeriut, lirisë dhe dinjitetit njerëzor.

Për këtë kërkohet angazhimi individual i gjithë aktorëve në këtë fushë madje dhe i vetë viktimave, për ta kthyer luftën kundër fenomenit në një kauzë kombatare në mbrojtje të më të dobtëve dhe të atyre që duan që zeri i tyre të dëgjohet.

Në radhë të parë si qytetarë të këtij vendi, por edhe si përfaqësues të institucioneve që drejtojmë të gjithë së bashku kemi mbi të gjitha përgjegjësi qytetare për t’u angazhuar në identifikimin e

trafikimit dhe në përfshirjen e komunitetit për tu bërë pjesë aktive e veprimit kundër trafikimit të personave në Qarkun tonë por dhe më gjërë.

Sigurisht që parandalimit i trafikimit dhe lufta ndaj tij në radhë të parë është sfidë e organeve ligjzbatuese por asnjë strukturë ose institucion nuk do kishte sukses në këtë “betejë” pa mbështetjen dhe përfshirjen e gjithë shoqërisë. Një përfshirje nëpërmjet informimit për të gjitha rastet e trafikimit apo trafikimit të mundshëm që mund të konstatohen nga qytetaret në bashkëpunim për të krijuar më shumë mundësi për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave.

Përtej ndaj gjithë asaj ç’ka kemi arritur deri tani në duhet të jemi të ndërgjegjshëm se çështja e luftës kundër trafikimit të personave është shumë komplekse dhe kërkon një ndërgjegjësim të përgjithshëm shoqëror.

Vetëm nëse kthejmë vështrimin tonë drejt viktimave të këtij krimi qofshin ata fëmijë që detyrohen të punojnë në kushte të papërshtatshme për moshën dhe zhvillimin e tyre , vajza të reja të cilat bien pre e mashtrimit dhe abezimit apo gra të privuara nga e drejta për të zgjedhur vetë jetën që duan të jetojnë ne do mund ti kthejmë shoqërisë vlerat dhe dinjitetin njerëzor të duhur. Janë vetë viktimat dhe historitë e tyre ato që duhet të orientojnë hapat që ne duhet të marrim për të vënë para përgjegjësisë trafikantët dhe përfituesit nga kjo industri e fuqishme ilegale si dhe për të vendosur në vend dinjitetin e viktimave të këtij krimi çnjerëzor.

Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe Plani i Veprimit janë udhërrëfyesit për veprimin antitrafik në vazhdimësi në përballjen me këtë krim duke ofruar një qasje gjithëpërfshirëse shumëplanëshe për trajtimin e duhur dhe dinjitoz të viktimave të këtij krimi.

Kthimi nga jashtë shtetit dhe ndihma për riintegrimin të shtetasve shqiptarë të identifikuar apo të paidentifikuar si viktimat të trafikut përbën një çështje që mbetet për tu adresuar, së pari si një sfidë humanitare për tu mundësuar viktimave për të rindërtuar jetën e tyre dhe të integrohen në shoqëri, por edhe për të parandaluar trafikimin apo që personat e trafikuar të kthehen në trafikantë, dukuri kjo e cila mbetet aktuale.

Faktorët social-ekonomikë mund të jenë thelbësore në rritjen e mundësisë për tu trafikuar, por ka dhe faktorë ndërmjetës, si psh. mungesa e ndërgjegjësimit që çojnë drejt trafikimit. Trafikimi i fëmijeve mbetet një problem shqetësues. Fëmijet trafikohen për mori qëllimesh, përfshirë ato për shfrytëzim seksual, shfrytëzim duke nxjerrë në rrugë për të lypur dhe forma të tjera të punës së detyruar si brenda ashtu dhe jashtë vendit.

Pranohet fakti që pjesëmarrja e shoqërisë civile është e domosdoshme për arritjen e synimeve në luftën kundër trafikimit. Të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë duhet të marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e veprimtarisë antitrafik dhe në monitorimin e saj. Organizatat e shoqërisë civile dhe në veçanti OJF-të luajnë një rol kyç në luftën kundër trafikimit dhe si të tilla janë përfshirë aktivisht në vendimarrje. Me këtë rast dua të falenderoj edhe këta “Heronj të heshtur”, që edhe pse nuk paguhen nga shteti, kanë dhënë kontribute të mëdha në luftën kundër këtij fenomeni. Kanë gjetur me dhjetra fëmijë që janë shfrytëzuar nga “padronët me kollare” dhe kanë shpëtuar me dhjetrajetë.

Dhuna në familje shihet si një dukuri e lidhur ngushtë me trafikimin. Ajo konsiderohet si një faktor që jo vetëm i paraprin, por edhe e shoqëron fenomenin e trafikimit. Këtë e dëshmon fakti që femrat janë më të prekura nga kjo dukuri. Për këtë nevojitet nga strukturat përkatëse identifikimi sidomos i familjeve me problematika të tilla dike u ardhur në ndihmë për tejkalimin e tyre.

Fenomeni i trafikimit të personave është një krim i rëndë, shkelje e të drejtave të njeriut me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën ekonomike, sociale.

Fenomeni nuk duhet të trajtohet vetëm si problem i Policisë, Prokurorisë, Gjykatës, por ky është një problem i gjithë shoqërisë, komunitetit, i institucioneve shtetërore dhe pushtetit vendor si dhe OJF-ve të ndryshme. Ky preokupim është manifestuar në vazhdimësi në institucionet dhe në punën e tyre në qarkun tonë.

Në shoqëritë e zhvilluara demokratike ku ne synojmë të arrijmë, fenomenet negative edhe trafikimi i qënieve njerëzore nuk mbulohen as minimizohen përkundrazi bëhen pjesë e zgjidhjes përmes programimit dhe angazhimit të të gjithë faktorëve.

Në këtë filozofi Komiteti Rajonal Antitrafik i Qarkut Gjirokastrë mbështetur në strategjinë dhe në Planin Kombëtar të Qeverisë kundër Trafikimit të Qënieve Njerëzore ka qenë sensibilizues dhe dobiprurës në veprimtarinë e tij.

Në Qarkun e Gjirokastrës në zbatim të strategjisë dhe planit kombëtar kundër trafikimit të qënieve njerëzore, Komiteti Rajonal Antitrafik është ngritur dhe funksionon prej vitit 2006. Vitet e fundit ky fenomen ka ardhur duke u reduktuar në menyrë të ndjeshme.

Me gjithë rezultatet e arritura, Qarku jonë është në pozicion të ekspozuar ndaj këtij fenomeni si pikë nyje, pranë zonës kufitare. Duke qenë të vetëdijshëm për riskun, Komiteti Rajonal Anti-Trafik në planin e veprimit të tij ka mbajtur parasysh disa drejtime kryesore:

1. **Punën për parandalimin e fenomenit.** Siç thamë dhe më lart për shkak të qarkullimit të lirë, zonës kufitare etj. në fushatën sensibilizuese ka patur në fokus Fëmijët, Vajzat dhe Fëmijët në nevojë.
2. **Mbrojtja.** Rëndësi e veçante i është kushtuar sistemimit dhe mbrojtjes së fëmijëve nëpër shkolla. Për këtë rol kryesor kanë patur psikologët dhe sidomos bashkëpunimi i tyre me gjithë strukturat e tjera të arsimit. Efektive ka qenë puna e njësisë mbrojtëse të fëmijëve në bashkitë e Qarkut tonë, të cilat kanë shërbyer si bërthama të identifikimit. Njësitë e Qeverisjes Vendore kanë grupet kërkimore në komunitet, lagje, fshatra. Këto njësi të mbrojtjes së fëmijëve kanë bërë punë të mirë në drejtim të rregjistrimit të fëmijëve në shkolla, përfshirjes së familjeve në nevojë në skemën e ndihmës ekonomike, këshillime dhe shërbime të tjera sipas nevojës.
3. **Kordinimi i planit të veprimit nga Komiteti Rajonal Antitrafik,** i cili ka patur në fokus adresimin e problemeve. Ky fenomen ka qenë në vëmendje të të gjitha strukturave të KRAT-i, Tryezes Teknike, Policisë Vendore, Drejtorisë Rajonale Arsimore, Institucioneve të Pushtetit Vendor, OJV-ve, etj.

Prefekti i Qarkut Gjirokastrë është i gatshëm që ashtu si deri tani të vijojë të jetë promotor i një bashkëpunimi ndërinstitucional, dhe ndërqytetar, të promovojë e të mbështesë nisma si dhe të ndikojë fuqishëm me strukturat e qarkut në fushata sensibilizuese në parandalimin dhe luftën pa kompromis ndaj këtij fenomeni.

- Mendime, pyetje dhe diskutime;
- Njohje me disa ndryshime në Rregulloren e KRAT-it;
- Plan Veprimi Vjetor i KRAT-it.

09.04.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Takimin me Drejtuesit e Degëve Territoriale dhe Institucioneve Shtetërore Vendore të qarkut Gjirokastrë

Të nderuar drejtues,

E zhvillojmë këtë takim në zbatim të detyrave që zv. Kryeministri z. Erjon Braçe ka lënë në mbledhjen me prefektët e qarqeve.

Kjo mbledhje ishte e veçantë pasi në muajin mars zv. Kryeministri ka ushtruar kontrolle të drejtpërdrejta në drejtoritë rajonale në shumë qarqe të vendit. Si rezultat i këtyre kontrolleve janë konstatuar shumë mangësi si :

Mos paraqitja në kohë në orarin e caktuar në punë

Largime nga vendi i punës pa përcaktuar arsyen e largimit.

Ambiente jo të pastra të vendeve të punës

Sjella e nëpunësve të administratës, sidomos e atyre që kanë lidhje me shërbimet lë për të dëshiruar (ZVRPP, Aluizmi, etj)

Veshja zyrtare jashtë normave të përcaktuara në rregulloren e institucionit.

Mungesa e planeve vjetore, mujore, objektivave dhe planet e masave nga institucionet etj.

Nisur nga këto problematika të konstatuara, zv. Kryeministri ka marrë një sërë masash administrative duke pezulluar nga puna shumë drejtues institucionesh dhe nënpunës ku kanë qenë me sjellje të theksuara në zbatim të detyrës. Gjithashtu, çdo ditë të mërkurë, ministrja e drejtësisë, në bazë të raportit të kontrollit të task-forcës evidenton masat e marra ndaj punonjësve të administratës.

Dua të theksoj se, për periudhën e deritanishme marrëdhëniet e institucionit të Prefektit me degët territoriale dhe institucionet shtetërore vendore, nuk kanë qenë në nivelin e duhur. Kjo është vënë re veçanërisht në disa takime të zhvilluara nga institucioni ynë, ku drejtues kryesorë të disa institucioneve nuk kanë marrë pjesë.

Po kështu edhe korrespondenca mes institucioneve tona lë për të dëshiruar sidomos në drejtim të raportimit periodik të veprimtarisë i cili është detyrim ligjor në zbatim të ligjit “Për Prefektin e qarkut”.

Duke marrë shkas nga këto zhvillime dhe për të luftuar raste të ngjashme që bien ndesh me ligjin e nëpunësit civil, kërkoj nga ana juaj që si drejtues të degëve territorial dhe institucioneve shtetërore vendore në qark të vlerësoni dhe të respektoni besimin e dhënë nga cdo ministri e linjës për të përmbushur me nder detyrat që ju janë besuar. Është më e ndershme të bësh tërheqjen nëse e shikon se nuk ke forca të përballosh cdo situatë apo sfidë që mund të përballesh, se sa të të shkarkojnë me motivacione të ndryshme.

Theksoj dhe vlerësoj se secili nga ju ka kontribute personale dhe familjare për detyrat që ju janë besuar por kursesi nuk duhet të mendoni se jeni të pa zëvendësueshëm.

Kryeministri Rama dhe qeveria që ai drejton, ndodhet përballë sfidave të mëdha për vendin në hapjen e negociatave për integrimin në Bashkimin Europian. Gjithashtu, opozita është

hedhur në një ofensivë të shfrenuar kundër qeverisë dhe në këtë situatë të gjitha degët territoriale duhet të jenë në lartësinë e duhur në zbatim të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave.

Në këtë kontekst, duhet të shfaqet integriteti juaj personal, të spikasi formimi juaj i përgjithshëm si një lidhësi, të dini të menaxhoni situatën të ndryshme në realizimin me sukses të misionit që ka institucioni që ju drejtoni; të keni aftësi për të ndryshuar gjendjen, të orientoni drejt punës në grup, të aplikoni metoda standarte, të planifikoni veprimtaritë duke i mbështetur me masa konkrete.

Kjo mënyrë pune shmanget të papriturat dhe garanton suksesin tuaj.

Një pikë tjetër e fortë është që të jeni sa më pranë qytetarit, të mos lodheni duke ju shpjeguar por të tregoni rrugën drejt zgjidhjes së problemit. Kjo, do ta bëjë administratën tonë të dobishme ndaj qytetarit. Ne paguhemi nga taksat e qytetarëve dhe për rrjedhojë duhet t'ja kthejmë shërbimin sa më parë atyre dhe në mënyrë sa më të kulturuar.

Bashkëpunimi me degët territoriale dhe institucioneve të tjera shtetërore në nivel vendor, ka qenë dhe do të jetë një nga drejtimet e punës time si Prefekt.

Në kuptimin e ligjit të Prefektit të qarkut degët territoriale dhe institucionet e tjera shtetërore në nivel vendor, janë struktura administrative të një ministrie ose të një institucioni të varësisë që krijohen për të ushtruar në territorin e një ose më shumë njësive të vetëqeverisjes vendore, detyra administrative që mund të kryhen më mirë në një territor, në përputhje me parimet e ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Këtë detyrë jam munduar ta realizoj në sajë të bashkëpunimit, koordinimit dhe monitorimit të veprimtarisë së institucioneve që lidhen me zbatimin e politikave të qeverisë në qarkun Gjirokastrë.

Krijimi i marrëdhënies të qëndrueshme me ju nuk ka qenë i thjeshtë jo vetëm për shkak të shtrirjes së madhe në territor por edhe për shkak të natyrave të ndryshme të punës që kryeni.

Si institucion i prefektit të qarkut kemi rritur ndjeshëm veprimtarinë në mbështetje të politikave sektoriale në zbatim të politikave të qeverisë. Në këtë mënyrë institucioni ynë është drejtuesi i disa task-forcave ku dhe ju jeni pjesë integrale.

Të gjitha këto, nga njëra ana i kanë shërbyer me mirë njohjes së realitetit në rang qarku dhe nga ana tjetër kemi ndikuar në dhënien e një efekti pozitiv në zhvillimin rajonal.

Në mbyllje të fjalës sime, në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “*Per Prefektin e qarkut*” neni 8, 10, 12 dhe 15 etj si dhe detyrave të caktuara nga zv. Kryeministri kërkoj nga ana e drejtuesve të degëve territoriale dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor, të zbatohen detyrat si më poshtë:

- Vlerësimi me seriozitet për zgjidhje i çdo shkrese zyrtare që adresohet nga institucioni i Prefektit të Qarkut në lidhje me problematikat dhe ankesat e qytetarëve si dhe informimi i këtij institucioni brenda afateve kohore mbi zgjidhjen e çdo problemi bazuar në VKM-në nr. 867, datë 10.12.2014 “Për bashkëpunimin me institucionet shtetërore”

- Dërgimi i planit vjetor për veprimtarinë dhe plotësimin e detyrave të institucionit tuaj për vitin 2019.

- Dërgimi i informacioneve periodike çdo muaj mbi realizimin e detyrave sipas planit vjetor pasi nga ana jonë për veprimtarinë e institucioneve që ju drejtoni informohen Ministria e Brendshme, ministritë e linjës dhe kabineti i Kryeministrit.

- Çdo drejtori rajonale të parashikojë hapjen e sporteveve shtesë për tu ardhur në ndihmë shtetasve shqiptarë që kthehen për pushime gjatë sezonit turistik veror.

- Të përgatiten plane të detajuara pune nga cdo degë territoriale dhe me afate konkrete pasi jemi në prag të fillimit të sezonit turistik.

- Inspektoriatet në ushtrimin e veprimtarisë së tyre për kontrollet e planifikuara në terren duhet të shoqërohen me urdhra pune.

- Bashkërendimi i punës midis institucioneve në përbërje të task forcave rajonale dhe informimi vazhdimisht i institucionit të Prefekti.

Jam i bindur se nëse nga të gjithë ne do të ekzistojë vullneti i mirë për të realizuar me rigorozitet dhe përpikmëri të gjitha detyrat që na ngarkon ligji besoj se do të marrim rezultatet e dëshiruara në punën tonë institucionale.

10.04.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për 25-vjetorin e Masakrës së Peshkëpisë.

Të nderuar familjarë të dëshmorëve,

I nderuar kryetar i Shoqatës së Veteranëve,

Të nderuar pjesëmarrës,

Sot përkujtojmë me nderim dhe respekt të thellë dy ushtarakët e postës kufitare të fshatit Peshkëpi, të cilët 25 vite më parë u vranë në krye të detyrës nga një sulm i papritur i një organizate greke.

Më 10 prill 1994, një komando e përbërë nga 7 persona, të veshur me uniformë të ushtrisë greke, sulmuan postën kufitare të Peshkëpisë duke vrarë ushtarin roje Arsen Gjini – 20 vjeç, dhe kapitenin e parë Fatmir Shehu – 34 vjeç, duke hapur zjarr mbi rekrutët që po flinin e duke plagosur prej tyre Eduart Vermishin, Frederik Kalemin dhe Janaq Xegën.

Masakra e Peshkëpisë është nga ato ngjarjet e rënda që nuk është hetuar anjëherë plotësisht. Autorët, pjesëmarrësit dhe mbështetësit e saj ende dhe sot jetojnë të lirë dhe të pashqetësuar. Zbardhja e kësaj ngjarjeje është detyrim në emër të drejtësisë për kapitenin e ndjerë Fatmir Shehu dhe ushtarin Arsen Gjini, është detyrim që historia mos të përsëritet, por të sjellë në fund të vërtetat.

Rihapja e dosjes së kësaj masakre vetëm pak muaj më parë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, Tiranë, pas 25 vitesh zgjon tek ne shpresën për vendosjen para drejtësisë autorëve të ngjarjes.

Jam sot këtu për të shprehur indinjatën e thellë për këtë ngjarje dhe për të siguruar familjarët, ushtarakët, repartet e sigurisë, forcat policore dhe për të mbështetur punën e tyre për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike.

Pavarësisht kësaj ngjarjeje marrëdhëniet midis dy shteteve tona kanë rritur frymën e bashkëpunimit në kuadër të fqinjësisë, të aleancës NATO, të Bashkimit Europian, duke respektuar të drejtat tona ndërkombëtare.

Le të jenë këta dëshmorë si dhe gjithë dëshmorët e tjerë të rënë në krye të detyrës shembull për rininë dhe vendin, të shërbejë si burim frymëzimi për të mbrojtur idealet e atdheut tonë.

Nderimi dhe respekti për dëshmorët është dhe do të jetë obligimi i krenarisë sonë kombëtare sepse dhanë jetën për lirinë e këtij vendi.

Lavdi dëshmorëve të Atdheut!

17.04.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin për stërvitjen me temë “Veprimtaria e dy stacioneve zjarrfikëse kufitare për shuarjen e një zjarri masiv në afërsi të qendrave të banuara në kufirin midis dy bashkive në rajonin Dervician-Lazarat”.

Të nderuar pjesëmarrës,

Zjarret në qarkun e Gjirokastrës gjatë viteve të fundit kanë qenë të pranishme dhe kanë shkaktur jo në pak raste dëme serioze, fatmirësisht jo në njerëz, por me kosto të konsiderueshme financiare dhe ekologjike. Në bazë të përvojave të deritanishme, si shkak për shfaqjen e zjarreve paraqitet njeriu. Pakujdesia, padituria, piromania si sëmundje apo si qëllim i pastër, ka sjellë dëme me kosto të lartë ekologjike dhe jo vetëm, sidomos në pranverën e hershme. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë blektorët, mbledhësit e bimëve medicinale, fermerët apo gjahtarët.

Stina pranverë-verë përbën periudhën më kritike të vitit për shfaqjen e zjarreve në hapësirë të hapur, e si e tillë marrja e masave edukative, informuese-propaganduese e alternuar me masa direkte nga organet përgjegjëse është e domosdoshme. Sensibilizimi i qytetarëve nëpërmjet leksioneve të hapura, fletëpalosjeve e mjeteve të tjera alternative mbi rrezikshmërinë e zjarrit dhe hapat që duhet të ndërmeren, është faza e parë dhe më kryesorja për të shpëtuar jetë njerëzish dhe për të ulur numrin e rasteve të zjarrvënies.

Koordinimi i veprimeve në kohë reale nga Drejtoritë për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi me agjencitë e shërbimeve të bashkive respektive, me strukturat e Policisë së Shtetit, me Forcat e Armatosura, me Shërbimin e Urgjencës Mjekësore dhe institucione të tjera qendrore është thelbësor.

Bashkëpunimi i sotëm midis Drejtorisë së MZSH-së Gjirokastrë dhe sektorit të MZSH-së Dropull, strukturave të Policisë Vendore dhe Bashkiake, spitalit rajonal, punonjësve të pyjeve dhe kullotave, për përballimin e situatave të ndryshme emergjente si dhe zjarreve masive në pyje dhe kullota gjatë stinës së verës, në formën e një stërvitjeje komplekse, tregon edhe një herë qartazi rëndësinë dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërinstytucional.

Situatat e paraqitura në këtë stimulim janë modeli më i mirë i koordinimit të veprimtarive ndërmjet institucioneve kompetente në raste reale. Angazhimi i të gjitha strukturave shtetërore dhe vendore, është e sigurt se do të sjellë përballimin me sukses edhe të situatave më të vështira për t'u menaxhuar.

Si kryetar i Shtabit të Emergjencave Civile të qarkut Gjirokastrë, kërkoj angazhim të plotë nga të gjithë aktorët dhe faktorët përgjegjës për përballimin me sukses të çdo rasti emergjent në vazhdimësi. Garantimi i jetës së qytetarëve, mbrojtja e gjësë së gjallë, pronës dhe e mjedisit janë detyrat tona, detyra këto të cilat kërkojnë seriozitet, bashkëpunim e përkushtim nga secili prej nesh.

Ju uroj stërvitje të mbarë!

07.05.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Ditën Ndërkombëtare të Infermierisë

Të nderuar pjesëmarrës,

Të nderuar punonjës të kujdesit shëndetësor,

Ju falenderoj në rradhë të parë për ftesën dhe jam i nderuar që ndodhem sot mes jush në këtë aktivitet në kuadër të 12 Majit, Ditës Ndërkombëtare të Infermierisë. Kjo ditë e veçantë përkon me ditëlindjen e Florenca Najtingeilit, e cila njihet edhe si themeluesja e infermierisë në botë. Figura e Najtingeilit është një forcë udhëheqëse në fushën e infermierisë, ku arritja e saj më e madhe ishte pikërisht transformimi i Infermieristikës në një profesion të respektueshëm për gratë.

Dita Ndërkombëtare e Infermierisë, kremtohet çdo vit në shenjë respekti për kontributin dhe punën e madhe që bëjnë profesionistët dhe stafi i infermierëve në të gjithë vendin dhe padyshim edhe ju si pjesë e Urdhërit të Infermierit të Shqipërisë.

Ndër faktorët e shumtë që kontribuojnë në cilësinë e shërbimeve shëndetësore kanë të bëjnë me kompetencat e personelit ku rol të rëndësishëm luajnë edhe infermierët. Infermiera është një mision, profesion dhe shkencë me ndikim të fuqishëm në shërbimin publik.

Profesioni i infermierit është një profesion që po ndryshon dita ditës duke e zgjeruar dhe pasuruar fushën e vet të njohurive. Prandaj janë të rëndësishme trajnimet dhe edukimi i vazhdueshëm mjekësor pasi janë elementet kyç në përgatitjen tuaj si infermierë, ku duhet të implementohen praktikat bashkëkohore në ofrimin e kujdesit shëndetësor për pacientët.

Roli i infermierisë në qarkun tonë vazhdon të jetë një prej prioriteteve të domosdoshëm, i cili është dëshmuar edhe me investime të vazhdueshme në ngritje profesionale dhe jo vetëm. Kështu, më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj që janë rikonstruuar qendra shëndetësore në disa njësi administrative të qarkut tone duke i kthyer ato në qendra moderne me shërbime bashkëkohore, të lidhura me prioritetin e programit të qeverisë shqiptare për reformimin e sistemit të kujdesit shëndetësor. Rikonstruksionit i janë nënshtruar, qendrat shëndetësore: Petran, Krahës, Lunxhëri, Cepo, ambulancat në lagjet “Dunavat”, “Palorto”, “18 Shtatori” dhe ajo e lagjes “11 Janari”.

Në këtë kuadër, qeveria shqiptare e ka në vëmendje edhe punën tuaj, për të përmirësuar jo vetëm mjedisin dhe kushtet ku ju punoni, por për të krijuar edhe mundësitë për një jetë më të mirë.

Ju jeni kontakti i parë dhe më i shpeshtë me të sëmurët me të cilët krijoni një marrëdhënie njerëzore më të afërt e më modeste ndaj tyre se sa mjekët, duke ofruar siguri dhe mbështetje morale për pacientin.

Duke vlerësuar rolin tuaj, atë të infermierit në këtë ditë të veçantë, dëshiroj t'ju uroj suksese të mëtëjshme për të cilën ju keni fituar respekt në profesionet tuaja të rëndësishme, dhe gjithashtu, uroj që grupi juaj i punonjësve të shëndetit në qarkun tonë të kontribuojë më tej në përmirësimin e cilësisë dhe rritjen e nivelit të kujdesit shëndetësor për shëndetin e bashkëqytetarëve tuaj.

Suksese në punën tuaj humane.

14.05. 2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit në takimin me Komitetin Rajonal të Zhvillimit të Turizmit Qarku Gjirokastrë

Të nderuar anëtarë të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit,

Të nderuar të ftuar,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe vlerësimin tuaj për këtë takim të rëndësishëm.

Ky takim organizohet në zbatim të Udhëzimit nr. 8502, datë 24.10.2016 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit*". Është takim i përbashkët i strukturave të Institucioneve Rajonale dhe të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, që ka për qëllim të trajtojë çështje të përbashkëta që kanë të bëjnë me menaxhimin me sukses të sezonit të ri turistik 2019, që do të sjellë përfitime për ekonominë e qarkut Gjirokastrë. Çështjet që do të diskutohen gjatë këtij takimi janë:

1. Një vështrim i përgjithshëm mbi ecurinë e sezonit turistik të vitit të kaluar dhe çelja e sezonit të ri turistik
2. Probleme të evidentuara gjatë sezonit turistik 2018
3. Rekomandime për zhvillimin e turizmit gjatë sezonit turistik 2019

1.Ecuria e sezonit turistik 2018

Turizmi është tashmë një sektor me ndikim të madh social dhe ekonomik që synon të plotësojë kërkesat e qytetarëve dhe turistëve vendas e të huaj për vizita kulturore, kohën e lirë, shëndetin dhe sportin, akomodimin, ushqimin dhe argëtimin, etj., duke ndryshuar pozitivisht strukturën ekonomike, duke krijuar vende të reja pune me një treg pune të qëndrueshëm dhe konkurrues dhe të ardhura të konsiderueshme, si dhe duke kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik të rang qarku dhe jo vetëm. Qarku i Gjirokastrës është tashmë një destinacion i popullarizuar turistik, por ka ende punë për të bërë, në mënyrë që turizmi të bëhet gjithëpërfshirës dhe gjithëvjeter.

Qarku ynë ka përparësi të shumta për zhvillimin e të gjitha llojeve të turizmit të lidhura me sportet si hiking (ecja në natyrë), rafting (vojitja në ujërat e lumenjve), horse riding (shëtitja me kuaj), etj në sitet natyrore dhe kulturore që përfshihen në qarkun tonë. Disa prej këtyre veprimtarive janë motivi kryesor i vizitave nga vizitorët e huaj në zonat natyrore. Kërkesa për aktivitete në natyrë po rritet shpejt në tregun kombëtar të turizmit.

Njësitë administrative të qarkut Gjirokastrë përbëjnë destinacionet më të rëndësishme të turizmit të aventurës në vend. Disa grupe të rinjsh të apasionuar pas ecjes, alpinizmit dhe kalërimit sportiv organizojnë guida duke përshkruar rrugë dhe shtigje historike në udhëtime një javore që kalojnë nëpër Lunxhëri, Zagori, Libohovë, Pogon, Cepo, etj.

Ky zhvillim i turizmit në qarkun tonë dëshmohej edhe nga suksesi i sezonit turistik të vitit të kaluar, i cilësuar si nga nga sezonet më të sigurt dhe me rritjen më të madhe të numrit të turistëve krahasuar me vitet e shkuara. Viti 2018 pati një ecuri pozitive në turizëm dhe një trend rritës të qëndrueshëm jo vetëm në numër, por çka është më e rëndësishme në netë-qëndrimi dhe të ardhura. Kjo ecuri e vitit 2018 ka reflektuar në kohëzgjatjen e shtrirjes së turizmit gjatë gjithë muajve të vitit, synim ky edhe për sezonet e ardhshme turistike.

Sipas informacioneve të marra nga infopoint-et, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe nga strukturat akomoduese mbi numrin e lëvizjes së turistëve, gjatë sezonit turistik të vitit të kaluar kemi pasur një numër të përgjithshëm rreth 162 995 vizitorë vendas e të huaj.

- Bashkia Gjirokastrë: 114 278 vizitorë
- Bashkia Përmet: 26000 vizitorë
- Bashkia Tepelenë: 8000 vizitorë
- Bashkia Libohovë: 9200 vizitorë
- Bashkia Dropull: 3000 vizitorë
- Bashkia Këlcyrë: 1517 vizitorë
- Bashkia Memaliaj: 1000 vizitorë

Gjatë sezonit turistik të vitit të kaluar, zonat më të frekuentuara nga turistët e huaj dhe vendas ishin : Kalaja e Gjirokastrës, Muzeu Etnografik, Shtëpitë Muze, Mali i Çajupit, Bredhi i Sotirës, Tuneli i Luftës së Ftohtë, Parqet arkeologjike Antigonea dhe Adrianopuli, Kisha në Labovën e Kryqit, Gryka e Këlcyrës, Ujrat Termale në lumin Langaricë, Bredhi i Hotovës, Lugina e Lumit Vjosë, e cila është frekuentuar për “Kanotazh” nga turistët e huaj, Kalaja e “Ali Pashës” Tepelenë, Uji i Ftohtë në Tepelenë, Kanionet e Nivicës etj.

Ndër faktorët që sezoni turistik 2018 konsiderohet si një nga sezonet e suksesshme në krahasim me vitet e kaluara, janë rritja e numrit të vizitorëve, kapaciteteve akomoduese, si dhe të kushteve më të përmirësuara dhe shërbime cilësore më të mira. Kjo falë punës së bërë të të gjithë aktorëve të përfshirë në fushën e turizmit, si operatorët turistik, bizneset e hotelerive, strukturave akomoduese, njësitë e vetëqeverisjes vendore, etj.

Nga ana e bashkisë Gjirokastrë është hartuar Kalendarit Vjetor të Eventeve dhe janë ngritur grupet e punës për menaxhimin e mbetjet, masa për mbrojtjen nga zjarri, liçensimin e bizneseve në zonën e mbrojtur nga UNESCO, ndriçimin urban, riorganizimin e zyrës së informacionit turistik, rikonstrukcion i Muzeut Etnografik dhe riparime në muzeumet e tjera.

Nga ana e bashkisë Tepelenë është fokusuar puna në turizmin e aventurës duke u nisur nga terrenin malor që ka kjo zonë dhe konkretisht në zonën Egnatia. Problemi që ka kjo bashki është numri i ulët i kapaciteteve akomoduese dhe mungesë e sinjalistikës orientuese në shumë zona të thella.

Nga bashkia Përmet është punuar me hapjen e galerisë muzeale, publikimit në ëeb dhe rrjete sociale i ofertës turistike dhe eventeve turistike në Përmet, zhvillimi i aktiviteteve dhe festave përgjatë muajve qershor-gusht 2018.

Bashkia Libohovë ka punuar për vendosjen e stendave informuese, shoqëruar me fotografi, tekst të shkurtër përshkrues shqip, anglisht dhe evidentimin e këtyre pikave në hartën e zonës në version të përpunueshëm. Është publikuar guida e re turistike për Bashkinë Libohovë në versionin Shqip, anglisht ku përfshihen të gjitha atraksionet turistike të zones në shërbim të plotë të turistëve vendas dhe të huaj.

Në bashkitë e Memaliaj, Këlcyrë dhe Dropull është punuar për përmirësimin e sektorit të turizmit duke krijuar kushte të favorshme për tërheqjen e sa më shumë turistëve vendas dhe të huaj, si dhe është punuar për pastrimin e territoreve përreth monumenteve të kulturës, objekteve të kultit për kthimin e tyre në destinacione të rëndësishme turistike.

Pavarësisht këtyre masave për sezonin turistik 2018, që kanë ndikuar pozitivisht në qarkun Gjirokastrë, për realizimin sa më efektiv për zhvillimin e sektorit të turizmit në vazhdimësi duhet ende një bashkëpunim më i ndërsjellë midis institucionesh vendore dhe degëve territoriale, si dhe shfrytëzimi i vendeve të kulteve fetare, fshatrave turistike, traditat, festat popullore. Promovimi i këtyre aseteve nga ana e bashkive duke i kombinuar me aktivitete artistike, folklorike, panairë të etnokulturës, kulinarisë, i japin një mbështetje në zhvillimin e mëtejshëm të turizmit të qarkut tonë.

1.2 Çelja e sezonit të ri turistik

Vlen të theksohet që promovimi i qarkut Gjirokastrë turistike është një mundësi e artë jo vetëm për të bërë biznesin e hotelierisë, por e kemi shumë të nevojshme të kuptojmë që i gjithë ky biznes i shërben Gjirokastrës për të promovuar vlerat e saj, pasi është një ekonomi e rëndësishme për zhvillimin e qarkut dhe të vendit tonë, është një mundësi për të shtuar biznesin, për të shtuar punësimin. Është një mundësi e artë që ne kemi, për të qenë pjesë e një tregu jo vetëm ballkanik, por edhe europian të promovimit të turizmit, por siç e kemi kuptuar edhe nga ajo që ndodhi në sezonin e kaluar kemi pritur një numër të lartë vizitorësh vendas dhe të huaj.

Në tremujorin e parë të vitit 2019, në qarkun Gjirokastrë vihet re një rritje e dallueshme e numrit të turistëve me rreth 52.57% krahasuar me vitin e kaluar. Rritja e numrit të vizitorëve në krahasim me vitin e kaluar apo rritja mesatare e strukturave akomoduese në qarkun tonë, është edhe një kërkesë më e madhe për të rritur përgjegjësinë ndaj vetes sonë për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve, shërbimeve në kuadër të sektorit të turizmit.

Turizmi në tërësi në qarkun e Gjirokastrës po zhvillohet me ritme të kënaqshme, falë dhe programeve të ndërmarrja nga qeveria shqiptare, por dhe investitorëve privat, për promovimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme turistike sidomos në zonat që kanë karakter rural me bukuri të rrallë.

Në kuadër të zhvillimit të këtyre zonave me potenciale turistike në qarkun Gjirokastrë, institucioni i Prefektit ka hartuar një libër për zhvillimin rural të 13 fshatrave turistik të qarkut Gjirokastrë, të cilat janë përfshirë në Programin e Integruar për Zhvillimin rural “100 Fshatrat”. Ky program i inicuar nga Qeveria Shqiptare ka si qëllim kryesor ruajtjen e trashëgimisë, kulturës dhe zhvillimin e turizmit. Duke u nisur dhe nga titulli i vendosur librit të hartuar nga institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë “Trembëdhjetë petalet e para në buqetën rurale” që nënkupton 13 fshatrat e përfshira në këtë program, nuk do të kufizohet

vetëm në këto fshatra, por edhe në fshatrat pranë tyre me potencial të zhvillimit ekonomik-social, të trashëgimisë kulturore, agroturizmit, turizmit rural dhe mjedisit.

2.Problematikat e evidentuara

Në qarkun e Gjirokastrës me ngritjen e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, lind nevoja të krijohet një dokument studimor ku të përfshihen personalitete historike, arkitektë, arkeolog, specialistë të fushave të ndryshme si të agroturizmit, shkencës, kulturës , artit, të cilët do të japin kontributin e tyre për kthimin e Qarkut Gjirokastrë në një destinacion të rëndësishëm turistik. Krijimi i një mjedisi atraktiv e të rregullt, si për vizitorët, ashtu edhe për investitorët duhet të jetë strategjia e qarkut për zhvillimin e sektorit të turizmit. Prandaj është e rëndësishme një koordinim ndërinstytucional i punës në lidhje me plotësimin e detyrimeve të parashikuara në ligj, si dhe masat që duhet të merren për të pasur një sezon turistik të mirëorganizuar duke marrë shkas edhe nga problematikat e dala gjatë sezonin turistik të vitit të kaluar.

Pavarësisht zhvillimit që ka pasur qarku ynë në sektorin e turizmit, turistët vendas dhe të huaj kanë përcjellë disa problematika të tilla si:

- Mbetjet urbane.
- Furnizimi jo i rregullt me ujë të pijshëm dhe energji elektrike.
- Mungesa e ndriçimit të zona muzeale në qarkun Gjirokastrë.
- Mungesa e infrastrukturës në zonat rurale
- Papastërtia e strukturave akomoduese, restorante dhe bare.
- Vështirësi në orientim për të gjetur pikat e interesit nga turistët, si pasojë e mungesës së sinjalistikës në vende të ekspozuara.
- Mungesa e shërbimeve cilësore të ofruara për vizitorët nga ana e strukturave akomoduese, bizneset e hotelerive.
- Trafiku i makinave që ndodhen në zonat turistike dhe historike, si sheshi i Çerçizit.

3. Rekomandimet

Duke u nisur nga përvojat e mëparshme dhe nga problematikat e hasura gjatë vitit të kaluar, institucioni i Prefektit jep këto rekomandime për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik 2019:

- Marrja e masave për sigurimin e rendit e të sigurisë publike.
- Marrja e masave për plotësimin e rrugëve kombëtare e rurale me sinjalistikën e nevojshme për në zonat turistike.
- Krijimin i një regjistri turizmi, nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore dhe nga institucionet shtetërore në nivel vendor, duke e përditësuar me informacionet e nevojshme turistike, me qëllim shkëmbimin ndërinstytucional të këtij informacioni dhe rritjen e eficiencës në kryerjen e detyrave funksionale.(veçanërisht në Bashkinë Dropull).

- Raportime periodike 1-mujore, 3-mujore, 6-mujore lidhur me numrin e turistëve vendas dhe të huaj që vizitojnë qarkun tonë.
- Ndërmarrja e aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe vendase për produktet e prodhuara në qarkun e Gjirokastrës. Këto investime janë të rëndësishme në ruajtjen e trashëgimisë, kulturës dhe zhvillimin e turizmit në qarkun e Gjirokastrës.
- Marrja e masave që në objektet muzeale të vendosen ciceronë të kualifikuar si historianë dhe njohës të mirë të gjuhëve të huaja si dhe të organizohen guida 1-ditore për vizitorët vendas dhe të huaj.
- Marrja e masave të nevojshme nga njësitë administrative të qarkut Gjirokastrë, për të realizuar ndriçimin e objekteve muzeale, kulturore e historike.
- Marrja e masave për krijimin e mundësive për të investuar në banesat e amortizuara për të krijuar impakt pozitiv tek turistës vendas dhe të huaj (sheshi i Agjencisë).
- Marrja e masave për liçensimin e të gjithë bizneseve të vogla të hotelerisë dhe jo vetëm nëpërmjet strukturave përkatëse të bashkive të qarkut për vitin 2019 e në vazhdim.
- Kryerja e investimeve për të mundësuar hapjen kryesisht të rrugëve që hyjnë në brendësi të zonave turistike si dhe investime në përmirësimin e sinjalistikës orientuese në zonat e mbrojtura, në ato të Bredhit të Hotovës, Sotirës dhe Zhejit.
- Marrja e masave për krijimin e mundësive nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore për rihapjen e muzeve të vjetra, të cilat nuk janë në funksion, me qëllim të shfrytëzimit të tyre në kuadër të zhvillimit të sektorit të turizmit.
- Inspektime për sigurinë ushqimore në hoteleri, restorante dhe ambiente që tregëtojnë produkte të mishit dhe nënproduktet e tij.
- Marrja e masave nga ana e Bashkisë Gjirokastrë dhe e Drejtorisë Vendore të Policisë për ndalimin e kalimit dhe të qëndrimit të makinave në sheshin e Çerçiz Topullit.

Plan –Veprimi për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik 2019

Institucioni i Prefektit, mbi bazën e ecurisë së sezonit turistik 2018 dhe të planeve të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve rajonale, ka hartuar plan veprimin, për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik 2019. Ky plan veprimi do të monitorohet nga grupi i punës, i cili do të ushtrojë funksionet sipas fushave të veprimtarisë dhe sipas problematikave, me qëllim efikasitetin në kryerjen e detyrave të ngarkuara.

Prandaj është e rëndësishme që në kuadrin e arritjes së një standarti cilësor të sektorit të turizmit të realizohet një bashkëpunim dhe koordinim ndër-institucional.

Një rol të veçantë në drejtim të zhvillimit të turizmit në rajonin tonë po luajnë dhe po bëhen pjesë aktive e punës edhe mediat lokale të shkruara dhe elektronike, shtetërore dhe private. Nëpërmjet punës së tyre sistematike dalin në pah problematikat e ndryshme duke bërë vazhdimisht sensibilizime në favor të zgjidhjes së tyre.

17.05.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin me përfaqësues Italian të Organizatës Ndërkombëtare të Asistencës Publike Humanitas.

I nderuar president i Organizatës Ndërkombëtare të Asistencës Publike Humanitas Itali Onlus dhe President i Universitetit Popullor Humanitas të Salernos- Itali ,
(del corpo internazionale di pubblica assistenza humanitas soccorso Italia Onlus e Presidente Rettore Universita' Popolare Universo Humanitas Salerno- Italia)

Dr. Prof. Roberto Schiavone di Favignana

I nderuar Drejtor i Përgjithshëm i Universitetit të Lirë Popullor Humanitas, (Universita' Popolare Universo Humanitas ,

Dr. Prof. Luigi garbo di Montechiaro!

I nderuar Konsulli i Nderit të Italisë në Gjirokastrë,

z. Teodor Bilushi!

Jam shumë i nderuar dhe njëkohësisht i vlerësuar që marrëdhëniet tona shoqërore të kthehen edhe në marrëdhënie institucionale. Ju jeni një personalitet shumë i lartë në fushën umanitare dhe këtë e keni paraqitur në çdo kohë dhe në shumë vende të botës. Humanizmi juaj nuk njihet kufi gjeografik, fetar apo politik. Ju me kontributin tuaj keni treguar se sot në këtë botë që ka shumë urrejtje dhe ndasi duhet të prevaloj dashuria midis njerëzve dhe popujve duke vënë në themel umanizmin njerëzor. Ju keni dhuruar mjete shëndetësore dhe autoambulanca në shumë vende që kanë patur nevojë si në disa shtete të Afrikës në Siri ku keni kontribuar në shpëtimin e shumë jetëve njerëzore. Edhe pse kanë kaluar mbi 8 vite që jemi larg me njeri tjetrin, mbas kërkesës time për të na ndihmuar me një autoambulancë për një qytet që ka mbi 20.000 banorë, ju treguat gatishmërinë tuaj dhe nuk e dërguat me të tjerë, por bëtë një rrugë të gjatë me tokë e det dhe erdhët vetë nga Salerno në Gjirokastrë ku po sot do të shkojmë t'ja dhurojmë qendrës shëndetësore të qytetit të Këlcyrës. Kjo tregoi shpirtin tuaj human por edhe respektin për vendin tim.

Në emër tim personal, të institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë dhe të të gjithë banorëve të qytetit të Këlcyrës ju shprehim mirënjohjen tonë më të thellë për ju dhe gjithë ata burra dhe gra të institucionit tuaj umanitar që kontribuoni ditë e natë për shpëtimin e jetëve njerëzore. Ju urojmë çdo të mirë për ju dhe familjen tuaj.

Tanimë nuk keni vetëm një mik në Shqipëri, por do të keni mik një qytet të tërë.

21.05.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për aktivitetin “Stolitë tona” në Parkun Arkeologjik të Antigonesë

I nderuar kryetar i Këshillit të Qarkut,

Të nderuar organizatorë të këtij aktiviteti,

Të nderuar pjesëmarrës,

Së pari, jam falënderues për ftesën që më është bërë për të qenë i pranishëm këtu mes jush, në një prej aktiviteteve kulturore më promovuese siç është “Stolitë tona”. Përgëzoj Kryetarin e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë për organizimin dhe kthimin e këtij aktiviteti në një traditë të përvitshme me qëllim promovimin e vlerave të trashëgimisë kulturore në qarkun tonë.

Parku i Antigonesë është një pasuri arkeologjike e historike e qarkut dhe e vendit tonë. Antigonea, qyteti i ndërtuar nga mbreti Pirro, në nderim të bashkëshortes së tij Antigona, u zhvillua si një qendër e rëndësishme ekonomike, sociale, kulturore dhe politike dhe në fund të shekullit të 3-të dhe në fillim të shekullit të 2-të para Krishtit mori formën e qytet – shtetit dhe u kthye në një nga vendet më të rëndësishme të antikitetit. Nga ekspeditat e ndryshme që janë kryer në parkun e Antigonesë janë gjetur materiale arkeologjike, të cilat dëshmojnë antikitetin e këtij qyteti të lashtë.

Me vlerat historike, arkeologjike dhe trashëgiminë kulturore që mbart Lugina e Drinos, po shndërrohet në një promovuese të turizmit të qëndrueshëm në qarkun tonë. Përgjatë kësaj lugine gjenden gjurmë të 15 qendrave urbane të lashtësisë, të cilat me kalimin e kohës po tërheqin jo vetëm studiuesit dhe arkeologët por edhe turistët.

Site të tilla si Antigonea, Adrianopoli, Melani, Palokastra etj, tashmë janë bërë pjesë e guidave të udhëtimeve të vizitorëve vendas dhe të huaj, duke shërbyer edhe si nxitje për zhvillimin social dhe ekonomik të zonave ku ndodhen. Turistët prej kohësh tashmë e përfshijnë qytetin e lashtë në guidat e gupeve të organizuara turistike. Krahas pasurisë historike dhe arkeologjike që ky park ofron, vizitorët e ndryshëm vendas dhe të huaj, mund të gjejnë në këtë destinacion të turizmit të aventurës një sërë veprimtarish të tjera argëtuese, çlodhëse dhe interesante si hipizmi me kuaj, ecje e gjatë në zonën e qytetit antik.

Në këtë pikë arkeologjike me vlera të mëdha duhen zhvilluar edhe më shumë të tilla aktivitete kulturore. Antigonea është një qytet antik në zbulim e sipër. Në këtë qytet të lashtë “flenë” vlera të jashtëzakonshme historike dhe kulturore. Prandaj si Prefekt i qarkut të Gjirokastrës, kërkoj angazhimin maksimal të të gjitha strukturave për realizimin e sa më shumë aktiviteteve promovuese produktive në dobi të kthimit të vëmendjes në drejtim të këtyre vlerave historike, arkeologjike dhe turistike.

24.05.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për 75-vjetorin e Kongresit të Përmetit

I nderuar Kryetar i Komitetit të Veteranëve të Shqipërisë,

I nderuar Sekretar i Organizatës së Dëshmorëve,

I nderuar Kryetar i Këshillit të Qarkut,

I nderuar Kryetar i Bashkisë së Përmetit,

Të nderuar veteranë,

Së pari ju falënderoj për ftesën që më është bërë për të qenë i pranishëm këtu mes jush, në 75-vjetorin e ceremonisë përkujtimore të Kongresit të Përmetit të vitit 1944. Është e rëndësishme të përkujtojmë këtë Kongres, i cili i dha fund juridikisht monarkisë dhe hodhi themelet për një Shqipëri të Lirë dhe Demokratike!

Kongresi i Përmetit shënoi një nga ngjarjet më me vlera të mëdha të LANÇ-it, dhe përcjell të gjithë shqiptarët patriotë një mesazh të paçmuar e të vlefshëm për çdo kohë, mesazhin se pushteti popullor është i vetmi pushtet i vërtetë në shërbim të atdheut e të popullit.

Mbledhja e Kongresit të Përmetit nuk ishte një veprimtari e rastit, por një domosdoshmëri jetike e historike në kushtet e luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Shteti demokratik shqiptar i ka fillesat pikërisht nga ky kongres!

Data e 24 Majit 1944, pa dyshim që zotëron peshën e saj eventuale në zhvillimet historike të këtij shteti, pavarësisht nga të gjitha ngjyrimet që asaj i janë veshur me kalimin e dekadave. Ky është momenti kyç historik kur u mor vendimi i madh “për ndërtimin e Shqipërisë së re dhe demokratike, sipas vullnetit të popullit”.

Vendimet e miratuara në këtë kongres për kohën e rrethanat kur u morën, për vlerat që patën për LANÇ dhe për vetë fatin e Shqipërisë, hapën një epokë të re në historinë e saj. Këto vendime patën jehonë të jashtëzakonshme brenda e jashtë vendit, por mbi të gjitha, këto vendime rritën entuziazmin në popull, forcuan besimin në fitore dhe krijuan bindjen se vetëm lufta e drejtë e popullit do të siguronte çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Prej 121 të deleguarve të cilët përfaqësonin të gjithë vendin dhe të gjitha shtresat shoqërore, nga Këshilli u zgjodhën 25 anëtarë të cilëve iu ngarkuan detyrat përkatëse.

Disa nga vendimet kryesore që u morën në këtë kongres ishin:

- Kalimi i luftës së popullit shqiptar nga faza e luftës partizane, në një luftë të rregullt e me veprime të mëdha të bashkërenduara dhe krijimi i Shqipërisë së re dhe demokratike.
- Ndalimi i kthimit të Mbretit Zog në Shqipëri dhe mos njohja e asnjë qeveri që mund të formohet brenda apo jashtë vendit kundër vullnetit të popullit.
- Vazhdimi me ashpërsi e luftës kundër pushtuesve gjermanë dhe tradhtarëve shqiptarë, deri në shkatërrimin e tyre të plotë dhe vendosjen e pushtetit demokratik popullor në të gjithë vendin.

Zgjedhja e Përmetit për mbajtjen e këtij Kongresi nuk ishte rastësore. Ky qytet ishte çliruar nga forcat antifashiste nacionalçlirimtare.

Gatishmëria dhe mikpritja përmetare u shfaq edhe këtë radhë me gjithë madhështinë e saj. Përmetarët, megjithëse të djegur disa herë, hapën zemrat e dyert e shtëpive të tyre për delegatët dhe forcat partizane të ardhur nga çdo cep i Shqipërisë.

Në këto ditë, një rol të veçantë për zhvillimin me sukses të punimeve luajti dhe Brigada e VI sulmuese, brigadë e formuar në këtë qytet, e cila zë vend nderi ndër 24 brigadat e LANÇ-it.

Të vlerësosh e të përkujtos ngjarjet madhore siç është dhe Kongresi i Përmetit do të thotë të nderosh e lartësosh Shqipërinë. Kongresi i Përmetit merr një rëndësi të veçantë, si stacioni i parë vendimtar që përcaktoi finalizimin e fitores në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe hodhi themelet për një Shqipëri të Lirë dhe Demokratike! E patjetër, në këtë kuadër 24 Maji duhet zërë vendin e tij të merituar

Lavdi dëshmorëve të Atdheut!

Lavdi emrit dhe veprës së Kongresit të Përmetit!

25.05.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Ditën Naimiane

I nderuar Kryetar i Këshillit të Qarkut, z. Armand Hilaj,

I nderuar Kryetar i Bashkisë Përmet, z. Niko Shupuli,

I nderuar Kryetar i Shoqatës Atdhetare Kulturore “Vëllezërit Frashëri”, z. Tomor Kotorri,

I nderuar Kryetar i bordit drejtues i Shoqatës Atdhetare Kulturore “Vëllezërit Frashëri”, z. Lumo Kolleshi,

Të nderuar autorë, të respektuar akademikë dhe artistë,

Është një kënaqësi e veçantë për mua të ndodhem këtu mes jush, për të çuar para traditën e Ditës Naimiane.

Jam i nderuar që ndodhem sot në Frashër, në vendin e vogël por me vlera të mëdha, në vendin e vëllezërve Frashëri, Laver Bariut, Tefta Tashko Koços, Mentor Xhemalit, Bardhyl Londos e Odhise Paskalit, në hapësirën e tolerancës fetare, në rajonin e mrekullueshëm turistik.

Si çdo vit tashmë, edhe këtë 25 maj, jemi mbledhur për të përkujtuar figurat më të ndritura të kombit tonë, ato të cilat meritojnë të ngrihen në pedestal jo vetëm nga ne, por nga gjithë brezat që do të vijnë. Përkujtojmë 53-vjetorin e vdekjes së Fan.S.Nolit, eruditit të letrave shqipe dhe 173-vjetorin e lindjes së atdhetarit të pashoq, Naim Frashërit.

Është e vështirë të përmbledhësh në pak rreshta veprimtarinë e tyre të gjerë dhe kontributin e paçmuar që ata dhanë për kombin shqiptar. Është e vështirë t’iu veshësh vetëm një epitete këtyre figurave shumëplanëshe e multidimensionale.

Poet i fuqishëm, demokrat revolucionar, mendimtar i shquar, publicist dhe orator, një nga stilistët më të mirë të prozës sonë, Noli mbetet një nga figurat më të njohura të artit dhe të shkencës shqiptare. Brendia e veprave atdhetare të tij, që është në vazhden e atyre të Rilindjes, ushqen ndikimin e thellë përparimtar të kulturës sonë.

Fan Noli ishte një arkitekt i madh i përpunimit të fjalës shqipe dhe inkubator i zhvillimit të mendimit dhe shkrimit publicistik. Me veprën e tij, ai krijoi një godinë solide shumëkatëshe, që gjithmonë do të pëlqehet, krijoi një godinë e cila nga jashtë të mahnit me format që ka në fasadë dhe nga brenda të surprizon me zhanret dhe format entuziaste të të shprehurit. Puna noliane dhe gjurmët e saj tregojnë më së miri se si mund të piqet ndër shekuj kultura e popullit shqiptar.

Nga ana tjetër, Naim Frashëri është figura qendrore e letërsisë së Rilindjes dhe një nga përfaqësuesit më të shquar të lëvizjes kombëtare, njeriu që u pagëzua si “apostull i shqiptarizms” dhe “bilbili i gjuhës shqipe”.

Naim Frashëri vuri themelet e letërsisë kombëtare shqiptare. Vepra e tij shënoi lindjen e një letërsie të re me vlera të vërteta artistike. Ajo shprehte aspiratat e shoqërisë shqiptare të kohës dhe ndikoi fuqishëm në luftën e saj për liri e progres.

Tradita që krijoi Naimi, është e gjallë dhe frymëzuese edhe në jetën e shoqërisë së sotme. Naimi më tepër se shkrimtar, është poeti më i madh i Rilindjes sonë Kombëtare, është

atdhetar, mendimtar dhe veprimtar i shquar i arsimit dhe i kulturës shqiptare. Ai i ngriti hymn atdheut dhe lirisë, gjuhës dhe shkollës, ditorisë dhe përparimit.

Misioni që këta dy atdhetarë kishin duhet të vazhdojë! Jemi ne të gjithë ata që duhet ta vazhdojnë atë!

Sot, Përmeti ose thënë ndryshe “Qyteti i trëndafilave”, mirëpret më shumë se 25 mijë turistë vendas e të huaj, të cilët kërkojnë të shijojnë dhe përjetojnë bukuritë e tij, si në turizmin kulturor, shëndetësor dhe atë ekologjik. Ky qytet po tërheq gjithnjë e më shumë me historinë dhe traditën përmetare. Këtu turistët mund të gjejnë gjithçka. Siç shprehet dhe Noli në vargjet e tij: “Nëse e do sofrën e shtruar si mbret, atë e gjen vetëm në Përmet”. Kultivimi dhe promovimi i vlerave kulturore dhe natyrore të qytetit të Përmetit duhet të jetë një nga detyrat tonat parësore, sepse vetëm kështu do të arrihet zhvillimi i mëtejshëm i turizmit.

Do ta përmbyllja këtë fjalë përshëndetëse duke shprehur përgëzimet e mia të shumta për Shoqatën Atdhetare Kulturore Mbarëkombëtare “Vëllezërit Frashëri” dhe Bashkinë Përmet, për traditën që po krijojnë vit pas viti, duke iu siguruar gjithashtu mbështetjen tonë të hapur e të papërtuar për t’i ngritur edhe më lart figurat e shquara të kombit tonë, për të ngritur më lart Përmetin dhe Frashërin.

Si guri që peshon rëndë në vendin e tij, Naim Frashëri dhe Fan Noli peshojnë në kulturën e kombit dhe atdheut tonë.

Ta mbajmë gjallë ndjenjën kombëtare, ashtu siç punuan Noli e Frashëri!

Të ruajmë identitetin tonë kombëtar, sepse vetëm kështu mund të integrohemi në shoqërinë demokratike të Europës!

29.05.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin mbi trajtimin e problematikave të pronësisë mbi tokën bujqësore.

Të nderuar pjesëmarrës, përfaqësues të institucioneve vendore dhe qendrore!

E organizojmë këtë takim për një seri çështjesh, që kanë lidhje me pronësinë dhe problemet e hasura me tokën bujqësore.

Të ftuar në këtë takim janë drejtuesit e sektorve të bashkive të qarkut që merren me problemet e tokës, drejtuesit e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër dhe Tepelenë, drejtori i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, drejtori i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës.

Qeveria Shqiptare ka patur në vëmendje të saj problemin e pronësisë mbi tokën bujqësore dhe kjo reflektohet në një sërë reformash që qeveria ka ndërmarrë në këtë drejtim.

Për të lehtësuar problemet që kanë realisht pronat, u krijua Agjencia Shtetërore e Kadastrës, ku një institucion i vetëm do të administrojë gjithë procesin e verifikimit dhe rregjistrimit të pronave.

Gjithashtu u realizua reforma në kuadrin ligjor me miratimin e ligjit për funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Ligji 10/2019, i cili është një shtesë i ligjit 9948 datë 07.07.2008, i cili bënë të mundur shtyrjen e afatit të verifikimit dhe plotësimit të AMTP-ve.

Në vijim të takimit të realizuar në shtator ku u bë i mundur konstatimi i problematikave që paraqet e drejta e pronësisë si një e drejtë themelore e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ju paraqitën problematikat Komisionit Qeveritar të Tokës nga ana e prefektëve të vendit.

Nga analizimi i problematikave u bë konkretizimi i tyre me hartimin e dy VKM-ve të reja, VKM Nr.299, datë 10.05.2019 që është një shtesë e VKM-së 994 dt. 09.12.2015 dhe ndryshimi në VKM Nr.337 datë 22.04.2015.

Në vijimësi të procesit të kalimit në pronësi të tokës bujqësore nga ana e Prefektit të Qarkut janë vrejtur një sërë mangësish në punën e bërë nga institucionet e qeverisjes vendore.

Mangësit konstatohen në mosnjohjen e mirë të kuadrit ligjor ligjit 171/2014 "Për përfundimin e procedurave ligjor të kalimit të tokës bujqësore të ish-NB në pronësi të përfituesve", VKM Nr.253 datë 06.03.2013, dhe VKM Nr.337 datë 22.04.2015.

Duke parë se disa prej vendimeve të këshillave Bashkiak janë kthyer nga ana e institucionit të Prefektit për mos respektim të procedurave dhe shkelje të ligjit, nga ana e Prefektit të Qarkut në kordinim me Komisionin Vendor, u vendos të realizohet ky takim për prezantim të bazës ligjore ku duhen të mbështeten Këshillat Bashkiak në vendimmarrjen e tyre.

Për përfundimin me sukses të procesit duhet marrë parasysh dhe situata politike e cila do të ndikoj drejtëpërdrejt në konstituimin e Këshillave Bashkiak të cilët janë organi që bëjnë vendimmarrjen për lëshimin e AMTP-ve të reja.

Ky takim do të realizohet në formë bashkëbisedimi për të mundësuar trajtimin dhe të problematikave specifike të hasura gjatë punës nga specialistët e fushës.

03.06.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për aktivitetin për mbylljen e vitit shkollor 2018-2019 të shkollës "Xhuzepe Gras"

E nderuar drejtoreshë e shkollës "Xhuzepe Gras",

Të nderuar mësues, nxënës dhe prindër,

Të nderuar pjesëmarrës,

Në radhë të parë ju falënderoj përzemërsisht për ftesën me rastin e mbylljes së vitit shkollor 2018- 2019 së shkollës 9-vjeçare "Xhuzepe Gras" dhe më lejoni që në emër të institucionit të Prefektit dhe në emrin tim personal të shpreh konsideratën e lartë për stafin akademik dhe stafin drejtues të shkollës 9-vjeçare "Xhusepe Gras".

Kam kënaqësinë që jam i pranishëm në këtë ceremoni së shkollës suaj, si një nga shkollat e cila, është rritur dhe zhvilluar me mbështetjen e pa kursyer të motrave katolike, të mësuesve të përkushtuar dhe nxënësve shembullorë të etur për dije dhe kulturë.

Misioni i motrave katolike në këtë shkollë jopublike 9-vjeçare është formimi tërësor i individit, bazuar në moton: "Edukimi është vepër dashurie". Ky formim arrihet përmes procesit të mësimdhënies dhe nxënies, respektimit të veçantisë dhe personit të nxënësit, gjithnjë bazuar dhe mbështetur në parimet e filozofisë së krishterë. Në këtë shkollë mësohen dhe kultivohen vlera si dija, dashuria, solidariteti, respekti, falja, harmonia, ndershmëria dhe

shumë vlera të tjera të jetës që e ndihmojnë nxënësin të rritet e të zhvillohet në formimin e personalitetit të tij.

Dua të citoj një nga thëniet që vlerëson rolin e edukimit për formimin e personalitetit të çdo individi: “Edukimi është arma më e fuqishme që mund të përdoret për të ndryshuar botën”, nga Nelson Mandela.

Nga përmbajtja e këtij citati kuptojmë se ish-presidenti i Afrikës së Jugut N. Mandela, i jep një rëndësi të madhe edukimit si motori i zhvillimit personal, si dhe për zhvillime e reja progressive të përmasave globale. Dhe vendi ku përfitohen këto dituri dhe përvetësohen njohuri të fushave të ndryshme është në institucione arsimore publike dhe jopublike.

Prandaj, shkolla cilësohet si një nga shtyllat e edukimit të njeriut dhe pothuajse shtylla kryesore e zhvillimit intelektual. Gjithashtu, aty marrim hapat e parë të zhvillimit tonë social si shkak i ndërveprimit me shumë individë të tjerë, me personalitete të ndryshme, që gjithsesi do ndikojnë më vonë edhe te ne, varësisht se si ne i përgjigjemi kërkesave të shoqërisë dhe se si ne i pranojmë sjelljet dhe të menduarit e tyre.

Kështu, arsimi në çdo aspekt është faktor thelbësor i zhvillimit. Asnjë vend nuk mund të arrijë që të ketë zhvillim ekonomik e shoqëror të mirëfilltë e të qëndrueshëm pa investime në faktorin human, pra investime në fushën e arsimit. Në të vërtetë arsimi është dituri dhe dituria është forcë shtytëse e zhvillimit të një shoqërie.

Arsimi nuk ka të bëjë vetëm me të mësuarit dhe marrjen e notave të mira, por është shumë më shumë se kaq. Çka në të vërtetë përfaqëson më shumë është të mësuarit e fenomeneve të reja për të cilat nuk dimë shumë dhe që kanë për qëllim zgjerimin e dijes sonë. Një person i arsimuar di të dallojë të drejtën nga e gabuara e të keqen nga e mira, kjo është ajo që të lë impakt kur dëgjon fjalën "i arsimuar". Ju të cilët do të mësoni se si të shkruani e të lexoni do t'i siguronin një të ardhme më të mirë familjeve tuaja, qarkut tonë dhe më gjerë. Pra arsimi ka fuqinë që ta bëjë botën një vend më të mirë. Dhe kjo fillon nga ky institucion mësimi dhe edukimi, e cila është shtëpia juaj e madhe dhe nga ku rrezatohet dritë e dituri, kulturë e respekt.

Festa e sotme e mbylljes së vitit shkollor është festa e dijes, festë të cilën e mirëpresin të gjithë ju, të gjithë nxënësit, të gjithë mësuesit dhe të gjithë ato që kanë punuar me përkushtim dhe me mund, me djersë e me sakrificë, me qëllim për të përmbushur objektivat që ka kjo shkollë, prandaj shijojeni atë si fryt i punës tuaj të palodhur.

06.06.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit “Mbi masat e marra në parandalimin, mbrojtjen dhe përgjigjen ndaj situatave të mundshme të emergjencave civile nga zjarret në pyje dhe kullota gjatë stinës së verës për vitin 2019”.

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Planifikimit, Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave!

Të nderuar të ftuar,

E zhvillojmë sot këtë takim me antarët e Komisionit, për tu informuar në lidhje me masat e marra nga ana e njëjësive të vetëqeverisjes vendore, degëve territoriale që veprojnë në qark dhe institucionet e tjera shtetërore, si dhe për të analizuar e diskutuar për angazhimin tuaj në

marrjen e masave teknike dhe organizative si dhe për t'u përgjigjur në kohë dhe me efektivitet të lartë situatave emergjente që mund të krijohen si rezultat i rënies së zjarreve në pyje dhe kullota nga shkaqe natyrore dhe nga veprimtaria njerëzore gjatë stinës së verës 2019.

Në bazë të ligjit 8756/2011 "Për emergjencat civile" të gjitha organet shtetërore dhe vendore janë përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe riaftësimin e pasojave të shkaktuara në rast emergjencash civile. Prandaj strukturat e planizuara dhe të ngritura për përballimin e emergjencave civile duhet të funksionojnë jo vetëm në nivel qarku në rastet e emergjencave dhe gjëndjeve të jashtëzakonshme, por duhet që çdo institucion duke filluar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe çdo institucion tjetër shtetëror t'i përgjigjen në çdo rast situatës së krijuar. Kjo kërkon njohje të terrenit, përgatitjen e kapaciteteve njerëzore dhe sigurimin e gatishmërisë së aseteve logjistike për parandalimin, përballimin dhe minimizimin e pasojave që mund të sjellin fatkeqësitë e mundshme.

Në Qarkun e Gjirokastrës ka një eksperiencë të mirë në funksionimin e Komisionit të Përballimit të Emergjencave dhe Krizave në rang Qarku, e cila ka funksionuar me efektivitet në përballimin e situatave të krijuara në mënyrë të veçantë në rastet e zjarreve gjatë verës së vitit që lamë pas dhe në muajt shkurt – mars 2019.

Do të vendosja në dukje punën e mirë të bërë nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi pranë Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore të bashkive Gjirokastrë, Dropull dhe Tepelenë si dhe forcat e Detashmentit të Mbështetjes Rajonale në përballimin e situatave të zjarreve, të cilët gjej rastin t'i falënderoj për punën e bërë dhe njëkohësisht t'i inkurajoj duke dashur që kjo eksperiencë të shërbejë si stimul edhe për strukturat e tjera në qarkun tonë.

Çështjet që do të trajtohen janë si më poshtë:

- 1- Mësimet e nxjerra nga emergjencat e vitit 2018.
- 2- Situata e vatrave të zjarreve në qarkun Gjirokastrë për periudhën janar – mars 2019.
- 3- Hartat e rrezikut nga zjarret në qarkun tonë.
- 4- Gjëndja e teknikës zjarrfikëse të MZSH-së që disponojnë Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe kapacitetet njerëzore dhe logjistike të qarkut.
- 5- Hartimi dhe miratimi i planit të masave parandaluese në përballimin e emergjencave për zjarret në pyje dhe kullota gjatë stinës së verës për vitin 2019.
- 6- Pyetje diskutime.
- 7- Rekomandime.

1- Mësimet e nxjerra nga rastet e zjarreve për vitin 2018

Shtrirja gjeografike e qarkut Gjirokastrë përbëhet prej 45.104 ha të sipërfaqes me tokë të punueshme, 95.533 ha kullota, 84.662 ha pyje, shkurre dhe drurë të ndryshëm.

Situata e sipërfaqeve të djegura nga zjarret deri në fund të shtatorit të 2018 janë : 40.2 ha kullota, shkurre tokë arë dhe pyje:

- Rreth 6 ha në bashkinë Gjirokastrë
- Rreth 3.5 ha në bashkinë Libohovë
- Rreth 15.5 ha në bashkinë Dropull
- Rreth 2.5 ha në bashkinë Tepelenë

- Rreth 14 ha në bashkinë Memaliaj
- Rreth 2 dynym në bashkinë Këlcyrë
- Rreth 1.6 dynym në bashkinë Përmet

Nisur nga rastet e zjarreve përgjatë vitit të kaluar, **mësimet e nxjerra janë:**

- Mosmenaxhimi i mirë i pasurive pyje kullota
- Mosrespektimi i legjislacionit përkatës nga ana barinjve e fermereve
- Mosinformimi në kohë nga ana e rojtarëve të pyjeve dhe institucioneve përgjegjëse
- Mungesa e organizimit nga grupet e krijuara për parandalimin dhe ndërhyrjen në kohë për shuarjen e zjarreve
- Mungesa e ndërgjegjësimit dhe informimit për pasojat e ardhura nga djegja e kullotave.

2. Situata e vatrave të zjarreve në qarkun Gjirokastrë për periudhën janar – mars 2019.

Gjatë periudhës së tre mujorit të parë të këtij viti, u konstatuan vatra zjarresh të shumta thuajse në të gjithë territorin e qarkut. Në muajin Mars 2019 nga problematikat e krijuara u organizua një takim me gjithë drejtuesit e komisariteve të policisë, specialistët e emergjencave civile të bashkive, përgjegjësat e MZSH-ve, shërbimet pyjore, etj., në lidhje me marrjen e masave parandaluese, reagimin me vonesë, mos raportimin në kohë dhe mos zbulimin e shkaqeve të (autorëve zjarrvënës) në kohë si dhe u dhanë porositë dhe rekomandimet e nevojshme.

Në disa Njësi të Vetëqeverisjes Vendore, vatrat e zjarreve morën përmasa duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në pyje, pemë frutore, dhe në disa raste u bënë rrezik potent për territore të banuara.

Rastet e zjarreve për periudhën janar - mars 2019:

- Në datën 20.02.2019, në Ujin e Ftohtë Tepelenë - Bashkia Tepelenë (zjarr i qëllimshëm);
- Në datën 24.02.2019, në Njësinë Administrative Memaliaj Fshat - bashkia Memaliaj (u dogj një sipërfaqe rreth 1 dynim shkurre dhe 7 rrënjë ullinj);
- Në datën 27.02.2019, në Qafën e Muzinës - Njësia Administrative - bashkia Dropull, zjarr i qëllimshëm (u dogj rreth 5 ha shkurre e ferra - shpëtuan 1 pikë karburanti, 1 stallë lopësh, 30 koshere bletësh);
- Në datën 08.03.2019, në fshatin Martaloz-Tosk, Njësia Administrative Luftinjë - bashkia Memaliaj, zjarr shkëndijë elektrike (u dogj një sipërfaqe rreth 10 ha nga këto 2 ha pyll me pisha, pyll me shkurre sipërfaqe me ullinj që ende nuk ka informacion, si dhe u përshkuan varrezat e këtij fshati);
- Në datën 08.03.2019, në Njësinë Administrative Krahës - bashkia Memaliaj, shkaqe zjarri të pa njohura (u dogj një sipërfaqe rreth 3 dynim pyll me pisha);

- Në datën 08.03.2019, në hyrje të qytetit Tepelenë - bashkia Tepelenë, shkaqe zjarri të pa njohura (u dogj një sipërfaqe me livadhe e kullota me dëm të pallogaritshëm).

3. Hartat e rrezikut nga zjarret në qarkun tonë.

Nga studimet e kryera të geoportal.asig.gov.al, për qarkun e Gjirokastrës më të rrezikuara janë:

a. Parku Kombëtar i Bredhit të Hotovës Dangëlli

Rreziku: Zjarr në pyje
Zona: Bredhi i Hotovës Dangëlli
Përshkrimi: Zonë e mbrojtur
S= 34.361 ha
Përgjegjës: AZM Gjirokastrë

b. Bredhi Zhejit

Rreziku: Zjarr në pyje
Zona: Bredhi Zhejit, Zhej, Lliarë
Përshkrimi: Zonë e mbrojtur
S= 1.500 ha
Përgjegjës: AZM Gjirokastrë

c. Zona Uji Ftohtë Tepelenë

Rreziku: Zjarr në pyje
Zona: Uji Ftohtë, Luzat
Përshkrimi: Zonë e mbrojtur
S= 328 ha
Përgjegjës: AZM Gjirokastrë

d. Zona e Kardhiqit Gjirokastrë

Rreziku: Zjarr në pyje
Zona: Kardhiq
Përshkrimi: Rezerva strikte natyrore, rezervat shkencor
S= 1.802 ha
Përgjegjës: AZM Gjirokastrë

e. Kurora e Gjelbërt Q. Përmet

Rreziku: Zjarr në pyje
Zona: Përmet, Leusë
Përshkrimi: Kurorë e gjelbërt (me halorë)
S= 150 ha
Përgjegjës: Bashkia Përmet

f. Kurora e Gjelbërt e Q Këlcyrë

Rreziku: Zjarr në pyje
Zona: Këlcyrë
Përshkrimi: Kurorë e gjelbërt (me halorë)
S= 90 ha
Përgjegjës: Bashkia Këlcyrë.

4. Gjendja e teknikës zjarrfikëse të MZSH-së që disponojnë bashkitë e qarkut :

Bashkia Gjirokastrë : Drejtoria e MZSH-së pranë bashkisë Gjirokastrë ka në dispozicion 3 automjete zjarrfikës dhe 1 automjet zjarrfikës bot me kapacitet 9000 litra ujë. Janë adaptuar 2 automjete kamionçina për transport uji 1 tonshe si dhe janë të pajisura me tubo hedhëse për përdorimin si zjarrfikëse në terrene të vështira. Në territorin e bashkisë Gjirokastrë ka rreth 29 hidrante, janë të kontrolluara dhe në gatishmëri të plotë.

Bashkia Dropull: Sektori i MZSH-së pranë bashkisë Dropull ka në dispozicion 1 mjet zjarrfikës të kompletuar me pajisjet e nevojshme. Ka 12 forca të shërbimit zjarrfikës + 5 forca sezonalë, ka një motopompë, 1 çisternë uji, 5 pompa uji shpine, fshesa, kazma e lopata.

Bashkia Libohovë: Sektori i MZSH-së pranë bashkisë Libohovë ka në dispozicion 1 mjet zjarrfikës 1.8 tonshe uji të kompletuar me pajisjet e nevojshme, ka 14 forca shërbim zjarrfikës, ka 6 cop pompa shpine, nuk ka ambiente qëndrimi për këtë stacion.

Bashkia Tepelenë: Sektori i MZSH-së pranë bashkisë Tepelenë ka në dispozicion 1 mjet zjarrfikës (i amortizuar), ka 14 forca shërbimi zjarrfikës, 14 pompa shpine si dhe një pompë me karele për raste përmbytje në banesa.

Bashkia Memaliaj: Sektori i MZSH-së pranë bashkisë Memaliaj, ka në dispozicion 1 mjet zjarrfikës 1.8 tonshe uji të kompletuar me pajisjet e nevojshme, ka 14 forca të shërbimit zjarrfikës, pompa shpine dhe të pajisur me uniforma përkatëse. Nuk ka ambiente për mjetin.

Bashkia Përmet: Sektori i MZSH-së pranë bashkisë Përmet, ka në dispozicion 1 mjet zjarrfikës 2.2 ton uji, gjendja e amortizuar, forca të shërbimit zjarrfikës 14, pompa shpine 8 cop, hidrante 2 cop një në qytetin Përmet dhe 1 në Njësinë Administrative Piskovë. Me vënien në punë të linjës së re të ujësjellësit të ujit do të vendosen rreth 20 cop hidrante.

Bashkia Këlcyrë: Sektori i MZSH-së pranë bashkisë Këlcyrë, ka në dispozicion 2 mjete zjarrfikës një mjet 2.2 tonshe dhe 1 mjet 1.8 tonshe uji, pjesërisht të kompletuara me pajisjet e nevojshme, forca shërbimi të MZSH-së 10 ka nga 14 që duhen kompletuar, pompa shpine 6 cop.

Siç shikohet, nga viti i kaluar janë pajisur me mjete zjarrfikëse bashkitë Libohovë e Memaliaj dhe personeli i tyre tanimë janë të pajisur me uniformën përkatëse.

4. Hartimi dhe miratimi i planit të masave parandaluese në përballimin e emergjencave 2019

Nisur nga problematikat e vitit 2018 për rastet e zjarreve si dhe mësimet e nxjerra kemi përgatitur planin e masave parandaluese në përballimin e emergjencave nga zjarret në pyje dhe kullota për vitin 2019.

Për këtë kryetarët e njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të ngrenë dhe të kontrollojnë funksionimin e grupeve vrojtuese dhe ato inspektuese të përhershëm të këtyre sipërfaqeve pyjore. Këto grupe duhet të kryejnë dhe realizojnë detyrën e tyre, për inspektimin, konstatimin dhe evidentimin e çdo vatre zjarri, kjo si në rastin e pakujdesisë dhe shkaqeve të ndryshme aksidentale por sidomos kur këto zjarre janë të qëllimshme dhe vihen nga dora e njeriut.

Po kështu nga ana e bashkive të qarkut, Drejtorisë Vendore e Policisë së qarkut, Agjencisë Rajonale e Zonave të Mbrojtura, Detashmentit të Mbështetjes Rajonale si dhe Shërbimeve të

MZSH-së të bashkive të qarkut Gjirokastrë të marrin të gjitha masat e nevojshme mbrojtëse dhe parandaluese, të rifreskohen kontratat për dhënien e kullotave dhe pyjeve me barinj të fermere që i shfrytëzojnë ato.

Çdo bashki të marrë masa për prodhimin dhe vendosjen në vende të dukshme për komunitetin të posterave për sensibilizim dhe informim në strukturat përkatëse për njoftimin e menjëhershëm të shfaqjes së zjarreve.

Drejtoria e Policisë Vendore të Qarkut në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore të organizojë takime me komunitetin, me administratorët e njësive vendore, kryepleqtë e fshatrave, me personat që kanë marrë me qera kullotat, për sensibilizimin e tyre, për njohjen e legjislacionit, penalteteve në zjarrvëniet e qëllimshme dhe pakujdesitë, të cilat sjellin shfaqjen e zjarreve në pyje dhe kullota.

Nga ana e Prefektit të Qarkut do të ushtrohen të gjitha funksionet e tij, në shkëmbimin e informacionit, në menaxhimin e çdo emergjence me strukturat qendrore në qark, në veçanti gjatë këtij sezoni për zjarret në sipërfaqet pyjore. Për rastet kur situatat emergjente zjarresh të pa përballueshme duke bashkëpunuar me ju, të kërkojmë ndihmë për pjesëmarrjen e forcave të tjera nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile do të realizojmë koordinimin e të gjitha forcave për parandalimin, ndërhyrjen dhe eliminimin e këtyre llojeve emergjencash.

Për sa më sipër, kërkojmë të informohet me shkrim çdo ditë të premte ora 12⁰⁰ (Qershor-Shtator) për sezonin e stinës së nxehtë, pranë sektorit të EC dhe Krizave në Institucionin e Prefektit të Qarkut Gjirokastrë në lidhje me ndjekjen nga ana e bashkive të gjithë problematikave të ndodhura për zjarret në pyje dhe kullota, ndërsa në rastet e rënies të vatrave të zjarreve në sipërfaqe të mëdha si dhe të pa përballueshme nga forcat tuaja ku kërkohet ndihmë për mbështetje me mjete dhe forca të tjera të informohemi në çdo kohë.

Media e shkruar dhe vizive, si një partnere e rëndësishme në sensibilizimin e opinionit, nëpërmjet organizimit të takimeve dhe tryezave të rrumbullakta për këtë problem, të ndikojë në angazhimin qytetar për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota.

Institucioni i Prefektit në vijimësi, gjatë gjithë stinës së verës, do të ndjekë dhe monitorojë me përparësi zbatimin e këtyre detyrave të shtruara për parandalimin dhe minimizimin e dëmeve nga zjarret e mundshme në pyje dhe kullota për mbrojtjen e vazhdueshme të tyre.

Më lejoni që në përfundim të këtij takimi, pasi dëgjuam raportimet dhe diskutimet e anëtarëve të këtij komisioni dhe të ftuarve, në zbatim të detyrimeve ligjore, për të mbajtur në kontroll të vazhdueshëm situatën dhe mundësinë e monitorimit dhe përballimit me sukses të emergjencave të mundëshme nga zjarret gjatë stinës së verës,

Rekomandime:

1. Të merren të gjitha masat paraprake nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, njësitë administrative, strukturat e shërbimit të MZSH-ve për planifikimin, përgatitjen e elementëve të gatishmërisë, organizimin, parandalimin, dhe rritjen e aftësive drejtuese në reagimin e menjëhershëm të bashkëpunimit e bashkërendimit të veprimeve me institucionet dhe strukturat e tjera të qarkut në përballimin e situatave të rënies së zjarreve.

2. Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut në bashkëpunim me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Sektorin e Ekstensionit Bujqësor, Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Administratën e Zonave të Mbrojtura të hartohet plan-kalendar me grafik, me objekt organizimin e takimeve me komunitetin, administratorët e njësive, personat që shfrytëzojnë pyjet dhe kullotat sipas kontratave të lidhura, forcat vullnetare etj., për sensibilizimin e tyre, për njohjen e legjislacionit, penalteteve në zjarrvëniet e qëllimshme dhe pakujdesitë, të cilat sjellin shfaqjen e zjarreve në pyje dhe kullota.

3. Brenda datës 15 qershor 2019, të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të qarkut në bashkëpunim me strukturat e Shërbimit Pyjor (*Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, Administratën e Zonave të Mbrojtura*), për ruajtjen e sipërfaqeve pyjore dhe kullotave, zonave më problematike apo të çdo njësie administrative, të organizohen dhe të inspektohen në vend masat e marra të ngritjes së grupeve vullnetare dhe të vrojtuesve sezonalë në çdo fshat, për zbulimin, evidentimin dhe njoftimin në kohë të çdo vatre zjarri të mundshëm.

4. Të raportohet çdo ditë dhe në çdo kohë me shpejtësi për vatrat e zjarreve që mund të krijohen, pranë pikave të kontaktit në institucionin e Prefektit të qarkut (Sektorit të Emergjencave Civile dhe Krizave).

Raportimi do të bëhet prej datës 15 qershor deri më 15 shtator 2019.

5. Të gjitha Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore në bashkëpunim me Drejtoritë e Shëndetit Publik duhet të kenë në vëmendjen e tyre marrjen e masave të ngritjes së shërbimit të emergjencës shëndetësore pranë zonave turistike, gatishmërinë e hidranteve të furnizimit me ujë të mjeteve zjarrfikëse etj., deri në mbylljen e sezonit turistik.

Në rastet e fluksit të madh të emigrantëve në Pikën Kufitare Kakavije, të merren masa të stacionimit të një mjeti autoambulance me personel shëndetësor në periudhën e stinës së verës.

6. Të gjitha strukturat e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (MZSH-të) sipas planit të hartuar të mbahen në gatishmëri automjetet zjarrfikëse dhe personelin për këtë periudhë. Rëndësia e bashkëpunimit konkret dhe shkëmbimit të informacionit në kohë do të bëjë të mundur përbalimin me efikasitet të çdo situatë që mund të shkaktohen.

7. Për shkak se rreth 90% e zjarreve të rëna kanë qenë të qëllimshëm dhe nga pakujdesia, kërkohet ndaj personave që indentifikohen si shkaktarë të zjarreve të zbatohen të gjitha procedurat për paditjen e tyre konform kërkesave të ligjit.

Motoja e punës për të gjitha strukturat duhet të jetë: parandalim-denoncim dhe tolerancë zero për cilindo zjarrvënës.

8. Stacionet e shërbimit të MZSH-ve në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të vazhdojnë të ushtrorjnë kontrole në subjekte private dhe ato shtetërore, kryesisht në pikat e karburanteve dhe të tregjeve të gazit të lëngshëm për parandalimin dhe mënjanimin e ngjarjeve të mundshme.

9. Specialistët e emergjencave civile pranë njësive të vetëqeverisjes vendore të qarkut të rifreskojnë planet e gatishmërisë për ndërhyrje jo vetëm në raste zjarresh, por për të gjitha rastet e emergjencave. Të mbajnë kontakt të vazhdueshëm me njësitë e vetëqeverisjes vendore për monitorimin dhe marrjen në kohë të informacionit. Këto struktura të raportojnë pranë Institucionit të Prefektit për situatën reale që ndodh në terren.

10. Institucionet vendore dhe strukturat shtetërore që kanë detyrimin ligjor si struktura monitoruese dhe vepruese, të rishikojnë dhe riorganizojnë veprimtarinë e shtabeve të emergjencës për të siguruar efektivitetin e duhur në veprimet për menaxhimin e situatave emergjente.

11. Strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë së qarkut të ushtrojnë kontrolle jo vetëm në zonat muzeale, por në gjithë territorin e qarkut me qëllim ndëshkimin e pronarëve të mjeteve që parkohen në vende të ndaluara. *(Për arsye pengesë kalimi të mjeteve zjarrfikëse në raste situate zjarresh...)*.

12. Nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të përcaktohen vendfurnizimet me ujë të mjeteve ajrore që mund të përdoren për shuarjen e zjarreve *(Kordinatat e Rezervuarëve)*.

13. Nga çdo Njësi e Vetëqeverisjes Vendore të merren masa për vënien në gatishmëri për ndërhyrje në rast nevoje, kapacitetet e tyre, strukturat e MZSH-së, të ndërmarrjeve që ato kanë në varësi, si Ujësjellës Kanalizime sh.a. etj., me qëllim furnizimin e popullatës në ato raste kur mungon uji i pijshëm.

09.06.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për çeljen e sezonit turistik në bashkinë Këlcyrë

I nderuar kryetar i bashkisë Këlcyrë, z. Klemend Ndoni

Të nderuar pjesëmarrës,

Së pari më lejoni të shpreh kënaqësinë time që jam i pranishëm sot mes jush në këtë ceremoni me rastin e çeljes së sezonit turistik në bashkinë Këlcyrë.

Zona e bashkisë së Këlcyrës është dalluar gjithmonë për cilësinë e lartë të frutave dhe rrushit dhe është njohur si qendër për kultivimin e rakisë dhe verës. Vera “Merlot”, e famshme në këtë zonë, është e njohur në tregun vendas dhe më gjerë. Atraksionet turistike të kësaj zone janë të larmishme. Dua të përmend një prej tyre si Gryka e Këlcyrës, në të ndodhet një nga burimet ujore më të bukura të Shqipërisë, Burimi i Ujit të Zi, i cili ndonëse jo shumë i përmendur siç mund të thoshim për pika të tjera ujore të natyrës shqiptare, është një vend i mrekullueshëm që vlen të vizitohet. Këlcyra është një qytet që shtrihet përgjatë maleve Trebeshinë dhe Nemërçkë dhe laget nga lumi Vjosë dhe Dëshnicë. Madhështore dhe hijerëndë Gryka e Këlcyrës çan mes honesh të thepisura dhe mbërrin në pikën më të lartë të pllajës që shtrihet mes Malit të Trebeshinës e Nemërçkës në qytetin e Këlcyrës, që është i vendosur në të djathtë të Vjosës, aty ku lumi i Dëshnicës së bashku me degët e veta nis bashkërrjedhjen me Vjosën.

Peizazhi i lumit Vjosë me ujëvara magjepëse, kanione e shpella të shumta, tërheqin çdo ditë e më shumë një numër të madh vizitorësh. Viti i kaluar 2018 konsiderohet si një nga sezonet turistike më të sukseshme ku qarku ynë u vizitua nga xx turistë, ku 1512 prej tyre kanë vizituar bashkinë e Këlcyrës. Ky vit do të jetë akoma më i sukseshëm, rezultat që shihet në rritjen e turistëve me 4 % në krahasim me 6-mujorin e vitit të kaluar.

Rritja e numrit të turistëve vendas dhe të huaj në atraksionet tërheqëse të bashkisë Këlcyrë është një gjë pozitive ashtu sikurse është edhe një sfidë, sepse kjo rritje e vizitorëve kërkon edhe rritjen e kapaciteteve akomoduese. Prandaj banorët e zonës apo fermerët duhet të investojnë që shtëpitë e tyre ti kthejnë ato në shtëpi pritëse për turistët, në mënyrë që të rriten

kapacitetet akomoduese. Investim ky i cili nënkupton të ardhura të qëndrueshme, përmirësim të mirëqenies dhe zhvillim ekonomik të zonës dhe më gjerë.

Kjo mund të realizohet me ndihmën e bashkisë, por edhe me mbështetjen institucionale të Prefektit të qarkut, i cili me miqtë të shumtë, të mëdhenj dhe bujarë muajin e kaluar dhuroi një autombulancë për bashkinë tuaj, në shërbim të banorëve të zonës.

Gjithashtu zhvillimi i sektorit të turizmit kërkon edhe përmirësimin e infrastrukturës, por kërkon edhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe në mënyrë të veçantë, kërkon edhe ruajtjen e traditave të zonës, të karakteristikave të saj më specifike, të cilat do t'u lënë mbresa vizitorëve vendas apo të huaj.

Ndaj edhe ndërmarrja për organizimin e aktiviteteve për promovim të potencialeve dhe pikave turistike nga vetë ju banorët e zonës, bizneset në bashkëpunim me bashkinë tuaj, si dhe mbështetjen e institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë është shumë i rëndësishëm dhe nxitës për zhvillimin e mëtejshëm të të gjithë zonës.

Ashtu sikurse turizmi dhe zhvillimi i bujqësisë janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe njëkohësisht janë një mundësi e shkëlqyer për të gjitha familjet që të përfitojnë përmes punës së tyre.

Me një reliev malor dhe një pozitë të favorshme gjeografike bashkia e Këlcyrës ofron një peizazh shumë të bukur panoramike, ku vizitorët vendas e të huajmund të provojnë këtu llojet e turizmit të aventurës si rafting, ngjitje në shkëmb, ecje, ciklizëm malor për të shijuar bukurinë e rrallë natyrore të bashkisë suaj.

Dua të theksoj se ardhmja e bashkisë së Këlcyrës do të jetë zhvillimi i saj nëpërmjet turizmit, gjë që ndikon dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të qarkut tonë.

Turizmi në tërësi në qarkun e Gjirokastrës po zhvillohet me ritme të kënaqshme, falë dhe programeve të ndërmarrja nga qeveria shqiptare, por dhe investitorëve privat, për promovimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme turistike sidomos në zonat që kanë karakter rural me bukuri të rrallë.

Ajo çfarë kërkon dhe vlerëson zhvillimi i sektorit të turizmit është ruajtja e traditave dhe origjinalitetit të produkteve të veçanta të zonës për ta bërë bashkinë Këlcyrë një vend më të vlerësuar që ka turizmin e ka prioritet.

10.06.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin me mësuesit dhe nxënësit me origjinë shqiptare të Ukrainës

Mirë se vini në qytetin e Gjirokastrës!

Dita e sotme, e 10 qershorit, do të mbahet në kujtesë si një ditë e shënuar, pasi shqiptarët e Ukrainës vijnë në qytetin e Argjiros, të Eqrem Çabejt, Ismail Kadaresë, Musine Kokalarit e të shumë personaliteteve të shquara të Kombit, që e kanë zanafillën nga ky qytet. Po kështu, dita e sotme, është një ditë historike e simbolike e Historisë së Kombit Shqiptar, Dita e Lidhjes së Prizrenit. Përkujtojmë sot, së toku, edhe 141 vjetorin e saj .

Kam nderin që, në cilësinë e Prefektit të Qarkut të Gjirokastrës t'iu uroj:

“Ti kaloni bukur këto dy ditë në vendin e origjinës të paraardhësve Tuaj, të njiheni me historinë, kulturën, gjuhën dhe progresin në kryeqendrën e Prefekturës sonë!

Këtë urim ua drejtoj juve mësuesve, nxënësve me origjinë shqiptare në Ukrainë, në vijim të takimeve Tuaja të frytshme me personalitete vendore dhe qeveritare të Shqipërisë, sikundër ishte dhe takimi me Ministrin e Diasporës, zotin Pandeli Majko.

Qeveria jonë ka zhvilluar dy samite me shqiptarët e Diasporës, për të rritur kujdesin dhe ndihmesën ndaj komuniteteve shqiptare prezente sot në shumë vende me këtë objekt dhe ndjejmë kënaqësinë që në këtë takim ndodhte dhe iniciuesja e turneve të fëmijëve, Mirabelle Supure, e cila ka bërë të mundur, grupimin e fëmijëve nga Ukraina, të vizitojnë Shqipërinë gjatë sezonit veror.

Inicimi i këtij rrugëtimi të bukur nga Karakurti i Ukrainës në tokën e të parëve, në tokën e origjinës me një objekt të qartë: “ Të njohim identitetin, gjuhën amë”, është e admirueshme. Kjo nisativë e ndërmarrë për disa vite është një ogur i mirë për të mos harruar kurrë prejardhjen.”

E dimë, tashmë, dhe jemi të informuar për një ringjallje të shqiptarëve të Ukrainës. Historiografët kanë bërë një punë të lavdërueshme në evidentimin e kësaj ringjallje .

Pak histori:

Shqiptarët, në Odesë të Ukrainës, janë vendosur aty nga vitet 1861- 1862. Ata, kryesisht, u vendosën në tre fshatra: në Devnya, Georgiev ka dhe Gammovka, në afërsi të Detit Azov. Ndërsa në Karakurt, nga ju vini, u vendosën aty nga viti 1878. Në vitin 1940, rajoni Izmail i Ukrainës, më 1954 u bashkua me Odesën. Gjatë regjimit komunist në Ukrainë, pikërisht në vitin 1947, katundit Karakurt, zyrtarisht i ndërrohet emri në Zhovtnevoe. Tani nga Jeni Karakurt (Karakurti i Ri), u quajt Zhovtnevoe i Ri. Duhet theksuar se, shqiptarët e Ukrainës bashkëjetuan me gagauzët dhe bullgarët, por, për asnjë çast, ata nuk e harruan origjinën e tyre, shqipen , gjuhën e nënës si dhe traditat, zakonet e tyre shqiptare. Ata sot e kësaj dite (2019) flasin shqipen tonë arkaike. Këtë e pohon më së miri dhe prezenca juaj sot. Disa nga banorët shqiptarë të Karakurtit e flasin edhe shqipen e sotme letrare, të cilën e kanë mësuar në Prishtinë dhe në Tiranë.

Shqiptarët e Ukrainës s’kanë qenë të panjohur për shqiptarët, si në të kaluarën, ashtu edhe sot, pra ata s’kanë qenë kurrë të harruar, apo të mënjanuar. Mund të sjellim ndërmend faktin kuptimplotë të vlerësimit, kur në vitin 1911, Fan Noli vizitoi shqiptarët e Odesës. Këtë e mësojmë të trumbetuar nga vetë ai. Takimin me shqiptarët e Ukrainës ai e konsideron mjaft të rëndësishëm, prandaj, midis tjerash, në librin e tij “Autobiografia” shkruan:

“Atë vit, Fan Noli vizitoi bashkësitë shqiptare të Odesës dhe Kishenevit në Rusi; të Bukureshtit, Brailës dhe Konstancës, në Rumani dhe të Sofjes në Bullgari. Në të gjitha këto qytete, ai bëri meshën në gjuhën shqipe”.

Sot gazetarët dhe televizionet kanë bërë disa emisione dokumentare për jetën e banorëve shqiptarë të Karakurtit, në Odesë të Ukrainës, të cilat janë parë edhe nga banorët e Qarkut tonë.

Kohët e fundit po shihet një ringjallje te shqiptarët e Ukrainës. Besohet se në gjithë Ukrainën ka 4000 mijë shqiptarë.

Ku shprehet gjallërimi i shqiptarëve të Ukrainës?

Së pari, në aktivitetet e tyre të fuqishme kulturore, arsimore e sportive, të cilat nuk kanë të ndalur. Ata kanë edhe klubin sportiv, për futboll të vogël me emrin e kryeheroit të tyre të dashur “Skënderbeu”.

Klubi i futbollit “Skënderbeu” në Karakurt – Odesë Ukrainë u themelua në dhjetor të vitit 2018.

Së dyti kemi informacionin se, gjatë këtij muaji (qershor) , në fshatin me më shumë shqiptarë, do të ngrihet busti i Skënderbeut. Ky është një akt i bukur.

Por bukuria qëndron edhe te ky rrugëtim juaji i bukur në Shqipëri në Kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë, Berat, Vlorë ,Gjirokastrë e Libohovë.

Së treti, në këtë kontekst ju uroj që ta kaloni bukur këtu në Gjirokastrë dhe në Libohovë, ku ju do të vizitoni qendra të rëndësishme të kulturës, historisë dhe letërsisë së Kombit tonë si dhe në takimet që do të zhvillojë ju mësues me kolegët Tuaj gjirokastritë e libohovitë si dhe ju nxënës me moshatarët tuaj.

Ju dhurojmë nga fondi ynë libror, libra të përkthyer, në gjuhën tonë shqipe, të autorëve klasikë botërore për fëmijë, të botuara nga Shtëpia Botuese “BOTA SHQIPTARE”e botuesit , regjisorit , skenaristit Kujtim Gjonaj si dhe libra të autorëve gjirokastritë, të cilat do t’iu mundësojnë mësimin sa më të mirë të gjuhës së sotme shqipe letrare.

18.06.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin në kuadër të Projektit AquaNEX Interreg IPA CBC Greqi –Shqipëri: “Ruajtja dhe sigurimi i cilësisë së trupave ujorë sipërfaqësorë në Greqi dhe Shqipëri duke përdorur teknikat e vëzhgimit të tokës”

I nderuar, z. Klosi, Ministër i Turizmit dhe Mjedisit
E nderuara znj. Kumbaro, Deputete e Kuvendit të Shqipërisë
I nderuar përfaqësues i BEC Greqi

Së pari, dëshiroj t’ju falenderoj për ftesën dhe që më bëtë pjesë e këtij diskutimi të projektit AquaNEX Interreg IPA CBC Greqi –Shqipëri “ Ruajtja dhe sigurimi i cilësisë së trupave ujorë sipërfaqësorë në Greqi dhe Shqipëri duke përdorur teknikat e vëzhgimit të tokës”.

Qarku i Gjirokastrës është një nga 12 qarqet në Republikën e Shqipërisë dhe ka një sipërfaqe prej 2884 km², 10% të territorit të saj tokësor. Si qark është i pozicionuar në qendër të Shqipërisë Jugore dhe përshkrohet nga dy prej luginave më të rëndësishme në Shqipërinë Jugore, Lugina e Vjosës së Sipërme dhe Lugina e lumit Drino, pozitë kjo e përshtatshme për zhvillimin ekonomik, me klimë mesdhetare, tokë prodhuese dhe bimësi të zhvilluar.

Zhvillimi i turizmit për Qarkun e Gjirokastrës, duke u bazuar dhe në trashëgiminë unike kulturore, historike dhe arkitekturore, është një nga rrugët më efektive për ringritjen ekonomike dhe si rrjedhojë reduktimin e varfërisë në zonat rurale dhe urbane. Zhvillimin e turizmit e bëjnë të mundur burimet e shumta që ofron zona duke përmbushur të gjitha kriteret për zhvillimin e të gjitha formave specifike të tij si:

- *Zhvillimi i turizmit kulturor*
- *Zhvillimi i turizmit të gjelbër*
- *Zhvillimi i eko-turizmit*

Potenciali i madh turistik i qarkut shprehet përveç të tjerash edhe në ekzistencën e 153 monumenteve natyrore të gjallë dhe jo të gjallë nga të cilat, 62.000 ha gëzojnë statusin **zona të mbrojtura**.

Në qarkun tonë, zonat e mbrojtura sidomos në 5 vjeçarin e fundit, janë kthyer në një atraksion turistik, që ka ardhur si pasojë e sigurimit të një menaxhimi shumë të mirë të tyre. Mbrojtja e natyrës dhe biodiversitetit përbën një ndër prioritetet e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe si e tillë edhe për qarkun tonë, ku 20% të territorit janë zona të mbrojtura.

Projekti Aquanex “**Ruajtja dhe sigurimi i cilësisë së trupave ujorë sipërfaqësorë në Greqi dhe Shqipëri duke përdorur teknikat e vëzhgimit të tokës**”, e cila po prezantohet sot, është një projekt ndërkuftar që financohet nga BE, në kuadër të programit IPA Interreg Greqi-Shqipëri 2014-2020, ku Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është Partneri Lider i projektit.

Zona në të cilën zhvillohet ky projekt, pra baseni i lumit Vjosë, është përzgjedhur jo pa qëllim nga partnerët shqiptarë për pilotimin e metodologjisë së re të prezantuar nga partnerët grekë fillimisht. Kjo zonë njihet për vlerat e larta për biodiversitetin dhe burimet natyrore.

Lumi Vjosa është një nga lumenjtë e fundit natyrorë në Evropë. Përgjatë gjithë rrjedhës së tij prej mbi 272 kilometra lumi është i paprekur dhe rrjedh i lirë, me larmi tiparësh hidromorfologjike. Së bashku me degët e saj, Vjosa përbën një ekosistem dinamik thua se natyror, të rrallë për Evropën. Lugina e Vjosës shtrihet në jug të Shqipërisë në një lartësi mesatare 855 m.n.d. Rrjeti hidrografik i sistemit lumor të Vjosës rrjedh përmes masiveve para-malore e malore, me lartësi maksimale mbi 2600 m.

Në Vjosë ose në degët e saj përfundojnë edhe shumë burime karstike si ato të grykës së Këlcyrës, të Libohovës, të Viroit, të Gjirokastrës, të Ujit të Ftohtë të Tepelenës, të Poçemit etj. Vjosa buron nga malet e Pindit (Greqi), ku rrjedh nëpër një luginë të thellë, e cila zgjerohet pasi hyn në territorin tonë.

Aktualisht, mijëra turistë nga e gjithë Evropa vijnë për të vizituar këtë lumë, nga të paktët në gjendje natyrore.

Lumi Drinos (84 km) i cili përshkon qytetin e Gjirokastrës është një nga degët kryesore të lumit Vjosa dhe buron nga Mali i Elates në Greqi. Ai rrjedh midis dy vargmaleve, nga njëra anë Shëndëlli – Lunxhëri – Bureto dhe nga ana tjetër Malësia e Kurveleshit – Mali i Gjerë – Stugarë. Lugina e Drinos zonë e pasur me objekte, rrënoja dhe gjurmë vendbanimesh antike, bizantine dhe mesjetare, gjithashtu shquhet për një numër të madh manastiresh.

Pra, baseni i Vjosës përbën një ndër ekosistemet më unike të kontinentit Evropian me vlera të jashtëzakonshme të biodiversitetit. Nga ana tjetër kjo luginë bart të gjitha potencialet e një zhvillimi të qëndrueshëm që do të sillte një shpërndarje të ekuilibruar të përfitimeve në komunitet. Për këtë arsye aktorët e përfshirë në mbrojtjen e kësaj trashëgimie natyrore, propozojnë si alternativë shpalljen e Vjosës Park Kombëtar! Në këtë mënyrë Vjosa mund të jetë Parku i parë Kombëtar i një lumi natyror në Evropë.

Dua të theksoj se turizmi në tërësi në qarkun e Gjirokastrës po zhvillohet me ritme të mira, falë edhe programeve të ndërmarra nga qeveria shqiptare, por edhe nga ana e investitorëve privat, të cilët po krijojnë kushte të përshtatëshme turistike sidomos në zonat me karakter rural aty ku dhe bukuritë e natyrës e bëjnë më tërheqës turistin.

Rritja e numrit të turistave me 52.6% me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, tregon për një rritje të strukturave akomoduese në qark dhe përmirësim të kushteve në shërbim ndaj turistave. Krijimi i një mjedisi atraktiv dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi si për turistat ashtu edhe për investitorët duhet të jetë strategjia e zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit në qarkun tonë.

Pra, sektori i turizmit sjell përmirësimin e mirëqënies së komunitetit duke ofruar mundësi punësimi. Megjithatë, zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit kërkon një përdorim të matur të burimeve natyrore dhe njerëzore dhe një bashkëpunim ndërinstytucional dhe jo vetëm, por edhe ndërgjegjësim të të gjithë faktorëve dhe aktorëve përgjegjës për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik.

Së fundi, Institucioni i Prefektit të Qarkut, do të ofroj gjithmonë mbështetje institucionale për realizimin e çdo projekti që do të zhvillohet në qarkun tonë.

Edhe njëherë ju uroj suksese partnerëve në realizimin e këtij projekti shumë të rëndësishëm ndërkuftar Greqi – Shqipëri, i cili do të bëjë të mundur monitorimin shkencor të ujrave sipërfaqësorë në basenin e lumit Vjosa dhe Drino.

21.06.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për zhvillimin e turizmit në qarkun Gjirokastrë

E nderuar Znj.Ministre, Elva Margariti,

Të nderuar pjesëmarrës,

Fillimisht më lejoni të falenderoj Znj.Ministre për angazhimin dhe bashkëpunimin që ka treguar në mbështetje të Kulturës në qarkun e Gjirokastrës.

Siç e dini qarku i Gjirokastrës, falë pozicionit të tij gjeografik, trashëgimisë së pasur kulturore, materiale dhe shpirtërore, historike dhe arkitektonike, paraqet mjaft interes në fushën e sektorit të turizmit dhe jo vetëm. Gjatë gjithë historisë së saj, Gjirokastra ka qënë një qendër e rëndësishme administrative, ekonomike e kulturore dhe pikë referente për emancipim kulturor dhe pavarësi për botën shqiptare. Ajo çfarë e bën Gjirokastrën të njohur janë vlerat arkitekturale të ndërtimit të shtëpive me gurë, çative me dërrasë, kalldrëmeve, shtëpive-muze. Këtu mund të vizitoni qendrën historike, pazarin unikal, kalldrëmet e tij karakteristike, kështjellën madhështore, etj. Qyteti i Gjirokastrës, për shkak dhe të anëtarësimit në UNESCO, është një nga qytetet më të vizituara nga vizitorët vendas e të huaj.

Njësitë administrative të qarkut Gjirokastrë përbëjnë destinacionet më të rëndësishme të turizmit të aventurës në vend. Disa grupe të rinjsh të apasionuar pas ecjes, alpinizmit dhe kalërimit sportiv organizojnë guida duke përshkruar rrugë dhe shtigje historike në udhëtime një javore që kalojnë në për Lunxhëri, Zagori, Libohovë, Pogon, Cepo, etj.

Ky zhvillim i turizmit në qarkun tonë dëshmohej edhe nga suksesi i sezonit turistik të vitit të kaluar, i cilësuar si një nga sezonet me rritjen më të madhe të numrit të turistëve krahasuar me vitet e shkuara.

Në kuadër të zhvillimit të turizmit kulturorë, natyror, Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë ka ndjekur hap pas hapi mbarëvajtjen e sezonit turistik 2019 nëpërmjet takimeve të punës me drejtuesit e strukturave përkatëse dhe informacioneve të herëpashershme lidhur me ecurinë e sezonit turistik 2019, si numrin e turistëve dhe strukturat akomoduese në çdo bashki të qarkut Gjirokastrë, gjendjen e monumenteve kulturore, problematikat që hasen etj.

Në mbështetje të asja që sapo citova, do doja të vija theksin në statistikat për muajt Janar-Maj 2019, Gjirokastra ka mirëpritur rreth 33.819 vizitorë. Janë kryer një sërë investimesh nga qeveria shqiptare, e cila i ka kushtuar vëmendje të veçantë të zhvillimit të turizmit në qarkun e Gjirokastrës si dhe rehabilitimit urban të disa qyteteve kryesore për ngritjen e vlerave të trashëgimisë kulturore të qarkut.

- Do të përmendja një prej investimeve si: rehabilitimi i Qafës së Pazarit, që pavarësisht punimeve intesive që po kryhen në këtë zonë muzeale të qytetit vihet re se nuk kanë ndikuar në fluksin e vizitorëve për të vizituar Kalanë e Gjirokastrës dhe pikat e tjera kulturore të qytetit. Prandaj kërkoj që të merren masa në mënyrë që rëhabilitimi i kalldrëmit të përfundoj sa më shpejt në shërbim të të gjithë banorëve të qytetit dhe të vizitorëve të shumtë.
- Dua të shtoj dhe një nga problemet shqetësuese, i cili është fakti i biletës hyrëse për në Kalanë e Gjirokastrës, pasi vizitorët vendas e të huaj paguajnë 2 bileta. Kërkoj që të shikohen mundësitë që të krijohet një biletë e vetme për të vizituar Kalanë e Gjirokastrës. Si dhe të bëhet një rivlerësim i shtëpive muze për gjendjen e tyre në të cilat ka probleme që lidhen me restaurimin e këtyre banesave karakteristike të

shpallura tashmë monumente kulturore. Duhet të përcaktohet sipas një kronologjie kush janë monumentet më të dëmtuara, më pak të dëmtuara dhe cilët duhet të jenë ndërhyrjet emergjente me qëllim ruajtjen e pasurisë sonë kulturore.

- Ndërmarrja e sa më shumë aktiviteteve kulturore gjatë gjithë vitit dhe shtimit të tyre gjatë sezonit turistik në mënyrë që të promovohen potencialet turistike.
- Rihapja e muzeumeve që do të shërbejnë po ashtu rritjes së këtij objekti. Duhet të ndërmerren aktivitete kulturore në mënyrë që të shtohet numri i vizitorëve që do të vijnë në Gjirokastrë për atë çfarë qyteti ofron më së miri: kulturë, traditë dhe histori.

Ajo çfarë kërkon dhe vlerëson zhvillimi i sektorit të kulturës është ruajtja e traditave dhe origjinaliteti i produkteve të veçanta të zonës për ta bërë qarkun Gjirokastrë një destinacion të vlerësuar dhe më tërheqës në rang kombëtar, duke qënë se turizmin e kemi prioritet. Prandaj dua të jap një mesazh sensibilizues për një rritje bashkëpunimi mes institucioneve, ndërmarrjen e aktiviteteve kulturore promovuese nga ana e vetë bizneseve që operojnë në fushën e turizmit dhe kulturës, sensibilizim për të pasur një mjedis të pastër dhe sigurisht theksi shkon për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në kuadër të zhvillimit të sektorit të turizmit që ndikon pozitivisht në ekonominë e qarkut.

26.06.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për ceremoninë e dhënies të titujve të nderit ish-partizanëve të LANÇ-it.

I nderuar Kryetar i Organizatës së Dëshmorëve dhe Veteranëve,
I nderuar Kryetar i Këshillit të Qarkut,
Të nderuar veteranë,
Të nderuar pjesëmarrës,

Sot, është privilegj i veçantë për mua të ndodhem mes jush në ceremoninë e dhënies së titullit “Nderi i Qarkut Gjirokastrë” për kontributin e shquar në Luftën Antifashiste Nacionale Çlirimtare të trashëgimtarëve të denjë të atdhetarisë.

Të vlerësosh e të përkujtossh ngjarjet madhore të LANÇ-it do të thotë të nderosh e lartësosh Shqipërinë. Rezultat i idealeve që udhëhoqën luftën e tyre është Shteti Shqiptar sot. Në luftën Antifashiste Nacionale Çlirimtare dhanë jetën e tyre për çlirimin e Shqipërisë shumë djem e vajza partizanë, midis tyre përmendim Sadik Bocaj, Rukie Gjoça Aliaj, Dalip Guçe dhe Asllan Veizi, të cilët po nderohen sot nga Këshilli i Qarkut me tituj nderi.

Përulemi ndaj veprave së këtyre partizanëve duke i nderuar me dhënien e titullit të nderit, i cili është një shenjë nderimi dhe krenarie për sakrificat e tyre ndaj atdheut tonë.

Ata kontribuan në luftë dhe në punë duke mbetur kështu një model me të cilët ne pasardhësit jemi krenar për veprat e tyre që luftuan e ranë për lirinë e Shqipërisë, për lirinë tonë, për mirëqenien tonë, për të ardhmen e fëmijëve tanë.

Shqipëria u është borxhëli për sakrificat prandaj meritojnë nderimin tonë. Nderimi dhe respekti për dëshmorët është dhe do të jetë obligimi i krenarisë sonë kombëtare sepse dhanë jetën për lirinë e këtij vendi.

Ndaj detyrimi dhe obligimi jonë është që veprën dhe historinë t'ua trashëgojmë brezave që vijnë dhe të shërbejnë model për të rinjtë e sotëm që të kontribuojnë në zhvillimin e vendit tonë.

Sot, Lufta Antifashiste Nacional-Çlirimtare duket e largët në kohë. Por ajo është aq e afërt për nga vlerat që u dha Shqipërisë e shqiptarëve, për nga mesazhet e fuqishme që mbart e rrezaton, për nga mësimet e vyera që na ka lënë.

Në këtë ditë të shënuar më lejoni të shpreh mirënjohjen, respektin, përlujen ndaj paraardhësve tanë, dëshmorëve, të cilët dhanë jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Gjaku dhe vepra e dëshmorëve do të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.

Lavdi dëshmorëve të Atdheut!

28.06.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit mbi masat paraprake nga ana e institucioneve për një process normal për zgjedhjet e datës 30 qershor 2019

Përshëndetje,

Në zbatim të ligjit 10019, datë 29.10.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë ” , Dekretit të Presidentit nr.10928, datë 5.11.2018 “Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore” , ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut” neni 8, pika i, Prefekti i qarkut ka ndërmarrë të gjitha hapat në zbatim të detyrimeve që përcaktohen në Kodin Zgjedhor, konkretisht:

I. Në zbatim të Vendimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve nr.9, datë 15.01.2009, pika 3 “*Prefektët e qarqeve do të sigurojnë ambientet dhe pajisjet e punës për Zyrat Rajonale Zgjedhore*”. Bazuar në këtë vendim janë caktuar 2 Zyra Rajonale Zgjedhore për Qarkun Gjirokastrë. Prefekti i qarkut ka përcaktuar ambientet dhe kam bërë pajisjen tyre me bazë materiale. Konkretisht dy Zyrat Rajonale Zgjedhore janë parashikuar:

1. Zyra Rajonale Zgjedhore Gjirokastrë, ambientet e Drejtorisë së Shërbimit Social Shtetëor.
 2. Zyra Rajonale Zgjedhore Tepelenë, ambientet e nënprefekturës Tepelenë.
- Këto Zyra do të funksionojnë për periudhën 1 mars – 31 korrik 2019.

II. Në nenin 94, pika 1 të ligjit 10019, datë 29.10.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” përcaktohet se “*Jo më vonë se 60 ditë para datës së zgjedhjeve, prefekti i qarkut i paraqet KQZ-së listën e plotë të objekteve brenda territorit të qarkut, që përmbushin kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2 të nenit 93 dhe të këtij neni. (Vendet e numërimit të votave)*” Prefekti i qarkut me shkresën nr. 456 prot, datë 23.04.2019 ka përcaktuar vendodhjen e 7 VNV-ve për çdo ZAZ si më poshtë:

ZAZ nr.74, Bashkia Përmet, VNV Pallati i Sportit (sip 400 m²)

ZAZ nr.75, Bashkia Këlcyrë, VNV Palestra e Shkollës (sip 200 m²)

ZAZ nr.76, Bashkia Memaliaj, VNV Pallati i Kulturës Memaliaj (sip 150 m²)

ZAZ nr.77, Bashkia Tepelenë, VNV Pallati i Kulturës Tepelenë (sip 150 m²)

ZAZ nr.78, Bashkia Gjirokastrë, VNV Pallati i Sportit Gjirokastrë (sip 1000 m²)

ZAZ nr.79, Bashkia Libohovë, VNV Pallati i Kulturës Libohovë (sip 210 m²)
ZAZ nr.80, Bashkia Dropull, VNV Shtëpia e Kulturës , Fshati Grapsh (sip 200 m²)

III. Në zbatim të nenit nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” prefekti përcakton numrin e anëtarëve të këshillit për çdo bashki nën juridiksionin e tij, mbi bazën e numrit të banorëve, sipas evidencave të zyrave të gjendjes civile të datës 1 janar të vitit kur zhvillohen zgjedhjet vendore.

Me shkresën nr.753/1 prot, datë 13.05.2019 “ Për përcaktimin e numrit të antarëve të këshillave bashkiakë” Prefekti i qarkut ka bërë përcaktimin e numrit të antarëve të këshillave bashkiakë për 7 bashkitë e qarkut, si më poshtë:

Nr.	Bashkia	Nr. i banorëve	Nr. i antarëve të këshillit bashkiak
1	Gjirokastrë	52 030 banorë	31 anëtarë
2	Dropull	22 690 banorë	21 anëtarë
3	Memaliaj	20 132 banorë	21 anëtarë
4	Përmet	19 461 banorë	15 anëtarë
5	Tepelenë	15 874 banorë	15 anëtarë
6	Këlcyrë	14 764 banorë	15 anëtarë
7	Libohovë	7 076 banorë	15 anëtarë

Nisur nga Dekreti i Presidentit me të cilin ka anuluar datën 30 qershor si datë e zgjedhjeve vendore, bashkia Gjirokastrë, bashkia Përmet dhe bashkia Dropull i janë drejtuar me kërkesë Komisioneve Zonale të Administrimit Zgjedhor të këtyrë bashkive, për dijëni Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve dhe institucionit të Prefektit të qarkut për lirim të ambienteve të cilat shërbejnë si seli të KZAZ-ve dhe VNV-ve dhe ndërprejën e veprimtarisë për afishimin e listës përfundimtare të zgjedhësve në institucionet arsimore.

Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve me shkresën “Për zbatim të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, datë 18.06.2019 nuk e ka pranuar këtë kërkesë duke e konsideruar atë në tejkallim të kompetencave, të drejtave dhe detyrave të njohura nga ligji 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” duke kërkuar nga këto bashki shmangien e veprimeve që pengojnë administrimin e procesit zgjedhor dhe përmbushjen e detyrave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës.

Bazuar në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë e cila ndihmon të gjitha organet publike për një interpretim, kuptim dhe zbatim sa më korrekt të legjislacionit, vendimit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, vendimit të Kolegjit Zgjedhor i cili e konsideroi akt absolutisht të pavlefshëm Dekretin e Presidentit për anulimin e datës së zgjedhjeve, si dhe mbështetjes së faktorit ndërkombëtar, data 30 qershor është data e zhvillimit të zgjedhjeve vendore.

Duke marrë shkas nga disa ngjarje të ditëve të fundit, të goditjes me Molotov të shkollave dhe ambienteve të tjera ku janë vendosur KZAZ-të dhe VNV-të si dhe në zbatim të detyrimeve

ligjore , në cilësinë e Prefektit të qarkut kerkoj nga ana juaj marrjen e masave për të realizur një proces zgjedhor sa me normal, nisur edhe nga fakti se jemi në mesin e sezonit turistik ku fluksi i turistëve është i konsiderueshëm.

1. Drejtoria Vendore e Policisë Gjirokastrë së bashku me Komisaritet në të gjithë qarkun të ushtrojë me përpikmëri të gjitha detyrimet ligjore në lidhje me procesin zgjedhor dhe të shmangë çdo formë presioni apo provokimi nga persona apo grupe të caktuara që mund të tentojnë të prishin rendin apo të cënojnë procesin zgjedhor.

2. Zyrat Vendore Arsimore Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet të orientojnë drejtoritë e shkollave të caktuara si Qendra Votimi për të bashkëpunuar në dorëzimin e ambienteve sipas kërkesave të ligjit Komisioneve të Qëndrave të Votimit si dhe sigurimin e materialeve mësimore që nuk do të përdoren dhe dokumentacionin shkollor me qëllim mosdëmtimin e tyre.

3. Drejtoria Rajonale dhe ato vendore të OSHEE të marrin masa për mirmbajtjen e sistemit dhe furnizimin e energji të pandërprerë të gjitha qarkut për zhvillimin normal të procesit zgjedhor dhe jetës normale të qytetarëve.

4. Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Gjirokastrë, Tepelenë dhe Përmet të marrin masa gatishmërie për shërbimin shëndetësor nisur dhe nga temperaturat e larta të këtyre ditëve si dhe të mbajnë në gatishmëri ambientet në administrim të tyre nëse do të kërkohen të vihen në dispozicion të procesit zgjedhor.

Institucioni i Prefektit të qarkut do të ndjekë dhe monitorojë në vazhdimësi veprimtarinë e institucioneve për të garantuar zhvillimin e një procesi normal zgjedhor.

17.07.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për 75-vjetorin e Heroinave të Popullit, Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima

Të nderuar familjarë të dëshmorëve,

I nderuar kryetar i Organizatës të Familjeve të dëshmorëve të LANÇ-it

Të nderuar qytetarë,

Shumë të nderuar të pranishëm në këtë ceremoni përkujtimore, jemi mbledhur në këtë shesh historik të qytetit të Gjirokastrës, për të përkujtuar 75- vjetorin e ekzekutimit nga pushtuesit gjermanë të dy simboleve të qëndresës shqiptare, Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima.

75- vite më parë në këtë shesh janë ekzekutuar me varje dy heroinat e popullit dhe ato mbetën si një rreze drite e pahuar për brezat në vite. Me kontributin e tyre duke dhënë jetën për çlirimin e vendit, thyen mjaft koncepte dhe u rradhiten përkrah burrave në atë epike heroike. Ato flakën tej zakonet dhe thyen tabutë e kohës, duke u bërë shembull frymëzimi në Luftën Nacionalçlirimtare, përkrah udhëheqësve të tyre partizanë. Kështu gruaja me plot dinjitet u rreshtua në LANÇ të popullit shqiptar.

Dua të theksoj që roli i gruas shqiptare u shqua akoma më shumë pas veprave heroike të shumë grave dhe vajzave shqiptare në historinë e popullit tonë për liri e pavarësi, për ruajtjen e individualitetit të vet, për një jetë të lirë nga shfrytëzimi dhe padrejtësitë shoqërore.

Bule Naipi bijë e një familje atdhetare nga Gjirokastra dhe Persefoni Kokëdhima nga Qeparoi i Himarës, ishin trimëresha, sypatrembura, të bukura, fisnike dhe Atdhetare, partizane të Brigadës VI-të Sulmuese. Ato ishin veprimtare të luftës duke zhvilluar takime të shumta me përgjegjës ushtarakë e të rinisë duke u ardhur në ndihmë partizanëve. Në historikun e Brigadës VI Sulmuese, Bule Naipi dhe Persefoni Kokëdhima veçohen si dy nga luftëtarët të shquara që me guximin e tyre mbrojtën idealet e Luftës NacionalÇlirimtare.

Ato qëndruan si heroina dhe si partizane të vendosura, të palëkundura me qëndresën e tyre pavarësisht torturave çnjerëzore nga pushtuesit gjermanë, u bënë shembull për të gjithë partizanet e partizanët që luftonin për çlirimin e Atdheut. Me heroizmin e tyre ato ngritën më lart figurën e gruas shqiptare.

Me përlësi nderojmë kujtimin e tyre që kontribuan në çlirimin e vendit dhe u bënë burim frymëzimi për guxim e trimëri, për ndershmëri e pastërti morale e shpirtërore, si dhe për forcimin e marrëdhënieve vëllazërore në radhët e luftëtarëve të lirisë.

Në këtë ditë të shënuar më lejoni të shpreh mirënjohjen, respektin, përlëjen ndaj dy heroinave të qytetit të gurtë dhe jo vetëm, por edhe ndaj gjithë dëshmorëve, të cilët dhanë jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Gjaku dhe vepra e këtyre heroinave le të shërbejë si shembull frymëzimi dhe të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.

I pavdekshëm qoftë kujtimi dhe vepra e Heroinave tona!

Lavdi dëshmorëve të Atdheut!

24.07.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit mbi masat që duhet të merren për turizëm më cilësor, të sigurt dhe me standarde gjatë sezonit veror 2019 me luftën kundër informalitetit fiskal.

Të nderuar drejtues të institucioneve vendore,

Takimi që organizohet sot, një takim i përbashkët i drejtorive dhe inspektoriateve rajonale, ka për qëllim që të trajtojë disa çështje të përbashkëta lidhur me menaxhimin me sukses të sezonit turistik dhe luftës kundër informalitetit.

Viti i kaluar ishte një përvojë e suksesshme e bashkëpunimit të këtyre strukturave, prej të cilit u sigurua një sezon turistik i suksesshëm me tregues të kënaqshëm, me rritje të konsiderueshme, i cili gjeneroi të ardhura të mëdha në buxhetin e shtetit por evidentoi edhe problematika, të cilat kanë qënë pjesë e programeve tuaja të punës për vitin 2019. Nisur nga tendenca e flukseve turistike ne rritje në qarkut tonë, kërkon dhe një nivel të shtuar të angazhimit të të gjithë strukturave shtetërore në qark si edhe ato të Njësisve të vetqeverisjes vendore që duhet të na bashkohen dhe të operojnë me të njëjtën nivel në rang qarku.

Nga ana tjetër ky vit është një vit i rëndësishëm politik për Shqipërinë, për arsye se është një vit në të cilin ne presim vendimin për hapjen e negociatave me BE-në.

Një sezon i mirë turistik është një kontribut për një imazh të mirë të qarkut që do të ndikoj pozitivisht në vendimmarrjen e shteteve anëtare të BE-së.

Vitin e kaluar qarkun tonë e kanë vizituar rreth 150 000 vizitorë vendas dhe të huaj. Pra, për një moment të llogarisim se çfarë impakti mund të ketë nëse të gjithë këta njerëz kur të kthehen në vendet e tyre mund të marrin me vete përshtypje positive për vendin ku kaluan disa ditë pushimesh. Destinacionet më të rëndësishme të turizmit në qarkun Gjirokastrë janë shtigjet historike në udhëtime një javore që kalojnë nëpër Lunxhëri, Zagori, Libohovë, Pogon, Cepo si dhe monumentet historike si Kalaja e Gjirokastrës, shtëpitë karakteristike, objektet e kultit fetar etj.

Sigurisht në të gjithë organizimin e sezonit turistik, roli i Institucionit të Prefektit të qarkut do të jetë rol qendror, sepse vetë funksioni i prefektit është funksion qendror; prandaj do të kërkoja një koordinim të punës mes të gjitha agjencive qoftë atyre të pushtetit qendror apo vendor, në mënyrë në mënyrë që reagimi dhe veprimi i të gjithë strukturave shtetërore të jetë në bashkërendim me njëri-tjetrin si një organizëm i vetëm. Është me shumë rëndësi të theksojmë se duhet të kemi plane të përbashkëta inspektimi dhe të evitojmë inspektimet individuale, pra të bëhen më të thelluara, por të mos rëndojnë herë pas herë, pa fund, sa mbaron njëri, fillon tjetri dhe shqetësohet. Në vend që të luhet një rol pozitiv, nganjëherë kthehet në negative për shkak të morisë së inspektorëve që rendin drejt subjekteve të ndryshme tregtare apo turistike.

Pra, është e rëndësishme të kemi një plan të mirë të akorduar nën drejtimin e Institucionit të Prefektit të qarkut për të kryer inspektime me ekipe të përbashkëta nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Drejtoria e Policisë Vendore, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Inspektoriati i Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, Inspektoriati Shtetëror i Punës, Inspektoriati Shtetëror Shëndetësor, etj. me radhë në mënyrë që ky subjekt, kur shkohet një herë për inspektim, të mbarohet punë me një herë. Në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik e një rëndësie të veçantë janë çështjet që kanë të bëjnë me qarkullimin rrugor duke qënë se flukset turistike janë një barrë e shtuar për qarkullimin rrugor të mjeteve. Drejtoria e Policisë Vendore duhet të marrë masa në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale Rrugore në mënyrë që projektet për përmirësimet infrastrukturore rrugore të zbatohen sa më shpejt dhe të ketë plane alternative për të devijuar dhe orientuar trafikun në rastet e fluksit të qarkullimit rrugor. Gjithashtu Drejtoria Vendore e Policisë krahas detyrave të saj ligjore për sigurimin e rendit publik, të marrë masa dhe të mbështesi turistët, operatorët dhe bizneset në menaxhimin e sezonit turistik. Flukset e mëdha turistike shoqërohen edhe me përpjekje jo të vogla për spekulim nga subjekte të ndryshme, qofshin turistike apo tregtare, prandaj keto struktura duhet të jenë në gatishmëri të plotë për të mbajtur nën kontroll situatën, për të mos lejuar që turistët të manipulohen dhe të mashtrohen, nga persona apo dhe subjekte të papërgjegjshme që mundohen të shfrytëzojnë mundësitë e krijuara nga flukset turistike.

Siç jeni në dijeni ka filluar zbatimi i Planit Operacional në luftë kundër Informalitetit. Monitorimi i biznesve po bëhet për të garantuar përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore dhe ligjore, regjistrimin pranë organeve kompetente, pajisjen me kasa fiskale, lëshimin e kuponëve tatimorë, si dhe regjistrimin e punonjësve.

Dua të theksoj se Drejtoria Rajonale Tatimore duhet të mbështesë dhe të inkurajojë bizneset, që përmbushin në mënyrë korrekte të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë kërkoj mirëkuptimin e çdo biznesi në qarkun tonë për të bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale Tatimore, në mënyrë që të garantohet nga të gjithë zbatimi rigoroz i ligjit.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka deklaruar se për t'i ardhur në ndihmë biznesit dhe konsumatorëve është duke u punuar në mënyrë intensive për krijimin e një aplikacioni të

dedikuar që do të quhet “Stop Informalitetit”. Ky aplikacion do të nisë të funksionojë që në muajin gusht dhe do të mund të shkarkohet, si nga individët, ashtu edhe bizneset.

“Të gjithë konsumatorët duhet ti bashkohen kësaj nisme për të sfiduar biznesin e parregullt, sepse qëllimi është që ata që tregohen korrekt të mos mbajnë barrën fiskale të atyre që nuk paguajnë. Në këtë aplikacion çdo i punësuar mund të denoncojë një biznes nëse ai nuk e ka regjistruar, nëse nuk paguhet mbi bazën e pagës reale, nëse nuk i paguan sigurimet, nuk i paguan tatimet sipas ligjit. Përmes këtij aplikacioni mund të bëhen edhe denoncime nëse konstatohen sjellje abuzive dhe korruptive nga ana e administratës tatimore”.

Ky aplikacion do të nisë të funksionojë që në muajin gusht dhe do të mund të shkarkohet, si nga individët, ashtu edhe bizneset.

Dua të theksoj se Drejtoria Rajonale Tatimore duhet të mbështesë dhe të inkurajojë bizneset, që përmbushin në mënyrë korrekte të gjitha detyrimet sipas legjislacionit në fuqi.

Prandaj në këto plane të përbashkëta Operacionale që do të vijojnë të zbatohen në terren, në të gjithë qarkun, për të garantuar konkurrencën e ndershme, rritjen e të ardhurave, si dhe për të luftuar informalitetin, që shkon në dëm të zhvillimit të ekonomisë.

Këtë takim e kam organizuar edhe me prezencën e mediave, për të ndarë me ju dhe publikun e gjerë, një mesazh të qartë, se lufta kundër informalitetit nuk është një plan i përkohshëm masash por vullnet i fortë i Qeverisë Shqiptare për të garantuar rregulla të barabarta në treg, për të mbështetur biznesin që respekton rregullat dhe punon çdo ditë për të siguruar fitime në mënyrë të ndershme.

Asnjë sipërmarrës nuk mundet që të pasurohet duke shkelur ligjet në kurriz të të tjerëve. Nuk do të ketë më bare, lokale apo hotele që operojnë në treg pa NIPT-e apo subjekte që nuk deklarojnë punonjësit. Kjo bie ndesh me parimet e barazisë në treg, bie në kurriz të qytetarëve që kërkojnë me të drejtë shërbime publike të barabarta, sepse ata paguajnë TVSH në çdo blerje që bëjnë, por kjo humbet në xhepat e biznesit që nuk e deklarojnë atë.

Do të kërkoja nga Task Forca Rajonale, që çdo ditë të premtë të informohet institucionit i Prefektit të qarkut mbi rezultatet e inspektimeve dhe njëkohësisht të informohen qytetarët mbi masat e mara në funksion të luftës kundër informalitetit. Gjithashtu kërkoj nga Drejtoria Rajonale Tatimore të sqarojë dhe informoj tatimpaguesit dhe bizneset mbi legjislacionin përkatës për formalizimin e subjekteve, me qëllim shmangien e masave administrative që do të rëndojnë në kurriz të bizneseve dhe qytetarëve. Institucioni kontrollor për mjedisin, pyjet, ujrat, zonat e mbrojtura është një drejtim tjetër shumë i rëndësishëm për mbrojtjen nga dëmtimet pa kriter por njëkohësisht i jep mundësi turistit të kënaqet me bukuritë natyrore. Sigurisht një çështje tjetër që duhet të konsiderohet si shkelje janë edhe zhurmat nga lokalet e natës, që nuk duhet të shndërrohen kurrë dhe kënaqësia e njëjës palë nuk duhet të shndërrohet në bezdinë e një pale që nuk bën pushime.

30.07.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin në kuadër të konstituimit të Këshillit Bashkiak dhe betimit të Kryetarit të Bashkisë Libohovë

I nderuar Ministër, Z. Blendi Çuçi,

E nderuara Sekretare e Këshillit Bashkiak,

Të nderuar Këshilltarë bashkiak,

I nderuar Kryetar i rizgjedhur i bashkisë Tepelenë, Z. Tërmet Peçi,

Të nderuar të ftuar dhe qytetarë të Tepelenës,

Më lejoni që në emër të institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë, t'ju uroj punë të mbarë në mbledhjen e parë për konstituimin e këshillit të bashkisë tuaj. Ky është një moment i rëndësishëm solemn, sepse prej sot ju këshilltarë do të jeni zëri i çdo qytetari Tepelenas!

Në përfundim të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 dhe të shpallur me vendimin nr. 1097, datë 27.07.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe vendimin e Kolegjit Zgjedhor nr. 46, datë 25.07.2019 “ Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Tepelenë, Qarku Gjirokastrë, theksoj se në gjithë qarkun këto zgjedhje u zhvilluan të qeta, të lira e demokratike dhe kjo është një arritje që na gëzon. Zhvillimi i suksesshëm i zgjedhjeve demokratike përbën një kontribut për stabilitetin e vendit tonë dhe për të ardhmen europiane.

Kam bindjen se këshillat e reja të njësive të vetëqeverisjes vendore në qarkun tonë, do t'i plotësojnë më së miri kërkesat e komunitetit, do të kenë vendimarrje më efikase në shërbim të tyre duke merituar kështu besimin që iu ka dhënë qytetarët. Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore janë shtyllat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe në këtë kuadër ju do të kontribuoni me mendime e vendime sa më të drejta për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të komunitetit.

Dua të uroj z. Tërmet Peçi për rikonfirmimin në detyrën e Kryetarit të Bashkisë Tepelenë. Falë punës së mirë të bërë katër vitet e shkuara, qytetarët e Tepelenës e rishprehën edhe një herë forcën e tyre të vullnetit duke ia besuar përsëri detyrën e Qytetit të parë të Bashkisë Tepelenë, z. Tërmet Peçi, për të vijuar më tej me ide, programe e projekte. Bashkia Tepelenë i ka hedhur themelet e saj të transformimit, por ky mandat tjetër do të garantojë një zhvillim më të qëndrueshëm në të gjitha Njësitë Administrative. Të tjera sfida edhe më të mëdha kërkojnë angazhimin tuaj maksimal, ndaj le të jetë ky mandat edhe më i suksesshëm se ai që sapo kaloi.

Misioni i njësive të vetëqeverisjes vendore është të dëgjojë kërkesat e qytetarëve dhe të punojë për gjetjen e mekanizmave për realizimin e tyre. Përvoja e mirë e viteve të kaluara në drejtim duhet të shërbejë si një “lessons learned” mësimet e mësuara dhe aty ku ka patur problem të përmirësohet puna e çdo nënpunësi të administratës. Ofrimi i një shërbimi cilësor ndaj qytetarëve, rritja e profesionalizmit në rradhët e administratës dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstucional do të sjellë progres të sigurt në punën tuaj!

Në emër të Qeverisë dhe si përfaqësues i saj në qarkun e Gjirokastrës, shpreh bindjen se veprimtaria juaj do të jetë konkrete për zgjidhjen e kërkesave të elektoratit që ju përfaqësoni. Njëkohësisht me ndershmëri, përgjegjësi morale e politike dhe profesionalizëm ju do të dini të justifikoni besimin që qytetarët tepelenas ju kanë dhënë.

Edhe një herë ju uroj punë të mbarë këshilltarëve bashkiak dhe kryetarit të Bashkisë Tepelenë, Z. Tërmet Peçi!

30.07.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin në kuadër të konstituimit të Këshillit Bashkiak dhe betimit të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj

I nderuar Ministër, Z. Blendi Çuçi,

E nderuara Sekretare e Këshillit Bashkiak,

Të nderuar Këshilltarë bashkiak,

I nderuar Kryetar i bashkisë Tepelenë, Z. Gjolek Guci,

Të nderuar të ftuar dhe qytetarë të Memaliaj,

Më lejoni që në emër të institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë, t'ju uroj punë të mbarë në mbledhjen e parë për konstituimin e këshillit të bashkisë tuaj. Ky është një moment i rëndësishëm solemn, sepse prej sot ju këshilltarë do të jeni zëri i çdo qytetari Memaliaj!

Në përfundim të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 dhe të shpallur me vendimin nr. 1097, datë 27.07.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe vendimin e Kolegjit Zgjedhor nr. 23, datë 22.07.2019 “ Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Memaliaj, Qarku Gjirokastrë, theksoj se në gjithë qarkun këto zgjedhje u zhvilluan të qeta, të lira e demokratike dhe kjo është një arritje që na gëzon. Zhvillimi i suksesshëm i zgjedhjeve demokratike përbën një kontribut për stabilitetin e vendit tonë dhe për të ardhmen europiane.

Kam bindjen se këshillat e reja të njësive të vetëqeverisjes vendore në qarkun tonë, do t'i plotësojnë më së miri kërkesat e komunitetit, do të kenë vendimarrje më efikase në shërbim të tyre duke merituar kështu besimin që iu ka dhënë qytetarët. Këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore janë shtyllat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe në këtë kuadër ju do të kontribuoni me mendime e vendime sa më të drejta për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të komunitetit.

Gjithashtu, dëshiroj të uroj z. Gjolek Guci për zgjedhjen në detyrën e Kryetarit të Bashkisë Memaliaj. Si djalë i kësaj bashkie edhe pse kishte shumë vite larguar, ai asnjëherë nuk e harroi vendlindjen e tij, por si një inxhinjer punoi me përkushtim dhe u afirmua si një person që mund të merrte përgjegjësi të lartë ndaj qytetarëve të tij. Qytetarët e Memaliaj shprehën vullnetin e tyre duke ia besuar detyrën e Qytetit të parë të Bashkisë Memaliaj, z. Gjolek Guci, për të sjellë ndryshime pozitive jo vetëm për qytetin por për gjithë territorin e saj. Me këtë mandat ai do të duhet t'ju tregoi qytetarëve të tij se fjalën e dhënë në çdo takim për të vijuar që nga dita e parë dhe deri në fund të mandatit një qytetar i thjeshtë si ata, por me një përgjegjësi më të madhe. Sfidat në jetë e kanë bërë që të dijë të kaloi situatë të vështira dhe uroj që ky mandat ta çojë nga suksesi në suksese për të mirën e qytetarëve të tij.

Misioni i njësive të vetëqeverisjes vendore është të dëgjojë kërkesat e qytetarëve dhe të punojë për gjetjen e mekanizmave për realizimin e tyre. Përvoja e mirë e viteve të kaluara në drejtim nga z. Durim Roshi, duhet të shërbejë si një “lessons learned” mësimet e mësuara dhe aty ku ka patur problem të përmirësohet puna e çdo nënpunësi të administratës. Ofrimi i një shërbimi cilësor ndaj qytetarëve, rritja e profesionalizmit në rradhët e administratës dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstucional do të sjellë progres të sigurt në punën tuaj!

Në emër të Qeverisë dhe si përfaqësues i saj në qarkun e Gjirokastrës, shpreh bindjen se veprimtaria juaj do të jetë konkrete për zgjidhjen e kërkesave të elektoratit që ju përfaqësoni. Njëkohësisht me ndershmëri, përgjegjësi morale e politike dhe profesionalizëm ju do të dini të justifikoni besimin që qytetarët tepelenas ju kanë dhënë.

Edhe një here ju uroj punë të mbarë këshilltarëve bashkiak dhe kryetarit të ri të Bashkisë Memaliaj, Z. Gjolek Guci!

30.07.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin në kuadër të konstituimit të Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë Libohovë

E nderuara Deputete, znj.Mirela Kumbaro,

I nderuar Sekretar i Këshillit Bashkiak,

Të nderuar Këshilltarë bashkiak,

E nderuar Kryetare e rizgjedhur e bashkisë Libohovë, Znja Luiza Mandi,

Të nderuar të ftuar dhe qytetarë të Libohovës,

Më lejoni që në emër të institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë, t'ju uroj punë të mbarë në mbledhjen e parë për konstituimin e këshillit të bashkisë tuaj. Ky është një moment i rëndësishëm solemn, sepse prej sot ju këshilltarë do të jeni zëri i çdo qytetari Libohoviti!

Në përfundim të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019 dhe të shpallur me vendimin nr. 1097, datë 27.07.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe vendimin e Kolegjit Zgjedhor nr. 65, datë 26.07.2019 “ Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Libohovë, Qarku Gjirokastrë, theksoj se në gjithë qarkun këto zgjedhje u zhvilluan të qeta, të lira e demokratike dhe kjo është një arritje që na gëzon. Zhvillimi i suksesshëm i zgjedhjeve demokratike përbën një kontribut për stabilitetin e vendit tonë dhe për të ardhmen europiane.

Kam bindjen se këshillat e reja të njësisve të vetëqeverisjes vendore në qarkun tonë, do t'i plotësojnë më së miri kërkesat e komunitetit, do të kenë vendimarrje më efikase në shërbim të tyre duke merituar kështu besimin që iu ka dhënë qytetarët. Këshillat e njësisve të vetëqeverisjes vendore janë shtyllat e decentralizimit të pushtetit vendor dhe në këtë kuadër ju do të kontribuoni me mendime e vendime sa më të drejta për zgjidhjen e problemeve të ndryshme të komunitetit.

Gjithashtu, dëshiroj t'i uroj suksese znj. Luiza Mandi, për rikonfirmimin në detyrën e Kryetarit të Bashkisë Libohovë. Qytetarët e Libohovës ditën ta vlerësonin punën e mirë të bërë prej administratores së tyre gjatë këtyre katër viteve të shkuara duke ia besuar për të dytën herë detyrën e Kryebashkiakes. Të tjera sfida edhe më të mëdha kërkojnë angazhimin tuaj maksimal, ndaj le të jetë ky mandat edhe më i suksesshëm se ai që sapo kaloi.

Misioni i njësisve të vetëqeverisjes vendore është të dëgjojë kërkesat e qytetarëve dhe të punojë për gjetjen e mekanizmave për realizimin e tyre. Përvoja e mirë e viteve të kaluara në drejtim duhet të shërbejë si një “lessons learned” mësimet e mësuara dhe aty ku ka patur problem të përmirësohet puna e çdo nënpunësi të administratës. Ofrimi i një shërbimi cilësor

ndaj qytetarëve, rritja e profesionalizmit në rradhët e administratës dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional do të sjellë progres të sigurt në punën tuaj!

Në emër të Qeverisë dhe si përfaqësues i saj në qarkun e Gjirokastrës, shpreh bindjen se veprimtaria juaj do të jetë konkrete për zgjidhjen e kërkesave të elektoratit që ju përfaqësoni. Njëkohësisht me ndershmëri, përgjegjësi morale e politike dhe profesionalizëm ju do të dini të justifikoni besimin që qytetarët libohovit ju kanë dhënë.

07.08.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për 76-vjetorin e themelimit të batalionit “Asim Zeneli”

Të nderuar familjarë të dëshmorëve,

I nderuar Kryetar i bashkisë Gjirokastrë,

I nderuar Kryetar i Organizatës të Familjeve të dëshmorëve të LANÇ

Të nderuar veteranë dhe të pranishëm,

Ndjehem i privilegjuar dhe njëkohësisht i emocionuar që ndodhem sot mes jush për të kujtuar dhe festuar së bashku 76-vjetorin e themelimit të batalionit “Asim Zeneli”.

Batalioni “Asim Zeneli” u formua më 7 gusht 1943 te rrepet e Kardhiq - Prongjisë, ku u mblodhën luftëtarë nga Kurveleshi, Kardhiqi, Gjirokastra e Bregu i detit të çetave partizane, me në krye Riza Veipi dhe komandant Shefqet Peçi, si një nevojë e bashkimit për luftën kundër pushtuesve nazifashistë.

Është e rëndësishme të përmend se themelimi i këtij batalioni është një arritje historike për popullin shqiptar, një rezultat i luftës patriotike dhe i përpjekjeve për liri e shtet-formim. Kështu luftimet e zhvilluara nga ky batalion së bashku me batalionet e tjera si ai i Misto Mames dhe me forcat territoriale të krahinës së Kardhiqit e të Lunxhërisë kundër forcave balliste e naziste janë të shumta.

Si luftimet më të ashpra të këtij batalioni mundt të përmendet ai i 2 tetorit 1943 në kështjellën e Manastirit të Cepos kundër pushtuesve gjermanë si dhe ai i 16 tetorit 1943 kundër forcave tradhëtare në katundin Gjorm të Vlorës. Në këto luftime, batalioni Asim Zeneli la shumë të vrarë e humbje të mëdha materiale për armikun por edhe në rradhët e batalionit, ranë disa dëshmorë si Demo Fejzo, Murat Bardhi, Hiqmet Dusha, Kapo Gaba e shumë partizanë të tjerë.

Luftime janë zhvilluar jo vetëm në zonën e Gjirokastrës, por janë shtrirë edhe më gjerë si në Këlcyrë, në Tendën e Qypit dhe më 14 dhjetor batalioni “Asim Zeneli” kaloi Malin e Gjerë për të vepruar në Rrëzomë e në Delvinë.

Batalioni “Asim Zeneli” ishte në malet e Frashërit, ku u rreshtua në brigadën e 6-të sulmuese në 26 janar 1944 duke qenë batalioni i parë. Në këtë brigadë, batalioni “Asim Zeneli” përshkoi rrugë të gjatë luftarake nga Jugu në Veri prej qindra kilometrash duke qenë gjithmonë në krye të luftimeve që zhvilloi kjo brigadë brenda e jashtë Atdheut.

Kjo është një epike e lavdishme e historisë tonë, ku të gjitha ato vajza e djem të labërisë trime, të cilët u përfshinë në luftë dhe që iu kundërvunë me heroizëm fashistëve italianë, dhe

nazistëve gjermanë, do të mbeten përherë në mendjet e zemrat tona dhe do të gëzojnë respektin më të madh.

Për të gjithë shqiptarët Lufta Antifashiste Nacional Çlirimtare është një periudhë e ndritur në historinë e kombit tonë, në të cilën djem e vajza nga jugu në veri u renditën në krah të shteteve aleate si ShBA, Franca e Anglia kundër bllokut nazi-fashist i përbërë nga Gjermania, Italia dhe Japonia. Falë trimërisë së këtyre partizanëve, këtë vit festojmë 75-vjetorin e çlirimit të Shqipërisë, lirinë dhe pavarësinë e saj që gëzojmë ne sot.

Sot pas 76 vjetësh të krijimit të batalionit të Asim Zenelit, me gjithë vështirësitë e rrugës sonë si komb, mund të themi se disa nga aspiratat e këtyre vajzave dhe djemve të labërisë janë realizuar.

Në këtë ditë të shënuar më lejoni të shpreh mirënjohjen, respektin, përlujten ndaj dëshmorëve, që dhanë jetën në shërbim të Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Gjaku dhe vepra e dëshmorëve do të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.

Lavdi Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare!

Lavdi partizanëve të Batalionit "Asim Zeneli"!

13.08.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për 76-vjetorin e themelimit të batalionit "Misto Mame"

Të nderuar familjarë të dëshmorëve,

I nderuar Kryetar i bashkisë Gjirokastrë,

I nderuar Kryetar i Organizatës të Familjeve të dëshmorëve të LANÇ,

Të nderuar veteranë dhe të pranishëm,

Jemi mbledhur sot për të përkujtuar një nga ngjarjet historike më të rëndësishme, 76-vjetorin e formimit të batalionit "Misto Mame", i cili ka një rëndësi të veçantë jo vetëm në historinë e krahinës së Lunxhërisë, por që ka dhënë një kontribut të madh në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Më 13 gusht 1943 u krijua batalioni partizan me emrin e Heroit të Popullit, Misto Mame, në kujtim të të cilit është ngritur një lapidar madhështor në fshatin Stegopul. Ky batalion u krijua në kulmin e luftës kundër pushtuesve nazi-fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, si një formacion luftarak që mori përsipër një mision të lartë atdhetar.

Batalioni "Misto Mame" u krijua mbi bazën e katër çetave partizane, si ajo e "Prokop Meksit", "Mihal Durit", "Lato Brahos" e "Sabaudin Gabranit, të dala nga gjiri i krahinave të Rrëzës, Lunxhërisë, Libohovës e më gjerë, krahina këto baza të rëndësishme të LANÇ, me 384 djem e vajza trime të këtyre krahinave, të cilët, të frymëzuar nga heroizmi i djemve lunxhotë Misto Mame e Mihal Duri, morrën armët dhe luftuan me heroizëm për çlirimin e atdheut, nga të cilët shumë prej tyre ranë në fushën e betejës për një Shqipëri të lirë dhe demokratike.

Komandant i këtij batalioni u caktua patrioti trim Lipe Boga, komisar intelektual i mirënjohur gjirokastrit Zini Sako, zv/komisar Vasil Kati dhe zv/komandant Misto Çipi. Kuadrot komanduese të këtij batalioni bashkëpunuan ngushtë me forcat e tjera partizane, si dhe duke i ardhur në ndihmë dhe brigadës së 8-të sulmuese për të luftuar rrezikun kombëtar, kundër forcave pushtuese nazi-fashistë. Në këto luftime të këtij batalioni u shpalos shpirti i sakrificës dhe i vetmohimit, i guximit dhe patriotizmit të partizanëve, duke hapur një faqe të ndritur në historinë e Shqipërisë, atë të çlirimit të Shqipërisë.

Në kuadër të kësaj fitoreje të madhe të LANÇ-it, ku përfshihej edhe Batalioni "Misto Mame" është gjaku i 28 mijë dëshmorëve, midis të cilëve edhe i 61 bijve e bijave të pavdekshëm të këtij batalioni, ndaj të cilëve përulemi me respekt të thellë për aktin sublim të tyre.

Prandaj, të mbrosh sot gjakun e dëshmorëve dhe idealet e vlerat e LANÇ-it është një detyrë patriotike ndaj të rënëve që përcjellin frymëzim dhe kurajo në mbrojtje të integritetit e sovranitetit të vendit tonë.

Kështu për të gjithë shqiptarët Lufta Antifashiste Nacional Çlirimtare është një periudhë e ndritur në historinë e kombit tonë. Është e rëndësishme të theksoj që falë kontributit të këtij batalioni dhe forcave partizane të tjera festojmë këtë vit 75-vjetorin e çlirimit të Shqipërisë.

Gjaku dhe vepra e dëshmorëve do të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.

Lavdi Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare!

Lavdi përjetë heronjve dhe dëshmorëve të batalionit "Misto Mame"!

15.08.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin me Kryetarët e bashkive të qarkut Gjirokastrë

E nderuar znj. Romina Kuko, Zv/Ministre e Brendshme,

Të nderuar Kryetarë,

Të nderuar nënprefektë,

Fillimisht më lejoni të falënderoj znj. Kuko për angazhimin dhe bashkëpunimin që ka treguar gjithmonë për qarkun e Gjirokastrës.

Sot po zhvillojmë këtë takim me kryetarët e bashkive të qarkut Gjirokastrë, të cilëve në radhë të parë dëshiroj t'ju përcjell sërish në emrin tim dhe të Institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë, urimet më të përzemërta dhe t'ju uroj suksese për detyrën e lartë dhe me përgjegjësi të drejtimit të bashkive përkatëse.

Kam besim të plotë se ju do t'ia dilni kësaj sfide të rëndësishme me të njëjtit sukses që keni përballuar edhe sfida të tjera në karrierën tuaj.

Pas një procesi zgjedhor ligjor në 30 qershor 2019 për zgjedhjet e organeve drejtuese të njësisë të vetëqeverisjes vendore, ky proces u finalizua me mbledhjet e para të konstituimit të këshillave bashkiakë, zgjedhjeve të kryetarëve të këtyre këshillave, ceremoninë e betimit të kryetarëve të bashkive dhe zgjedhjen e antarëve për këshillin e qarkut.

Institucioni i Prefektit të qarkut, gjatë gjithë këtij procesi ka zbatuar me përpikmëri detyrimet që i përcaktohen nga Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë dhe ligji 107/2016 "Për prefektin e qarkut".

Dua të falënderoj stafin e sektorit juridik të institucionit të Prefektit për një punë të lavdërueshme për përgatitjen e projekt-udhëzimit për konstituimin e organeve të vetëqeverisjes vendore si një detyrë e lënë nga Ministri i Brendshëm z.Sander Lleshaj. Na vjen mirë që ky projekt-udhëzim u miratua dhe u shpërnda në të gjitha prefekturat e vendit duke sjellë një risi në zhvillimin e ceremonisë dhe ndihmoi në unifikimin dhe standartizimin e kësaj procedure në rang vendi.

Tanimë në qark kemi të gjitha stafet e bashkive në punë dhe uroj që votat e popullit të kthehen në mirëqënie për qytetarët nëpërmjet vendimeve dhe punëve që do të kryeni gjatë këtij mandati 4-vjeçar.

Bindjen time e kam shprehur edhe në fjalët e mia përshëndetëse për secilin prej jush, si për ata që do të vazhdojnë në detyrë edhe për ata që për herë të parë kanë kandiduar dhe kanë fituar për kryetar bashkie.

Si përfaqësues i Këshillit të Ministrave në nivel qarku, ju ofroj gjithë mbështetjen time dhe të Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastër në realizimin e misionit tuaj të rëndësishëm. Dëshiroj që bashkëpunimi midis institucioneve tona të forcohet më tej për të mirën e komunitetit të qarkut tonë.

Në këtë kontekst, vlen të theksojmë se në bazë të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e qarkut” misioni i prefektit është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Këshillit të Ministrave, në nivel qarku.

Marrëdhëniet e institucionit të Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore bazohet në ligjin 107/2016 “Për prefektin e qarkut” dhe ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në të cilat parashikohet se këto marrëdhënie bazohen në parimin e konsultimit dhe të bashkëpunimit për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.

Pranë institucionit të Prefektit janë ngritur dhe funksionojnë disa Task Forca, Komitete dhe Grupe pune bazuar në legjisllacionin përkatës, të cilat drejtohen nga Prefekti i qarkut dhe në të cilat bëjnë pjesë kryetarët e bashkive dhe drejtues të degëve territoriale. Në cilësinë e kryetarit të Task Forcave të cilat janë ngritur për trajtimin e problematikave të ndryshme që përfshijë edhe kompetencat që ushtrohen nga ana juaj, kërkoj angazhimin tuaj maksimal. Prezenca juaj në këto takime, përveçse detyrim ligjor do të jetë edhe një kontribut për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tyre në vazhdimësi.

Në zbatim të nenit 23 të ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut” pranë Prefektit të qarkut funksionon organi këshillues i tij. Në bazë të ligjit, në këtë organ marrin pjesë edhe kryetari i këshillit të qarkut dhe kryetarët e bashkive. Unë mendoj se kontributi juaj personal në këtë organ do të jetë shumë i vlefshëm për dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve për trajtimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme që lidhen me qarkun tonë.

Në këtë kuadër pranë Prefektit funksionin Komisioni për Planifikimin dhe Përballimin e Emergjencave Civile dhe Krizave në rang qarku pjesë e të cilit jeni edhe Ju. Puna për përballimin dhe menaxhimin e emergjencave civile mbetet një sfidë e vazhdueshme e cila është prioritet i qeverisë shqiptare si dhe të gjithë aktorëve të sistemit të mbrojtjes civile.

Së fundi është miratuar ligji i ri “Për mbrojtjen civile” i cili ka për qëllim reduktimin e riskut nga fatkeqësitë. Ky ligj detyron njësitë e vetëqeverisjes vendore të planifikojnë të paktën 4% të totalit të buxhetit vjetor për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, duke përfshirë investimet parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese nga fatkeqësitë, si psh krijimin e rezervave për dhënien e ndihmës së parë në rast fatkeqësish si dhe fondin e ndihmës financiare për dëmshpërblimin e familjeve me banesa të dëmtuara nga fatkeqësi të ndryshme.

Reforma administrative dhe puna e qeverisë për të kontrolluar territorin kanë dhënë padyshim rezultate shumë pozitive. Bashkitë kanë detyrim që ta çojnë më tej këtë betejë dhe të bëjnë më të mirën e mundshme, për të korrigjuar gabimet e së shkuarës.

Institucioni i Prefektit të qarkut beson se megjithëse EC janë sfida të vështira, mund të evitohen dhe përballohen me sukses, nëse vlerësohen seriozisht dhe merren në kohë të gjitha masat mbrojtëse.

Në zbatim të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut” Prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore, pa penguar zbatimin e tyre, duke respektuar procedurën e parashikuar në ligj. Nga eksperiencia e deritanishme rezulton se depozitimi i akteve nga ana e këshillave bashkiak ka qënë korrekt në pikpamje të afateve dhe procedurës së kërkuar, por jo gjithmonë në drejtim të bazueshmërisë së tyre ligjore. Një numër i konsiderueshëm aktesh të këshillave bashkiakë janë kthyer të pakonfirmuara nga institucioni i Prefektit për shkak të mungesës së bazueshmërisë së tyre ligjore. Problemet që hasen më shpesh në aktet e pakonfirmuara kanë të bëjnë me mungesën e mbështetjes ligjore të vendimeve që këshillat marrin, zbatimin jo të saktë të ligjit, mospërputhja e dispozitivit të vendimit me bazën ligjore të tij, në disa raste pasaktësi në formën e paraqitjes së aktit. Në shumicën e rasteve mungon relacioni apo dokumentacioni shoqërues si pjesë e rëndësishme e vendimit.

Lidhur me këtë, do të kërkoja nga ana juaj të rritet vëmendja në drejtim të përpilimit të akteve konform legjislacionit përkatës nga ana e administratës së bashkisë përpara se ato të kalojnë për miratim në këshillin bashkiak. Gjithashtu, të punohet nga ana e këshillave por edhe e specilistëve të bashkisë për të bërë një interpretim korrekt të ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, neni 16 sipas të cilit duhet të paraqiten për verifikim të ligjshmërisë pranë institucionit të Prefektit vetëm aktet me karakter normative dhe jo aktet me karakter individual. Gjithashtu tërheqim vëmendjen se në zbatim të kësaj dispozite, mbartin detyrimin për paraqitjen e akteve me karakter normative për verifikimin e ligjshmërisë pranë Prefektit jo vetëm këshilli bashkiak si organi përfaqësues i bashkisë por edhe kryetari i bashkisë si organi ekzekutiv i saj.

Ligji “Për prefektin e qarkut” parashikon se Prefekti duhet të verifikojë pranë bashkive realizimin e funksioneve e të përgjegjësisve të deleguara nga pushteti qendror dhe përdorimin e fondeve të parashikuara për këto funksione, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave si dhe përdorimin e fondeve, donacioneve apo kredive që rrjedhin nga marrëveshje të qeverisë me organizma ndërkombëtarë.

Lidhur me këtë funksion, nga ana e qeverisë po punohet për hartimin e VKM-së e cila do të përcaktojë modalitetet e ushtrimit të kësaj përgjegjësie nga ana e Prefektit.

Në këtë kuadër, do të kërkoja nga ana juaj shtimin e përgjegjësisë në ushtrimin ndër të tjera edhe të funksioneve të deleguara nga pushteti qendror dhe fondeve që shoqërojnë këto funksione në mënyrë që të maksimalizohet përfitimi që qytetarët marrin nga këto funksione.

Prioritet në punën e institucionit të Prefektit mbetet trajtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve. Gjatë trajtimit të këtyre kërkesë-ankesave kemi konstatuar se një pjesë e tyre lidhen me kompetenca që i përkasin pushtetit vendor. Kërkojmë bashkëpunimin tuaj që ankesat që ju përcillen nga institucioni i Prefektit të trajtohen në një kohë sa më të shpejtë për të rritur cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve konform akteve ligjore në fuqi dhe të na informoni për zgjidhjen e tyre.

Gjithashtu në zbatim të programit politik të qeverisë në nivel vendor kërkojmë vëmendjen tuaj për disa nga problemet që janë në ndjekje e mbikqyrje.

Jemi koshientë për sa po ndodh sot në botë ku ngrohja globale po reflekton pasojat në prishjen e ekuilibrave duke patur një luhajtje të madhe të temperaturave të cilat bëhen shkak për fatkeqësi natyrore si rezultat i këtyre ndryshimeve klimaterike, si psh përmbytje, zjarrje, shkarje të tokës të cilat kanë pasojat deri në humbje të jetës së njerëzve. Me shumë nga këto pasojat po përballemi edhe ne. Këto probleme kërkojnë njohje të thella teknike e logjistike, por njëkohësisht stafe të përgatitura për të parandaluar apo për të eliminuar pasojat në një kohë sa më të shkurtër.

Ndarja e re administartivo-territoriale ka bërë që bashkitë tashmë të kenë në administrim një territor shumë më të gjerë duke përfshirë edhe territoret e ish komunave por njëkohësisht kompetenca shumë më të zgjeruara. Në këtë kontekst pasuritë si pyje, kullota, ujra janë në adminsitrimin tuaj prandaj do të kërkoja ngritjen e kapaciteteve njerëzore e teknike për të mirëadministruar këto pasuri për t'i vënë në shërbim të komunitetit, por njëkohësisht edhe për t'i mbrojtur ato.

Së fundi dëshiroj të sjell në fokusin e punës tuaj disa problematika të rëndësishme siç janë:

- Përfundimi i hartimit të Planeve të Përgjithshme Vendore për çdo bashki.
- Ndjekja dhe finalizimi i procesit të adresarit sipas Planit të masave të Ministrisë së Brendshme ku afati përfundimtar është 31 tetor 2019.
- Marrja e masave për përgatitjen e infrastrukturës në objektet shkollore e parashkollore për fillimin e vitit të ri arsimor.
- Përcaktimin e venddepozitimeve të mbetjeve urbane sipas standarteve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.
- Kujdes i veçantë duhet treguar në drejtim të ambulancave dhe qendrave shëndetësore në territorin që mbulojnë bashkitë tuaja.
- Resurset natyrore dhe objektet e trashëgimisë kulturore që janë të shumta në territorin e qarkut tonë kërkojnë një vëmendje të veçantë me qëllim zhvillimin e turizmit gjithëvjetor.
- Jemi në fazën e rinovimit të pasaportave dhe kartave të identitetit ku afati përfundimtar është data 31 tetor 2019. Ky proces kërkon angazhim maksimal nga ana e punonjësve tuaj të zyrave të gjendjeve civile dhe ku shihet e nevojshme shtyrjen e pushimeve vjetore për këta punonjës.

Edhe njëherë, dua të ritheksoj se respektimi i ligjit dhe përmbushja e detyrimeve tona funksionale nuk është vetëm një detyrë institucionale, por edhe detyrim moral i gjithësecilit ndaj qytetarëve tanë.

03.09.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për 99-vjetorin e Luftës së Vlorës

Të nderuar deputetë,

I nderuar Prefekti i qarkut Vlorë z. Flamur Mamaj,

I nderuar Kryetar i bashkisë z. Dritan Leli,

Të nderuar pjesëmarrës,

Së pari më lejoni t'ju shpreh si Prefekti i qarkut Gjirokastrë dhe njëkohësisht si djalë vlonjat t'ju përcjell përshëndetjet më të përzemërta të qytetarëve të qarkut Gjirokastrës për të festuar së bashku 99-vjetorin e epopesë më të lavdishme të shqiptarëve, “Luftën e Vlorës”.

Sa herë kam kënaqësinë dhe nderin të vij në qytetin e Flamurit përjetoj ndjenja drithëruese dhe emocionuese, pasi në vargun e luftërave dhe përpjekjeve të shqiptarëve për lirinë dhe pavarësinë e tyre kombëtare, bën pjesë edhe epopeja legjendare e Vlorës e vitit 1920, e cila, pas Kongresit Historik të Lushnjës, shënoi një nga faqet e ndritura në historinë e popullit shqiptar.

Kongresi i Lushnjës, janar 1920, me vendimet e veta, shënoi një kthesë të re në jetën historike shqiptare, duke hedhur poshtë vendimet e Konferencës së Paqes në Paris për copëtimin e trojeve shqiptare, duke rritur ndërgjegjen kombëtare të shqiptarëve. Në këto kushte, pas Kongresit të Lushnjës, atdhetarët vlonjatë, por jo vetëm, së bashku me krahinat e tjera filluan përpjekjet për organizimin e qëndresës kundër pushtuesve italianë. Në maj të vitit 1920 Komiteti “Mbrojtja Kombëtare” organizoi kryengritjen çlirimtare kundër pushtuesve italianë me kryetarë Osman Haxhiu, e anëtarë Sali Bedini, Hamit Selmani, Duro Shaska, e shumë patriotë të tjerë.

Këta burra trima me pushkë e gunë luftuan më mirë se 100 gjeneralë e komandantë të shkolluar dhe të stërvitur në shkollat më të mira të Europës. Burrat e gratë mendjeprehtë të labërisë trime ua treguan vendin gjithë atyre që kërkonin përçarjen, pushtimin dhe asimilimin e popullit tonë, se zemra e tyre rrihte fortë për atdheun.

Në këtë betejë me forca të pabarabarta ranë katërqind dëshmorë nga radhët e luftëtarëve trima. E shtrenjtë ishte jeta për secilin prej tyre, por për ta edhe më e shtrenjtë ishte liria e tokës mëmë. Në këtë luftë spikati trimëria e Selam Musait, i cili dha jetën për çlirimin e vendit më 12 qershor 1920, dhe u bë simbol i patriotizmit, vendosmërisë dhe heroizmit popullor të Labërisë e mbarë Shqipërisë.

Luftëtarët e luftës së Vlorës, ata që sollën riçlirimin e Shqipërisë, përgjigjen e dhanë me pushkë, këngë e diplomaci, flijuan jetën bashkë me atë pak pasuri që patën. Është ky një moment reflektimi për të respektuar e vlerësuar pishtarët e Atdheut, kontributet e brezave të mëparshëm. Ata janë gurë kilometrik që i shërbejnë të tashmes e të ardhmes, udhërrëfyes të ligjëruar nga koha dhe nga historia.

Pra Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës dëshmuar për zhvillimin politik të shoqërisë shqiptare, për rritjen e ndërgjegjes kombëtare që sollën bashkimin e të gjitha shtresave të popullit shqiptar për të përballuar rreziqet që mund t'i kanoseshin atdheut tonë.

Të vlerësosh e të përkujtos ngjarjet madhore të historisë së popullit tonë shqiptar do të thotë të nderosh e lartësosh Shqipërinë. Rezultat i idealeve që udhëhoqën luftën e tyre është shteti shqiptar sot.

Fjalët nuk mjaftojnë për të shprehur thellësinë e shpirtit, por ne si pasardhësit e tyre duhet ta tregojmë me vepra mirënjohjen për ta. Me këtë rast do t'i drejtohem brezit të ri të Shqipërisë që të ecin në hapat dinjitoze të trimave të Vlorës duke e dashur dhe respektuar atdheut. Ashtu si pasardhësit e tyre të ruani dhe të përcillni në breza lavdinë e kësaj epoke, ngjarje të rëndësishme kombëtare që sa më shumë kalojnë vitet aq i shtohet shtohet vlera e saj në historikun e lavdisë së Shqipërisë.

Ju jemi mirënjohës për jetë të gjithë atyre që kanë shkruar me gërma të arta emrat e tyre në historinë e këtij populli. Vlora e luftës, le të jetë sot Vlora e zhvillimit dhe përparimit të vendit tonë.

Ta gëzojmë lirinë, ta gëzojmë Vlorën, ta gëzojmë Shqipërinë!

13.09. 2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për “76-vjetorin e çlirimit të Përmetit”

I nderuar Kryetare e Këshillit të Qarkut,

I nderuar Kryetare e Bashkisë së Përmetit,

I nderuar Kryetar i Komitetit të Veteranëve,

Të nderuar veteranë,

Së pari ju falënderoj për ftesën që më është bërë për të qenë i pranishëm këtu mes jush, në 76-vjetorin e çlirimit të Përmetit. Është kënaqësi e veçantë që të marr pjesë sot në ceremoninë përkujtimore të 13 Shtatorit të vitit 1943, e cila do të njihet gjithmonë si dita e revoltës së bashkuar të përmetarëve ndaj pushtuesve nazi-fashistë.

Një ngjarje e shënuar, jo vetëm për popullin e Përmetit, por edhe për Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare të popullit tonë. 13 shtatori është një nga ato ngjarjet e rëndësishme për arsye sepse i dha një shkëndijë të fortë shpresës dhe besimit se vendi mund të çlirohej.

Përmeti është i lidhur ngushtë me çlirimin e vendit dhe të gjithë ne jemi mirënjohës ndaj djemve dhe vajzave të cilët me sakrificat e tyre u bënë bijtë e gjithë Kombit. Përmetarët janë shquar në historinë shumëshekullore të popullit shqiptar me ideale të larta dhe dashurinë e madhe për atdheun që luftuan si rrallë të tjerë. Nga gjiri juaj kanë dalë trima dhe luftëtarë që u sakrifikuan dhe kontribuan për këto ditë lirie që jetojmë ne sot. Do të përmendja disa prej personaliteteve të shquara si udhëheqësit e mëdhenj të Rilindjes Kombëtare, Poetin e madh Naim Frashërin, filozofin, dhe dijetarin e shquar Sami Frashërin dhe revolucionarin e madh Abdyl Frashërin dhe jo më pak të rëndësishëm dëshmorët dhe partizanët që dhanë jetën në luftë për çlirimin e vendit si Meleq Gostinishti, Lefter Talo, Dino Kalenja e shumë të tjerë.

Përmeti mori pjesë aktive në LANÇ gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe u kthye në një nga bazat më të fuqishme dhe një nga zonat e para të çliuara në shkallë vendi. Duke qenë e tillë, në Përmetin e çliruar u mblodh Asambleja Popullore, i njohur si Kongresi i Përmetit, një nga ngjarjet madhore të historisë së popullit shqiptar.

Vendimet e miratuara në këtë kongres për kohën e rrethanat kur u morën, për vlerat që patën për LANÇ dhe për vetë fatin e Shqipërisë, hapën një epokë të re në historinë e saj. Këto vendime patën jehonë të jashtëzakonshme brenda e jashtë vendit, por mbi të gjitha, këto vendime rritën entuziazmin në popull, forcuan besimin në fitore dhe krijuan bindjen se vetëm lufta e drejtë e popullit do të siguronte çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Kështu, vendimet e Kongresit të Përmetit ishin një mësim i madh në histori që e bënë Përmetin si stacionin e parë vendimtar që përcaktoi finalizimin e fitores në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe hodhi themelet për një Shqipëri të Lirë dhe Demokratike!

Prandaj është e rëndësishme për këtë vit të përmend që falë një procesi të tërë me akte, me vendime e ngjarje që pasuan njëra tjetrën përkujtojmë 75-vjetorin e çlirimit të Atdheut, e çdo ngjarje të saj, çdo dëshmor e hero të rënë duke i nderuar me solemnitet dhe dinjitet.

Ju jemi mirënjohës për jetë të gjithë atyre që kanë shkruar me gërma të arta emrat e tyre në historinë e këtij populli.

Respekt dhe mirënjohje të të rënëve dhe dëshmorëve për lirinë e Përmetit, për lirinë e atdheut!

Gjaku dhe vepra e dëshmorëve do të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.

Lavdi Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare!

15.09.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për “76-vjetorin e çlirimit të Tepelenës ”

I nderuar Zv. Kryeministër, Z. Erion Braçe,

E nderuar kryetare e Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, Znj. Lindita Rova,

I nderuar Kryetar i Bashkisë Tepelenë, Z. Tërmet Peçi,

I nderuar Kryetar i Komitetit të Veteranëve,

Të nderuar veteranë, familjarë e qytetarë të Tepelenës!

Sot jam i lumtur të ndaj gëzimin me ju, të nderuar veteranë, pasardhës e patriotë që jeni mbledhur në Tepelenë me rastin e ceremonisë përkujtimore të 76-vjetorit të çlirimit të qytetit të Tuaj.

Data 15 shtatori, është dhe do të mbetet një nga ato ngjarje më të rëndësishme për Tepelenën dhe tepelenasit, për arsye sepse i dha një shkëndijë të fortë shpresës dhe besimit dhe se vendi ynë mund të çlirohej nga pushtuesi.

Tepelenasit janë shquar në historinë shumëshekullore të popullit shqiptar me ideale të larta dhe dashurinë e madhe për atdheun që luftuan si rrallë të tjerë.

Populli i Tepelenës mori pjesë aktive në LANÇ gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe krahina e Tepelenës u kthye në një nga bazat më të fuqishme dhe një nga zonat e para të çliuara në shkallë vendi. Në Kurvelesh në vitin 1942, u vendos krijimi i këshillave nacional çlirimtarë në shkallë vendi, me nismën e veprimtarëve të parë antifashistë si Mustafa Matohiti, Shefqet Peçi, Ago Çela, Ali Lala, Memo Meto, Abaz Shehu.

Këto këshilla nacionalçlirimtarë thujse u krijuan në të gjitha fshatrat bashkë me grupet e armatosura të fshatrave. Bijtë dhe bijat e Tepelenës, krahas çetave e batalioneve të para partizane të krijuara në krahinë u rreshtuan në Brigadat e V-të dhe VI-të sulmuese, si dhe në formacionet luftarake të Zonës së Parë Operative (Grupi i 1-rë, rezervë operative e shtabit në Kurvelesh), po ashtu dhe në formacionet vullnetare territoriale.

Tepelena në fundin e vitit 1944 ishte krahina më e dëmtuar, më e djegur dhe më e shkatërruar ekonomikisht nga operacionet fashiste gjermane në raport me gjithë vendin. Por kjo nuk ndikoi absolutisht në përpjekjet e tyre për të vazhduar përpara. Çdo plagë e luftës, Tepelenën e bëri edhe më të fuqishme. Edhe pse lufta e dërrmoi, Tepelena diti të ngrihej në këmbë, sepse ka një popull të mrekullueshëm, të mençur dhe punëtor.

Nga të gjithë fshatrat e Tepelenës dolën mbi 2.000 luftëtarë të lirisë të rreshtuar nëpër formacionet partizane, ndërsa në forcat territoriale u angazhuar mbi 6.000 veta. Në katër operacione nazifashiste u dogjën masivisht radhazi shtëpitë në shumicën e fshatrave.

Nder dhe lavdi për drejtuesit e Luftës nga krahina e Tepelenës si Mustafa Matohiti, Abaz Shehu, Shefqet Peçi, Ago Çeli, Zenel Shehu, Asaf Dragoti etj. Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, populli i Tepelenës kontribuoi me çfarë mundi dhe bëri sakrifica të mëdha, ku u dogj dhe u shkatërrua nga pushtuesit. Tepelena i ka dhënë Atdheut 484 dëshmorë dhe 6 “Heronj të Popullit” Mustafa Matohiti, Abaz Shehu, Asim Zeneli, Nimete Progonati, Xheladin Beqiri (Karadaku), Memo Nexhipi.

E vërteta e kësaj Luftës Nacional Çlirimtare e popullit shqiptarë as mund të mohohet, as mund të errësohet. Asnjë kontribut tjetër nuk mund të sillte çlirimin e Shqipërisë pa luftën e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Ishte lufta e Ushtrisë së partizanëve shqiptarë që e vendosi Shqipërinë në anën e duhur të historisë dhe në krahun e aleancës më progresiste të kohës. Përulemi me respekt dhe mirënjohje të thellë për të gjithë dëshmorët dhe heronjtë e Tepelenës dhe gjithë Shqipërisë që skalitën emrat me gërma të arta në altarin e lirisë me gjakun e tyre dhe duke dhënë jetën për lirinë e atdheut.

Të vlerësosh e të nderosh ngjarjet madhore të LANÇ-it do të thotë të nderosh e lartësosh Shqipërinë. Prefektura e qarkut Gjirokastrë u ka dhënë dhe u jep gjithnjë e më shumë një rëndësi të veçantë nderimit e përkujtimit të ngjarjeve madhore të LANÇ-it, një nga të cilat është edhe dita e çlirimit të Tepelenës.

Ky vit përkon edhe me 75 vjetorin e çlirimit të Atdheut, ku në rang prefekturë janë përgatitur dhe planifikuar aktivitete me karakter historik e kulturor në kujtim të të gjitha datave historike dhe do të kulmojë me një Konferencë shkencore Kombëtare “ Prefektura e Gjirokastrës gjatë Luftës së Dytë Botërore , 7 prill 1939 – 29 nëntor 1944 ”.

Gjaku dhe vepra e dëshmorëve do të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do të vijjnë.

Lavdi Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare!

Lavdi dëshmorëve dhe heronjve të Tepelenës!

Gëzuar festën e 76-vjetorit të çlirimit të Tepelenës !

18.09. 2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për “75-vjetorin e çlirimit të Gjirokastrës”

E nderuar Deputete e Qarkut, znj. Mirela Kumbaro,

I nderuar Kryetar i Bashkisë së Gjirokastrës Z. Flamur Golemi,

E nderuar Kryetare e Këshillit të Qarkut, znj. Lindita Rova,

I nderuar Kryetar i Organizatës së familjeve të Dëshmorëve, Z. Hodo Liço,

I nderuar Kryetar i Komitetit të Veteranëve të Luftës, z. Shkëlqim Guçe,

Të nderuar veteranë, familjarë e qytetarë të Gjirokastrës!

Sot jam i lumtur të ndaj gëzimin me ju, të nderuar veteranë, pasardhës e patriot që jeni mbledhur në qytetin e gurtë me rastin e ceremonisë përkujtimore, të 75-vjetorit të çlirimit të Gjirokastrës nga pushtuesit nazi-fashistë.

Ne vijmë në këtë përvjetor me respekt të madh dhe përvujtje përpara heroizmit, luftës, përpjekjeve, sakrificave të dëshmorëve e heronjve që derdhën gjakun jo vetëm për çlirimin e qytetit së Gjirokastrës, por për të gjithë luftëtarët e lirisë që kontribuan në LANÇ për çlirimin e Shqipërisë, por edhe ata që e ndoqën armikun përtej kufijve tanë dhe ranë dëshmorë deri më 9 maj 1945, ku u arrit fitorja e madhe mbi nazifashizmin.

Më 7 prill 1939, kur Italia fashiste sulmoi Shqipërinë, populli dhe atdhetarët gjirokastrit e pritën pushtuesin me protesta dhe demonstrata, por morën pjesë edhe në luftimet që u zhvilluan në Sarandë, Durrës e Vlorë. Banorët e qytetit të Gjirokastrës u përfshinë që në muajt e parë në rezistencën antifashiste dhe u lidhën ngushtë me Lëvizjen Antifashiste Nacionalçlirimtare. Rezistenca antifashiste vazhdoi e organizuar me çeta, batalione dhe brigada partizane që u ngritën në teritorinë e prefekturës sonë. Shumë djem dhe vajza mbushën radhët e formacioneve luftarake të Ushtrisë Nacional Çlirimtare.

Me këtë rastë përmendim: çetat **“Çerçiz Topulli”**, dhjetor 1942 në Fushëbardhë, **“Haredin Tremishti”** dhe **“Avni Rustemi”** gjatë periudhës nëntor – dhjetor 1942, **“Koto Hoxhi”** në tetor 1942 në Poliçan, **“Selam Musai”** nëntor 1942 Sinanaj, **“Naim Frashëri”** nëntor 1942 në Krahës, dhe **“Kurveleshit”** nëntor 1942 , e **“Rrëzës”** (At Gjergj Suli) mars 1943, Batalionet **“Asim Zeneli”** më 7 gusht 1943 në Prongji, **“Baba Abaz”**, më 10 gusht 1943 në Kalivaç, **“Themo Vasi”** në Poliçan, **“Misto Mame”** në gusht 1943 në Lunxhëri, **“Batalioni i Rinisë”**, në nëntor 1943 në Krahës, **“Naim Frashëri”** në Përmet **“Thanas Ziko”** tetor 1943 në Dervişan dhe batalioni territorial i Kardhiqit.

Po në teritorin administrativë të Prefekturës Gjirokastrë u krijuan dhe vepruan brigadat: Brigada e VI-të, e VIII-të, e XIV dhe XIX –të Sulmuese. Dy prej tyre në trevën e Gjirokastrës (Sheper) Brigada VIII-të dhe XIV-të Sulmuese.

Populli i trevave tona përballoi me sukses operacionet armike dhe mjetet e luftës nga më çnjerëzoret. Historia ka argumentuar me dokumente autentike heroizmin e nënave dhe bijëve të trevave tona si të: Kurveleshit, Zagorisë, Lunxhërisë, Krahësit, Lopsit, Rrëzës Përmetit e Libohovës. Në frontin e luftës për liri vetëm nga Gjirokastra u rreshtuan 2000 partizan, midis tyre edhe nga minoriteti grek. Në frontin e luftës mori pjesë dhe femra gjirokastrite, ku janë të dokumentuara rreth 200 femra në gjithë teritorin e prefekturës sonë.

Në teritorin e prefekturës sonë u zhvilluan disa përpjekje të armatosura midis të cilave përmendim: Luftën e Qafës së Miricës, e Mogilave, e Malit të Bardh, Dukaj – Salari, Shkallës së Zezë, Luftën për çlirimin e Përmetit, Luftën e Mezhgoranit, Luftën për çlirimin e Zagorisë, luftën për çlirimin e Tepelenës, Luftën e Libohovës, luftën e Lunxhërisë si dhe lufta për çlirimin e qytetit të Gjirokastrës. Pas Operacionit gjerman të Qershorit 1944, trupat naziste dhe ato kolaboracioniste u dislokuan kryesisht nëpër qytete.

Detyra e FANÇ ishte çlirimi i qyteteve. Me urdhër të shtabit operativ Vlorë – Gjirokastrë, brigadës së XIV-të iu ngarkua detyra për çlirimin e qytetit të Gjirokastrës. Në këto luftime morën pjesë edhe forcat e Brigadës XIX Sulmuese, të Grupit të parë operativë. Brenda në qytet, në kala dhe në Grehotë qëndronin rreth 300 trupa naziste dhe 250 forca kolaboracioniste. Gjithashtu gjendej një garnizon gjerman edhe në Jorgucat. Prandaj, sulmi u përqëndrua si mbi forcat armike që gjendeshin në Gjirokastrë ashtu edhe mbi garnizonin gjerman të Jorgucatit, për të mos lejuar kordinimin e veprimeve midis tyre. U zhvilluan gjithësej pesë sulme mbi forcat armike nga data 15 – 18 shtator 1944. Mëngjesi i 18 shtatorit e gjeti qytetin e Gjirokastrës të çliruar.

Qytetet në qarkun Gjirokastrë kanë qenë pjesë aktive në LANÇ duke u kthyer kështu në bazat më të fuqishme për luftën dhe qytetet e para të çliruara në shkallë vendi ishin Libohova, Përmeti e Tepelena gjatë vitit 1943.

Është nder të përkujtojmë protagonistët e Luftës antifashiste që ditën ta rreshtonin Shqipërinë në radhët e frontit antifashist. Përulememi me nderim përpara veprës së dëshmorëve dhe heronjëve të Luftës së Dytë Botërore si: Mihal Duri, Misto Mame, Themo Vasi, Fato Sako Berberi, Nimete Isuf Progonati, Xheladin Beqiri (Karadaku), Asim Zeneli, Mustafa Matohiti, Abaz Shehu, Bule Naipi, Persefoni Kokëdhima, Myzafer Asqeriu, Pertef Kokona, Kapo Baco, Isuf Omari, Ago Topulli, Arshi Lengo, si dhe qindra dëshmorë të tjerë. Gjirokastra i ka dhënë atdheut mbi 230 dëshmorë prej të cilëve 10 heronj të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare.

E vërteta e kësaj Luftës Nacional Çlirimtare e popullit shqiptarë as mund të mohohet, e as mund të errësohet. Asnjë kontribut tjetër nuk mund të sillte çlirimin e Shqipërisë pa luftën e Ushtrisë Nacional-Çlirimtare. Ishte kjo luftë e ushtrisë së partizanëve shqiptarë që e vendosi Shqipërinë në anën e duhur të historisë dhe në krahun e aleancës më progresiste të kohës.

Prefektura e qarkut Gjirokastrë u ka dhënë e u jep gjithnjë e më shumë një rëndësi të veçantë nderimit e përkujtimit të ngjarjeve madhore historike, një nga të cilat është dita e çlirimit të Gjirokastrës, veçanërisht ky vit përkon edhe me vitin jubilar të 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë. Në këtë kuadër, në rang qarku janë përgatitur dhe planifikuar aktivitete me karakter historik e kulturor për të përkujtuar çdo dëshmor e hero të rënë dhe duke i nderuar me solemnitet dhe dinjtet.

Gjaku dhe vepra e dëshmorëve do të respektohen përherë në kujtesën e brezave që do të vijnë.

Lavdi Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare!

Lavdi dëshmorëve dhe heronjve të Gjirokastrës!

Gëzuar festën e 75-vjetorit të çlirimit të Gjirokastrës!

25.09.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin me drejtuesit e degëve territoriale dhe me institucionet shtetërore në nivel vendor “Analiza 9-mujore e punës”

E nderuar deputete!

Të nderuar drejtues të degëve territoriale në qarkun Gjirokastrë,

Të nderuar drejtues të institucioneve shtetërore në nivel vendor,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe vlerësimin tuaj për këtë takim të rëndësishëm.

Ky takim ka për qëllim analizën e punës së institucioneve që ju drejtoni në përmbushje të objektivave të qeverisë shqiptare dhe performancën tuaj për periudhën janar-shtator 2019.

Gjatë këtij takimi do të diskutohen çështjet:

- Realizimi i planit të punës për periudhën 9-mujore të vitit 2019 (arritjet, mosarritjet dhe shkaqet).

- Objektivat për 3-mujorin e fundit të vitit 2019 (tetor, nëntor dhe dhjetor).

Dua të theksoj se, për periudhën e deritanishme marrëdhëniet e institucionit të Prefektit me degët territoriale dhe institucionet shtetërore vendore, nuk kanë qenë në nivelin e duhur. Kjo është vënë re veçanërisht në disa takime të zhvilluara nga institucioni ynë, ku drejtues kryesorë të disa institucioneve nuk kanë marrë pjesë.

Po kështu edhe korrespondenca mes institucioneve tona lë për të dëshiruar sidomos në drejtim të raportimit periodik të veprimtarisë i cili është detyrim ligjor në zbatim të ligjit “Për Prefektin e qarkut”.

Për realizimin e objektivave institucionalë dhe detyrave tuaja funksionale është shumë i rëndësishëm roli juaj si drejtues. Në këtë kontekst, duhet të shfaqet integriteti juaj personal, të spikasi formimi juaj i përgjithshëm si një lidhësi, të dini të menaxhoni situata të ndryshme në realizimin me sukses të misionit që ka institucioni që ju drejtoni; të keni aftësi për të ndryshuar gjendjen, të orientoni drejt punën në grup, të aplikoni metoda standarte, të planifikoni veprimtari duke i mbështetur me masa konkrete.

Një pikë shumë e rëndësishme e takimit të sotëm është realizimi i detyrave funksionale institucionale nga ana juaj. Në këtë kuptim bashkëpunimi me degët territoriale dhe institucioneve të tjera shtetërore në nivel vendor ka qenë dhe do të jetë një nga drejtimet kryesorë të e punës së institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë.

Dua të ritheksoj rëndësinë që ka bashkëpunimi i institucionit të Prefektit me degët territoriale në qark pasi vetëm përmes kësaj fryme do të arrihet zgjidhja e problematikave duke synuar gjithmonë e më shumë një afrim me komunitetin, në mënyrë që të zbatohen me përpikmëri dhe përgjegjësi detyrimet ligjore të ngarkuara secilit prej tyre.

Prandaj është e nevojshme që të kemi një koordinim më të mirë institucional duke ofruar bashkëpunim dhe zgjidhje gjithëpërfshirëse në mënyrë që të kemi një rritje të performancës së administratës si dhe cilësi në ofrimin e shërbimeve përkatëse ndaj qytetarëve.

Dua të theksoj rolin shumë të rëndësishëm që kanë inspektoriatet shtetërore të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në territorin e qarkut tonë, për sa i përket sigurisë ushqimore, mbrojtjes së mjedisit, shëndetit publik si dhe mbrojtjes së territorit dhe zhvillimit urban. Në realizimin e detyrave tuaja është shumë e rëndësishme kontrolli, monitorimi dhe trajtimi i problematikave të ndryshme si në marrëdhëniet institucionale ashtu edhe me kërkesat dhe ankesat e komunitetit.

Në këtë analizë që zhvillojmë sot një vëmendje e veçantë duhet t’i kushtohet masave të marra në drejtim të sigurisë ushqimore. Në këtë drejtim puna duhet të përqëndrohet në realizimin e planeve të Inspektiveve të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e AKU dhe zbatimin me rigorozitet të praktikave sipas ligjit.

Një fushë tjetër prioritare për qarkun është arsimiku në kuadër të fillimit të vitit të ri arsimor 2019-2020 nga ana e Zyrate Vendore Arsimore Gjirokastrë, Tepelenë, Përmet në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore u bë i mundur fillimi i mbarë i procesit mësimor. Vlen të theksohet angazhimi i institucionit të Prefektit në monitorimin e gjendjes së infrastrukturës në institucionet arsimore, por gjithashtu duhet theksuar se nga ana e institucioneve përgjegjëse duhet të ketë një anagazhim më të madh për sa i përket evidentimit dhe adresimit në kohë të problematikave që kanë institucionet arsimore në mënyrë që masat të merren në kohë për të mos dëmtuar procesin mësimor në vazhdim.

Nisur nga ankesat e shumta të qytetarëve dhe disa njësi administrative vlen të theksohet një problematikë që ka të bëjë me lëvizjen e pakontrolluar të nxënësve drejt shkollave të mëdha në qendër të qyteteve gjë e cila krijon mbingarkesë në shkolla të caktuara. Ky fenomen përveçse është në shkelje të ligjit krijon problematika në drejtim të cilësisë së procesit mësimor, rrezikut të mbylljes së klasave apo edhe shkollave në njësitë administrative si dhe rrit mundësinë e shkurtimit të personelit mësimor në këto shkolla.

Për sa i përket ndryshimeve në strukturë dhe kompetenca të degëve territoriale dhe institucioneve të tjera shtetërore në nivel vendor, është e nevojshme që nga ana juaj të njoftohet zyrtarisht institucioni i Prefekti të qarkut në lidhje me emërtimin e ri të institucionit, drejtuesit të tij si dhe çdo ndryshim tjetër.

Institucioni i Prefektit të qarkut në zbatim të ligjit nr. 107/2016 “*Per Prefektin e qarkut*” neni 8, 10, 12 dhe 15 etj kërkon nga ana e drejtuesve të degëve territoriale dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor seriozitet për zgjidhjen e çdo shkrese zyrtare që adresohet nga institucioni i Prefektit të Qarkut në lidhje me problematikat dhe ankesat e qytetarëve si dhe informimi i këtij institucioni brenda afateve kohore mbi zgjidhjen e çdo problemi bazuar në VKM-në nr. 867, datë 10.12.2014 “Për bashkëpunimin me institucionet shtetërore”

Me qëllim përmirësimit e mëtejshëm të punës dhe performancës në çështje, të cilat kërkojnë përkushtim dhe angazhim nga të gjitha strukturat, dua të rendit disa rekomandime, si më poshtë:

- Respektimin e afateve kohore në raportimin periodik mujor të arritjeve dhe problematikave nga ana e çdo institucioni.
- Profesionalizmi dhe integriteti moral duhet të jetë kusht thelbësor i punonjësve të të gjithë degëve territoriale dhe institucioneve shtetërore në nivel vendor.
- Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve duke i adresuar drejt zgjidhjes ligjore brenda afateve kohore.
- Rritja e përgjegjësisë dhe angazhimi i strukturave përkatëse në planifikimin dhe marjen e masave për parandalimin dhe menaxhimin e situatave të mundshme emergjente dhe krizave në qark gjatë vitit 2019 dhe vitit të ardhshëm.
- Evidentimin e problematikave të gjendjes fizike të godinave të institucioneve shtetërore dhe planifikimin e masave në rastet e emergjencave civile.
- Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimi i veprimtarisë ndërinstytucionale mes të gjitha degëve territoriale dhe institucionet shtetërore në nivel vendor që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qark.
- Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve duke shërbyer me profesionalizëm dhe me integritet moral.
- Rritja e performancës së punonjësve të administratës shtetërore brenda çdo institucioni apo degë territoriale.
- Nisur nga situata e krijuar pas rënies së tërmetit në qarqet Tiranë dhe Durrës, qeveria shqiptare ka ndërmarrë nismën për sensibilizimin e komunitetit dhe institucioneve për ti ardhur në ndihmë zonave të prekura nga tërmeti. Në këtë kuadër, si Prefekt i qarkut ju bëj thirrje të gjitha institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe njësi të vetëqeverisjes vendore të kontribuojnë vullnetarisht sipas mundësive të gjithsecilit në numrin e llogarisë së dedikuar për këtë qëllim.

25.09.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për “Takimin mbi Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm dhe Përparësitë e Zhvillimit në nivele vendore.”

I nderuar përfaqësues i Agjensive të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, z.Ëilliams,

Të nderuar përfaqësues të UNICEF, UNHCR, FAO,UNDP,UNFPA, UN EËOMAN,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar Ministra,

Të nderuar kolegë, kryetarë të bashkive të qarkut Gjirokastër,

Të nderuar pjesëmarrës,

Dëshiroj t’ju uroj mirëseardhjen në Gjirokastër dhe t’ju shpreh mirënjohjen e thellë që përzgjedhët këtë qytet, në nivel kombëtar, për të ndarë së bashku idetë mbi **“Objektivat e Zhvillimit të Qendrueshëm de Përparësitë e Zhvillimit në nivele vendore”**.

Ndërsa përfaqësuesit e rreth 190 shteteve janë mbledhur për disa ditë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në NEË YORK për të ndërtuar konsensusin mbarëbotëror për të mirën e përbashkët, ne sot mbidhemi këtu për të këmbyer ide mbi synimet për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Kjo platformë është vërtet e vogël dhe në nivel vendor, por çështjet e saj janë mjaft të rëndësishme dhe ndërlidhen gjithnjë e më shumë me ato të njerëzimit.

Dhënia fund e varfërisë, çështjet e rëndësishme të ruajtjes së mjedisit, promovimit të energjive të pastra, zhvillimit të qyteteve dhe promovimit të barazisë dhe dinjitetit për të gjithë qytetarët kudo që ndodhen janë tashmë sfida mbarë botërore, kombëtare dhe vendore.

Ndaj besoj se përcaktimi i hapave konkretë të bashkëpunimit, kontributi i përbashkët dhe ndima e ndërsjelltë dhe e kordinuar janë një përpjekje e vazhdueshme për të arritur çdo lloj qëllimi të përbashkët.

Bashkitë tona në nivelin vendor kanë mjaft punë për të kryer në drejtime të rëndësishme të synimeve globale që përfshijnë përmirësimin e qeverisjes, reduktimin e korupsionit, uljen e varfërisë, nxitjen e punësimit etj.

Dua t’ju siguroj në cilësinë e Prefektit, se Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastër është një urë lidhëse e punës së gjithëkujt dhe në këtë aspekt roli koordinues i Institucionit që drejtoj mes Qeverisjes Qendrore dhe asaj lokale garanton bashkëpunimin strategjik për arritjen e objektivave të Axfordës 2030.

Jam i bindur se ky Kuvendim do të na shërbejë si udhërrëfyes i diskutimeve, debateve dhe ideve në këtë tryezë të nderuar.

03.10.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin për projektin Balkan's Gate

Të nderuar organizatorë të projektit Balkan's Gate,

Të nderuar pjesëmarrës,

Si fillim doja të falënderoja gjithë mbështetësit e projektit Balkan's Gate, si për tematikën e zgjedhur ashtu edhe për faktin që po e realizojnë në qytetin tonë këtë projekt. Edicioni i 5-të i këtij projekti është zgjedhur të zhvillohet në qytetin e Gjirokastrës pasi mbart vlera të veçanta historike e kulturore. Kalaja mbresëlënëse plot histori e mistere, pazari i vjetër i shekullit XVII, shtëpitë e gurta me arkitekturën e rrallë, lagjet e vjetra karakteristike, teqetë dhe kishat, historitë e fshehura në çdo skutë të qytetit, muzeumet dhe monumentet, përbëjnë kontekstin shumëshekullor e tepër origjinal të një mënyre jetese dhe organizimi shoqëror të ruajtur deri në ditët e sotme. Evidentimi i këtyre vlerave është shumë i rëndësishëm pasi Gjirokastra është një pasuri jo vetëm e vendit tonë, por e gjithë njerëzimit duke qenë pjesë e trashëgimisë botërore kulturore, e UNESCO-s.

Për shumë arsye ky qytet do të japë kontributin e tij, me shumë frymëzim, me shumë kulturë, e memorizuar në filmat që do të përcjellin mesazhe të qarta lidhur me temat sociale dhe shqetësimet e përditshme në shoqërinë tonë.

Çështjet sociale që do të reflektohen përmes artit tuaj janë aktuale, si e tillë dhuna ndaj grave, e cila është një problematikë e përhapur në shoqërinë tonë në të gjitha format e saj si verbale, fizike apo ekonomike. Thujse çdo ditë shohim kronikat e zeza të lajmeve që paraqesin lajme të tilla. Fakt shqetësues është edhe ushtrimi i kësaj dhune në prani të fëmijëve.

Do t'ju lutesha që të gjithë së bashku të bashkëpunojmë në mënyrë të tillë që të rrisim sensibilizimin e shoqërisë pjesë e së cilës jemi si individ, por dhe si institucione shtetërore. Njëkohësisht do të vlerësoja mundësinë që krijon ky projekt me bashkëpunimet ndërkulturore mes vendeve të ndryshme, por në të njëjtën kohë u jep atyre mundësinë që të kuptojnë më nga afër perspektivat e tyre në vendin tonë.

Uroj që ky bashkëpunim të rris ndërgjegjësimin qytetarë të të gjithë ne pasi një femër është vajza e një babai, motra e një vëllai, nëna e një fëmije dhe nuk besoj se ndokush nga ne do të ndihej mirë nëse ndaj nënës, motrës apo vajzës së tij do të ushtrohej dhunë.

Ndaj ju ftoj të gjithë të bashkëpunojmë për të organizuar më shumë projekte të tilla sensibilizuese, për të shmangur një tjetër kronik të zezë, një tjetër dhunim.

Një falënderim shkon për Ministrinë e Kulturës, Ambasadën Amerikane, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, Ambasadën Franceze dhe Bashkinë Gjirokastrë për mbështetjen e këtij projekti me vlerë jo vetëm kombëtar por edhe ndërkombëtar.

Ju uroj punë të mbarë regjisorëve të huaj dhe shqiptarë, si dhe të rinjve të gazetarisë nga vende të ndryshme të Shqipërisë, si dhe një vazhdimësi të këtyre projekteve të tilla.

14.10.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për fillimin e vitit të ri akademik 2019-2020

I nderuar Rektor i Universitetit të Gjirokastrës!

Të nderuar profesorë!

Të nderuar studentë!

Jam sot këtu në Universitetin e Gjirokastrës “Eqrem Çabej”, në këtë ditë të parë të vitit të ri akademik për të përcjellur urimet në emër të institucionit të Prefektit të qarkut dhe në emrin tim personal pedagogëve dhe studentëve një vit sa më të suksesshëm akademik.

Në veçanti, dua të uroj studentët që ulen për herë të parë në auditorët e këtij universiteti, ku do të përgatiten profesionalisht që të jenë të aftë të përballen me të gjitha sfidat e jetës në të ardhmen. Zgjedhja juaj për të ndjekur rrugën e edukimit dhe arsimimit në degët që ofron Universiteti i Gjirokastrës, jo vetëm që na e ofron besimin se e ardhmja do të jetë më e mirë, por ne si drejtues institucionesh na vendos para përgjegjësive që të vijojmë përpjekjet, angazhimin intensiv në rritjen e standardeve të cilësisë së sistemit arsimor si një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare.

Universiteti i Gjirokastrës është një institucion i rëndësishëm arsimor, shkencor e kulturor i Rajonit Jugor të Shqipërisë. Arsimi i lartë në Gjirokastrë, deri sa u kaluanë themelimin e Universitetit ka patur një traditë dhe përvojë të konsiderueshme. Aktualisht, situata që po përballemi sot në të cilët studentët preferojnë të zgjedhin universitetet publike apo ato private në kryeqytet, ka ndikuar ndjeshëm në uljen e numrit të studentëve që zgjedhin universitetin e qarkut tonë. Por le të punojmë të gjithë së bashku që të arrihen synimet e përbashkëta për cilësi, që të avancohen standardet universitare dhe mbi të gjitha për të mbajtur lart emrin e Universitetit “Eqrem Çabej”, i njohur si model i vlerave, kontributeve, të cilat ndikojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të qarkut dhe më gjerë.

Padyshim që zhvillimi ekonomik e shoqëror i vendit varet nga ajo se çfarë një universitet ofron për studentët, nga programet e ndryshme e cilësore lidhur me kërkesat e tregut të punës.

Të nderuar pedagogë!

Ju keni një peshë dhe një përgjegjësi të jashtëzakonshme në formimin e personalitetit dhe kultivimit të mëtjeshëm të studentëve, të atyre që janë pasuria më e vyer e këtij kombi.

Në cilësinë e Prefektit të qarkut, në këtë ditë të parë të vitit akademik, do të inkurajoja gjithësecilin prej jush, për të mos hequr dorë, për asnjë arsye nga standartizimi i komunikimit dhe i dëgjimit të secilit prej jush, nga kritikata, vërejtjet, këshillat, sugjerimet sepse vetëm përmes këtij komunikimi ne do të mund të realizojmë një histori të re suksesi, që është suksesi i dijes dhe i të ardhmes së gjithë shoqërisë shqiptare.

Në përfundim do të doja të uroja gjithë studentëve dhe stafin akademik të universitetit tuaj një fillim sa më të mbarë për vitin akademik 2019-2020, rritje të cilësisë së mësimdhënies, por edhe të përvetësimit të njohurive shkencore me qëllim përgatitjen e studentëve për të qenë të aftë dhe për t’iu përshtatur sa më mirë kërkesave të tregut të punës.

16.10.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Takimin me Organin Këshillues për Emergjencat Civile

Të nderuar anëtarë të Organit Këshillues të Prefektit,

Të nderuar të ftuar,

Në bazë të programit vjetor të Organit Këshillues të Prefektit, sot zhvillojmë takimin me tematikë “Puna e bërë për parandalimin dhe përballimin e zjarreve gjatë stinës së verës si dhe masat që do të merren për përballimin e periudhës vjeshtë – dimër 2019-2020”.

Çështjet që do të trajtohen në këtë takim janë:

Çështja 1. Masat e marra për parandalimin dhe përballimin e zjarreve gjatë vitit 2019.

Çështja 2. Situata e zjarreve dhe dëmet e shkaktuara në rang qarku.

Çështja 3. Masat që do të merren për përballimin e situatave emergjente të mundshme për periudhën vjeshtë – dimër 2019-2020 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Çështja 4. Diskutime

Çështja 5. Rekomandime

Çështja 1: Masat e marra për parandalimin dhe përballimin e zjarreve gjatë vitit 2019.

Institucioni i Prefektit të qarkut Gjirokastrë duke pasur parasysh situatën që mund të krijohej nga zjarret në stinën e verës, ka organizuar disa takime në muajt maj-qershor me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe drejtoritë territoriale ku ka kërkuar marrjen e masave organizative lidhur me koordinimin, bashkëpunimin, informimin midis institucioneve si dhe sigurimin e domosdoshëm të burimeve njerëzore, logjistike dhe financiare të nevojshme për parandalimin dhe përballimin e situatave të zjarreve.

Gjithashtu janë kryer inspektime në të gjitha bashkitë për masat e marra për përballimin e situatave emergjente të mundshme si dhe janë marre kontakte me administratorë të njesive administrative, kryepleqtë e fshatrave dhe specialiste pranë Sektorëve Pyjore e mjedisorë të bashkive ku ju janë kërkuar angazhimi dhe rritja e përgjegjësisë për përballimin e situatave të zjarreve.

Çështja 2: Situata e zjarreve dhe dëmet e shkaktuara në rang qarku.

Megjithë masat e marra, për periudhën qershor – shtator 2019 situata e zjarreve në qarkun tonë ka qënë si më poshtë:

Ka patur rreth 81 raste zjarri, kryesisht në kullota, shkurre, pyje, ullishte, pemëtari, vreshta, banesa, automjete me një sipërfaqe totale prej 483.9 ha.

- Në bashkinë Gjirokastrë, 19 raste zjarri, 55.8 ha shkurre /kullota.
- Në bashkinë Libohovë, 10 raste zjarri, 5.3 shkurre /kullota.
- Në bashkinë Dropull, 12 raste zjarri, 303.7 ha shkurre/kullota dhe 43 pyll pishe ha.
- Në bashkinë Memaliaj, 13 raste zjarri, 42.5 ha shkurre/kullota dhe 300 rrënjë ulliri.
- Në bashkinë Tepelenë, 10 raste zjarri, 59.5 ha shkurre/kullota, 3 dy sipërfaqe me vresht, 200 rrënjë ulliri.

- Në bashkinë Këlcyrë, 7 raste zjarri, 7.5 ha shkurre/kullota, 3.6 ha pyll pishe, 50 rrënjë hardhie.
- Në bashkinë Përmet, 11 raste zjarri, 9.6 ha shkurre/kullota, 500 m² sipërfaqe me vresht, 15 rrënjë ulliri, 15 koshere bletësh.

Nisur nga situata emergjente të shkaktuara nga zjarret në territorin e qarkut Gjirokastrë për vitin 2019, konstatoi se angazhimi juaj në përballimin e situatave emergjente ka reflektuar përgjegjësi e përkushtim por i pamjaftueshëm, pasi janë evidentuar edhe mangësi sidomos me masat tekniko organizative në informimin në kohë, parandalimin e situatave emergjente dhe angazhimin e të gjitha kapaciteteve që ju dispononi.

Konkretisht, disa nga mangësitë e konstatuara janë:

- Planet e masave të hartuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për parandalimin dhe përballimin e situatave emergjente të shkaktuara nga zjarret, në pjesën më të madhe të tyre, nuk gjejnë zbatim konkret.
- Mungesa të njoftimit dhe të lajmërimit në kohë për veprime të menjëhershme në raste të rënies së zjarreve, si dhe mungesa bashkëpunimi nga strukturat vendore.
- Pamjaftueshmëri e mjeteve dhe burimeve njerëzore e teknike nga MZSH-të e bashkive, dhe strukturat e pyjores dhe të mjedisit.
- Mungesa e planifikimit dhe përdorimit të fondeve të emergjencave civile nga bashkitë si detyrim ligjor, për të rritur kapacitetet tekniko-operacionale, sidomos për pajisje të përdorimit personal për fikjen e zjarreve, si: zjarrfikëse, pompa shpine për fikje të zjarreve dhe pajisje të tjera.
- Mossigurimi nga bashkitë i pajisjeve dhe mjeteve të nevojshme për vullnetarët / komunitetin që angazhohet për fikjen e zjarreve.
- Mungesë solidariteti dhe vullnetarizmi nga komuniteti, por dhe mungesë sensibilizimi nga strukturat vendore.
- Punë e pamjaftueshme nga strukturat përkatëse ligjzbatuese, për kapjen dhe vënien para përgjegjësisë të personave zjarrvënës. Rezulton se, shkak për rënien e zjarreve është kryesisht zjarrvënia e qëllimshme, papërgjegjshmëria e veprimeve të personave të ndryshëm, hedhja pa kujdes në ambiente të ndjeshme ndaj zjarreve dhe sendeve të ndezura që shkaktojnë vatra zjarri etj.
- Punë e pamjaftueshme nga sektorët e emergjencave civile pranë bashkive për dëmet dhe pasojat që shkaktohen nga një fatkeqësi natyrore. Njësia e vetëqeverisjes vendore në disa raste nuk kanë patur gati grupet e konstatimit që brenda 5 ditëve të shkojnë dhe të kryejnë konstatimet në territor dhe gjithashtu në këto grupe mungojnë specialist të fushës si inxhinjer ndërtimi, dhe më pas grupet e vlerësimit nuk plotësojnë dokumentacionin sipas standartit. Kjo çon në mos përfundimit në kohë të dorëzimit të dokumentacionit pranë Drejtorisë së Mbrojtjes Civile, në Ministrinë e Mbrojtjes dhe par pasojë të mos dhënies së dëmshpërblimit qytetarit.

23.10.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Luftën kundër Trafikimit të Personave

Të nderuar nxënës,

Bazuar në Strategjinë e Luftës kundër Trafikimit të Personave, Planit të Veprimit 2018-2020, Urdhërin nr.6, datë 26.01.2017 të Kryeministrit “Për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës

kundër Trafikut të Personave në çdo qark” përgjatë muajit Tetor 2019 i cili njihet si muaji i Luftës kundër Trafikimit të Personave në rang qarku zhvillohen një sërë aktivitete me pjesëmarrjen e institucioneve të ndryshme që përfaqësohen në Komitetin Rajonal Antitrafik dhe në Tryezën Teknike.

Prefekti i qarkut duke qenë drejtues i Komitetit Rajonal Antitrafik ka ndjekur në vazhdimësi personalisht por edhe nëpërmjet përfaqësuesve të tij këto aktivitete sidomos gjatë këtij muaji. Për sa më sipër nga ana e institucionit tonë është hartuar një kalendar aktivitete i dakortësuar me zyrat arsimore të qarkut tonë, si dhe me strukturat e bashkive, për të zhvilluar këto aktivitete në shkolla të ndryshme, ndërmarrje private etj, me qëllim sensibilizimin dhe parandalimin e fenomenit të trafikimit.

Aktivitetet konsistojnë në biseda të ndryshme me temë trafikimin e qenieve njerëzore, seminare, shfaqje filmash, dokumentarë si dhe ekspozita të ndryshme pikturash. Për këtë dua t’u përgëzoj edhe ju për punën tuaj për këtë tematikë që po diskutojmë. Edhe njëherë ju falënderoj për përkushtimin që keni treguar, si dhe ju uroj suksese në të ardhmen në përgatitjen tuaj mësimore.

30.10. 2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Takimin me Komitetin Rajonal të Zhvillimit të Turizmit

Të nderuar anëtarë të Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit,

Të nderuar të ftuar,

Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe vlerësimin tuaj për këtë takim të rëndësishëm.

Ky takim organizohet në zbatim të Udhëzimit nr. 8502, datë 24.10.2016 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit”. Është takim i përbashkët i institucioneve shtetërore në nivel vendor dhe i Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, që ka për qëllim të trajtojë çështje që kanë të bëjnë me ecurinë e sezonit turistik në periudhën janar-shtator 2019, problematikat e hasura gjatë kësaj periudhe, si dhe marrjen e masave për mbarëvajtjen e sezonit turistik për vitin e ardhshëm 2020.

Çështjet që do të diskutohen gjatë këtij takimi janë:

4. Ecuria e sezonit turistik gjatë periudhës 9-mujore Janar- Shtator.
5. Probleme të evidentuara gjatë sezonit turistik 2019.
6. Rekomandime për zhvillimin e turizmit gjatë sezonit turistik 2020.

1. Strategjia kombëtare për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit 2018 – 2022 ofron zgjidhje të qëndrueshme për sfidat e sektorit. Vizioni i qeverisë në këtë strategji është: “Shqipëria do të njihet si një destinacion turistik tërheqës, mikëpritës në rajonin e Mesdheut dhe Evropë, bazuar në përdorimin e qëndrueshëm të potencialeve natyrore, kulturore dhe historike për zhvillimin e produkteve të cilësisë lartë dhe të shumëllojshme, e arritshme lehtësisht nga tregjet ndërkombëtare.” Kjo strategji është ndërtuar mbi parime rigorozë që sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke e vlerësuar turizmin si sektor strategjik dhe prioritar të ekonomisë, me ndikim të lartë social dhe komunitar, si dhe duke e vendosur mbrojtjen dhe

respektin ndaj mjedisit si kriter të panegociueshëm të çfarëdo planifikimi dhe zhvillimi në sektorin e turizmit. Pikësynimet kryesore të politikave në fushën e turizmit janë:

- Rritja e kontributit të turizmit në të ardhurat e përgjithshme të vendit,
- Zhvillimi i balancuar i ofertës turistike dhe shërbimeve,
- Rritja e punësimit në sektorin e turizmit,
- Përmirësimi i nivelit të jetesës dhe zbutja e varfërisë në zonat turistike në gjithë territorin e vendit,
- Rritja e shpenzimeve për turizëm (investimet publike),
- Rritja e të ardhurave nga aktivitetet dhe shërbimet turistike dhe
- Sigurimi i mbrojtjes ligjore dhe institucionale të të drejtave të udhëtarëve dhe vizitorëve.

Për zbatimin e këtyre qëllimeve strategjike është vepruar në 5 fusha kryesore të cilat synojnë në përmirësimin e konkurrencës dhe realizimin e objektivave strategjikë. Fushat kryesore në të cilat që po zbatohen në politikat e turizmit janë:

1. Zhvillimi i produktit (diversifikimi i ofertës turistike),
2. Zhvillimi i burimeve njerëzore (përmirësimi i cilësisë së shërbimeve),
3. Marketingu (promovimi i Shqipërisë si destinacion i turizmit gjithëvjetor),
4. Investimet private dhe publike dhe
5. Kuadri i politikave dhe menaxhimi i destinacioneve.

Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit është përgjegjësi e një numri të konsiderueshëm aktorësh, përfshi institucionet e shtetit (qendrore dhe vendore), sipërmarrjet e turizmit, organizatat e shoqërisë civile, institucionet shkollore, mediat dhe qytetarët. Rol qenësor në arritjen e kësaj objektivave luajnë edhe institucionet ndërkombëtare që kanalizojnë fondet e asistencës zhvillimore në Shqipëri.

Në këtë kuadër, si është vepruar në qarkun tonë? Sa janë mbajtur parasysh këto politika për zhvillimin e turizmit për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror në qarkun e Gjirokastrës?

Siç e dimë, qarku i Gjirokastrës, falë pozicionit të tij gjeografik, trashëgimisë së pasur kulturore, materiale dhe shpirtërore, historike dhe arkitektonike, paraqet mjaft interes në fushën e turizmit, prej të cilit përfitojmë të ardhura të larta, garantimin e punësimit dhe mundësinë e vetëpunësimit në rajonin tonë.

Për këtë, Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë ka ndjekur dhe po ndjek hap pas hapi mbarëvajtjen e sezonit turistik nëpërmjet takimeve të punës me drejtuesit e strukturave përkatëse dhe informacioneve të herëpashershme lidhur me ecurinë e këtij sezoni turistik,

numrin e turistëve dhe kapacitet akomoduese, gjendjen e monumenteve kulturore si dhe në zbulimin e problematikave të ndryshme që hasen në gjithë territorin e qarkut dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.

Konkretisht, gjatë vitit 2019, numri i vizitorëve për muajt Janar- Shtator 2019 qarku ynë ka mikëpritur rreth 140 071 turistë vendas dhe të huaj. Gjithashtu nga informacionet e marra nga Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, hyrjet e shtetasve të huaj në të tre pikat kufitare të qarkut për periudhën 9-mujore është 273. 603 persona. Dua të përmend gjithashtu se gjatë muajit gusht ka pasur një trend rritës, ku u shënuar fluksi më i lartë i frekuentimit të turistëve, informacion i marrë nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare. Shifra tregojnë një rritje të numrit të turistëve vendas dhe të huaj krahasuar me të njëjtën periudhë të sezonit turistik të vitit të kaluar. Duke paraqitur një krahasim mes këtij viti dhe të vitit të kaluar, pati një ecuri pozitive në turizëm dhe një trend rritës të qëndrueshëm jo vetëm në numër me mbi 150 mijë turistë, por çka është më e rëndësishme në netë-qëndrimi të turistëve dhe të ardhura që ata sjellin. Kjo ecuri e vitit 2019 ka reflektuar në kohëzgjatjen e shtrirjes së turizmit gjatë gjithë muajve të vitit, synim ky që u arrit dhe për këtë sezon turistik dhe që synohet edhe për sezonet e ardhshme turistike. Pra, shohim një tendencë në rritje të numrit të turistëve, që sjell nevojën për shtimin e kapaciteteve akomoduese, përmirësim të shërbimit, cilësisë së produkteve turistike, etj. Ecuria e këtij sezoni turistik ka qenë mjaft e sukseshëm përse i përket zhvillimit të aktiviteteve promovuese artistike dhe kulturore, ku do të përmendja “Qyteti me kala”, “Divani Lunxhot”, “Stolitë tona”, “Java e Ali Pashë Tepelena”, “Dita e Verës” në Këlcyrë, e shumë të tjera aktivitete të tilla.

Faktorë të tjerë që duhen përmendur dhe kanë ndikuar në mbarëvajtjen e sezonit turistik janë mirëmbajtja dhe mirëadministrimi i kalasë së Gjirokastrës, plotësimi me sinjalistikën informuese dhe orientuese në zonat e mbrojtura si parqet natyrore “Zagori” dhe “Bredhi i Hotovës-Dangëlli”, monumente natyrore si Ujërat termale të Bënjës, Kanioni i Nivicës, Ujëvara e Progonatit etj, si dhe angazhimin e të gjitha strukturave në përballimin e fluksit të turistëve, problematikave të hasura, etj.

Sipas informacioneve të marra nga infopoint-et, njësitë e vetëqeverisjes vendore si dhe nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare, numri i turistëve vendas dhe të huaj që kanë vizituar qytetet e qarkut tonë për periudhën janar- shtator 2019 janë:

Bashkia Gjirokastrë	100104 vizitorë
Bashkia Libohovë	7750 vizitorë
Bashkia Tepelenë	6500 vizitorë
Bashkia Përmet	13105 vizitorë
Bashkia Këlcyrë	12612 vizitorë

Bashkitë Dropull dhe Memaliaj nuk kanë krijuar një zyrë turistike me qëllim mbledhjen dhe dhënien e informacionit për lëvizjen e numrit të turistëve. Padyshim që këto dy bashki janë të pasura me asete turistike si monumentet kulturore, parqe natyrore, monumente të kultit fetar si kishat, manastiret etj. A nuk do të ishte me interes që turistët që vizitojnë qytetin e Gjirokastrës dhe jo vetëm, por të vizitonin dhe këto pasuri të shumta të këtyre dy bashkive? Kjo do të sillte rritje të përmirësimit ekonomik të dy bashkive dhe më gjerë për qarkun tonë.

Për mbarëvajtjen e këtij sezoni turistik kanë ndikuar aktorët e përfshirë në fushën e turizmit si operatorët turistik, bizneset e hoteleri, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe investimet e

ndërmarrja nga qeveria shqiptare në këtë fushë, duke përmendur dhe kontributin e investitorëve privat për promovimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme turistike dhe kulturore. Vlerësojmë investimet e Qeverisë Shqiptare në kuadër të projektit “Rilindja Urbane”, investime që gjatë këtyre viteve të fundit kanë ndryshuar pamjet e qendrave të qyteteve të qarkut tonë. Konkretisht, projekti për rikualifikimin urban të qendrës historike Gjirokastrë, ku është punuar në 6 000 m² kalldrëme, në mbi 900m² hapësira publike të rikualifikuara, sheshe që kanë sjellë një impakti pozitiv në rritjen e numrit të turistëve. Para investimeve infrastrukturore, në qendrën muzeale të Gjirokastrës kishte gjithsej 4 bujtina. Ndërsa sot, pas transformimit të tij në pazarin e vjetër ka plot 70 bujtina dhe mbi 10 hotele.

Dua të theksoj se në zbatim të ligjit nr. 93/2015 “Për turizmin” dhe të urdhrimit të Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 267/2019 “Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese”, afati kohor i aplikimeve për procesin e kategorizimit të strukturave akomoduese është deri në datën 31.12.2019. Nëse subjekti nuk ka aplikuar brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e cituar më sipër, përfitimi i TVSh-së së reduktuar do të ndërpritet. Prandaj, kërkoj që të gjithë së bashku të informojmë të gjitha strukturat akomoduese që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në qarkun tonë për të aplikuar sa më herët, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve në këtë struktura akomoduese.

Krahas investimeve të qeverisë shqiptare, të investitorëve privatë, janë kryer një sërë investimesh të tjera në institucionet arsimore, rikonstruksione në ujësjellësa dhe kanalizime, rehabilitime në qendra shëndetësore që ndikojnë në zhvillimin e turizmit. Për këtë të fundit, njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë marrë një sërë masash në kuadër të mbarëvajtjes së sezonit turistik.

2. Pavarësisht masave të marra nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për sezonin turistik 2019, që kanë ndikuar pozitivisht në qarkun Gjirokastrë, nuk kanë qenë mjaftueshëm për të minimizuar problematikat e evidentuara nga turistët vendas dhe të huaj, si të tilla:

Mbetjet urbane; Mungesa e infrastrukturës në zonat rurale; Vështirësi në orientim për të gjetur pikat e interesit nga turistët, si pasojë e mungesës së sinjalistikës në vende të ekspozuara; Mungesa e shërbimeve cilësore të ofruara për vizitorët nga ana e strukturave akomoduese; Mungesa e një pakete për guidë turistike për qytetet, njësitë administrative, në tërësi të qarkut.

Krahas këtyre problematikave të përvitshme, dua të përmend se nga ana e disa bashkive nuk është bërë sa duhet në drejtim të promovimit të vlerave turistike, ndërkohë dhe korrespondenca mes institucioneve tona nuk është në nivelin e duhur, sidomos në raportimin periodik të veprimtarisë të institucionit që jeni pjesë. Kërkoj nga ana juaj realizimin dhe zbatimin me përpikmëri dhe përgjegjësi të objektivave insitucionale dhe të detyrave tuaja funksionale. Në këtë kuptim, bashkërendimi i punës ndërmjet njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera të turizmit në nivel vendor dhe jo vetëm në këtë fushë, ka qenë dhe do të jetë një nga drejtimet kryesore të punës së Institucionit të Prefektit të qarkut Gjirokastrë.

Dua të rikthejoj rëndësinë që ka bashkëpunimi midis insitucioneve që operojnë në qark për të arritur zgjidhjen e problematikave të cilat po evidentohen nga vit në vit, si dhe ndikimin në të ardhmen me qëllim që të kemi një turizëm më cilësor, gjithëvjetor dhe të mirëorganizuar. Prandaj është e rëndësishme që në kuadrin e arritjes së një standarti cilësor të sektorit të turizmit të realizohet një bashkëpunim dhe koordinim ndërinsitucional.

3. Duke u nisur nga përvojat e mëparshme dhe nga problematikat e hasura gjatë viteve të kaluara dhe të këtij viti, institucioni i Prefektit jep këto rekomandime për një menaxhim dhe mbarëvajtje më të mirë të sezonit turistik për vitin e ardhshëm:

- Nga ana e bashkive nëpërmjet projekte të ndryshme të bënë të mundur tërheqjen e investimeve jo vetëm në qytete por dhe në zona rurale pasi kanë potenciale të shumta me resurset e tyre natyrore, të cilat ofrojnë mundësi për zhvillimin e turizmit malor, turizmit të aventurës. Promovimi i këtyre aseteve nga ana e bashkive duke i kombinuar me aktivitete artistike, folklorike, panairë të etnokulturës, kulinarisë, i japin një mbështetje në zhvillimin e mëtejshëm të turizmit të qarkut tonë.

- Plotësimin e rrugëve kombëtare e rurale me sinjalistikën e nevojshme për në zonat turistike.

- Krijimin i një regjistri turizmi, nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore dhe nga institucionet shtetërore në nivel vendor, duke e përditësuar me informacionet e nevojshme turistike, me qëllim shkëmbimin ndërinstytucional të këtij informacioni dhe rritjen e eficiencës në kryerjen e detyrave funksionale.

- Raportime periodike lidhur me informacione mbi ecurinë e sezonit turistik, si dhe numrin e lëvizjes së turistëve vendas dhe të huaj që vizitojnë qarkun tonë.

- Organizimi i aktiviteteve promovuese për nxitjen e investimeve të huaja dhe vendase për produktet e prodhuara në qarkun Gjirokastrë. Këto aktivitete janë të rëndësishme në ruajtjen e trashëgimisë, kulturës dhe zhvillimin e turizmit në qarkun e Gjirokastrës.

- Krijimi i mundësive për të investuar në banesat e amortizuara për të krijuar impakt pozitiv tek turistët vendas dhe të huaj.

- Krijimi i mundësive nga ana e njësive të vetëqeverisjes vendore për rihapjen e muzeve të vjetra, të cilat nuk janë në funksion dhe pasurim të materialeve historike me qëllim shfrytëzimin e tyre në kuadër të zhvillimit të sektorit të turizmit.

Ftoj antarët e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit dhe të ftuarit të marin fjalën dhe të diskutojmë për ecurinë e sezonit turistik 2019 dhe masat që duhet të merren për një sezon më të mirë organizuar për vitin e ardhshëm 2020.

02.11.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Eventin e dytë të nismës “Promovimi i konsumit të produkteve organike, tradicionale dhe treguesve gjeografikë të Shqipërisë”

I nderuar z. Ministër Bledi Çuçi,

E nderuar z. Deputete Mirela Kumbaro

I nderuar z. Kryetar i bashkisë Flamur Golemi,

Të nderuar organizatorë,

Të nderuar të ftuar,

Ju falënderoj paraprakisht për ftesën për të qenë i pranishëm në këtë aktivitet. Më vjen mirë që Gjirokastra, por jo vetëm, pothuajse çdo ditë gëlon nga aktivitetet, festat, promovimet, të cilat kanë gjetur padiskutim mbështetjen e të gjithëve.

Vitet e fundit, qarku i Gjirokastrës është kthyer në destinacionin më të preferuar të vizitorëve e turistëve të huaj për kuzhinën bashkëkohore, kreative dhe atë tradicionale që ofrohet në restorante që nisin prej pazarit karakteristik të Gjirokastrës dhe deri tek ato të ndërtuara në zonat rurale të Përmetit e Këlcyrës. Turistët kërkojnë për gjëra më autentike, të cilat u mësojnë atyre mbi të shkuarën dhe u tregojnë mundësitë e së ardhmes së vendit. Një prej tyre këtyre elementëve është edhe ushqimi tradicional.

Ushqimi është i lidhur me shumë aspekte të tjera të jetës, përfshirë kulturën, politikën, bujqësinë dhe mjedisin. Nëpërmjet zgjedhjeve tona ushqimore, ne mund të ndikojmë kolektivisht në atë se si ushqimi kultivohet, prodhohet dhe shpërndahet. Sot, shihet një tendencë gjithnjë e në rritje e fermerëve të cilët janë rikthyer traditës së kultivimit të produkteve lokale, duke marrë shkas dhe nga mbështetja e ofruar prej qeverisë shqiptare. Ministria e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural nëpërmjet implementimit të programeve të saj siç është IPARD II, i cili ofron mbështetje në investime në zonat rurale, me synim diversifikimin e ekonomisë rurale dhe krijimin e bizneseve që çojnë në përmirësim të mundësive të punësimit dhe të përfshirjes sociale.

Organizatrat kombëtare dhe ndërkombëtare si Sloë food, CESVI, Pro Përmeti, janë përpjekur fort për të parandaluar zhdukjen e kulturave dhe traditave vendore të ushqimit dhe kanë krijuar qasje me ushqimet e mira, organike dhe ekonomike.

Agroturizmi nuk duhet të shihet vetëm si burim fitimi në këndvështrimin e biznesit por gjithashtu ai hedh dritë mbi veçantitë e secilës krahinë të qarkut tonë. Prandaj mbështetja jonë institucionale është maksimale ndaj këtyre nismave. Përgëzime dhe një herë për punën e mire të bërë në drejtim të promovimit të prodhimit dhe konsumit të produkteve organike, lokale. Uroj që këto aktivitete të ndiqen edhe nga të tjera në vazhdimësi!

07.11.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për 75-vjetorin e Çlirimit të Atdheut

Të nderuar anëtarë të komisionit të qarkut Gjirokastër, “Për përkujtimin e 75 vjetorit të çlirimit të Atdheut”.

Së pari dëshiroj të bëjë një falenderim për të gjithë kryetarët e bashkive të qarkut tonë, të cilët në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve me rastin e 75 vjetorit të Çlirimit kanë planifikuar, organizuar dhe drejtuar drejtpërsëdrejti këto aktivitete duke bashkëpunuar me organizatat e veteranëve, familjet e dëshmorëve dhe zyrat arsimore në qark.

Këto aktivitete kulmuan me festimet për çlirimin e çdo qyteti të qarkut tonë, ku për herë të parë, falë masave shumë të mira të marra nga ana juaj u arrit një pjesëmarrje masive ku u angazhuan jo vetëm veteranët e luftës dhe familjet e dëshmorëve por kanë qenë dhe nxënës të shkollave, studentë dhe qytetarë të cilët vlerësuan këto data historike dhe treguan se historia e LANÇ-it është një faqe e ndritur e historisë kombëtare që duhet të përcillet brez pas brezi.

Kjo frymë duhet të vazhdojë gjatë gjithë muajit të festave, duke zbatuar me rigorozitet axhendën e aktiviteteve, për tu përmbyllur me festimet e datës 29 nëntor.

Më poshtë po ju paraqes një breifing të shkurtër lidhur me punën e bërë nga ky komision si dhe detyrat që kanë mbetur deri në realizimin e aktivitetit sipas një plani veprimi për të cilën kërkohet kontributi i secilit prej jush.

14.11.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për ekspozitën e emëtimit të kartëmonedhave kombëtare të Bankës së Shqipërisë

E nderuar Zëvendësguvernatore zonja Minxhozi,

Të nderuar pjesëmarrës,

Është një kënaqësi e madhe për qytetin e Gjirokastrës të mirëpresë dhe të mbështesë sot Bankën e Shqipërisë në organizimin e këtij aktiviteti sa interesant por dhe aq të rëndësishëm siç është njohja e publikut me serinë e re të dy kartëmonedhave që Banka Qendrore ka hedhur në qarkullim.

Si Prefekt i qarkut por dhe si qytetar i këtij qyteti do të doja të shprehja falënderimet e mia të përzemërta për Bankën e Shqipërisë për organizimin e kësaj ekspozite në qytetin tonë.

Gjirokastra si qendër e dijes dhe si qyteti i lindjes së shumë personaliteteve të shquar, për qytetarët e Gjirokastrës organizimi i aktiviteteve të tilla, është një vlerë e shtuar për të rritur kulturën financiare të qytetarëve tanë.

Ftojme të gjithë qytetarët të vizitojnë ekspozitën në mënyrë që të mësojnë me shumë lidhur me pamjen e kartëmonedhave të reja, personalitetet e pasqyruara mbi to dhe elementet e sigurisë.

21.11.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin me nxënësit me rastin e festave kombëtare të Pavarësisë.

Të dashur nxënës dhe nxënëse,

Dëshiroj t'ju falenderoj për sukseset në procesin mësimor.

Ti përfaqëson një pasuri shumë të madhe për të gjithë ne, në ndërtimin e mesëm të Shqipërisë.

Për këtë arsye, Institucioni i Prefektit të Qarkut ka menduar të jap një dhuratë të veçantë.

Në këtë pako të veçantë, ju do të gjeni flamurin kombëtar dhe një disk për të dëgjuar Himnin kombëtar.

Himni dhe Flamuri Kombëtar janë simbole që bashkojnë të gjithë shqiptarët si brenda ashtu edhe jashtë territorit të saj, krenarë që janë pjesë e një prej kombeve më të vjetra në botë, që edhe pse gjatë shekujve i është dashur të luftojë me fqinjët, i ka rezistuar dhe ka ditur të

mbrojë me dinjitet identitetin kombëtar, atë ç'ka shumë popuj dhe kombe edhe pse më të mëdhenj në popullsi dhe sipërfaqe janë asimiluar.

Shpresoj se kjo dhuratë, në kujtim të një rasti kaq të rëndësishëm, 107 vjetorit të shpalljes së pavarësisë, ngritjes së flamurit në Vlorë, dhe 75 vjetorit të Çlirimit të Atdheut t'ju shoqërojë gjatë gjithë jetës.

21.11.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin me Agjencinë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore

I nderuar z.Agron Sojati,

I nderuar kryetar i bashkisë Gjirokastrë z.Flamur Golemi,

Të nderuar pjesëmarrës,

Së pari më lejoni të shpreh falenderimet për organizimet e këtij takimit në vazhden e aktiviteteve të tjera ndërgjegjësues mbi çështjet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Rëndësia e trajtimit të këtyre çështjeve lidhur me kriminalitetin, dhunën në familje dhe ekstremizmin e dhunshëm mobilizon të gjithë aktorët sidomos strategjitë dhe qasjet bashkëpunuese ndërmjet të gjithë aktorëve lokalë e rajonalë me në qendër komunitetin, për identifikimin dhe parandalimin e akteve ekstreme të dhunës.

Këshilli Vendor i Sigurisë Publike (KVSP), i ngritur tashmë pranë Bashkisë Gjirokastrë është një nga instrumentat kryesor që funksionon për zgjidhjen e këtyre problemeve që çenojnë sigurinë e komunitetit tonë.

Pra, dua të theksoj dhe njëherë rëndësinë e bashkëpunimit të frytshëm për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmin të çdo lloji pasi është një detyrë e të gjithë institucioneve dhe është një e mirë për shoqërinë tonë.

26.11.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit “Prefektura e Gjirokastrës në vitet e LANÇ (1939 – 1944)” nga Dr. Astrit Aliaj, Prefekti i Qarkut të Gjirokastrës

I nderuar Kryetar i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi,

I nderuar Zv/ Kryeministër, z. Erion Braçe,

Të nderuar përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në vendin tonë, Të nderuar studiues, veteranë, familjarë të dëshmorëve të atdheut dhe heronjve të popullit, miq dhe të ftuar, pjesëmarrës në këtë konferencë!

Iniciuam këtë konferencë historike kombëtare, në kuadrin e 75 vjetorit të çlirimit të Atdheut, me synimin dhe me objektin e evokimit tërësor të një Epoke heroike, të historisë sonë kombëtare. Viti 2019, viti përkimit të përvjetorëve të rëndësishme të historisë tonë kombëtare: 75-vjetori i Çlirimit të vendit nga pushtuesit fashistë, 20-vjetori i Çlirimit të Kosovës, si dhe 10-vjetori i anëtarësimit të

Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Këto momente kulmore historike të Kombit shqiptar kanë qenë në qendër të vëmendjes së Qeverisë së Shqipërisë në këtë vit jubilar. Me urdhër të Kryeministrit Edi Rama u ngrit Komisionin Qendror Shtetëror për përkujtimin e 75-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, i cili hartoi programe për organizimin, drejtimin, bashkërendimin e punës për realizimin e veprimtarive në shkallë vendi. Edhe në Prefekturën tonë, në bazë të urdhërit të Qeverisë, u ngrit komisioni vendor, i cili hartoi një program bashkërendues, duke vënë në funksion aktiv të përkujtimit të 75-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, gjithë organet vendore, organizmat shkencore, institucionet arsimore kulturore, artistike organizatat e dëshmorëve, të veteranëve dhe shoqërinë civile. Sot, ne konkretizojmë punën tonë edhe me këtë konferencë shkencore kombëtare si dhe me shumë veprimtari të tjera, në të gjithë hapësirën e shtrirjes së Prefekturës. Qëllimi i kësaj konference është të evidentojë vlerat tërësore, dimensionale dhe kontributin e popullit tonë në përgjithësi, por edhe të popullit të Prefekturës sonë në veçanti, në ato vite të stuhisë kundërvepruese ndaj pushtuesve, okupatorëve eminentë nazi-fashistë. Konferenca është nismë e Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, në bashkëpunim me Universitetin “Eqrem Çabej” dhe akademikë, studiues të QASH dhe Institutit të Historisë Tiranë. Sa herë që evidentohen vlerat historike, sa herë që hulumtohet e djeshmja, dhe dalin në pah dokumente të reja historike për Luftën, aq më shumë rriten dijet, përforcohen bindjet, saktësohen ngjarjet dhe freskohen mendjet.

Është qartësisht dhe e forcuar bindja, tashmë e pranuar edhe nga historiografia e huaj për rolin e Shqipërisë në kuadrin e Luftës së Dytë Botërore.

Një tjetër synim i kësaj konference është që, nëpërmjet dokumenteve dhe analizës shkencore, të pasqyrojë me objektivitet historik, ngjarjet dhe veprimtarinë e figurave drejtuese, organizatave politike, FANÇ, Brigatat Sulmuese, trevave dhe popullit, në gjithë hapësirën e prefekturës sonë, rolin dhe ndikimin që ka luajtur prefektura e Gjirokastrës në fitoren e Luftës. Kumtuesit e kësaj konference janë angazhuar totalisht në një veprimtari efikase, për të paraqitur materiale shkencore me objekte të veçanta në fusha të ndryshme, duke fokusuar katërcipërisht Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Temat e kumtesave, të cilat do të referohen, kanë një larmishmëri tematike. Ato prekin gjithë hapësirën e prefekturës në kufijtë e sotëm: problematikën historike të periudhës së LANÇ dhe kronologjinë e saj që nga fillesa e deri në mbarim; luftën italo – greke dhe qëndrimin e popullit tonë ndaj saj; ngjarjet kryesore historike; krijimin dhe organogramën e formacioneve partizane, si: çetat, batalionet, brigadat dhe formacionet e tjera ndihmëse në territorin e Prefekturës, prezencën e forcave të tjera të Ballit dhe të Legalitetit, taktikën dhe strategjinë si dhe elementët e përdorur, artin e të luftuarit; figurat dhe komandat kryesore drejtuese; rolin e femrës gjirokastrite, minoritare, përmetare dhe tepelenase në LANÇ; kontributin e rinisë, konferencat LANÇ dhe ato për arsimin, Kongresin e Përmetit; letërsia dhe arti në fokusimin e LANÇ, rolin e institucioneve dhe klerikëve të objekteve fetare si dhe bilancin e luftës për prefekturën tonë etj. Prefektura e Gjirokastrës, gjatë viteve të luftës, përfshinte, pothuajse, gjithë territorin e Shqipërisë së jugut: Gjirokastrën, Tepelenën, Përmetin, Delvinën, Sarandën, Himarën, Konispolin. Në këtë hapësirë administrative përfshiheshin: 8 N/Prefektuara (Çamëri, Delvinë, Kurvelesh, Libohovë, Tepelenë, Sarandë, Përmet, Himarë), 5 bashki (Gjirokastrë, Përmet, Libohovë, Sarandë dhe Delvinë), si dhe 28 komuna. Prefektura e Gjirokastrës kishte një popullsi prej 148. 799 banorë. Të dhëna këto të marra nga statistikat prej Prefekturës, në vitet 1940 - 1942. (AQ Fondi 294, viti 1942, dosja 1001, faqe 1,2) Dihet saktësisht, që zjarrin e Luftës së Dytë Botërore e ndezi grykësia e bishës nazi – fashiste me planin e vet të okupimit global.

Në kontekstin e përgjithshëm, në atë luftë të përmasave botërore, dhanë jetën 62 milionë njerëz, duke djegur edhe vetë zjarrëvënësit e saj. Zyrtarisht, fillesa e saj përkon me 2 shtatorin e vitit 1939, por Shqipëria u pushtua rreth 5 muaj më parë, më 7 prill 1939, dhe u bë viktimja e dytë e fashizmit italian, pas Abisinisë (Etiopisë). Në kumtesat e paraqitura në këtë konferencë, do të paraqiten në detaje larmishmëria tematike e cituar më lart, por ne do të ndalemi kryesisht në disa probleme

thelbësore: Historia duhet të shkruhet, ashtu siç ka ndodhur realisht. Ndaj kjo është puna e historianit, i cili “ngul” të vërtetën historike, pa e cënuar, transplantuar, apo nëpërkëmbur dhe elementin më të vogël, apo të padukshëm historik. Historia nuk shkruhet sipas dëshirave dhe ideve vetiake, apo parapëlqesave..., paragjytimeve. Historia është e patjetërsueshme. **Individët kërkojnë të quhen si “titullarë dhe bërës të historisë” për të përfshirë “bëmat” e veta... Jo pa qëllim, përmendëm në fillësë, këtë nocion dhe këto parime të mosdeformimit të faktit historik, të arritjes historike, të pjesëmarrjes direkte dhe indirekte në fenomenin historik dhe veprimit të tij, duke sjellë evoluimin. Këtë nocion ne e kemi materializuar në tematikën tonë.**

Librat studimorë të karakterit historik edhe në qarkun tonë, të cilët janë të shumtë, kanë pasur si objekt analitikën, përpunimin e detajit, renditjes kronologjike, evidentimin e faktit, përfundesën, përcjelljen direkte, të shkruarën dokumentare me dritësim ngjarjeje dhe sjelljen e tyre, ashtu, sikundërse kanë ndodhur realisht në një zinxhirim historik dhe dator, vjetor dinamik, i cili tregon, kapërcipërisht, atë punë të madhe të bërë për përgatitjen e një Luftë nga më të mëdhatë, e quajtur me të drejtë “Epopë” që ka zhvilluar i organizuar ky popull për çlirim, nën drejtimin e një force politike progresiste njohëse të asaj kohe, e ndikuar edhe me nxitje e influencë nga një aleancë e madhe botërore, ku u grupuan forca të mëdha si: Anglia, Bashkim Sovjetik dhe SHBA, e shfaqur qysh në fillim me një platformë të qenësishme, të admirueshme dhe me një synim madhor: çlirimin e vendit nga pushtuesit e huaj nazi-fashistë. Meritë të madhe, në këtë rezistencë ka FANÇ dhe Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, i cili organizoi formacionet, përpunoi taktikën dhe

strategjinë e fitores së kësaj Luftë dhe e drejtoi atë me kompetencë në të gjitha fazat e saj ! Ndaj, edhe ne në këto materiale, që do të paraqitim para jush, në këtë konferencë për qarkun tonë, jemi treguar shumë të kujdesshëm në paraqitjen ekzakte të datës historike, kur ka ndodhur ngjarja, përshkrimin e ngjarjes, ndodhisë, protagonistët veprues, duke e treguar atë si ka ndodhur në realitet. * * * Populli dhe atdhetarët gjirokastritë e pritën pushtuesin me demonstrata, sikurse ishte ajo në sheshin e Çerçizit, më 7 prill 1939. Në atë miting u hodhën parullat: “Poshtë fashizmi”, “Dua armë”, “Poshtë Zogu” etj. Gjirokastritët organizuan pritën në rrugën nacionale Gjirokastrë (kthesa e Libohovës) kundër kolaboracionistëve, më 7 prill, të premten e zezë, dhe vranë komandantin e xhandarmërisë zogiste, Gjek Marashin, së bashku me 10 bashkëpunëtorë të tij në Dhuvjan. Forcat e armatosura të atdhetarëve nuk lejuan që makinat e mbushura me kolaboracionistët të shkonin për të pritur në Sarandë trupat pushtuese fashiste. Ata i eliminuan ato nga Sofratika, në kthesën e Libohovës. Organizimi i lëvizjes antifashiste mori hov dhe karakter të organizuar me formimin e PKSHT dhe organizimin e Konferencës së Pezës.

Ajo filloi nga krijimi i grupeve edukative që vepronin në ilegalitet. Mbledhjet e tyre bëheshin brenda qytetit si dhe jashtë tij në Leknjas dhe Shëntriadhë. Pas kësaj veprimtarie agjitative, startuan në qytete e krahina grupet ilegale dhe njësitë guerile.

Ato kryen disa aksione midis të cilëve përmendim: grabitjen e zyrave të fashos, grabitjen e magazinave të manufakturës, grabitja e ndërmarrjes italo – shqiptare, marrja e radios nga shtëpia e Kuestorit Koço Mukës, gusht 1942, si dhe prerjen e shtyllave të postë – telegrafës, sulmet mbi PostëKomandat e Krahësit, Libohovës, Kardhiqit, Sinanajt etj. Elementë atdhetarë gjirokastritë punuan edhe në radhët e fashizmit, por, me kurajë i kanë shërbyer lëvizjes antifashiste, midis tyre përmendet Izet Jaho me pseudonimin “Ciroku”, i cili njoftonte Komitetin Qarkor të Partisë Komuniste të Gjirokastrës për çdo lëvizje që kryhej nga kuestura dhe fashizmi në dëm të popullsisë gjirokastrite. Lëvizja antifashiste në qytetin e Gjirokastrës dhe trevat përreth spikati me demonstratën e nxënësve të gjimnazit më 6 marsi 1942. Tashmë, është shkruar në disa varjante zhvillimi i demonstrave antifashiste të organizuara nga nxënësit e gjimnazit, gjatë nëntorit 1942. Por, kjo demonstratë nuk ishte e vetmja formë e lëvizjes antifashiste. Më 6 mars 1942, nxënësit e gjimnazit bënë një piknik në kalanë e Shëntriadhës, mbi Valare. Ata kujtuan atje veprimtarinë e Çetës së

Çerçiz Topullit, i cili kishte ndenjor në atë kala. Mbasditen e asaj dite, kur nxënësit u kthyen në qytet u grumbulluan te sheshi i Çerçizit dhe kënduan këngë patriotike, revolucionare dhe hodhën parrulla antifashiste si: “Poshtë fashizmi”, “Rroftë Shqipëria”, “Duam liri”, “Jashtë okupatori” etj. Këto demonstrime zgjatën nga sheshi i Çerçizit në Qafën e Pazarit e deri te sheshi i Kokonës. Aty nxënës e mësues u ndeshën me forcat e karabinerisë dhe ushtarët fashistë. Pas dymbëdhjetë ditësh, nxënësit e gjimnazit, së bashku me mësuesit e tyre organizuan, më 18 mars 1942 piknikun në Mashkullorë. Atje u organizua një miting politik, në të cilin fjalën e rastit e mbajti, bilbili i Labërisë, Mustafa Matohipi. Përkrah nxënësve në këto lëvizje antifashiste ishin mësuesit: Siri Shaplo, Kadri Baboçi, Aqif Selfo, Zihni Sako etj. Në historinë gjirokastrite të kësaj kohe duhet evidentuar: “Kortezhi në formën e një demonstrate”. Më 13 korrik 1942 në Goricë të Dropullit, në luftë me xhandarë e karabinierë, bie heroikisht Muzo Asqeriu, nga dëshmorët e parë të qarkut të Gjirokastrës. U lajmëruan njerëzit të merrnin pjesë në varrimin e Muzos. Ndjenja e urrejtjes dhe e hakmarrjes gufante në zemrat e çdo patrioti që, atë mbasdite të 20 korrikut, shoqëronin arkivolin e kuq të Muzos. Në kortezh morën pjesë nënat dhe motrat gjirokastrite, labe, libohovite, zagorite, dropullite, lunxhote, rreth 300 “vajtonjëse” dhe Gjirokastra s’kishte parë varrim më madhështor! Herë pas herë, edhe në mes të pazarit, hidheshin parrulla: “Të rrojë Shqipëria e lirë!” Kortezhi po merrte formën e një demonstrate. Karabinierë dhe policë të armatosur shoqëronin popullin, por s’guxonin të thoshnin asnjë fjalë. Shikoje të moshuar, po dhe fare të rinj të vretur, duke ecur me atë çap të matur e duke shtrënguar dhëmbët. Dhe ja ashtu, duke menduar gjithë rrugën për hakmarrje, korteu arriti në varreza. Gjithë populli u grumbullua rreth arkivolit veshur me beze të kuqe. Fashistë, karabinierë, policë, spiunë, rrinin larg. I tmerronte afshi patriotik i asaj mizërie njerëzish.

Nga mesi i turmës del Qemal Karagjozi, i deleguari i Komitetit Qarkor të Partisë dhe i flet popullit për të kaluarën revolucionare të Muzos, për vendosmërinë e tij për t’i shërbyer popullit dhe atdheut, gjersa dha jetën. Ai i bëri thirrje popullit, që në luftë kundër bishës naziste, e cila kishte pushtuar vendin tonë, që po e torturonte dhe po e gjakoste, të ndiqej shembulli i komunistit Muzo Asqeriu. Fashistët në Goricë panë trimërinë e Muzos, po këtu, në varreza, panë vullnetin e një populli të tërë, i vendosur për të ndjekur rrugën e Muzos së tyre, i vendosur për hakmarrje! Ky varrim, i cili u kthye në një demonstratë të vërtetë antifashiste, i tmerrroi fashistët italianë e tradhtarët e vendit. Ata shihnin tani një popull të tërë në shtigjet e luftës së armatosur.

Nxënësit e gjimnazit morën pjesë në demonstratën e Bukës, e cila u organizua, më 19 tetor 1942. Më 28 nëntor 1942, po në gjimnazin e Gjirokastrës, u organizua një demonstratë antifashiste. Disa prej nxënësve që bënë organizimin e kësaj demonstrate ishin: Frirdes Toto, Evanth Duda, Xhemile Shamenti, Safo Deiku, Nurie Çiço. Ndërsa nga mësuesit e gjimnazit përmenden: Siri Shaplo, Kadri

Baboçi, Aqif Selfo etj. Mbajtësja e flamurit ishte Nurie Çiço. Demonstruesit hynë deri në zyrën e prefektit Tahir Kolgjini. Lufta vazhdoi e organizuar me çetat, batalionet dhe brigadat partizane që u ngritën në territorin e prefekturës sonë. Me këtë rast, përmendim: çeta “Çerçiz Topulli”, dhjetor 1942 në Fushëbardhë; çeta “Haredin Tremishti” dhe “Avni Rustemi” gjatë periudhës nëntor – dhjetor 1942; çeta “Koto Hoxhi” në tetor 1942 në Poliçan; çetën “Selam Musai” nëntor 1942 Sinanaj(Lab Koll); “Naim Frashëri”(Verikoll) nëntor 1942 në Krahës; çeta e “Kurveleshit” nëntor 1942; çeta e “Rrëzës” (Atë Gjergj Suli) mars 1943; çeta “Toto Bolena”; çetë “Çamëria” e organizuar nga Lifter Talo më 02. 02. 1943, ku u inkuadruan edhe djemtë e prefekturës sonë. Batalionet “Asim Zeneli” më 7 gusht 1943 në Prongji; “Baba Abaz” më 10 gusht 1943 në Kalivaç; “Themo Vasi” në Poliçan; “Misto Mame” në gusht 1943 në Lunxhëri; “Batalioni i Rinisë”, në nëntor 1943 në Krahës; “Naim Frashëri” në Përmet “Thanas Ziko” tetor 1943 në Dervicjan dhe batalioni territorial i Kardhiqit. Në hapësirën administrative të Prefekturës u krijuan dhe vepruan brigadat: Brigada VI, VIII, XII dhe XIV S. Dy prej tyre në trevën e Gjirokastrës, Brigada VIII Sulmuese më 25. 04. 1944 në Sheper të Zagorisë dhe XIV Sulmuese më 17. 08. 1944 në Zagori, e cila ishte eçliruar. Edhe në Përmet u formuan dy brigada: Brigada VI dhe XII Sulmuese. Hapësira e Prefekturës së Gjirokastrës,

nga pikëpamja e organizimit të luftës së FANÇ, u përfshi në Zonën I Operative, më 4. 08. 1943. Populli i trevave tona përballoi me sukses operacionet armike të Dimrit 1943-1944 dhe të Qershorit 1944 dhe mjetet e progomit (luftës) nga më çnjerëzoret si: Operacioni fashist italian Mallakastër – Memaliaj (Qafë – Miricë) qershor - korrik 1943, Operacioni gjerman i Dimrit 1943 – 1944, Operacionin gjerman i Qershorit 1944, luftat në trevën Këlcyrë - Përmet - Dangëlli, Qafën e Këçokut etj. Historia ka argumentuar me dokumente autentike heroizmin e nënave dhe bijëve të trevave tona si të: Kurveleshit, Zagorisë, Lunxhërisë, Krahësit, Lopsit, Rrëzës, Buzit, Këlcyrës, Përmetit, Dëshnicës, Labërisë, Dangëllisë, Dropullit, Pogonit, Kardhiqit e Libohovës. Në territorin e prefekturës sonë u zhvilluan disa përpjekje të armatosura midis të cilave përmendim: Lufta e Qafës së Miricës, e Mogilave, e Malit të Bardhë, Dukaj – Salari, Shkallës së Zezë, Lufta për çlirimin e Përmetit, Lufta e Mezhgoranit, Lufta për çlirimin e Zagorisë, lufta për çlirimin e Tepelenës, Lufta e Libohovës, lufta e Lunxhërisë, si dhe lufta për çlirimin e qytetit të Gjirokastrës. Në Prefekturën tonë lufta kundër nazi-fashistëve, jemi të ndërgjegjshëm, se ka pasur edhe momente konfliktuale midis forcave politike të kohës, si në: Libohovë, Lazarat, Zhulaj, Grehot e tjerë. Me urdhër të Komandës së Zonës së Parë Operative Vlorë - Gjirokastrë, brigada XIV u ngarkua me çlirimin e qytetit të Gjirokastrës. Luftimet filluan më 10 shtator 1944. Në këto luftime morën pjesë edhe forcat e brigadës XIX Sulmuese, Grupit të Parë operativ. Brenda në qytet, në kala dhe në Grehot qëndronin rreth 450 trupa naziste dhe 250 forca kolaboracioniste, të cilat ishin dislokuar në Gjirokastrë (Grehot, Kala) dhe Jorgucat. Gjithashtu, gjendej një garnizon gjerman edhe në Jorgucat. Prandaj sulmi u përqëndrua si mbi forcat armike, të cilat gjendeshin në Gjirokastrë, ashtu edhe mbi garnizonin gjerman të Jorgucatit, për të mos lejuar koordinimin e veprimeve midis tyre. U zhvilluan gjithsej pesë sulme mbi forcat armike nga data 15 – 18 shtator 1944. Mëngjesi i 18 shtatorit e gjeti qytetin e Gjirokastrës të çliruar. Në memorijen e popullit të prefekturës sonë kanë ngelur edhe disa ngjarje makabre si: Vrasja me bombë e 3 banorëve gjirokastritë dhe plagosja e 10 të tjerëve në sheshin “Çerçiz Topulli”, e cila ishte vepër kriminale e autoriteteve të xhandarmërisë. Sipas dokumentacionit të kohës rezultoi vepër e ushtarit Iljaz Aliu, rekrutuar nga QarkKomandanti Idriz Jazua (U vra më 17 shkurt 1945 për krimet e bëra në Libohovë, Mashkullorë dhe ndaj Bules dhe Persefonit). Fashistët dhe kolaboracionistët si: Idriz Jazua, Veip Runa dhe Ismail Golemi organizuan edhe hedhjen e bombës në sheshin e qytetit të Gjirokastrës, sheshin historik “Çerçiz Topulli”. Treva tepelenase Krahës – Buz përballoi dy sulmet e forcave italiane: më 10 maj 1943 në frontin Levan – Allkomemaj – Rabie dhe më 21 – 26 qershor 1943 në frontin Ballsh - Gjerbës – Allkomemaj – Rabie. Trupat italiane për të kompesuar humbjet dhe për të ngjallur terror në zonë, kryen masakrën e Teqesë së Rabies më 24 qershor 1943. Kjo teqe ishte shndërruar në vatër e organizimit të luftës, ndaj fashistët vranë Baba Abaz Memushin dhe 5 dervishët e teqesë: Dervish Feimin, Dervish Bajam Levanin, Dervish Barjam Bardhaj, Dervish Lamën dhe Dervish Xhaferin. Territori i prefekturës sonë u përfshi edhe në frontin e luftës italo – greke tetor 1940 – prill 1941. Atdhetarët, intelektualët dhe populli ynë ditën të distancohen prej ofensivës fashiste, viktimë e së cilës kishin qenë qysh më 7 prill 1939. Prefektura jonë, dhe veçanërisht Përmeti, ka nderin të jetë vendi, ku u organizua Kongresi i Përmetit, pas së cilit FANAÇL dhe ushtria NAÇL kaluan në ofensivën e përgjithshme. Kujdes të veçantë treguan liderët e luftës për problemin e arsimit. Ende pa përfunduar lufta, u organizuan dy konferenca arsimore në Zagori (Poliçan) korrik 1944 dhe në Lipë të Përmetit 29 gusht 1944.

Prefektura e Gjirokastrës i dha FANÇ 7672 bijë e bija, sipas anketës së bërë, menjëherë, pas luftës në lagjet e qytetit të qytetit të Gjirokastrës. Vetëm nga qyteti i Gjirokastrës dolën në radhët e FANÇ 485 partizanë, prej të cilëve 41 femra. Bijtë e bijat e Prefekturës së Gjirokastrës mbushën radhët e brigadave partizane si: Brigadës së IV, V, VI, VII, VIII, XII, XIV dhe XIX Sulmuese. Prefektura e Gjirokastrës i dha LANÇ 1101 dëshmorë prej të cilëve 90 janë nga qyteti i Gjirokastrës dhe 403 nga fshatrat e Gjirokastrës. Treva e Tepelenës ka 419 dëshmorë, ndërsa treva e Përmetit 189 dëshmorë. Por, me vendim nr. 4558 të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Gjirokastrës, u shpallën më 02. 10.

1971 252 dëshmorë. Minoriteti grek (Dropull – Pogon) i dha luftës gjithsej 58 dëshmorë, Pogoni 8 dhe Dropulli 50. Prefektura ka 18 heronj, midis tyre pesë janë vajza. Gjirokastra ka 10 heronj, Tepelena 6 dhe Përmeti 2. Me vendim të Presidiumit të Kuvendit Popullor, 85 bijë e bija të rënë në vitet e LANÇ 1939 – 1944, janë dekoruar me titullin e lartë: “Heroi i Popullit”. Prej tyre 13 janë heroina të LANÇ. Në kurorën me xhevaire të heroinave të luftës qëndrojnë edhe 5 vajzat e Prefekturës së Gjirokastrës: Bule Ustref Naipi (1924 – 1944), Fato Sako Berberi (1927 – 1944), Inajete Jusuf Dumi (1924 – 1944)¹, Nimete Isuf Progonati (1929 -1944) dhe Ylibere Emin Bylibashi (1928- 1944). Okupatorët kanë shfrytëzuar në interesin e tyre qëndrimin e “gjoja” klasës “elitare”, por në realitet tmerrsisht tradhtarë. . . Tradhtia dhe përftesa e ka shndërruar këtë klasë në vegël okupatore të popullit dhe vendit të vet. . . Veprimtaria bashkëpunuese e saj është një njollë e zezë, në dëm vendit dhe të Kombit. Kjo Luftë edhe në Prefekturën tonë tonë realizoi daljen në pah të aftësive organizuese, drejtuese dhe komanduese të shumë kuadrove, ku shumica prej tyre u “poqën direkt në këtë Luftë. U krijua një armatë e madhe kuadrosh edhe në Prefekturën tonë që u shquan. Një rol të rëndësishëm në organizimin e luftës në prefekturën tonë kanë luajtur: Medin Axhemi, Asim Zeneli, Abaz Shehu, Zenel Shehu, Muzafer Asqeri, Fato Berberi, Bule Naipi, Misto Mame, Vito Kondi, Asaf Dragoti, Qebir Aliu, Bexhet Mema, Nexhip Sinoimeri, Mustafa Matohiti, Shefqet Peçi, Alqi Kondi, Themo Vasi, Thanas Ziko, Mihal Duri, Memo Meto, Bedri Spahiu, Haki Toska, Mustafa Asllani, Adil Çarçani, At Gjergj Suli, Ali Lalaj, Ago Çeli, Asim Shehu, Mehmet Shehu, Gjon Banushi, Idriz Seiti, Haki Toska, Adil Çarçani, Parashqevi Llukani, Mustafa Asllani, Peço Kagjini, Telo Mezini, Memo Nexhipi, Muhamet Gjollësja, Misto Mame, Muzafer Asqeri, Meleq Gostinishti, Skënder Çaçi. Klerikët Baba Abaz Memushaj, Baba FejzoTherepeli(Dervishi), Sheh Muharem Toçi, Sheh Sulo Levani, Sheh Ali Hormova Atë Gjergj Suli, Xheladin Beqiri. Populli i Prefekturës sonë u është mirënjohës përjetë Heroinës himariote Persefoni Kokëdhima dhe kosovarit Xheladinë Beqiri, të cilët punuan dhe luftuan në këtë prefekturë.

Ne në këtë konferencë duam të rishprehim edhe një herë me forcë: Të marrësh përsipër të shkruash historinë, do të thotë të jesh i saktë, i matur, i ditur dhe të zbatosh kryekriterin bazë të njohjes realitetin e ndodhur. Kolona e librave historike, të cilët bazohen në dokumente reale, kanë një vlerë të veçantë, e cila shpjegon dhe nxjerr në pah dëshmi, të cilat, deri më tashmë, kanë qenë të kyçura dhe dritëzon një periudhë për të cilën ka materiale shkrimore okulare të pakta shpjeguese dhe ndriçuese. Pjesëmarrja e popullit tonë në Luftën Antifashiste Nacionaçlirimtare, është analizuar me nota shumë pozitive nga politikanë të shquar, ushtarakë të mëdhenj dhe shumë studiues, të cilët shprehin konsideratat për rolin dhe kontributin që dhamë në këtë Luftë. Po ndalem vetëm në dy ilustrime:

Senatori amerikan Elbert D. Thomas, i cili vlerëson luftën e shqiptarëve (FANÇ), ku, midis të tjerash, thekson: “Miq të amerikanë të Shqipërisë janë shumë të lumtur që sot mund t’i tregojnë botës se çfarë kanë bërë patriotët shqiptarë për të fituar lirinë e tyre. Ne e admirojmë këtë popull të fortë dhe kreshnik për qëndresën shembullore, që bëri kundër armikut të përbashkët për pesë vjet me radhë”. (Gazeta “Mundimi”, botuar nga aleatët Anglo- Amerikanë, Bari, Itali, nr. 38, datë 23. 12. 1944). Rexhinald Hibbert, oficer i shërbimit të fshehtë informativ anglez gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe ambasador i Britanisë së Madhe në Francë (1982 doli në pension), ka shkruar librin “ Fitoreja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë”, në të cilën përmenden me detaje Misionet britanike në Shqipëri(madje dhe në Prefekturën tonë) një libër mbi bazën dokumentare të arkivave ushtarake e të jashtme të Anglisë dhe të ditareve e të përvojës së autorit në Shqipërinë e kohës së Luftës, jep përgjigje të reja për shumë pyetje të vjetra. Ky libër hyn në fondin e qëndrueshëm të burimeve të historiografisë shqiptare. Shprehja e tij kapitale: ”Për punët e kësaj bote, Shqipëria do të mbetet universiteti im”.

Është koha, kur në botë po forcohet ideja dhe përpjekja për një paqe universale, kjo për të mirën e gjithë njerëzimit, ndaj dhe ne, në këtë konferencë kombëtare, japim mesazhin e madh të paqes, në

këtë në këtë 75-vjetor të çlirimit të Atdheut tonë të dashur. Edhe politika shqiptare këtë synon në marrëdhëniet me fqinjët dhe më gjerë. Kjo për arsyen e fortë të ndalimit të nxitjeve të Luftrave, ekspansioneve, të cilat kanë tronditur dy herë fuqimisht botën. Këtu duhet të kihet parasysh thënia e John F. Kennedy: “Njerëzimi duhet t’i vëjë fund luftës, para se lufta t’i vëjë fund njerëzimit”. Si përfundim doja të citoja një fragment të një analize shkencore të Akademik Kristo Frashërit, në konferencën e Akademisë së Shkencave, datë 27. 11. 2014, me objekt: “Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare e parë pas 70 vjetësh”: “Lufta Nacionalçlirimtare e parë në thellësinë e veprimeve të saj, por edhe një revolucion demokratik.” Një analizë e tillë shkencore hedh dritë dhe në këtë konferencë kombëtare.

Ne, në këtë 75 vjetor të çlirimit të atdheut, përulemi me nderim përpara mundit, djersës, sakrificës gjakut të bijve dhe bijave të prefekturës sonë dhe gjithë Shqipërisë. Përulemi përpara atyre, të cilët e rreshtuan Shqipërinë në anën e triumfatorëve; e rreshtuan luftën e popullit tonë me Aleatët e Mëdhenj: Britaninë e Madhe, Bashkimin Sovjetik dhe SHBA-të. Lufta dhe vepra e protagonistëve të saj janë përherë simbol i heroizmit dhe krenarisë së popullit tonë. Heroizmin e kësaj lufte titanike ne duhet ta përcjellim në brezat që vijnë, pasi kjo është një traditë e admirueshme, një përvojë historike krenuese. Ndaj, është e nevojshme që, gjithmonë ta mbajnë të ndezur këtë “pishtar-flakandan” të heroizmit popullor. Lavdi Dëshmorëve dhe Heronjve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare!

02.12.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për Takimin e Jashtëzakonshëm të Komisionit të Mbrojtjes Civile në nivel qarku

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Mbrojtjes Civile,

Të nderuar të ftuar,

Organizojmë këtë takim të jashtëzakonshëm të Komisionit të Mbrojtjes Civile lidhur me situatën aktuale që po përjeton vendi ynë pas lëkundjeve të fuqishme të ditës së martë, të datës 26 nëntor. Qarqet më të prekura nga dëmtimet e shkaktuara nga tërmeti janë qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, me pasojë marrjen e 51 jetëve dhe me mijëra të pastrehë nga dëmtimet e objekteve ndërtimore.

Në nderim të viktimave të tërmetit ju ftoj të mbajmë 1 minutë heshtje!

Së pari, dua të falenderoj të gjitha ekipet e MZSH të bashkive të qarkut tonë, të cilët morën pjesë në operacionet e kërkim shpëtimit duke treguar përkushtim dhe profesionalizmin të lartë në shpëtimin e jetëve njerëzore. Gjithashtu pas thirrjes së bërë nga qeveria shqiptare, institucionet shtetërore e vendore, individët dhe bizneset u solidarizuan duke kontribuar me ndihma materiale dhe monetare në mbështetje të banorëve të dëmtuar nga tërmeti.

Së dyti, falenderojmë njësitë akomoduese dhe familjarët e qarkut Gjirokastrë të cilët kanë pritur dhe strehuar banorët e ardhur nga zonat e dëmtuara gjatë këtyre ditëve.

Që prej ditës së rënies së tërmetit, Prefekti i qarkut ka qene prezent në zonat e dëmtuara në qarkun e Durrësit për të asistuar dhe për të dhënë ndihmën e nevojshme pranë Prefektit të qarkut Durrës në mbështetje të organizimit të punës dhe marrjes së masave urgjente.

Pas vendimit Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, institucioni i Prefektit të qarkut ka marrë të gjitha masat për ti ardhur në ndihmë të

gjithë banorëve të dëmtuar nga tërmeti të cilët kanë zgjedhur qarkun tonë për tu akomoduar. Në ditët në vijim, Prefekti i qarkut mori pjesë në mbledhjen e Komisionit Vendor të Mbrojtjes Civile të Bashkive Përmet dhe Këlcyrë, ku u njoh nga afër me punën e bërë dhe masat e marra lidhur me pritjen dhe akomodimin e qytetarëve të ardhur nga këto zona.

Gjithashtu në ambientet e institucionit, Prefekti i qarkut me një pjesë të stafit të tij, ka ndjekur në vazhdimësi situatën dhe problematikat që lidhen me akomodimin e banorëve të ardhur, duke siguruar të dhëna të sakta për numrin e personave të akomoduar në njësitë administrative të qarkut tonë, evidentimin e nevojave të personave të dëmtuar dhe mbështetjen e tyre në vazhdimësi.

Gjatë këtyre ditëve është dërguar informacion i vazhdueshëm nga ana jonë pranë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile lidhur me masat e marra për pritjen dhe akomodimin e banorëve të ardhur dhe plotësimin e të gjitha nevojave të tyre jetike. Po ashtu, lidhur me këtë situatë është informuar edhe opinioni i gjerë qytetar nëpërmjet medias së shkruar dhe asaj vizive.

Ju ftoj që nëpërmjet fjalës tuaj të na informoni mbi masat konkrete që janë marrë lidhur me përballimin e kësaj situatë emergjente në qarkun tonë.

Në vijim të detyrave të dhëna nga Kryeministri, në mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave, si Kryetar i Komisionit të Mbrojtjes Civile për qarkun rekomandoj si më poshtë:

1. Kryetarët e bashkive të ngrenë grupet e punës me specialistë për evidentimin e ndërtimeve me risk dhe ndërtimeve që kanë shtesa pa leje dhe të informoj institucionin e Prefektit të qarkut brenda datës 25 dhjetor.
2. Kryetarët e bashkive në rolin e kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes Civile në bashki të marrin masa të menjëhershme për forcimin e strukturave të mbrojtjes civile dhe MZSH dhe pajisjen e tyre me bazë materiale të nevojshme për përballimin e situatave të ngjashme.
3. Nga ana e bashkive të merren masa për krijimin e rezervave materiale dhe ushqimore për rastet e fatkeqësive natyrore (çadra, veshmbathje, krevat, dyshekë, batanije dhe ushqime).
4. Nga ana e bashkive dhe degëve territoriale të bëhet listimi i personave specialistë të fushave të ndryshme të gatshëm për të dhënë kontributin e tyre si vullnetar në zonat e dëmtuara.
5. Thirrje gjithë bizneseve të qarkut që brenda mundësive të tyre të kontribuojnë në mbështetje të të dëmtuarëve.

Çështja 2: Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente gjatë periudhës së dimrit.

Institucioni i Prefektit të Qarkut në zbatim të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, të ligjit nr. 45/ 2019 “Për Mbrojtjen Civile”, në vazhdimësi do të ushtrojë të gjitha kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore për organizimin, koordinimin dhe bashkëpunimin e të gjithë aktorëve dhe faktorëve që kanë përgjegjësi ligjore për marrjen e masave të domosdoshme për përballimin e situatave emergjente të stinës së dimrit, në të gjithë teritorin e qarkut.

Menaxhimi i situatave emergjente kërkon organizim dhe menaxhim të burimeve dhe përgjegjësi për trajtimin e të gjitha aspekteve të emergjencave, në veçanti gatishmërisë, përgjigjes dhe hapave fillestarë të rimëkëmbjes.

Periudhat e pritshme me shira dhe temperature të ulëta, kërkojnë planifikim të detajuar masash organizative – teknike, rritjen e aftësive drejtuese; reagim të menjëhershëm; bashkëpunim dhe bashkërendim të veprimeve të institucioneve dhe strukturave të qarkut, për përballimin e situatave të mundëshme të shkaktuara nga të gjitha llojet e fatkeqësive, duke pasur si prioritet situatat emergjente të shkaktuara nga shirat, ngricat dhe dëbora.

Për monitorimin dhe menaxhimin e situatave të krijuara nga veprimet e faktorëve natyror dhe njerëzor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet shtetërore dhe degët territoriale tashmë kanë përvojë të konsiderueshme.

Prioritet për stinën, është risku që krijohet për shkak të shirave. Strukturat përgjegjëse, shërbimet e MZSH-ve pranë bashkive, drejtoritë e shërbimit pyjor dhe njësitë administrative, të kenë të përgatitura planet e veprimit dhe të bashkërendimit të detyrave, për menaxhimin e situatave emergjente.

Duke e konsideruar domosdoshmëri përsheptimin e masave tekniko - organizative të strukturave monitoruese dhe vepruese, për parandalimin, shmangien dhe minimizimin e dëmeve nga situatat e mundëshme emergjente të stinës së dimrit, kërkoj nga të gjithë aktorët dhe faktorët, që kanë rol dhe përgjegjësi në përballimin e situatave të mundëshme emergjente, të vënë në efikasitet të plotë të gjitha mjetet dhe strukturat që disponojnë, për parandalimin, mbrojtjen dhe përballimin e EC të mundëshme në të gjithë territorin e qarkut Gjirokastrë.

REKOMANDIME

Si Kryetar i Komisionit të Mbrojtjes Civile në rang qarku ju rekomandoj:

- Të merrni masat e duhura për përballimin e situatave emergjente civile të të gjitha natyrave, me qëllim mbrojtjen e jetës njerëzore, pronës, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit.
- Të riorganizoni punën bazuar në eksperiencën e akumuluar dhe të planifikoni përballimin e situatave emergjente që mund të ndodhin;
- Të rishikoni planet e bashkëpunimit dhe të përgatisni skenarë të mundshëm veprimi në përshtatje me kushtet konkrete të çdo bashkie e institucioni, për të gjitha fazat: parandalim, pakësim dhe riaftësimin.
- Të vlerësoni dhe rishikoni të gjitha masat për t'u paraprirë situatave emergjente civile, me prioritet parandalimin dhe përballimin me sukses të emergjencave të mundshme, me kosto sa më të ulët.
- Të identifikohen rreziqet e mundshme në nivel njësie të vetëqeverisjes vendore dhe të merren masat e duhura mbrojtëse për shmangien e pasojave të mundshme.
- Të intensifikohen masat për pastrimin e kanaleve, tombinove, përforcimin e argjinaturave.
- Sigurimin e sasisë së domosdoshme të kripës dhe skorieve.
- Të punohet për ndërgjegjësimin e blegtorëve për sigurimin e rezervave ushqimore për bagëtitë.
- Strukturat monitoruese pranë bashkive, në raste të emergjencave civile të jenë të përgatitura të funksionojnë NON STOP, dhe të raportojnë pranë sektorit të emergjencave civile në institucionit e Prefektit të qarkut Gjirokastrë.

05.12.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin në kuadër të Mbledhjes së parë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje në bashkinë Dropull (MKR).

I nderuar Kryetar i Bashkisë Dropull z. Dhimitraq Toli,

Të nderuar anëtarë të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit,

Më vjen mirë që bashkia Dropull, megjithëse një bashki e re, dita ditës po ndërmerr hapa të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të sigurisë dhe stabilitetit të jetës së qytetarëve të saj. Formalizimi i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje në bashkinë Dropull vjen si domosdoshmëri, si pikë kryesore mbështetje dhe mirëbesimi për qytetarët që hasen me fenomenin e dhunës në përditshmërinë e tyre.

Dhuna në të gjitha format e saj është një shkelje e hapur e të drejtave të njeriut dhe një problem global i shëndetit publik me përmasa epidemike. Dhuna brenda familjes e shfaqur në forma të ndryshme si fizike, seksuale, psikologjike dhe ekonomike shkatëron shëndetin mendor dhe fizik të të dhunuarve duke ndikuar negativisht në sigurinë dhe paqen e tyre afatgjatë.

Në Shqipëri, fenomeni i dhunës në familje vazhdon të jetë një plagë e madhe dhe tepër e ndjeshme. Shqiptarët priren ta konsiderojnë dhunën në familje si një çështje private, familjare, dhe si një pjesë normale të jetës bashkëshortore e familjare. Duke qenë se dhuna në familje shpesh ndodh pas dyerve të mbyllura dhe nuk diskutohet, pranohet apo trajtohet hapur në shoqërinë shqiptare, viktimat përgjithësisht vuajnë në heshtje.

Është e rëndësishme që të monitorohet përhapja e dhunës në familje dhe të reagohet drejtpërdrejt, jo vetëm nëpërmjet hartimit të politikave, por nëpërmjet marrjes së masave konkrete për zbatimin e tyre. Ngritja e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje, në bashkinë Dropull, është një domosdoshmëri dhe mirëfunksionimi i saj varet nga gjithësecili prej nesh. Rritja e efektivitetit të funksionimit dhe ofrimi i shërbimeve shumë-sektoriale, që qëndrojnë në fakt në themel të Mekanizmit të Koordinuar të Referimit, varet nga koordinimi dhe bashkërendimi i veprimeve të të gjitha institucioneve publike dhe organizatave jo-qeveritare jo-fitimprurëse, që do të koordinojnë punën brenda juridiksionit territorial të Bashkisë së Dropullit.

Parandalimi, mbrojtja, mbështetja dhe rehabilitimi i viktimave të dhunës në familje duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave, fëmijëve, të moshuarve(ave) dhe personave me aftësi të kufizuara duhet të shihet me prioritet nga secili anëtarë i këtij mekanizmi. Shkëmbimi i rregullt e periodik i informacionit, hartimi i procedurave standarde të veprimit, ndërveprimi shumë-sektorial, shtimi dhe përmirësimi i shërbimeve për mbrojtjen e viktimave, por edhe përmirësimi i vazhdueshëm i MKR-së, do të sjellë rezultate pozitive dhe efektivitet.

Një familje e lumtur, në mirëqënie dhe paqe brenda saj, ka vlera të jashtëzakonshme për zhvillimin e shoqërisë. Duke pasur në konsideratë, sa të rëndësishme janë jeta dhe shëndeti për çdo anëtar të familjes, vlerësoj së tepërmi punën e bërë nga ju me qëllim uljen e rrezikshmërisë që paraqesin individët dhunues në familje dhe marrjen në mbrojtje të viktimave.

Si pjesë e Komitetit Drejtues të këtij mekanizmi shpreh gatishtësinë time për të ndërmjetësuar për adresimin e nevojave të paraqitura nga antarët e MKR-së, si dhe për të

bashkëpunuar për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta në bazë të nevojave të identifikuar.

06.12.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin lidhur me situatën e ndërtimeve në qarkun e Gjirokastrës (marrin pjesë specialistë si: inxhinierë, arkitektë, gjeolog, MZSH, ISHMPUT, konstruktorë, kualikatorë, supervizorë, përfaqësues të institucioneve vendore).

I nderuar Kryetar,

Të nderuar pjesëmarrës,

Organizojmë këtë takim, në bashkëpunim me bashkinë Gjirokastrë, lidhur me situatën aktuale që po përjeton vendi ynë pas lëkundjeve të fuqishme të ditës së martë, të datës 26 nëntor. Qarqet më të prekura nga dëmtimet e shkaktuara nga tërmeti janë qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, me pasojë marrjen e 51 jetëve dhe me mijëra të pastrehë nga dëmtimet e objekteve ndërtimore.

Lidhur me situatën e krijuar, Qeveria Shqiptare me Vendimin nr.750 dt 27.11.2019 të Këshillit të Ministrave, ka shpallur gjendjen se fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, i ndryshuar si dhe ka marrë masa të menjëhershme për strehimin dhe sistemimin e banorëve të dëmtuar nga kjo fatkeqësi natyrore.

Në mbështetje të Vendimit të Qeverisë, institucioni i Prefektit të qarkut, ka zhvilluar më datë 2 dhejtor 2019 takimin e jashtëzakonshëm të Komisionit të Emergjencave Civile në nivel qarku, lidhur me situatën e krijuar pas tërmetit dhe masat e marra për pritjen dhe akomodimin e qytetarëve të ardhur nga zonat e dëmtuara.

Lëkundjet e fuqishme të tërmetit edhe pse nuk kanë shkaktuar dëme në qarkun tonë, kanë prekur shpirtërisht dhe solidarizuar të gjithë banorët e qarkut të Gjirokastrës, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre me ndihma materiale dhe financiare.

Në përfundim të këtij takimi Prefekti i qarkut si Kryetar i Komisionit të Mbrojtjes Civile për qarkun ka dhënë rekomendimet si më poshtë:

Në njësitë e vetëqeverisjes vendore të ngrihen grupet e punët me inxhinierë të fushave të ndryshme të cilët do kontrollojnë dhe verifikojnë:

- Zonat më të rrezikshme dhe me risk të qytetit të Gjirokastrës.
- Shtëpitë e ndërtuara prej shumë vitesh lidhur me gjendjen fizike aktuale të tyre.
- Parametrat dhe cilësinë e ndërtimeve të reja bazuar në lejen e ndërtimit dhe projektin e miratuar.
- Evidentimin e ndërtimeve pa leje, shtesave anësorë dhe shtesave të kateve në godinat e ndërtuara.

Për sa më sipër do të kërkoja nga ana juaj një vetëdeklarim lidhur me zbatimin e projektit dhe cilësinë e ndërtimeve të kryera, zbatimin e kushteve teknike të ndërtimit në realizimin e këtyre objekteve si dhe respektimin e praktikës dokumentare për kolaudimin dhe marrjen në përdorim të objektit.

Gjithashtu për ndërtimet të cilat janë të përfunduara dhe të shitura, prej disa vitesh nuk ka përfunduar praktika dokumentare e hipotekimit, për arsyen se nuk është zbatuar projekti i miratuar duke shtuar numrin e kateve në lartësi ose shtesa anësore. Kërkojmë nga ana juaj garantimin e qëndrueshmërisë së objektit dhe zgjidhjen për mbylljen e procedurës së hipotekimit.

Do të doja të dija si e ka lozur rolin bashkia, nëpërmjet Drejtorive të saj si ajo e Urbanistikës, Ujësjellës kanalizimeve, MZSH në realizimin e infrastrukturës urbane dhe respektimin e parametrave për urbanizimin e zonës, duke përfshirë këtu furnizimin me energji elektrike, furnizimin me ujë dhe kanalizimin e ujërave të zeza e të bardha.

Së fundi, dua të di si ka zbatuar detyrat zyra ALUIZMI dhe ajo e hipotekës sot Agjencia Shtetërore e Kadastrës lidhur me hipotekimin e ndërtesave.

18.12.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin me sekretarët e këshillave bashkiakë dhe specialistë të njësive të vetëqeverisjes vendore

Të nderuar pjesëmarrës,

Institucioni i Prefektit të qarkut ka organizuar sot këtë takim me sekretarët e këshillave bashkiakë dhe specialistë të njësive të vetëqeverisjes vendore me qëllim përmirësimin e punës në lidhje me procedurën e verifikimit të akteve të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në zbatim të ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut” Prefekti bën verifikimin e ligjshmërisë së akteve sipas procedurës së parashikuar në ligj. Gjatë këtij procesi, kemi konstatuar problematika të ndryshme në lidhje me aktet që ju paraqisni, prandaj e menduam të nevojshme organizimin e këtij takimi ku të diskutojmë mbi problematikat si dhe vendosjen e njëjloj standarti në mënyrën ligjore që duhet të kenë aktet që paraqiten te Prefekti.

Aktet që prodhohen nga organet e njësive të vetëqeverisjes vendore janë shumë të rëndësishme pasi lidhen me ushtrimin e funksioneve të njësisë vendore si dhe trajtimin e problematikave që lidhen direkt me qytetarët, por njëkohësisht ato janë “fytyra” e institucionit dhe si të tilla duhet të jenë në përputhje me ligjin si nga ana formale ashtu edhe nga përmbajtja.

Problematikat e hasura në punën e deritanishme kanë qënë të natyrave të ndryshme, që kanë patur të bëjnë me formën dhe përmbajtjen e aktit si psh:

Ana formale e aktit nuk është sipas formës së kërkuar (mungon logo, behen korrigjime me stilolaps, mungojnë elemntet e aktit) etj.

Baza ligjore e akteve shpesh është e paplotë.

Mungon ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe aktet ligjore e nën ligjore të tjera në të cilat bazohet vendimmarrja.

Aktet ligjore e nënligjore në bazën ligjore shkruhen të paplota, të pasakta, të shfuqizuara.

Dispozitivi i vendimit është i paqartë.

Vendimi merret në kundërshtim me kuadrin ligjor që lidhet më objektin e tij.

Titulli i vendimit nuk përputhet me përmbajtjen e tij.

Tërheq vëmendjen tuaj në lidhje me përmirësimin e këtyre problematikave dhe kërkoj të zbatohet me rigorozitet shkresa udhëzuese e Prefektit nr.2741 prot, datë 28.12.2018 “Udhëzim mbi paraqitjen e akteve normative të organeve të njësisë të vetëqeverisjes vendore për verifikim të ligjshmërisë pranë Prefektit të qarkut Gjirokastrë”.

Ju ftojme të diskutojmë sot me të gjithë specialistët e institucionit të Prefektit të pranishëm në këtë takim ku ju ftoj të jeni aktiv dhe të ezaurojmë problemet që ju hasni për ditë në punën tuaj duke siguruar bazueshmërinë ligjore të akteve dhe punës tuaj në vazhdimësi.

19.12.2019

Fjala përshëndetëse e Prefektit për takimin e Komisionit Qeveritar të Tokës

I nderuar Z. Zëvendës Kryeministër, Erion Braçe

Të nderuar Prefekt,

I nderuar drejtor i Sekretariatit Teknik të Tokës.

Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë, ka rifilluar aktivitetin e tij për këtë vit në datën 02.04.2019 me hyrjen në fuqi të Ligjit 10/2019, i cili e shtyu afatin e veprimtarisë deri më 31.12.2019.

Gjatë këtij viti u vu re një rritje e numrit të kërkesave për verifikim AMTP-je, kërkesa këto të ardhura nga individ ose nga institucione shtetërore.

Për vitin 2019 pranë Komisionit Vendor të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë Gjirokastrë janë administruar 40 kërkesa të reja deri në këto momente.

Janë zhvilluar 58 seanca gjyqësore.

Komisioni Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë përgjatë veprimtarisë së tij ka konstatuar këto probleme:

Problemet Teknike:

- 1- Gabime në Emër Atësi Mbiemër
- 2- Mospërputhje të sipërfaqes së tokës
 - a- Me AMTP
 - b- Me faktin në terren
 - c- Me azhornimin
- 3- Gabime në zërin kadastral
- 4- Gabime në numrin kadastral
- 5- Gabime në ndarjen në hartën 1:5000
 - a- Gabime në renditje
 - b- Gabime në orientim (veri-jug)

Problemet Ligjore

1- Ligji numër 7501 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar dhe gjithë aktet nënligjore në zbatim të tij kanë anët negative dhe pozitive të tyre.

a- Anë pozitive:

Bëri pronarë 450000 familje Shqiptare

b- Anët negative:

Nuk zgjidhi problemin e ish-pronarëve

Shpërndanë në pronësi tokat e ish-NB

- Parcelizoi në ngastra të vogla tokën bujqësore, duke prishur gjithë planimetrinë e tyre (ndarja e tokës nga 2-12 ngastra)

Regjistrimi fillestar

- Shkaktoj më shumë probleme duke u anuar më shumë nga fiktiviteti .

- U ndryshuan hartat kadastrale.

- U ndryshuan numrat kadastral.

- U ngatërruan emrat e pronarëve legjitim.

- U ndryshuan kufitarët e pronës.

Zgjidhje

Për përgatitjen e dokumentacionit për çertifikim :

a- Për çdo njësi administrative të formohet një grup pune me:

- Topograf

- Agronom

- Jurist

Në krye administratori i njësisë: për çdo fshat –kryetari i fshatit

- Të përgatitet dokumentacioni për çdo parcelë duke e zgjidhur përfundimisht:

- Sipërfaqen e tokës për çdo fermer

- Kufijtë e pronës (kufitarët)

- Rrugët brenda parcelës (infrastruktura)

- Kanalet ujitës dhe kullues (pronë e përbashkët)

- Planvendosje për çdo pasuri

- Pasqyrimi në hartë dhe regjistër i ndryshimeve të bëra në vite (transaksione, ndërtime) etj.

Grupi i specialistëve do të jetë në çdo fshat të njësisë administrative dhe për çdo fshat pjesë e grupit të punës do të jetë administratori i Njësisë Administrative ose kryeplaku i fshatit, si njohës i problematikave në fshatin e tij .

- Grupi i punës në terren do të ketë të përcaktuar edhe normën ditore të azhornimit .

Ky grup do të evidentojë dhe ndërrimet apo transaksionet që janë bërë në terren dhe kur nuk ka probleme me të tretët të përgatisë dokumentacionin për regjistrim kur nuk tejkalohet norma për frymë.

Regjistrimi të bëhet për të gjithë antarët e familjes bujqësore .

Madhësia e pronës për regjistrim mos të jetë më e vogël se norma për frymë.

Baza e të dhënave:

- DAMT në këshillat e qarqeve

Bashkitë (njësitë administrative)

ASHK (ZVRPP) me këto të dhëna :

- a- Lista e Gjendjes Civile 1 gusht 1991 për punonjësit e ish-kooperativave bujqësore, dhe 1 tetor 1992 për ish- NB
- b- Formulari NR.6 (Dokumenti bazë sipas të cilit janë plotësuar AMTP)
- c- Zbërthimi i ngastrave
- d- Ndarja në hartë 1:5000

Gjithashtu në ASHK ndodhet i gjithë dokumentacioni i regjistrimit fillestar dhe gjithë veprimtaria e kësaj zyre në vite.

Përpara se të shkohet në terren të jenë përpunuar paraprakisht të dhënat për çdo familje bujqësore dhe për çdo parcel.

Ky dokumentacion përgatitet nga grupi i punës në varësi të pushtetit vendor (bashkia) miratohet në këshillin bashkiak apo komisionin e tokës në bashki dhe dërgohet për regjistrim në ASHK

Problemet që dalin

Ky komision zgjidh gjithë gabimet e bëra me ose pa dashje nga komisionet e ndarjes së tokës sipas VKm nr 230 dt 22.07.1991 “Për krijimin e komisioneve të tokave” Në rastin e Emër Atësi Mbiemër të merret për bazë regjistrimi në gjëndjen civile 1 gusht 1991 dhe tetor 1992.

Të bëhet llogaritja e sipërfaqes së tokës së dhënë në bazë të normës për frymë duke pasur parasysh edhe të dhënat e bonitetit të tokës bujqësore.

Në rastet kur sipërfaqja e dhënë nga komisioni i tokës del mbi normën atëherë duhet të veprohet:

- a- Duke ja ofruar tokën atij që e administron me çmim sipas hartës së vlerës së tokës .
- b- Duke ja dhënë më qera në përdorim duke e evidentuar në një kolonë të veçantë në çertifikatën e pronësisë kjo për efekt të taksës së tokës.
- c- Kur ka mospërputhje të merret parasysh vetëm fakti në terren duke bërë korrigjimet përkatëse.

- d- Në rastet kur ka probleme të cilat nuk mund të zgjidhen nga ky komision palët mund të dërgohen në gjykatë .

Përfundimi

KM të nxjerrë një VKM ‘‘Për përgatitjen e dokumentacionit për regjistrim’’ analoge me VKM 230 dt 22.07.1991 ku të përcaktohen detyrat e komisioneve në nivel Fshati, Njësie Administrative, Bashkia dhe KQT.

Proçesi i paisjes së fermerëve më AMTP të quhet i përfunduar .

Dokumentacioni i përgatitur ti dërgohet ASHK për regjistrim.

Ky komision do të evidentojë dhe sipërfaqen e tokës jo bujqësore të tjetërsuar duke bërë përfundimisht ndryshimin e zërave kadastrale dhe hartografike të vitit 1991 .

Gjithë sipërfaqja e tokës në zërat kadastrale: PF, Livadhe, Kullotë, Pyje etj, janë zaptuar nga individë të ndryshëm duke u mbjellë me pemë, agrume e sidomos me ullinj.

Shumë sipërfaqe të tokës bujqësore janë zënë me ndërtime me ose pa leje.

Ky komision do të bëjë një sistem të ri të të dhënave të fondit të tokës në nivel lokal dhe kombëtar. Vetëm në këtë mënyrë ne bëjmë realitet një premtim të qeverisë shqiptare dhe Kryeministrit të vendit:

Do ti japim në dorë çertifikatën e pronësisë mbi tokën bujqësore fermerit Shqiptar.

Realizojmë brenda këtij mandati qeverisës paisjen e mbi 80% të familjeve bujqësore me çertifikatë pronësie.

